



# *Një botë për t'u zbuluar*



**Save the Children**  
në Shqipëri



# ***Një botë për t'u zbuluar***

**Udhëzues praktik**  
*për mësuesit e arsimit parashkollor  
që punojnë me fëmijët e moshës 4-5 vjeçare*

## **Autorë:**

**Prof. Dr. Erleta MATO**, Instituti për Zhvillimin e Arsimit

**Prof. Asc. Dr. Pranvera KAMANI**, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës

**Msc. Edlira SINA**, Instituti për Zhvillimin e Arsimit

**Msc. Marina NDRIO**, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale

Redaktor shkencor: Prof. Dr. Erleta MATO

Redaktor letrar: Olta Çakçiri

Koordinator projekti: Msc. Rodika Goci, Save the Children në Shqipëri

© 2010 Save the Children në Shqipëri

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej mësuesve dhe specialistëve të arsimit për qëllime mësimore, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e Save the Children në Shqipëri si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi, jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children në Shqipëri.

## **Të dashur mësues,**

Libri që po merrni në duar është një material ndihmës për punën tuaj të përditshme me fëmijët 4-5 vjeçarë. Ky material është rezultat i punës së mjaft ekspertëve dhe mësuesve që dëshirojnë ndryshimin në mësimdhënie dhe nxënie si dhe ecurinë më të mirë të fëmijëve dhe grupit me të cilin ndërveprojnë për të rritur cilësinë e veprimit edukativ dhe mësimor.

Falënderojmë të gjithë ata që lehtësuan dhe kontribuan në përmirësimin e manualit gjatë procesit të hartimit të tij. Në mënyrë të veçantë përmendim organizatën SAVE THE CHILDREN në Shqipëri si dhe zonjën Rodika Goci, anëtare e stafit të kësaj organizate, që mundësuan hartimin e këtij materiali me nxitjen, lehtësimin dhe rekomandimet e tyre profesionale.

Grupi i autorëve dëshiron që, gjatë përvojës që do të keni përgjatë vitit shkollor, të mbani shënime dhe të jepni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja konkrete për gjithçka që mendoni se mund të përmirësohet në këtë botim. Duke ju falënderuar paraprakisht, ju urojmë punë të mbarë dhe zhvillime të mëtejshme cilësore në arsimin parashkollor në vendin tonë.

**Autorët**



# PËRMBAJTJA E LIBRIT

<b>HYRJE</b> .....	<b>7</b>
--------------------	----------

## **PJESA I.**

1. PARIMET E UDHËZUESIT .....	9
2. FUSHAT E TË MËSUARIT: .....	17
2.1. Fusha gjuhësore-komunikuese .....	17
2.2. Fusha e matematikës .....	26
2.3. Fusha e shkencës dhe e vëzhgimit .....	40
2.4. Fusha sociale dhe emocionale .....	56
2.5. Fusha e zhvillimit fizik dhe shëndeti .....	70

## **PJESA II.**

PLANIFIKIMI JAVOR, MUJOR DHE VJETOR .....	81
---	----

## **PJESA III.**

VEPRIMTARI TEMATIKE SIPAS FUSHAVE TË TË NXËNIT .....	100
1. Emri im është i veçantë .....	100
2. Familja ime .....	110
3. Trupi ynë .....	120
4. 5 shqisat .....	128
5. Stinët .....	142
6. Molla .....	158
7. I madh dhe i vogël .....	173
8. Të njohim numrat duke numëruar .....	180
9. Transporti .....	193
10. Treni .....	205
11. Ngjyrat .....	215
12. Biblioteka .....	226
13. Në dyqan .....	234

## **PJESA IV**

FLETORE VLERËSIMI .....	243
1. Fusha sociale dhe emocionale .....	249
2. Fusha gjuhësore-komunikuese .....	254
3. Fusha e matematikës .....	270
4. Fusha e shkencës dhe e vëzhgimit .....	274
5. Fusha e edukimit fizik dhe shëndeti .....	278
6. Artet .....	284



## HYRJE

Udhëzuesi që keni tashmë në dorë është pjesë shoqëruese e standardeve që kërkohen të zbatohen në kopshtet e të gjithë vendit për fëmijët 4-5 vjeçarë. Materiali është i vlefshëm për të gjithë ata që punojnë me fëmijët e moshës parashkollore dhe për pjesëtarët e familjeve të këtyre fëmijëve si mësuesit, kujdestarët apo prindërit. Ky udhëzues është hartuar për të shpjeguar standardet dhe për të dhënë sugjerime praktike për angazhimin krijues të komuniteteve të të mësuarit të përshtatshëm ku secili fëmijë përshpejton dhe zhvillon aftësitë e të mësuarit parapërgatitor për shkollë.

Pse janë të rëndësishme standardet në fushat e ndryshme të zhvillimit? Ato sigurojnë përvetësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave që udhëheqin brezin e ri drejt një jete produktive, të përmbushur dhe të suksesshme. Për të realizuar të gjitha këto, ne tashmë e dimë që bazat hidhen tek secili fëmijë para se ai të shkojë në shkollë. Në fakt, kërkimet tregojnë që edukimi në institucionin e kopshtit jep mundësi të shumta për mësuesit dhe edukatorët që të ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Nëse qëllimi ynë është që çdo fëmijë që hyn në kopsht të mësojë dhe të jetë i suksesshëm, standardet për grupet e veçanta na japin një të kuptuar mbi kompetencat kryesore rreth të cilave do të zhvillojmë procesin mësimor edukativ. Në të njëjtën kohë, standardet e grupit të fëmijëve të moshës 4-5 vjeç janë të lidhura me atë që pritet të ndodhë me fëmijët në klasat përgatitore, duke klasifikuar dhe ndihmuar si ata me pritje të larta, ashtu edhe ata me probleme.

Ky material përshkruan se çfarë shumica e fëmijëve duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë në fushat kryesore të njohjes përpara se të hyjnë në klasat përgatitore. Standardet e publikuara të parashkollorit përshkruajnë një set pritjesh për fëmijët e grupeve të ndryshme moshore, pritje të zhvilluara mbi bazat e kërkimeve të fundit të bëra rreth mënyrave se si fëmijët parashkollorë mësojnë.

Është e rëndësishme të mbajmë në mendje faktin që fëmijët zhvillohen dhe mësojnë në mënyra të ndryshme. Ndërsa treguesit demonstrojnë se pritet e mësuesve dhe prindërve janë të përshtatshme për shumicën e fëmijëve që janë gati të hyjnë në grupet apo klasat përgatitore, është përgjegjësi e mësuesve dhe edukatoreve të vlerësojnë në cilin nivel janë fëmijët që hyjnë në grupin e fëmijëve të moshës 4-5 vjeç dhe si do të ndërtohet njohja e tyre me atë që duhen të dinë dhe të bëjnë ata.

Vlerësimi vëzhgues është elementi kyç për mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve në fushat e ndryshme. Ky udhëzues do të ilustrojë disa tregues dhe do të japë shembuj mbi të cilët mësuesit do të shënojnë dhe do të realizojnë punën për progresin e fëmijëve kohë pas kohe.

Të dhënat e nxjerra do të shërbejnë për një planifikim të kuptimshëm, një motivim të eksperiencave të të mësuarit që së bashku nxisin zhvillimin e fëmijëve dhe dashurinë për lexim-shkrimin, matematikën, shkencën, artin, zhvillimin social etj.

Ju do të gjeni materiale të shumta rreth krijimit të mjedisëve të të mësuarit, veprimtarive me fëmijët në fusha të ndryshme të njohjes si dhe shumëllojshmërisë së të mësuarit në metodologji bashkëkohore aktive. Do të përfshihet po ashtu edhe një listë e burimeve ndihmëse.



Udhëzuesi është i ndarë në katër pjesë:

Në pjesën **e parë** janë përshkruar **treguesit e vlerësimit** që ju ndihmojnë ju si mësues të kuptoni se deri në ç'shikallë janë përmbushur standardet. Këta tregues evidentojnë mangësitë e arritjeve të fëmijëve në fushat e ndryshme të zhvillimit dhe, në njëfarë mase, udhëzojnë lidhur me çfarë duhet të bëni për përmirësimin e këtij zhvillimi të fëmijëve që janë gati për të hyrë në shkollë.

Në pjesën **e dytë** jepet një **planifikim orientues vjetor i programit** të grupit të fëmijëve të moshës 4-5 vjeçare. Planifikimi është gjithnjë një model alternativ që mësuesit e përdorin në raport me qytetin ku ndodhen, karakteristikat e kopshtit dhe të grupit etj.

Për të qenë më ndihmës në punën e përditshme të mësuesit, në pjesën **e tretë**, materiali që keni në dorë përmban rreth **13 veprimtari tematike të integruara** që u përkasin fushave të ndryshme të zhvillimit, të cilat mund të shërbejnë si shembuj të kërkimit dhe praktikës ditore me grupet e fëmijëve të moshës 4-5 vjeç.

Këto veprimtari përkrijnë edhe me fletët e punës së fëmijëve të përfshira në manualin që keni në dorë. Mbështetur në fushat e ndryshme të zhvillimit, ushtrimet janë të grupuara sipas disa parimeve didaktike të cilësuar më poshtë:

- Ngjyrosni
- Vizatoni
- Ndiqni pikat ose vijat
- Ngjyrosni sipërfaqet me pika, numra dhe shkronja
- Ecni nëpër labirint për të gjetur.....
- Gjeni të përbashkëtat dhe dallimet
- Klasifikoni sipas formës, numrit, masës dhe llojit
- Tregoni një histori të shkurtër mbështetur te figurat
- Zhvilloni një lojë me role etj.

Veprimtaritë tematike të dhëna në manualin e mësuesit nuk janë të detyrueshme për t'u zbatuar me të gjithë fëmijët. Sikurse shënohet edhe në tekst, disa pjesë të këtyre veprimtarive mund të kenë si objektiv vetëm fëmijët e avancuar, ndërsa disa të tjera fëmijët me nevoja të veçanta. Është mirë që për fëmijët me nevoja të veçanta mësuesit të zhvillojnë **plane edukative individuale**.

Mësimi i shkronjave apo numrave nuk nënkupton leximin apo numërimin përtej asaj që parashikon programi i arsimit parashkollor për moshën 4-5 vjeç, por vetëm familjarizimin e fëmijëve me to, me më shumë fokus te ajo që do të jetë përmbajtja e grupeve pasardhëse.

Në pjesën **e tretë**, mësuesi ndihmohet edhe me një sërë **fletësh pune për mësuesin dhe fëmijën** në realizimin e temave të ndryshme të programit. Në pjesën më të madhe të tyre ato janë të lidhura me komunikimin, matematikën, artin dhe shkencën. Fletët e punës së mësuesit kërkojnë që ky i fundit të fotokopjojë modelet e dhëna për t'i përdorur më pas me fëmijët për ngjyrosje, prerje, ngjitje, qepje, ndërtim etj.

Në pjesën **e katërt**, mësuesit dhe prindërit njihen edhe me fletët e vlerësimit të zhvillimit të fëmijës në fushat bazë, të cilat shërbejnë për përmirësimin e punës me fëmijët e veçantë dhe arritjen e objektivave finale të parashikuara në programet dhe standardet e moshës 4-5 vjeç.

## PARIMET E UDHËZUESIT

Praktikat e të mësuarit në grupin e fëmijëve të moshës 4-5 vjeç janë të bazuara në parimet e mëposhtme. Ato (parimet apo praktikat???) japin një strukturë që mbështet punën tonë me fëmijët dhe që na kujton në çdo moment “tablonë e madhe”- kornizën teorike të të mësuarit tonë.

1. **Të gjithë fëmijët prekin aktivisht botën në të cilën jetojnë. Mundësitë e dhëna për të bërë zgjedhje lidhur me veprimtaritë e tyre, i bëjnë ata të fitojnë njohuri, aftësi dhe shprehi për të zgjidhur problemet.** Fëmijët lindin me dëshirën për të mësuar dhe për t'i dhënë kuptim botës së tyre. Kërkimet na kanë treguar se fëmijët jo vetëm janë të aftë të zgjedhin se çfarë u pëlqen e jo vetëm fitojnë njohuri dhe aftësi, por kanë edhe motivim të madh për të vepruar. Mësuesit dhe prindërit mund ta përshpejtojnë dashurinë e fëmijëve për të mësuar duke i lejuar ata të bëjnë zgjedhje në veprimtari të ndryshme si dhe duke i mbështetur në përpjekjet për të zgjidhur problemet e tyre
2. **Fëmijët e ndërtojnë njohjen dhe vlerat përmes ndërveprimit me bashkëmoshatarët, prindërit dhe të rriturit e tjerë si dhe përmes zbulimit aktiv të mjediseve sociale dhe fizike.** Fëmijët duhet të gëzojnë një komunitet të të mësuarit ku të kenë mundësi të veprojnë drejtpërsëdrejti me objektet dhe të ndërveprojnë me njerëzit. Kjo për arsyen se, te fëmijët parashkollorë, të menduarit dhe veprimet janë të lidhura shumë ngushtë. Kur ne u japim fëmijëve mundësinë të zbulojnë, të eksperimentojnë, të bëjnë gjykime, të bashkëpunojnë dhe të ndajnë të menduarin e tyre me të tjerët, ne mbështesim zhvillimin e tyre njohës dhe social.
3. **Të menduarit e fëmijëve përmban gabime të paparagjykuara.** Gjatë zhvillimit të tyre, fëmijët e ndërtojnë njohjen përmes integritit të informacionit të ri me atë çfarë ata dinë. Në këtë mënyrë, fëmijët bëjnë shpesh gabime ose arrijnë në përfundime të gabuara. Kjo është pjesë e domosdoshme e procesit të të mësuarit. Kur ne u japim fëmijëve kohë të mjaftueshme dhe udhëheqje të përshtatshme për të njohur dhe korigjuar gabimet e tyre, ne jo vetëm i mësojmë ata si të mendojnë për veten, por dhe u tregojmë se kemi besim se ata mund t'i figurojnë gjërat si duhet. Fëmijët me besim në aftësinë e tyre për të punuar mbi problemet që kanë, janë mendimtarë aktivë.
4. **Të mësuarit e hershëm dhe fushat e zhvillimit ndërveprojnë dhe ndikojnë te njëri-tjetri.** Ndërsa të rriturit janë në gjendje të kategorizojnë të mësuarin në fusha lëndore (shkencë, matematikë, art, edukim fizik dhe shëndetësor etj.), kjo nuk vlen për fëmijët, të cilët e organizojnë të menduarit e tyre në një tjetër mënyrë. Zhvillimi i tyre social dhe emocional shkon hap

pas hapi me të mësuarin e tyre në fusha të ndryshme. Në fakt, aftësitë e fëmijëve për të ndërtuar njohuritë bazë varen nga zhvillimi i tyre social, emocional dhe fizik; ato janë të lidhura ngushtë me to. Si mësues dhe edukatorë, ne u shërbejmë fëmijëve eksperiencat më të mira të të mësuarit, të cilat janë jo vetëm domethënëse, por edhe të shtrira në fusha të ndryshme të zhvillimit.

5. **Familjet (prindërit) janë mësuesit më parë më të rëndësishëm të fëmijës.** Familjet (prindërit) janë mësuesit më të hershëm të fëmijëve. Ato janë gjithashtu edhe partnerët tanë më ndihmës në edukimin e fëmijëve parashkollorë. Ne të gjithë përpiqemi të investojmë sa më shumë në suksesin e fëmijëve dhe realizimin e një qëllimi të përgjithshëm: dhënies së edukimit më të mirë të mundshëm në një mjedis sa më të sigurt dhe të shëndetshëm, të pasur me mundësi për të nxënë. Ndërtimi i marrëdhënieve të hapura, me respekt reciprok dhe besueshmëri të madhe, me prindërit dhe familjet e fëmijëve na ndihmon të zhvillojmë te fëmijët ndjenjën e sigurisë dhe të vazhdimësisë nga grupi i dytë të klasat përgatitore në kopsht dhe në shkollë.
6. **Fëmijët shfaqin ndryshime individuale në zhvillimin e kompetencave të tyre.** Kërkimet dhe eksperiencat jonë na kanë treguar se fëmijët në përgjithësi kalojnë nëpër fazat e identifikuar të rritjes dhe zhvillimit, por është gjithashtu e vërtetë se ata mund të kenë ndryshime të mëdha individuale në përqindjen dhe mënyrat me të cilat i kapërcejnë këto faza. Ky ndryshim është normal. Ne mund t'i japim mbështetjen më të mirë progresit të çdo fëmije duke përmbushur nevojat e tij dhe duke ndërtuar punën ditore dhe vjetore mbi pikat e tij të forta.
7. **Parashkollorët 4-5 vjeç kanë karakteristikat e sjelljes së moshës dhe sfidat e krijimit të personalitetit të tyre.** Fëmijët 4-5 vjeçarë janë duke zhvilluar personalitetin e tyre e duke treguar më shumë zhvillim intelektual nëpërmjet:
  - **Egocentrizmit.** Një parashkollor është qendra e botës. Fëmija juaj beson që çdo gjë në botë është duke u rrotulluar rreth tij;
  - **Pavarësisë.** Një parashkollor dëshiron të vishet vetë dhe dëshiron t'ju ndihmojë ju në punët e shtëpisë apo të kopshtit. Kini durim që ta lini fëmijën 4-5 vjeçar t'i praktikojë këto aftësi;
  - **Krijimtarisë.** Imagjinata është gjithnjë në lëvizje. Bota e fëmijës 4-5 vjeçar është e mbushur me gjëra magjike gjatë gjithë kohës;
  - **“Pse?”-së** Parashkollorët 4-5 vjeçarë janë në përpjekje të vazhdueshme për të mësuar gjithçka mbi mjedisin që i rrethon; ata dëshirojnë të pyesin gjithnjë “Pse?”. Gjeni kohën e duhur si edukatorë dhe prindër për të ndihmuar fëmijët të mësojnë rreth shkaqeve të ngjarjeve që ndodhin rrotull tyre;
  - **Shoqërizimit.** Parashkollorët janë duke mësuar të jenë shoqëruar të mirë ose shokë për fëmijët e tjerë të moshës së tyre. Kopshti dhe qendrat ditore ofrojnë mundësi të mrekullueshme për fëmijët 4-5 vjeçarë që të mësojnë aftësitë e rëndësishme sociale;
  - **Dëgjimit.** Parashkollorët duhet të mësojnë të dëgjojnë të tjerët me interes. Modeli i përshtatshëm i sjelljes së dëgjimit për parashkollorët është të

dëgjuarit tuaj aktiv kur ata tregojnë rreth ditës së tyre, shokëve dhe zbulimeve që kanë bërë;

- **Aftësive motore.** Parashkollorët 4-5 vjeçarë janë duke mësuar lëvizje komplekse të tilla si kërcimi, ngjitja dhe hedhja. Lëri fëmijët t'i praktikojnë këto lëvizje dhe të argëtohen;
- **Aventurave.** Fëmijët mund të jenë shumë aktivë gjatë kësaj moshe. Kujdesuni për sigurinë e tyre duke u vënë mbrojtëset kur udhëtojnë me biçikletë dhe duke bërë në mënyrë të rregullt kontrollin e pajisjeve të lojës;
- **Gjuhës.** Drejtshqiptimi përmirësohet shumë në këtë periudhë të zhvillimit të parashkollorit. Mos u alarmoni nëse fëmijët lënë jashtë fjalës ndonjë bashkëtingëllore rastësisht;
- **Parimeve.** Parashkollorët 4-5 vjeç janë duke mësuar ndryshimin midis të drejtës dhe të gabuarës. Ju mund t'i ndihmoni ata të fitojnë vlerat e së drejtës dhe t'u bëni të qarta kufizimet e nevojshme lidhur me gabimet;
- **Realitetit përkundër fantazisë.** Parashkollorët 4-5 vjeç duhet të mësojnë ndryshimin midis realitetit dhe fantazisë. Në përfundim të viteve të edukimit parashkollor, fëmijët duhet të kenë një të kuptuar të mirë të së kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes;
- **Fobive.** Frika nga gjërat e reja, veçanërisht nga shenjat dhe zërat e panjohur, është e zakonshme në këtë moshë. Jini mbështetës ndërsa përpiqeni të lehtësoni frikën irracionale;
- **Aleancës së varfër sportive.** Parashkollorët 4-5 vjeç mësojnë të ndjekin rregulla të thjeshta në lojërat që luajnë, por ata dëshirojnë që të fitojnë gjithnjë dhe të jenë në "vend të parë". Loja e ndershme është diçka që e mësojnë në vitet e mëvonshme të zhvillimit të tyre;
- **Përshtypjeve të forta.** Parashkollorët 4-5 vjeç ndikohen shumë nga ato që shohin. Është e rëndësishme që të vrojtoni aktivisht ndaj ç'objekteve apo fenomeneve janë duke u ekspozuar fëmijët tuaj, në media apo në botën reale;
- **Kuriozitetit seksual.** Është normale që parashkollorët 4-5 vjeç të angazhohen në zbulimin seksual. Ndihmohuni fëmijët e kësaj moshe të mësojnë çfarë është e përshtatshme dhe çfarë jo.
- **Mosdiskriminimit dhe pranimit.** Fëmijët janë pranues dhe tolerantë ndaj ndryshimeve që ekzistojnë ndërmjet tyre. Fëmijët nuk paragjykojnë dhe nuk e veçojnë njëri-tjetrin bazuar në ndryshimet që çdonjëri prej tyre paraqet. Ata mbështesin dhe ndihmojnë pa kushte shokun që ka nevojë dhe rrinë e luajnë së bashku pavarësisht nëse mund të jenë të ndryshëm për nga origjina, ngjyra e lëkurës, niveli i aftësive, pamja fizike etj. Meqenëse fëmijët imitojnë sjelljet e të rriturve, mësuesit duhet të jenë të kujdesshëm që të mos ekspozojnë qëndrime diskriminuese ndaj dallimeve midis individëve të grupit.
- **Balancës gjinore.** Është e rëndësishme që fëmijët të zhvillojnë rolet e tyre gjinore pa kufizime dhe etiketime lidhur me stereotipat gjinorë. Nuk është e domosdoshme që djemtë dhe vajzat të zhvillojnë patjetër sjellje tipike të gjinisë së cilës i përkasin, përfshirë këtu veshjet, lojërat, pjesëmarrjen në aktivitete etj.

## Përdorimi i strategjive të ndryshme kur fëmijët gjenden në situata konflikti me njëri-tjetrin në kopsht

Diskutoni me fëmijët kur ata janë përfshirë në një situatë konflikti mes tyre.

**Hapi I:** Si fillim, dëgjoni të dyja palët, pavarësisht nëse një fëmijë është më i madh apo më i vogël, nëse është djalë apo vajzë.

- Diskutoni me fëmijët rastin e mëposhtëm dhe kërkojuni të japin mendimin e tyre rreth ngjarjes.

### Rast studimor

“Dy vajza të moshës 5-vjeçare shkuan për t’u ankuar tek edukatorja duke qarë dhe i thanë se Marku, shoku i tyre, kishte qëlluar njëren dhe tjetren e kishte hedhur nga shilarësi. Në fillim, edukatorja pa nëse goditjet kishin shkaktuar ndonjë dëm të madh tek vajzat dhe, pasi u sigurua se nuk kishte asnjë rrezik, shkoi tek Marku. Pa e ngritur zërin dhe pa i bërtitur ajo i kërkoi të tregonte se çfarë kishte ndodhur. Ai uli kokën dhe nuk foli. Edukatorja nuk i bërtiti e as nuk e akuzoi për goditjet që u kishte dhënë vajzave; ajo i ledhatoi flokët dhe i kërkoi t’i tregonte se çfarë kishte ndodhur. Marku, që është gjithashtu 5 vjeç, midis lotëve i tha se gjithë ditën vajzat e kishin sharë dhe nuk e kishin lënë të luante me asgjë prej gjëje. Sapo merrte topin, ato ia merrnin. Kur ai ishte rrugës për të shkuar tek rrëshqitësja, ato vraponin para tij dhe nuk ia linin radhën. Gjatë pushimit të drekës, i kishin thënë se sanduichi i tij vinte erë e keqe. Në fund të ditës, Marku s’e kishte duruar më këtë gjendje dhe njëren nga vajzat e kishte qëlluar, kurse tjetren e kishte rrëzuar nga shilarësi”.

- Nxitini fëmijët të flasin mbi si do të silleshin ata në vendin e Markut. Si do ta zgjidhnin ata situatën në fjalë?

**Hapi II:** Mësuesja duhet të bindë palët e përfshira në konflikt që të kërkojnë falje. Ngandongëherë, pasi janë dëgjuar të dyja palët, thjesht një “Më fal” nga të dy palët e qetëson situatën, pasi nuk ka një fajtor të vetëm. Edhe pse në konflikt/zënie e sipër fëmijët duket sikur do ta vrasin njëri-tjetrin, në thellësi të zemrës ata duhen dhe kjo gjë duhet mbajtur gjithmonë parasysh nga edukatorja para se ajo të japë një gjykim apo një opinion të sajën rreth situatës. Nëse edukatorja dënon/qorton vetëm një nga fëmijët, të dy fëmijët nuk do të ndihen mirë. Fëmija që gjykohet si “fajtor” nuk do ta harrojë se u dënua për shkak të shokut me të cilin po luante e më pas u konfliktua; kurse fëmija tjetër nuk do të ndihet i qetë kur të shohë shokun të marrë një dënim në sy të tij. Prandaj, në të tilla raste, është më mirë që edukatorja t’i vërë fëmijët që, në varësi të situatës, t’i kërkojnë falje njëri-tjetrit ose të shkëmbejnë një përfaqim miqësor plot me dashuri.

- Tregojini fëmijëve se, në një konflikt, të dyja palët mund të kenë pjesën e tyre të fajit, prandaj pasi janë dëgjuar u kërkohet atyre që të marrin përgjegjësinë përkatëse dhe të kërkojnë falje.

**Hapi III:** Mësuesja i nxit fëmijët e përfshirë në konflikt dhe fëmijët e tjerë të japin mendimin e tyre për të zgjidhur situatën.

Duhet mbajtur mend që fëmijët, pavarësisht moshës, janë *njerëz* dhe, *edhe pse të vegjël*, duhen trajtuar si të tillë.

- Mësuesja nxit fëmijët të japin mendimin e tyre rreth historisë së mëposhtme si dhe të tregojnë shembuj nga jeta e tyre në kopsht apo në shtëpi.

### Rast studimor

Era dhe Mira po dëgjojnë edukatoren që po u lexon një libër me përralla. Kur edukatorja mbaron librin, ua jep të dyjave që të shikojnë figurat. Më pas, edukatorja ngrihet nga vendi e shkon për të marrë një libër tjetër. Kur kthehet, shikon që të dyja vajzat po tërheqin librin nga duart e njëra-tjetres dhe disa fleta janë shqitur e kanë rënë përtokë.

- Lëreni librin dhe mos u grindni! – thotë me një ton paksa të prerë edukatorja.

Kur vajzat dëgjojnë tonin e zërit të saj, pushojnë grindjen menjëherë e fillojnë të thonë:

- Era s'ma dha mua librin!

- Mira e mori e para dhe unë desha radhën time!

- Era shqiti një nga fletët...

- A mund të ndaloni? – thotë edukatorja.

Më pas, u drejtohet me një ton më të zbutur: “Që të dyja keni faj sepse keni prishur librat e kopshtit. Librat janë për të lexuar dhe ne duhet të tregojmë shumë kujdes ndaj tyre. Nga librat ne mësojmë shumë gjëra. A do ndiheshit mirë po të griseshin librat tuaj?

- Jooo! - thonë të dyja vajzat pothuajse në të njëjtën kohë.

- Atëherë, le të mendojmë se si mund ta rregullojmë situatën. Cila prej jush ka ndonjë ide?

Mira ngre dorën.

- Edukatore, po sikur t'i ngjisim fletët me vinovil?

- Shumë ide e mirë! – thotë edukatorja. - Le të fillojmë nga puna.

- Unë do të ndihmoj duke mbledhur letrat e grisura e do të marr vinovilin nga sirtari – thotë Era”.

- Diskutoni me fëmijët rreth mënyrës me të cilën e zgjidhën vajzat situatën që u krijua.

**HAPI IV:** Mësuesja u tregon fëmijëve se, nëse gjatë një konflikti/situatë të tensionuar ajo u bën atyre ndonjë premtim, e mban atë gjithmonë.

Ndonjëherë, kur fëmijët zihen me njëri-tjetrin, e vetmja mënyrë për t'i qetësuar është t'u premtosh diçka.

P.sh. kur fëmijët janë duke u zënë dhe mësuesja ose edukatorja nuk ka ndonjë rrugëzgjidhje tjetër, ajo mund t'u bëjë atyre ndonjë premtim (por premtimi nuk duhet të përfshijë ushqime sepse fëmija mund të ketë ndonjë tip alergjie që mësuesja nuk e di ose prindërit mund të mos jenë dakord që fëmija të hajë diçka pa aprovimin e tyre). Ajo mund të premtojë se do t'i lexojë fëmijës librin e tij/saj të preferuar ose mund ta lejojë të luajë me lodrën e tij/saj të preferuar etj.

- Nëse mësueset nuk e mbajnë fjalën e dhënë, fëmijëve u krijohet ideja se ato gënjejnë, se çdo gjë që thuhet prej tyre mund të mos jetë e vërtetë. Fëmijët zhgënjehen, humbasin besimin dhe u shtohet ankthi.
- Fëmijët nxiten të tregojnë situata në të cilat ata vetë ose persona të tjerë nuk e kanë mbajtur premtimin. Si janë ndierë? Çfarë kanë menduar?

**HAPI V:** Mësueset duhet të jenë të kujdesshme që të mos u vendosin fëmijëve asnjëherë etiketime, përcaktime, tituj!

Fëmijët nuk mund të jenë gjithmonë në sjelljen e tyre më të mirë. Ka raste kur

fëmijët do të qajnë, do të zihen, do të grinden me njëri-tjetrin, do të kthejnë përgjigje negative kur nuk u pëlqen diçka etj. Por, kjo s'do të thotë se janë fëmijë të pabindur, të llastuar ose se janë fëmijë të këqij. Edhe në të rriturit nuk i kemi të gjitha ditët njësoj. Kemi ditë të mira e të gëzueshme por kalojmë edhe ditë kur jemi nervozë, nuk ndihemi mirë shpirtërisht e jemi të stresuar. Duhet të mbajmë mend se fëmijët janë si ne, me ndjenja si tonat, vetëm se janë të vegjël.

- Nëse një fëmijë në kopsht bën një gabim dhe mësuesja u thotë fëmijëve të tjerë “Mos luani me të, ai është rrëmujaxhi/i tmerrshëm!” e të tjera si këto, duke dëgjuar shpeshherë të njëjtin përcaktim për veten, fëmija nuk ka ndonjë rrugë tjetër veçse të fillojë të besojë se është me të vërtetë i tillë. Kështu, ai s'do të përpiqet të ndryshojë por, përkundrazi, do të përkrahë idenë se është i tillë. Kur ai bën përsëri ndonjë gabim dhe mësuesja i kërkon të tregojë shkakun përse e bëri, fëmija fare thjesht mund të thotë me plot besim: “Sepse jam rrëmujaxhi, i tmerrshëm”.
- Etiketimi ose vënia e një emri/titulli për fëmijën nuk ndikon vetëm në rastet kur fëmijët bëjnë ndonjë gabim, por edhe në ato raste kur një fëmijë është i urtë, i dëgjueshëm ose shumë i talentuar në ndonjë fushë (p.sh. vizaton bukur, këndon mirë, i bie pianos etj.). Nuk është e rekomandueshme ta lavdërosh fëmijën duke i vënë një titull, por është më mirë të lavdërosh punën që ai/ajo ka bërë. P.sh. nëse një fëmijë që pikturon bukur i thuhet gjithmonë “artist i vogël”, ai do të rritet duke e besuar këtë gjë; e nëse ndonjëherë piktura nuk do t'i dalë ashtu siç duhet, fëmija do të zhgënjehet e nuk do të ndihet më i aftë për të mbajtur titullin “artist”.

Tek shembulli i parë, i “fëmijës rrëmujaxhi”, kur ai godet ndonjë fëmijë tjetër, i duhet thënë: “Shpulla të vret. Shokët janë këtu për të luajtur me ty e jo për t'u qëlluar nga ty, se ndryshe nuk do të duan të luajnë më me një shok që gjithmonë i vret”. Duke i shpjeguar një fëmijë “të vështirë” se cilat janë gabimet e tij dhe pasojat që i shoqërojnë ato, ai do të mundohet të mos e përsërisë më atë mënyrë sjelljeje. Kjo lloj metode nuk i vret ndjenjat e fëmijës me ndonjë përcaktim të padëshiruar, por e bën atë të mendojë dhe të reflektojë për veprimin që ka bërë.

Në rastin e fëmijës “artist”, është e nevojshme të lavdërohet puna e jo punëtori. P.sh. “Më pëlqejnë ngjyrat që ke zgjedhur për këtë vizatim” ose “Qeni i pikturuar duket si i gjallë!”. Me këto fjalë, fëmija do të ndiejë kënaqësi pa marrë një titull që në të ardhmen mund ta vrasë emocionalisht pasi e vë përpara sfidës për të bërë gjithmonë më të mirën, gjë që është e pamundur edhe për të rriturit.

Mësueset duhet të jenë të kujdesshme kur krahasojnë arritjet dhe sjelljet e fëmijëve për të mos krijuar pakënaqësi dhe armiqësi mes tyre. Çdo fëmijë është kampion në diçka, pavarësisht fushës ku ai dallon apo shpallos aftësitë e tij.

## **Bashkëpunimi prindër - edukatorë, kusht i domosdoshëm gjatë procesit të rritjes, edukimit dhe shoqërizimit të fëmijëve**

- Prindërit kanë nevojë të ndiejnë mbështetjen e edukatoreve; ata duhet të informohen mbi gjithçka që lidhet me fëmijët e tyre.
- Mësueset duhet t'u përgjigjen nevojave të prindërve për të qenë të informuar lidhur me çdo gjë që ka të bëjë me fëmijën e tyre.

- Prindërit duhet të dëgohen me shumë kujdes dhe vëmendje, pasi ata e njohin fëmijën e tyre më mirë se kushdo tjetër dhe përbëjnë një burim të çmuar informacioni.
- Prania dhe pjesëmarrja e prindërve në aktivitetet mësimore duhet nxitur dhe inkurajuar.
- Mësueset duhet të diskutojnë me prindërit për shumëllojshmërinë e aktiviteteve që fëmija duhet të kryejë në familje. Prindërit, në ditë të caktuara, mund të vijnë më herët në kopsht për të parë se si fëmijët e tyre përfshihen në aktivitete, se si ata zbatojnë rregullat dhe respektojnë autoritetin e kopshtit, se si luajnë dhe mësojnë e të tjera si këto.
- Prindërit nuk duhet të jenë shumë kërkues, qortues e korrigjues ndaj fëmijëve. Edukatorët duhet t'u tregojnë prindërve se çfarë kanë bërë fëmijët e tyre, se cili është progresi i tyre dhe vështirësitë me të cilat ata ndeshen.

### Pjesëmarrja e prindërve në aktivitete praktike

- Prindërit dhe mësueset duhet të ndajnë me njëri-tjetrin çdo etapë të rritjes, zhvillimit, edukimit dhe ndërhyrjeve tek fëmijët.
- Edukatorët duhet t'u përcjellin prindërve qetësinë, besimin dhe sigurinë se fëmijët e tyre janë në duar të sigurta.
- Prindërit duhet t'i shohin institucionet parashkollëre si pikënisjen e proceseve relacionale të fëmijëve të tyre, si zanafillën e procesit të gjatë të edukimit dhe formimit të fëmijëve të tyre.
- Ndërmjet familjes dhe institucionit arsimor nuk duhet të ketë korniza, duhet të ketë aftësi të mira dialogu dhe mirëkuptim reciprok.
- Prindërit ndonjëherë shfaqin qëndrime tepër mbrojtëse ndaj fëmijëve, duke i penguar ata të krijojnë disa eksperiencë të domosdoshme për të zhvilluar aftësitë e tyre.
- Shpesh, prindërit i projektojnë në mënyrë subjektive fëmijët e tyre.
- Është e nevojshme që, brenda kopshtit, prindërve t'u krijohet një mjedis ku ata të mund të flasin për të gjitha shqetësimet, nevojat, problemet dhe dëshirat që kanë lidhur me fëmijët e tyre. Ata duhet të ndajnë me njëri-tjetrin përjetimet dhe eksperiencat e të mësojnë nga përvoja dhe praktika të suksesshme.
- Prindërit duhet të përfshihen fillimisht në aktivitete me karakter social-edukativ si p.sh. ekskursionet, shëtitje, ekspozita pikturë, vajtje në cirk, në kinema etj.
- Më pas, prindërit duhet të përfshihen në jetën e kopshtit si asistentë: të marrin pjesë në aktivitete mësimore; të vëzhgojnë se ç'ndodh brenda klasës; të vëzhgojnë mënyrat se si fëmija përfshihet, si i merr dhe si i zbaton instruksionet.
- Prindërit mund të ndahen në grupe për t'i shërbyer më mirë fëmijës dhe për të bashkëpunuar më nga afër me mësueset.
- Familja dhe kopshti nuk mund të realizojnë misionin e tyre pa siguruar një bashkëpunim të plotë e të suksesshëm me njëri-tjetrin.
- Por, prindërit duhet të përfshihen edhe në vendimmarrje brenda institucionit parashkollor, për çdo vendim apo proces që lidhet në mënyrë direkte apo indirekte me fëmijët e tyre.



## Mënyrat e një komunikimi efektiv ndërmjet të rriturve (prindër, kujdestarë) dhe fëmijëve në kopsht

### Komunikimi me prindërit dhe kujdestarët

Komunikimi i mirë me prindërit dhe kujdestarët mund të mbështesë dhe përforcojë punën që mësueset kanë bërë me fëmijët në kopsht.

Është e rëndësishme që edukatorët të komunikojnë me prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve sepse kështu:

- ata do të kuptojnë më mirë se si mund t'i ndihmojnë edukatorët që t'i përgatisin fëmijët e tyre për të pasur sukses në shkollë.
- ata do të mësojnë se si po përparojnë fëmijët e tyre.
- ata do të mësojnë mënyrat me të cilat mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre në shtëpi.
- ato vetë do të kuptojnë më mirë eksperiencat dhe historinë e fëmijës.
- fëmijët do të shohin se prindërit e tyre kujdesen për ta dhe interesohen për mësimet dhe zhvillimin e tyre.

### Disa mënyra me të cilat mund të komunikohet me prindërit dhe kujdestarët në mënyrë efektive:

- Flisni me ta kur sjellin apo marrin fëmijën.
- Dërgojini në shtëpi letra, shënime ose postë elektronike për t'i informuar lidhur me çfarë janë duke mësuar fëmijët në kopsht.
- Organizoni rregullisht mbledhje për t'u treguar se si po ecin fëmijët e tyre, anët e tyre të forta dhe fushat ku ata kanë nevojë për më shumë mbështetje në shtëpi.

P.sh. Klajdi po i mëson shumë mirë shkronjat. Ndoshta ai mund t'ju tregojë sot se sa shkronja di.

Ose

Amanta ka pak probleme lidhur me ritregimin e historive që unë i kam lexuar në klasë. Do të ishte mirë sikur t'i kërkonit që të fliste rreth historive që ju i lexoni në shtëpi. Pasi të mbaroni së lexuari një libër, ju mund t'i thoni p.sh. "Amanta, tregoja këtë histori edhe arushit tënd?".

### Inkurajoni prindërit dhe kujdestarët që:

- të flasin me fëmijët gjatë ditës, p.sh. kur janë në makinë, gjatë larjes së fëmijës, gjatë ngrënies në tryezë etj.
- t'i ndihmojnë fëmijët që të njohin emrat e objekteve në mjedisin e tyre.
- t'i lexojnë dhe rilexojnë libra fëmijëve.
- të përshkruajnë idetë dhe eksperiencat që janë të rëndësishme për ta.
- të vizitojnë bashkë me fëmijët libraritë dhe muzetë.
- të nxisin fëmijët të vizitojnë, të përdorin lapsin dhe ngjyrat.

Mësueset duhet të ftojnë prindërit të shohin klasën ku mëson fëmija në kopsht.

Ato duhet të ndajnë me prindërit idetë e tyre rreth aktiviteteve që ata mund të bëjnë në shtëpi dhe atyre që ato vetë realizojnë në kopsht.

## FUSHAT ETË MËSUARIT

### I. FUSHA GJUHËSORE - KOMUNIKUESE

#### Qëllimet e zhvillimit gjuhësor-komunikues dhe strategjitë e të mësuarit

Në fushën e zhvillimit gjuhësor-komunikues mësuesit dhe prindërit duhet të punojnë duke u mbështetur në disa komponentë: zhvillimi nëpërmjet simboleve, gjuha e folur, gjuha e dëgjuar, gjuha e shkruar, njohuritë rreth librave dhe shenjave, tingulli i gjuhës dhe strategjitë e të mësuarit. Në faqet e mëposhtme ju do të gjeni procesin e përmbushjes së standardeve të paraqitur përmes treguesve dhe shembujve, shoqëruar me secilin nga këta komponentë të përmbajtjes. Së bashku, përmbajtja dhe proceset e treguesve reflektojnë dimensione të ndryshme të zhvillimit gjuhësor-komunikues për fëmijët e moshës 4-5 vjeç.

#### Zhvillimi nëpërmjet simboleve

- Prezanton ndjenjat dhe idetë nëpërmjet lojës së pretenduar;
- Prezanton ndjenjat dhe idetë nëpërmjet lëvizjeve;
- Prezanton ndjenjat dhe idetë nëpërmjet muzikës;
- Prezanton ndjenjat dhe idetë nëpërmjet artit dhe ndërtimit.

#### Gjuha e folur shprehëse

- Komunikon në familje dhe është i kuptueshëm nga të tjerët;
- Përdor gjuhën për të pretenduar dhe krijuar;
- Përgjigjet në bashkëbisedimet dhe diskutimet me të rriturit dhe bashkëmoshatarët;
- Përdor fjali të plota, të shkurtra ose me gjatësi mesatare.

#### Gjuha e dëgjuar

- Ndjek udhëzime të thjeshta;
- Dëgjon dhe përfshihet në bashkëbisedimet me të tjerët;
- U përgjigjet pyetjeve;
- Dëgjon me vëmendje tregimin e historive dhe leximin e librave.

#### Gjuha e shkruar

- Eksperimenton me pajisjet dhe materialet e të shkruarit;
- Përdor shkarravina, forma të ndryshme vizatimi dhe letra për të shkruar;
- U tregon të tjerëve për kuptimet e synuara në vizatimet dhe shkrimet e tij;
- Përdor lloje të ndryshme burimesh për të lehtësuar të shkruarin.

#### Njohuri rreth librave dhe shenjave

- Shfaq interes për të lexuarin dhe librat;

- Shfaq aftësitë e mbajtjes së librit;
- Bën sikur i lexon librat ose tenton “të lexojë” pjesën e historisë që i pëlqen më shumë;
- I përgjigjet tekstit;
- Tenton të lexojë shkronjat dhe simbolet në mjedis;
- Identifikon disa shkronja të alfabetit;
- Zhvillon një kuptim të thjeshtuar të historisë.

### **Tingulli i gjuhës**

- Përsërit vjersha, këngë të thjeshta, poema dhe lojërat me gishta;
- Merr pjesë në lojërat me fjalë;
- Ka vështirësi në shqiptimin e disa bashkëtingëlloreve ose eliminon disa tinguj në fjalë.

### **Strategjitë e të mësuarit**

- Tregon kuriozitet për shkrimet në mjedise të ndryshme;
- Ndërmerr iniciativa komunikuese;
- Shfaq shpirt krijimtarie;
- Tregon dashuri dhe interes për librat;
- Përdor aftësitë problemzgjdhëse.



## ZHVILLIMI NËPËRMJET SIMBOLEVE

### Prezantojnë idetë dhe ndjenjat në mënyra të larmishme

Arritja i referohet aftësisë së fëmijëve për të interpretuar, krijuar dhe përdorur simbole në paraqitjen e diçkaje (një ideje, një ndjenje apo një objekti). Katër janë treguesit e vlerësimit të zhvillimit nëpërmjet simboleve tek fëmijët:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Prezanton ndjenjat dhe idetë nëpërmjet lojës me role.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bën sikur është zjarrfikës, doktor, nënë, baba etj.</li> <li>Bashkëvepron me të tjerët gjatë lojës (p.sh. fëmijët punojnë së bashku për të bashkuar vagonët e një treni).</li> <li>Krijon tema lojërash me të tjerët (p.sh. "Unë jam doktori, ti je fëmija dhe unë do të të vizitoj dhe do të të jap mjekim).</li> <li>Përdor emocionet gjatë lojës.</li> </ul>
Prezanton ndjenjat dhe idetë nëpërmjet lëvizjeve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bën sikur lëviz, vrapon, hidhet, rrëshqet etj. si mace, ujk, lepur, kërcimtar etj.</li> <li>Shpreh ndjenjat e tij nëpërmjet lëvizjes (p.sh. hidhet nga gëzimi, përplas këmbët nga mërzitja).</li> </ul>
Prezanton ndjenjat dhe idetë nëpërmjet muzikës.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Reagon ndaj ritmeve të ndryshme muzikore (marshon me melodi marshi, qetësohet me muzikë të lehtë).</li> <li>Këndon këngët që i pëlqejnë teksa i dëgjon, duke ndjekur ritmin apo përplasur duart etj.</li> <li>Krijon këngë dhe muzikë (p.sh. u ndryshon fjalët melodive më të njohura, bën sikur u bie instrumenteve etj.).</li> </ul>
Prezanton ndjenjat dhe idetë nëpërmjet artit dhe ndërtimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bën vizatime dhe më pas ua tregon të tjerëve punën e vet.</li> <li>Ndërton me kuba, plastelinë dhe lodra të tjera dhe thotë "Unë bëra shtëpinë e kukullës".</li> <li>U përgjigjet të tjerëve kur i kërkohet të tregojë rreth një ndërtimi apo vizatimi.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të promovuar zhvillimin nëpërmjet simboleve

- Të lejojë kohë dhe hapësira të mjaftueshme për të zhvilluar një lojë të thjeshtë.
- Të sigurojë objekte teatrale për lojërat me role.
- Të tregojë ose aktrojë histori të cilat janë të njohura për fëmijët e grupit, në mënyrë që fëmijët ta "ritregojnë" vetë historinë.
- Të sigurojë kukulla, kafshë pelushi dhe figura njerëzish prej kartoni pranë këndit të blloqeve.
- Të mbajë në kopsht mbetje të lejueshme riciklimi, në mënyrë që fëmijët të krijojnë vetë mjetet apo objektet teatrale.
- Të bashkëngjisë veprimtari lëvizëse në planin dhe veprimtaritë ditore.
- Të bashkëngjisë muzikën dhe këngën në planin dhe veprimtaritë ditore.

- Të sigurojë vegla dhe instrumente të ndryshme që fëmijët të luajnë.
- Të sigurojë materialet me të cilat fëmijët të mund të krijojnë veglat dhe instrumentet e tyre.
- Të luajë lojëra ritmike (p.sh. duke trokitur duart ose duke përplasur këmbët).
- T'u krijojë kohë dhe hapësirë të mjaftueshme fëmijëve për të ndërtuar me materiale të ndryshme si dhe për të bërë punime artistike.
- T'i lejojë fëmijët të eksplorojnë dhe krijojnë me materialet artistike si dhe t'i angazhojë ata në projekte për të hartuar dhe për të finalizuar produkte jo identike.
- Të sigurojë një sasi letrash, tabelash, pajisjesh artistike, të cilat të jenë të mjaftueshme dhe të arritshme për fëmijët.
- Të sigurojë një sasi të bollshme lodrash, kubesh etj. në mënyrë që të jetë e mundur të përdoren nga një numër i madh fëmijësh.
- Të sigurojë mjete ndihmëse dhe pajisje që ndihmojnë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e pakicave etnike, të cilët mund të kenë vështirësi në të kuptuarin e mesazheve lidhur me përfshirjen në aktivitete të ndryshme.

## GJUHA E FOLUR

### Përdorin gjuhën për të komunikuar idetë, ndjenjat, pyetjet apo edhe për të zgjidhur problemet

Arritja i referohet aftësisë së fëmijës për të shprehur veten duke përdorur gjuhën. Katër treguesit e vlerësimit të gjuhës së folur ekspresive të fëmijëve janë:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Komunikon në familje dhe është i kuptueshëm nga të tjerët.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor gjuhën për qëllime të ndryshme.</li> <li>• Nëpërmjet gjuhës, komunikon nevojat, preferencat dhe ndjenjat.</li> </ul>
Përdor gjuhën për të pretenduar dhe krijuar.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Me fjalë dhe veprime, bën si ndonjë personazh i tregimeve apo programeve televizive.</li> <li>• Tregon ngjarje të vërteta ose histori imagjinare por të besueshme.</li> </ul>
Fillon dhe përgjigjet në bashkëbisedimet dhe diskutimet me të rriturit dhe bashkëmoshatarët.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve për dhënie informacioni apo zgjidhje problemesh.</li> <li>• Përgjigjet ndaj ndjenjave dhe shqetësimeve të shprehura nga të rriturit.</li> <li>• Ndan informacionin me të tjerët dhe jep udhëzime, sidomos gjatë lojërave.</li> <li>• Bën pyetje si: pse, çfarë, kur dhe ku.</li> </ul>
Përdor fjali të plota, të shkurtra ose me gjatësi mesatare.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor gjuhë përshkruese (për ngjyrat, fjalët, madhësitë, format).</li> <li>• Eksperimenton me fjalët ekzistuese dhe të reja të fjalorit të tij.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të promovuar gjuhën e folur të fëmijës

- Të planifikojë për fëmijët kohën e nevojshme për të realizuar bashkëbisedime rreth çështjeve të rëndësishme për ta.
- Të inkurajojë ndërveprimin me fëmijët përgjatë gjithë ditës.
- Të zhvillojë vazhdimisht tema të ndryshme për të inkurajuar pjesëmarrjen gojore të fëmijëve.
- Të organizojë takime në grup për të zgjidhur konfliktet, për të bërë listën e përgjegjësive, për të votuar etj.
- Të shërbejë për fëmijët si shembull për sa u përket formave me të cilat ata duhet të pyesin dhe të përgjigjen.
- Të lexojë dhe të diskutojë histori në grupe të vogla (2-3 fëmijë për grup).
- Të sigurojë mundësi dhe materiale për të prezantuar fjalë të reja të kuptueshme për fëmijët (p.sh. "Po, kjo është lodër dhe quhet lodër konstruktive").
- Të nxisë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata të pakicave etnike që, nëse e kanë të vështirë të përdorin gjuhën e folur, të komunikojnë përmes simboleve, vizatimeve, gjeesteve etj.

## GJUHA E DËGJUAR

### Dëgjojnë për qëllime të ndryshme

Arritja i referohet aftësisë së fëmijëve për t'u përqendruar dhe për të kuptuar gjuhën. Katër treguesit e vlerësimit të gjuhës së dëgjuar të fëmijëve janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Ndjek udhëzime të thjeshta.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mund të ndjekë deri në dy hapa udhëzuese, p.sh. "Ngri lodrat dhe vish bluzën e kuqe".</li> </ul>
Dëgjon me vëmendje historitë dhe leximin e librave.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• U përgjigjet historive dhe librave me gjuhë trupore dhe shprehje të fytyrës (buzëqesh, trishtohet etj.).</li> <li>• I jep përgjigje gojore historisë apo tekstit.</li> </ul>
Dëgjon dhe përfshihet në bashkëbisedimet me të tjerët.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• U përgjigjet me korrektësi fjalëve të të tjerëve në këmbim të ideve, komenteve apo pyetjeve.</li> </ul>
U përgjigjet pyetjeve të thjeshta.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën pyetje të thjeshta (p.sh. "A e ha ujku Kësulëkuqen?") dhe jep përgjigje po ashtu të thjeshta: "po" ose "jo".</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të promovuar gjuhën komunikuese

- Të lexojë shpesh me zë të lartë.
- T'u japë fëmijëve mundësi për të bashkëvepruar me njëri-tjetrin përgjatë gjithë ditës.
- Të krijojë hapësira për pyetjet dhe përgjigjet e tyre.
- Të angazhojë fëmijët në bashkëbisedime me njëri-tjetrin.
- Të bëjë të mundur që edhe fëmijët që e kanë të vështirë të përvetësojnë

gjuhën e dëgjuar për arsye të ndryshme të përfshihen në aktivitetet e planifikuara duke siguruar materialet dhe udhëzimet e përshtatshme për ta.

## GJUHA E SHKRUAR

### Shkrimi si mënyrë komunikimi

Arritja i referohet rritjes graduale të aftësisë së fëmijëve për të kuptuar se simbolet grafike (shkrimi me dorë, shkronjat) kanë kuptimin e tyre dhe mund të përdoren për të komunikuar me të tjerët. Katër treguesit për të vlerësuar gjuhën e shkruar të fëmijëve janë:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Eksperimenton me pajisjet dhe materialet e të shkruarit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fillon të ketë kontroll mbi materialet e vizatimit, të të shkruarit dhe të artit (p.sh. përdor lapsat e zinj dhe me ngjyrë duke i shtrënguar mes gishtave, përdor shkurmesat në tabelë, përdor plastelinën për të bërë figura të ndryshme).</li> </ul>
Përdor shkarravina, vizatime dhe letra për të shkruar.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shkarravit letrën - sikur po përdor simbole dhe po shkruan shkronja.</li> <li>Shkruan diçka dhe i pyet të tjerët nëse dinë ta lexojnë atë.</li> <li>Tenton të shkruajë për qëllime të ndryshme (p.sh. mesazhe, lista, histori).</li> </ul>
U tregon të tjerëve kuptimet e synuara në vizatimet dhe shkrimet e tij.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdor vizatimin për të komunikuar idetë dhe informacionet.</li> <li>I thotë shokut, gjatë një loje me role, "Kur unë të them "ariu", ti do ecësh shumë ngadalë".</li> <li>Përdor simbole apo vizatime për të shprehur ndjenjat, mendimet dhe idetë. Fëmija mund të shkruajë ose të vizatojë rreth një eksperience.</li> </ul>
Përdor shumëllojshmëri burimesh për të lehtësuar të shkruarin.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mund t'u kërkojë të tjerëve ta ndihmojnë për të shkruar.</li> <li>Tenton të kopjojë shkronja ose fjalë nga mjedisi rrethues (p.sh. nga kutia e qumështit, emri, shenjat publike, logot, librat etj.)</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të promovuar gjuhën e shkruar të fëmijëve

- Të sigurojë një shumëllojshmëri mjetesh që bëjnë të mundur shkrimin (lapsa me ngjyra, shkurmesa, çfarëdolloj letre, zarfe, fletore vizatimi, shkronja me magnet etj.).
- Të sigurojë këmbalecë për të vizatuar, pikturuar dhe shkruar.
- Të organizojë një qendër shkrimi, të sigurojë gazeta dhe kohë për të shkruar.
- T'u krijojë fëmijëve mundësi për të shkruar për qëllime të kuptimshme si listat, firma, letrat e falënderimit, bashkëbisedimet etj.
- Të kompozojë librin e grupit së bashku me fëmijët.
- T'u kërkojë fëmijëve të përshkruajnë vizatimet dhe të shkruajë fjalët që ata i diktojnë. T'i lexojë fjalët disa herë me zë të lartë.

## NJOHURI RRETH SHKRONJAVE DHE LIBRAVE

### Aplikojnë aftësi të hershme të lexuari

Arritja i referohet aftësisë në rritje të fëmijës për të njohur dhe kuptuar shkronjat dhe librat.

Ka tetë tregues për të vlerësuar njohuritë rreth shkronjave dhe librave të fëmijët.

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Shfaq interes për leximin dhe librat.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njih dhe kërkon rregullisht librat e preferuar</li> <li>Vendos të "lexojë" ose të shohë librin.</li> <li>Flet rreth pikturave në libër.</li> </ul>
Shfaq aftësitë e mbajtjes së librit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>E mban librin para dhe kthen faqet.</li> <li>Fillon të vëzhgojë faqet nga lart-poshtë dhe nga e majta në të djathtë.</li> <li>Kupton kur një libër është për t'u "lexuar".</li> </ul>
Bën sikur lexon me lehtësi librat ose tenton të lexojë pjesën e tij të preferuar të historisë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>I bashkohet leximit me fraza të parashikueshme (p.sh. Vrapo shpejt, shpejt, shpejt. Ti nuk më kap dot mua, unë jam njeriu më i shpejtë në botë).</li> <li>Përdor figurat për të shprehur kuptimet e tyre.</li> <li>Mund të "lexojë" hyrjen e librit, fjalë të pakta nga libri, riprodhon rimat e njohura nga poezi të ndryshme, krijon histori nga memoria e vet letrare apo nga pikturat e varura.</li> </ul>
I përgjigjet tekstit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon objektet e njohura në ilustrime.</li> <li>Flet ose shfaq emocione në varësi të tekstit.</li> <li>Bën parashikime dhe mund të përdorë vizatimet si udhërrëfyes (p.sh. Unë them se Piter Pan do të fitojë).</li> <li>Mund të imitojë zërin e një personazhi.</li> </ul>
Lexon disa nga shenjat dhe simbolet në mjedis.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njih shenja dyqanesh (LODRA, AKULLORE, LIBRA etj.).</li> <li>Njih shenjat në mjedis (p.sh. Mos hidh mbeturinat, STOP etj.).</li> </ul>
Identifikon disa shkronja të alfabetit. Di që shkronjat janë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon disa shkronja nga emri i vet.</li> <li>Mund të identifikojë shkronja edhe në fjalë të tjera të rëndësishme (p.sh. "m" për mami, "q" për qeni).</li> </ul>
pjesë përbërëse e fjalëve të shqiptuara.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njih shkronjën e parë të emrit të vet.</li> <li>Di që fjala "katror" e shkruar mbi formën e katrorit nënkupton katrorin.</li> <li>I sheh fjalët në faqen e librit dhe "lexon" historinë.</li> <li>Di që një shkronjë është e ndryshme nga një fjalë.</li> </ul>



Zhvillon një të kuptuar të thjeshtë të historisë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon një histori me piktura.</li> <li>• Parashikon fundin e historive.</li> <li>• Tregon historitë sipas rendit logjik - fillim, mes dhe fund.</li> <li>• Tregon histori bazuar në eksperiencën e tij personale, imagjinatën, ëndrrat apo dhe historitë nga librat.</li> </ul>
---	---

### Strategjitë e mësuesit për të ndihmuar fëmijët të kenë aftësi të hershme leximi

- Të lexojë me zë të lartë çdo ditë.
- Të përdorë libra me përmasa të mëdha dhe të rekomandojë leximin e tyre rregullisht dhe në mënyrë të përsëritur.
- Të inkurajojë fëmijët që t'u përgjigjen historive duke i nxitur ata të bëjnë pyetje të hapura ose të mbyllura dhe duke i angazhuar në bashkëbisedime rreth këtyre historive.
- Të mbajë në bibliotekë kopjet e librave më të pëlqyer nga fëmijët e grupit për një vit të tërë.
- Të lexojë të njëjtin libër në kohë të ndryshme duke përdorur teknika alternative.
- Të ketë një kohë “të qetë” leximi të programuar në planin dhe veprimtarinë ditore.
- Të përdorë etiketa dhe të promovojë ndërgjegjësimin nëpërmjet etiketave dhe shenjave në mjedisin rrethues dhe përtej tij.
- Të gjejë “kohën e librit” për të nxjerrë librat që duhen lexuar apo duhen marrë në shtëpi.
- Të organizojë një kënd ose qendër leximi me libra të përshtatshëm për fëmijët (7-10 libra për fëmijë) ku ata të mund të zgjedhin dhe të lexojnë qetësisht librat e tyre.
- Të shkruajë, së bashku me fëmijët, ditarin e klasës për ta vendosur në bibliotekën e klasës, material ky që mund të merret nga fëmijët në shtëpi për të biseduar me familjarët e tyre.

## TINGULLI I GJUHËS

### Njohin tingullin e gjuhës

Arritja i referohet zhvillimit të ndërgjegjes fonologjike të fëmijës. Ka tre tregues për të vlerësuar ndërgjegjen fonologjike të fëmijës.

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Përsërit rimat, këngët e thjeshta, poezitë dhe lojërat me gishta.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë ose këndon rima këngësh për fëmijë.</li> <li>• Këndon këngë të thjeshta.</li> <li>• Thotë poezi apo luan me lojëra fëmijësh.</li> </ul>
Merr pjesë në lojërat me fjalë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përplasat me rrokjet e fjalëve (p.sh. përplas emrat me rimat).</li> <li>• Krijon fjalë duke thënë një tingull për një tjetër (p.sh. mollë dhe dardhë, molë dhe darlë etj.).</li> </ul>

Nuk i shqipton drejt disa bashkëtingëllore dhe eliminon disa tinguj në fjalë.

- Pëlqen librat që fokusohen në tinguj specifikë.
- Eksperimenton me tingujt e gjuhës (p.sh. "mmmm", "kërr, kërr, kërr" etj.).
- Luan me tingujt në mënyrë të përsëritur.

### Strategjitë e mësuesit për të promovuar ndërgjegjësimin fonologjik

- Të krijojë lojëra fjalësh.
- Të përfshijë fëmijët në të mësuarin e këngëve të ndryshme, lojërave me gishta dhe rimave për fëmijë.
- T'u mësojë fëmijëve vjersha dhe t'i thotë ato me zë të lartë.
- Të krijojë mundësi që fëmijët të luajnë lojëra me tinguj të ndryshëm, në mënyrë që të mësohen të identifikojnë dhe të shqiptojnë si duhet tinguj të caktuar; sidomos kur demonstrojnë defekte të shqiptimit të disa tingujve.

## KRIJIMI I NJË MJEDISI STIMULUES PËR TË MBËSHTETUR SHKRIMIN DHE LEXIMIN

Një nga çelësat për ndërtimin e një mjedisi të pasur për mësimin e shkrimit dhe leximit është që të kesh në klasë pajisjet e duhura, libra dhe materiale për të shkruar. Një fillim i mbarë është që të kesh 3-7 libra për fëmijë. Biblioteka duhet të ketë shumëllojshmëri zhanresh si histori, libra me piktura, libra shkencorë, libra pa fjalë, poezi etj. si edhe libra me format të madh që janë të rëndësishëm gjithashtu. Si fillesë, duhet të ngrihen këndet e leximit, shkrimit dhe dëgjimit, me librat dhe materialet e duhura, në një cep të klasës, në mënyrë që të inkurajohen fëmijët që të marrin pjesë në veprimtari të cilat do t'i ndihmojnë të përvetësojnë shkrimin dhe leximin gjatë aktivitetit të tyre ditor. Librat dhe materialet e tjera duhet të jenë të arritshme nga fëmijët, të vendosura në shporta apo në raftet e ulëta. Një vend i qetë për të lexuar, shkruar, pikturuar dhe vizatuar do të kontribuojë për krijimin e një mjedisi ku fëmijët do të mësojnë ta duan shkrimin dhe leximin.

## PËRFSHIRJA E PRINDËRVE DHE E FAMILJES

Prindërit dhe familja janë partnerët më të rëndësishëm për të promovuar tek fëmijët zhvillimin e shkrimit dhe leximit. Inkurajimi i prindërve dhe anëtarëve të tjerë të familjes që t'u lexojnë çdo ditë libra fëmijëve të tyre dhe të ruajnë atë çka ata lexojnë është një fillim i mbarë dhe i dukshëm. Duke ftuar familjet që të krijojnë mjediset e librit në shtëpitë e tyre apo t'i çojnë fëmijët 4-5 vjeçarë në një qendër leximi apo bibliotekë, u tregojmë atyre rrugën e duhur përmes të cilës familja mund të mbështesë të mësuarin. Ka shumë alternativa për mësuesit të cilët janë të interesuar të përfshijnë prindërit në mësimin e fëmijëve tyre dhe të dy, si mësuesit ashtu edhe familja, janë burime potenciale për të zhvilluar më tej aftësimin në shkrim dhe lexim të fëmijëve të vegjël.

## 2. FUSHA E MATEMATIKËS

### Qëllimet e zhvillimit matematikor dhe strategjitë e të mësuarit

Në fushën e zhvillimit matematikor, janë gjashtë komponentët lidhur me të cilët mësuesit dhe prindërit duhet të bashkëveprojnë: numrat dhe veprimet, gjeometria dhe hapësira, modelet dhe marrëdhëniet, matjet, eksplorimi i të dhënave dhe strategjitë e të mësuarit. Në faqet e mëposhtme, kemi paraqitur procesin e përbushjes së standardeve, përmes treguesve dhe shembujve, shoqëruar me secilin nga këta komponentë të përmbajtjes. Së bashku, përmbajtja dhe proceset e treguesve reflektojnë dimensione të ndryshme të zhvillimit matematikor për fëmijët e moshës 4-5 vjeçare.

#### Numrat dhe veprimet

- përdor numrat për të treguar sasi;
- përdor fjalë për të treguar numrin e objekteve;
- zgjidh probleme duke përdorur numrat;
- përdor treguesit numerikë.

#### Gjeometria dhe hapësira

- vëzhgon pozicionet dhe vendndodhjet;
- eksploron format në një mjedis.

#### Modelet dhe marrëdhëniet


- njeh marrëdhëniet në një mjedis të caktuar;
- përdor modelet në një mjedis.

#### Matjet

- bën krahasime;
- përdor matës.

#### Investigimi i të dhënave

- mbledh, organizon dhe përdor informacionin.



## NUMRAT DHE VEPRIMET

### Përdorin numrat për të treguar sasi të

Arritja i referohet aftësisë së fëmijëve për të kuptuar numrin, i cili përfaqëson një sasi të caktuar. Tre treguesit kryesorë për të vlerësuar aftësitë e fëmijës në njohjen e numrave dhe bërjen e veprimeve janë:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Tregon interes për numërimin dhe sasinë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor gishtat për të treguar numrin (p.sh. tregon katër gishta për të thënë moshën);</li> <li>• Përsërit vjersha, këngë dhe lojëra me numërime;</li> <li>• Numëron objekte familjare, jo gjithmonë në mënyrë korrekte (p.sh. anëtarët e familjes, shokët, lodrat);</li> <li>• Pyet se sa janë ose sa bëjnë.</li> </ul>
Numëron mekanikisht	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numëron nga 1-shi te 6-ta ose më shumë.</li> </ul>
Numëron objektet në mënyrë të kuptueshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numëron pesë artikuj (p.sh. blloqe, lapsa, makina) në mënyrë të saktë;</li> <li>• Merr aq objekte sa i kërkohen (p.sh. merr tre objekte kur i thuhet "Era, më jep tri kokrra qershi, të lutem").</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të ndihmuar fëmijët të fitojnë aftësinë e numërimit dhe të tregojnë sasi të

- Të nxisë fëmijët për të eksperimentuar me numërimin në mënyrë të kuptimshme për ta;
- Të angazhojë fëmijët të këndojnë këngë me numra;
- Të lexojë libra të formatit të madh që përmbajnë renditjen e numrave;
- Të japë shembuj të numërimit të objekteve ose njerëzve në situata të kuptueshme për fëmijët (p.sh. të përcaktojë sa fëmijë ndodhen në tryezë ose sa fëmijë kanë ardhur në kopsht, sa mungojnë etj.);
- Të sigurojë sa më shumë mundësi për numërimin e objekteve;
- Të japë shembuj të fjalëve që përdoren për numërimin e çdo objekti;
- Të bëjë pyetjen "Sa..?";
- Të tregojë tabelën me numra e cila duhet të jetë vendosur në nivelin e syve të fëmijëve;
- Të organizojë lojëra me numërime.

### Përdorin fjalë për të treguar numrin e objekteve

Arritja pasqyron rritjen e njohurive të fëmijëve dhe përdorimin e fjalorit të shoqëruar me numra dhe sasi. Katër janë treguesit kryesorë për vlerësimin e aftësisë së fëmijës për të treguar numrin e objekteve:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Përdor fjalët krahasuese për numrat: më shumë/më pak, më i madh/më i vogël, po aq sa.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sheh veten dhe të tjerët dhe përcakton se kush ka më shumë lapsa, lodra etj.;</li> <li>• Krahason objektet e tij me të shokut dhe përcakton nëse kanë të njëjtën sasi;</li> <li>• Pyet, "Sa më shumë se mua ke?".</li> </ul>
Kombinon objektet dhe përcakton se sa janë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendos lapsin e kuq, të verdhë dhe blu bashkë dhe numëron se sa lapsa janë gjithsej;</li> <li>• Di që tri vetura dhe dy kamionë bëjnë një total prej pesë objektiv - makina;</li> </ul>
Ndan objektet dhe përcakton se sa janë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në lojën me gishta, këngë ose tregime të cilat kanë në përmbajtje numra dhe numërime;</li> <li>• Godet shishet (birilat) me top dhe tregon se sa kanë rënë poshtë dhe sa kanë mbetur pa u goditur.</li> </ul>
Eksploron, vëzhgon pjesët e së tërës në kontekstin e jetës së përditshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë (jo gjithmonë saktë), "Unë kam një portokall të plotë" ose "Unë kam një çerek ose gjysmë kokrre mollë".</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të nxitur te fëmijët përdorimin e fjalorit matematikor

- Të zgjedhë libra që përmbajnë koncepte matematikore gjatë kohës së leximit;
- Të angazhojë fëmijët në identifikimin numrave në mjedisin përreth;
- Të bëjë, bashkë me fëmijët, një libër me numra, p.sh. "Libri i matematikës";
- T'u japë fëmijëve materiale për të bërë koleksione dhe të bashkëbisedojë me ta lidhur me si i kanë klasifikuar objektet dhe sa janë gjithsej;
- Të angazhojë fëmijët në lojëra me gishta, këngë dhe tregime të cilat përfshijnë numërimin (nga 1 deri në 10 dhe nga 10 deri në 1);
- Të krijojë sa më shumë mundësi për të numëruar objekte dhe të pyesë për sasinë e tyre;
- Të ndihmojë fëmijët të bëjnë lidhje matematikore edhe gjatë kohës së lojës (p.sh. duke pyetur "A keni që të gjithë topa? Edhe sa të tjerë ju duhen?").

### Zgjidhin problema të thjeshta duke përdorur numrat

Arritja i referohet aftësisë së fëmijës për të identifikuar dhe për të zgjidhur personalisht probleme të kuptueshme nëpërmjet numrave. Katër treguesit kryesorë për të vlerësuar këtë aftësi të fëmijës janë:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Përcakton numrin e elementeve të bashkësisë (edhe më shumë se pesë objekte)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Di që në kuti ndodhen 2 ose 3 lapsa;</li> <li>• Hedh zarin dhe tregon se sa pika ndodhen në faqet e tij pa i numëruar ato.</li> </ul>
Përdor korrespondencën me mënyrën I e nga I për të numëruar objektet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mund të numërojë 5 blloqe në një rresht dhe të thotë numrin pasi i ka prekur blloqet;</li> <li>• Merr nga një gotë me qumësht për çdo fëmijë që është ulur në tavolinë;</li> <li>• Vendos një pjatë bashkë me pecetën përkatëse kur shtron tavolinën ose një fletë dhe një laps kur vizaton;</li> <li>• Ngre një gisht lart për çdo numër që numëron me gojë</li> </ul>
Përdor korrespondencën me mënyrën I e nga I për të krahasuar madhësinë e një grupi objektësh	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krahason numrin e makinave të tij lodër me atë të shokut dhe thotë se kush ka më shumë e kush ka më pak;</li> <li>• Krahason vijat e vizatuara në blloqe dhe tregon se cili nga blloqet ka më shumë ose më pak;</li> </ul>
Vlerëson përafërsisht e më pas numëron objektet për të verifikuar.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë përafërsisht numrin e lapsave, blloqeve, lodrave, kupave etj. që ndodhen në tavolinë e më pas i numëron ato konkretisht.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të ndihmuar fëmijët të zgjidhin problema të thjeshta duke përdorur numrat

- Të përdorë situatat reale gjatë ditës për të nxitur zgjidhjen e problemave me numra;
- T'u tregojë fëmijëve një grup të vogël objektësh dhe t'u kërkojë të gjejnë me një shikim se sa janë gjithsej;
- Të pajisë qendrën e matematikës me një llojshmëri lojërash matematikore me qëllimin që fëmijët të eksplorojnë vetë;
- Të angazhojë fëmijët në të gjitha llojet e lojërave matematikore në grup;
- Të nxisë fëmijët të organizojnë vetë lojën e tyre.

**Përdorin treguesit numerikë**

Arritja i referohet aftësisë së fëmijës për të identifikuar dhe për të zgjidhur personalisht probleme të kuptueshme nëpërmjet numrave. Pesë treguesit kryesorë për vlerësimin e aftësisë së fëmijës në këtë fushë janë:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Përdor vizatimin për të treguar numrat	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bën vizatime për të treguar madhësinë dhe sasinë e anëtarëve të familjes (p.sh. i shkurtër/i gjatë/i madh/i vogël);</li> <li>Bën një vizatim për të treguar numrin e objekteve.</li> </ul>
Identifikon numrat në situata të jetës së përditshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njeh numrat deri në 10 në telefon, ashensor, kompjuter, makinë llogaritëse;</li> <li>Gjen dhe emërton numrat në libra ose në simbole.</li> </ul>
Përdor numërorët rreshtorë (i pari, i dyti, ...i fundit)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon pozicionin në një rresht fëmijësh (p.sh. kush është i pari, i dyti, i fundit);</li> <li>Vendos tre objekte në një rresht dhe tregon se kush është i pari, i mesit dhe i fundit;</li> <li>Tregon pozicionin e objekteve (i pari, i dyti, i fundit)</li> </ul>
Shkruan disa numra deri në 10	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krijon dhe sajon numra me plastelinë, karton etj.;</li> <li>Përpiqet të shkruajë se sa vjeç është ajo/ai;</li> <li>Përpiqet të kopjojë një numër telefoni.</li> </ul>
Krahason numërorët sipas sasisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kur luan një lojë në mënyrë korrekte vendos numrat sipas simbolit ose hapësirës së fushës;</li> <li>Përdor numra magnetikë për të treguar sasinë e objekteve.</li> </ul>

**Strategjitë e mësuesit që i ndihmojnë fëmijët të përdorin treguesit numerikë**

- Të krijojë në klasë një mjedis që përmban shumë shembuj mbi si gjenden dhe përdoren numrat në jetën e përditshme (p.sh. në qendrën e shkrimit të vëzhgojë librin e telefonave, recetat e gatimit etj.; në qendrën e matematikës të përdorë një makinë llogaritëse);
- Të nxisë fëmijët që të flasin për numrat në mënyra të ndryshme;
- Të sigurojë sa më shumë numra të printuar me figura të ndryshme;
- T'u krijojë mundësi fëmijëve që të llogarisin me numra;
- Të organizojë sa më shumë veprimtari në të cilat fëmijët të shkruajnë duke eksperimentuar me numrat në qendrën e shkrimit dhe të artit;
- T'u sigurojë fëmijëve kohën dhe hapësirën e duhur për të luajtur sa më shumë lojëra matematikore;
- Të japë shembuj të fjalorit që përdoret për numrat rreshtorë;
- T'u mundësojë fëmijëve të përdorin treguesit numerikë me objekte dhe të ndajnë e shkëmbejnë mendimet e tyre me shokët.

## GJEOMETRIA DHE HAPËSIRA

### Vëzhgojnë pozicionet dhe vendndodhjet

Arritja i referohet zhvillimit të aftësisë së fëmijëve për të kuptuar marrëdhëniet dhe relacionet ndërmjet objekteve në botën fizike sipas ndërgjegjësimit të tyre hapësinor: perceptimin se ku ndodhet ai/ajo në lidhje me të tjerët dhe objektet. Tre treguesit kryesorë të kësaj aftësie janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
I ndan objektet veç dhe i bashkon përsëri ato	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërton me blloqe bashkues;</li> <li>Vendos lëngjet nëpër shishe apo enë të ndryshme;</li> <li>Bashkon copëzat e ndara të figurave të thjeshta.</li> </ul>
Përdor veprime dhe fjalë për të treguar pozicionin dhe vendndodhjen	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lëviz për të treguar pozicionin gjatë lojës;</li> <li>Përdor objekte për të treguar pozicionin;</li> <li>Flet për objekte që ndodhen "në, mbi, poshtë, prapa, midis, brenda, jashtë, pranë" etj.;</li> <li>Përdor saktë fjalët për të treguar vendndodhjen.</li> </ul>
Përdor veprime dhe fjalë për të treguar lëvizjet dhe orientimin	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lëviz për të treguar pozicionet (p.sh. lart, poshtë, para, mbrapa, përreth, në, prej, anash, drejt);</li> <li>Shpjegon se ku kanë lëvizur objektet në dhomë;</li> <li>Përshkruan se si mund të gjendet një vend duke përdorur shenja treguese familjare;</li> <li>Ndjek një rrugë ose gjen kalimin e nevojshëm për kapërcimin e një barriere;</li> <li>Vizaton rrugë ose fillesat e një harte për të treguar vendndodhjet gjatë një loje.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët të hetojnë pozicionet dhe vendndodhjet

- Të manipulojë me lodra formuese, si p.sh. bashkimi i pjesëve të një figure etj., të pranueshme për moshën e fëmijëve dhe sa më të larmishme;
- Të nxisë fëmijët të luajnë me objekte që ndahen dhe bashkohen lehtësisht;
- Të pasurojë mjedisin e klasës me një shumëllojshmëri lodrash manipuluese (kuba me ngjyra dhe forma të ndryshme që bashkohen dhe ndahen lehtë);
- Të sigurojë një hapësirë të mjaftueshme për blloqet e të gjitha formave dhe madhësive si edhe kohën e duhur që fëmijët të luajnë me to dhe të diskutojnë për veprimet dhe krijimet e tyre;
- Të modelojë fjalorin e fëmijëve duke e shoqëruar me tregimin e pozicionit dhe vendndodhjes;
- Të lexojë me zë të lartë tekste që tregojnë për pozicione dhe vendndodhje dhe që i angazhojnë fëmijët në bashkëbisedime lidhur me këto koncepte;
- Të organizojë fëmijët në lëvizje dhe lojëra që përfshijnë pozicionet dhe vendndodhjet si për shembull "ku ka fsheh";



- Të mbështesë përpjekjet e fëmijëve për të bërë vizatime ose modele të objekteve;
- Të inkurajojë fëmijët për të bërë harta të thjeshta të mjedisit përreth tyre dhe të tregojnë rrugët që kanë bërë në vizatim me shenjat treguese.

### Vëzhgojnë format në mjedis

Arritja i referohet zhvillimit të aftësisë së fëmijëve për të identifikuar format dhe madhësitë në një mjedis. Katër treguesit kryesorë për vlerësimin e kësaj aftësie janë si më poshtë:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Vëzhgon dhe flet rreth karakteristikave të formave	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë "Rrethi është i rrumbullakët";</li> <li>• Zbulon se disa trupa i kanë anët të rrumbullakëta dhe disa të drejta;</li> <li>• Thotë që ky katrori dhe trekëndëshi kanë kënde, anë dhe vija të drejta.</li> </ul>
Përdor veprime dhe fjalë për të treguar pozicionin dhe vendndodhjen	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor blloqet për të bërë forma të tjera ose objekte;</li> <li>• Bën forma me rërë, plastelinë etj.;</li> <li>• Tenton të vizatojë forma dhe të bëjë vizatime duke përdorur format;</li> <li>• Thotë, pas prerjes së djathit "shiko, unë bëra një trekëndësh (ose katror) me djathin tim;</li> </ul>
Identifikon dhe emërton disa forma	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërton forma të thjeshta (p.sh. formë kutie, formë topi, rreth, trekëndësh, katror);</li> <li>• Thotë, "pica është e rrumbullakët, pjesa ime ka formë trekëndëshi.;</li> <li>• Thotë, jo gjithnjë saktë "Flamuri ka formë drejtkëndëshi".</li> </ul>
Tregon kur format janë të njëjta ose të ndryshme duke përdorur një ose disa nga karakteristikat	<p><b>Format tri-përmasash</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë, "Një fluskë dhe një portokall ngjajnë si topa (sfera)";</li> <li>• Thotë, "Ky blloku (formë kubi) e ka formën si një kuti";</li> <li>• Thotë, "Ky topi është i rrumbullakët, ndërsa ky blloku nuk është";</li> </ul> <p><b>Format dy përmasash</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë, "Një trekëndësh ka tri anë," ose "Një katror ka katër anë";</li> <li>• Thotë, "Një rreth është i rrumbullakët si një "ula hop"</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët në vëzhgimin e formave

- Të sigurojë sa më shumë mundësi për lojëra me blloqe dhe të nxisë bashkëbisedimet e fëmijëve rreth veprimeve dhe eksperimenteve;
- Të drejtojë pyetje me fund të hapur rreth punimeve të fëmijëve (p.sh. thotë, "Pse ky blloku e rrëzoi kullën e ndërtuar?";

- Të sigurojë një hapësirë pune për të ndërtuar me materiale të ndryshme duke bërë që fëmijët të eksplorojnë format;
- T'u lexojë me zë të lartë fëmijëve tekste që ilustronë, paraqesin forma;
- Të nxisë fëmijët të bëjnë vëzhgime dhe krahasime rreth formave;
- T'u mundësojë fëmijëve që të eksplorojnë karakteristikat e formave të ndryshme (p.sh. në qendrën e blloqeve ose në qendrën e artit)



## MODELET DHE MARRËDHËNIET

### Njohin marrëdhëniet në një mjedis të caktuar

Fëmijët kanë një kuriozitet natyral për të eksploruar botën përreth tyre dhe në hetimet e tyre fillojnë bëhen të gjitha llojet e relacioneve, të cilat janë një reflektim i të menduarit matematikor.

Dy treguesit kryesorë që vlerësojnë aftësinë e fëmijës 4-5 vjeçar për njohjen e marrëdhënieve në një mjedis të caktuar janë:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Krahason, klasifikon dhe rigrupon objektet duke u bazuar në një ose disa karakteristika	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Klasifikon objektet plastike sipas madhësisë, ngjyrës, formës ose kategorisë;</li> <li>• Krahason objektet që janë njësoj (p.sh. vendos të gjitha komçat me dy vrima në një vend dhe komçat me katër vrima në një tjetër);</li> <li>• Krahason, vendos, ballafaqon kafshët me "bebet" këlyshët e tyre;</li> </ul>
Rendit sendet sipas cilësive të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Klasifikon duke ndarë veç kafshët e mëdha nga kafshët e vogla;</li> <li>• Tregon se kush është i gjatë, më i gjatë se, më i gjati;</li> <li>• Rendit një grup blloqesh nga më i gjati te më i shkurtri.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë zhvillimin e njohjes së marrëdhënieve në një mjedis të caktuar

- Të pasurojë mjedisin me sa më shumë materiale të cilat fëmijët mund t'i klasifikojnë dhe ndajnë lehtësisht. (Këto mund të jenë produkte komerciale të riciklueshme ose të gjetura e të mbledhura, si: guriçka, boça pishe, guaska etj.).
- T'u krijojë sa më shumë mundësi fëmijëve për të ndarë e klasifikuar objekte dhe për të bërë koleksione të vogla me to;
- Të angazhojë fëmijët sa më shumë në bashkëbisedime se si ndahen dhe klasifikohen objektet
- Të organizojë lojëra dhe veprimtari të cilat përfshijnë fëmijët në klasifikimin dhe në identifikimin e modeleve.



### Përdorin modelet në një mjedis

Arritja reflekton në rritjen e aftësisë së fëmijës për të identifikuar modelin. Tre treguesit kryesorë të vlerësimit të aftësisë së fëmijës për të përdorur modelet janë:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Njeh modelet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Flet për ngjyrat ose modelin në veshje (p.sh. "Unë kam ngjyrë të kuqe dhe blu në bluzën time");</li> <li>• Identifikon modelin e ngjyrave që përsëriten (p.sh. e kuqe, blu, e kuqe, blu).</li> </ul>
Dyfishon dhe e zgjeron më tej modelin	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Imiton një model tingulli dhe një lëvizje fizike;</li> <li>• Ndjek modelin ritmik;</li> <li>• Plotëson modelin në një tregim, përrallë;</li> <li>• Përsërit modelin sipas madhësisë, ngjyrës, formës etj., gjatë vendosjes në një rresht;</li> <li>• Hamendëson se çfarë vjen pas, kur një i rritur "lexon" modelin, duke përdorur një fjalor të thjeshtë (p.sh. makinë, makinë, anije, makinë, makinë, _____);</li> </ul>
Krijon modele	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijon modele të thjeshta në një rresht me blloqe sipas ngjyrave, madhësive ose formave;</li> <li>• Krijon modele të thjeshta nëpërmjet vizatimit dhe ngjyrosjes.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët për të përdorur modelet

- Të modelojë dhe të diskutojë për modelet;
- Të angazhojë fëmijët në realizimin e trupit të modelit;
- Të sigurojë materiale për fëmijët që të bëjnë modele (mund të jenë materiale të riciklueshme, objekte të gjetura, apo edhe produkte komerciale siç janë blloqet me forma të ndryshme);
- Të lexojë me zë të lartë libra të cilat përmbajnë modele dhe fëmijët t'i plotësojnë ato;
- Të angazhojë fëmijët në këngë, kërcime, marshe dhe lojëra kërcimi që kanë në përmbajtje modele ritmike;
- Të përdorë një libërth xhepi për të krijuar dhe treguar modele me numra, shkronja, ngjyra, forma etj., dhe të angazhojë fëmijët në hamendësime për të gjetur se çfarë vjen më pas.

## MATJET

### Kryejnë krahasime

Arritja i referohet përmirësimit të aftësisë së fëmijës për të bërë krahasime dhe për të gjetur rregullin. Pesë treguesit kryesorë për këtë fushë janë:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Krahason objektet duke përdorur karakteristika të matshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor fjalë për të përshkruar të kundërtën (p.sh. i madh/i vogël, i gjatë/i shkurtër, i rëndë/i lehtë);</li> <li>• Zgjedh topin më të madh;</li> <li>• Thotë, "çanta ime është e rëndë";</li> <li>• Thotë, "shkopi im është i shkurtër"</li> </ul>
Përshkruan matjet e kryera	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Flet rreth një objekti që është më i gjatë se një tjetër;</li> <li>• Përdor një shumëllojshmëri fjalësh për të përshkruar matjet (p.sh. më i shkurtër, më i gjatë, më i gjerë, më i madh, më i rëndë, më i lehtë, mban më shumë, nxehtë, ftohtë).</li> </ul>
Vendos tre ose më shumë objekte sipas ndryshimit të gjatësisë ose të madhësisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendos shiritat sipas gjatësisë nga më i gjati te më i shkurtri ose anasjelltas;</li> <li>• Vendos makinat sipas madhësisë në një rresht;</li> <li>• Vendos kupat brenda njëra tjetrës nga më e madhja te më e vogla.</li> </ul>
Përshkruan krahasimet duke u mbështetur në kontekstin e jetës së përditshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë, "Pasditja vjen pas drekës";</li> <li>• Thotë, "Është natë sepse është errësirë";</li> <li>• Thotë, "Unë e ha mëngjesin në mëngjes";</li> <li>• Thotë, "Ditëlindja ime është në dimër";</li> </ul>
Përdor kujtesën për të përshkruar sekuencat e veprimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë, "Unë laj dhëmbët përpara se të shkoj në shtrat";</li> <li>• Thotë, "Ne shkuam te lodrat dhe më pas në dyqan";</li> <li>• Kujton jo qartë ndodhitë e fundit dhe flet për to (p.sh. Pardje ne shkuam në kopshtin zoologjik";</li> <li>• Përshkruan sekuencat e veprimtarive kur është duke shkuar në dyqan;</li> <li>• Tregon përrallën si për shembull "Tre derrkucët" sipas ndodhive përkatëse;</li> <li>• Zbulon kur një përrallë ose një tregim familjar, nuk është treguar sipas ndodhive përkatëse në mënyrë korrekte.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët për të bërë krahasime

- Të modelojë fjalorin kur bën krahasime (p.sh. pyet, "Është treni yt më i gjatë - ose më i shkurtër - se sa i Jonit?");
- Të angazhojë fëmijët në bashkëbisedim aty ku ata janë duke bërë krahasimet;
- Të lexojë me zë të lartë tregime familjare, të njohura për fëmijët dhe t'u kërkojë

atyre të hamendësojnë se çfarë vjen më pas;

- Të nxisë fëmijët të ritregojnë historinë e njohur për ta;
- Të sigurojë mundësinë që fëmijët të krijojnë një "libërth" të ilustruar me figura ku të pasqyrohet një ditë ekskursioni në natyrë;
- Të përdorë një vizatim ose kalendar xhepi që fëmijët të shënojnë ose të qarkojnë ngjarjet e rëndësishme.

### Përdorin matës

Arritja i referohet zhvillimit të aftësisë së fëmijës për t'u angazhuar në procesin e matjeve. Dy treguesit kryesorë për këtë aftësi janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Eksploron mënyrat e matjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbush një kavanoz me material të lëngshëm ose të fortë (p.sh. rërë, kuba akulli, ujë);</li> <li>• Zbraz lëngun nga një kavanoz në një tjetër;</li> <li>• Gjen se sa blloqe duhen për të mbuluar një fletë letër.</li> </ul>
Mat duke përdorur objekte	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendos njëri pas tjetrit objektet për të matur gjatësinë;</li> <li>• Përdor termometrin lodër për të matur temperaturën e "pacientit";</li> <li>• Imiton përdorimin e vizores kur ndihmon të rriturit.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët për të bërë matje

- " Të sigurojë një shumëllojshmëri mjetesh për eksperimente si mbajtëse të ndryshme, gota, kupa, peshore, vizore etj., që fëmijët të eksplorojnë me to dhe të bëjnë matje të ndryshme;
- " Të shtrojë pyetje që lejojnë fëmijët të bëjnë krahasime të cilat mund të maten nëpër qendrat e veprimtarive;
- " Të përdorë situatën në klasë për të angazhuar fëmijët në matje (p.sh. pyet, "Si mendoni a ka hapësirë të mjaftueshme në tavolinë për të vendosur akuariumin? Si mund ta gjejmë?");
- " Të modelojë mjetet matëse të cilat përdoren nga fëmijët dhe i ndihmojnë ata në matjet që kryejnë sipas qëllimit që kanë.;
- " Të nxisë fëmijët të llogarisin shuma, gjatësi etj. dhe më pas t'i ndihmojë në matje për të bërë krahasime me gjetjet e tyre.

## EKSPLORIMI I TË DHËNAVE

### Organizojnë dhe përdorin informacionin e mbledhur

Arritja i referohet aftësisë së fëmijëve për të mbledhur dhe organizuar informacion sipas qëllimit të tyre. Tre janë treguesit kryesorë për vlerësimin e aftësisë së fëmijës në organizimin dhe përdorimin e informacionit të mbledhur:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Bën pyetje për të mbledhur informacion	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyet, "Cila ngjyrë të pëlqen më shumë?";</li> <li>• Pyet, "Në cilin muaj e ke datëlindjen?";</li> <li>• Pyet, "Çfarë loje dëshiron të luash jashtë?";</li> <li>• Pyet, "Sa motra e vëllezër ke?".</li> </ul>
Ndan, klasifikon objektet në grup dhe ndonjëherë shpjegon se çfarë bashkësisht ka formuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendos bashkë objektet që kanë të njëjtin përdorim (p.sh. blloqe, enë, makina, rroba);</li> <li>• Shpjegon se si i ka grupuar komçat, kubat (p.sh. thotë, "Kam vendosur të kuqet bashkë")</li> </ul>
Vlerëson informacionin për t'iu përgjigjur pyetjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë, "Dy fëmijë e kanë datëlindjen në korrik";</li> <li>• Thotë, "Unë kam pesë kamionë dhe katër vetura";</li> <li>• Thotë, "më shumë janë komça të kuqe".</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët për të eksploruar të dhënat

- Të nxisë fëmijët për të bërë pyetje që të mbledhin informacion.
- T'ju sigurojë fëmijëve sa më shumë mundësi që të ndajnë e të klasifikojnë objekte për të bërë koleksione të vogla dhe më pas të diskutojnë se si i kanë organizuar ato.
- Të angazhojë fëmijët në bashkëbisedime se si i kanë ndarë dhe klasifikuar objektet;
- Të përdorë interesin e fëmijëve për të bërë pyetje rreth hetimit të tyre (p.sh. gjatë kohës së qëndrimit në rreth shumë fëmijë flasin për kafshët e tyre shtëpiake, "Sa qenushë keni ju të gjithë bashkë? Si do t'i gjejmë?").

## KRIJIMI I NJË MJEDISI QË NXIT TË MENDUARIN MATEMATIKOR

Kur mendojmë krijimin e një mjedisi që mbështet të menduarin matematikor është e rëndësishme të kujtojmë që matematika zhvillohet dhe zgjerohet edhe nëpërmjet fushave të tjera kurrikulare. Pikërisht ashtu sikurse gjuha dhe komunikimi që mund të zhvillohet në shumë qendra aktiviteti, mund të zhvillohet edhe matematika.

Në qendrën e leximit duhet të ketë dhe libra me përmbajtje matematikore. Në qendrën e shkrimit duhet të përfshihen edhe mjete të thjeshta si vizore, fletore matematike, peshore, të cilat ngjallin dhe nxisin te fëmijët e vegjël të menduarin matematikor.

Duhet pasur kujdes që demonstrimi i tabelave me numra dhe figura të ndryshme të jenë në nivelin e syve të fëmijëve.

Shumë i rëndësishëm është dhe pasurimi i klasës me sa më shumë materiale të ndryshme për fëmijë që të hetojnë dhe të mbështesin të menduarin dhe zhvillimin matematikor dhe t'i ftojnë ata hap pas hapi në eksplorime dhe zgjidhjen e problemeve.

Qendra e matematikës duhet të ofrojë një shumëllojshmëri materialesh dhe lojërash matematikore, p.sh. bllloqet u japin mundësi fëmijëve të zgjerojnë njohuritë e tyre matematikore.

Sigurimi i materialeve bazë (gurë, guaska, boça pishe etj.) shërbejnë që të bëhen koleksione të vogla, të përdorshme në situata të ndryshme duke marrë parasysh avantazhin që matematika është e kudondodhur.

## PËRFSHIRJA E PRINDËRVE DHE E FAMILJES

Angazhimi i prindërve për të mbështetur zhvillimin matematikor të fëmijëve është aq i kënaqshëm dhe argëtues! Një mënyrë e mirë për të përfshirë prindërit në kurrikulën e matematikës është shkëmbimi i librave me ta, mësimi i lojërave matematikore duke mundësuar realizimin e tyre edhe në shtëpi, si për shembull, libra me përralla, libra që kanë koncepte matematikore të integruara me fushën e artit. Në vazhdim, mbledhja e materialeve të printuara, mbledhja e informacioneve për mjedisin e grupit me postera me grafikë të ndryshëm, të cilat mund të kthehen në projekte familjare janë një tjetër formë e përfshirjes së prindërve të fëmijëve 4-5 vjeçarë në mësimin matematikor. Për mësuesit e interesuar për të përfshirë prindërit në mbështetje të të menduarit matematikor të fëmijëve të tyre gjenden mjaft burime, shumë prej të cilave janë të paraqitura edhe në faqet e tjera në vazhdim të këtij materiali. Prindërit mësues janë gjithashtu një burim i mrekullueshëm, për mbështetjen e punës tuaj mësimore edukative.



### 3. FUSHA E SHKENCËS DHE VËZHGIMIT

#### Qëllimet e zhvillimit shkencor dhe strategjitë e të mësuarit

Në fushën e zhvillimit shkencor mësuesit dhe prindërit duhet të dinë se janë katër komponentë në të cilat duhet të investojnë me fëmijët e tyre: shkencë fizike, shkencë e jetës, Toka dhe hapësira dhe strategjitë e të mësuarit. Në faqet e mëposhtme ju do të gjeni procesin e përbushjes së standardeve, përmes treguesve dhe shembujve, të shoqëruar me secilin nga këto komponentë të përbajtjes. Së bashku përbajtja dhe proceset e treguesve reflektojnë dimensione të ndryshme të zhvillimit shkencor të fëmijëve.

#### Shkencë fizike:

- Eksploron vetitë fizike të objekteve dhe materialeve;
- Heton vetitë fizike të objekteve dhe materialeve;
- Zgjidh problema duke përfshirë vetitë fizike të objekteve dhe materialeve;
- Prezanton vëzhgimin në forma të ndryshme.

#### Shkencë e jetës:

- Eksploron karakteristikat e gjallesave
- Heton karakteristikave e gjallesave
- Zgjidh problema lidhur me gjallesat
- Prezanton vëzhgimin rreth gjallesave në mënyra të ndryshme

#### Toka dhe hapësira

- Eksploron karakteristikat e tokës dhe të hapësirës
- Heton karakteristikat e tokës dhe të hapësirës
- Zgjidh problema duke përfshirë tokën dhe hapësirën
- Prezanton vëzhgimin rreth tokës dhe hapësirës në mënyra të ndryshme

#### Strategjitë e të mësuarit

- Tregon kuriozitet për natyrën dhe objektet e saj në mjedis të ndryshme
- Ndërmerr iniciativa vëzhgimi dhe zbulimi
- Shfaq shpirt veprimi
- Tregon dashuri dhe interes për natyrën, bimët dhe kafshët
- Përdor aftësitë problemzgjdhëse

## SHKENCA FIZIKE

### Eksplorojnë vetitë fizike të objekteve dhe materialeve

Fëmijët nga natyra janë të interesuar për objektet dhe materialet që i rrethojnë; si objektet dhe materialet manipulohen dhe ndryshohen. Sapo fëmijët fillojnë të eksplorojnë këto veti, ata njëkohësisht ndërtojnë edhe njohuritë për shkencën fizike. Tre treguesit kryesorë për të vlerësuar njohuritë rreth objekteve dhe materialeve janë:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Tregon interes për botën fizike.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komenton ndryshimet e botës fizike (p.sh. "Ne bëjmë brumin duke përzierë ujin me miellin")</li> <li>• Sheh librat e ndryshëm me ilustrime (makina të mëdha, trena, topa bore etj.) për të kuptuar se si funksionojnë gjërat dhe merr dije rreth botës fizike.</li> <li>• Komenton ndryshimet kur substancat janë të përziera, tunden, ose piqen (përziera e ngjyrave, përtimi i gjalpit, loja e gatimit)</li> </ul>
Përdor një ose më shumë shqisa për të vëzhguar botën fizike përreth.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Grumbullon objekte të formave dhe madhësive të ndryshme (guriçka, gjethe dhe lule, monedha)</li> <li>• Dëgjon dhe identifikon tingujt e mjedisit përreth (makina, aeroplan, era, shiu, zogjtë)</li> </ul>
Eksperimenton me mjete të thjeshta	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Eksploron magnete, xhama zmadhues, pikatore, pasqyra të pathyeshme, gota, tuba etj.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të ndihmuar fëmijët të eksplorojnë objekte dhe materiale

- Të sigurojë një shumëllojshmëri materialesh përdorimi ose manipulimi për fëmijët në ndërtimin e gjërave të ndryshme (blloqe të madhësive të ndryshme, tuba, kuti, litarë, kushineta krik).
- Të organizojë qendra aktiviteti ku fëmijët të eksplorojnë objekte dhe materiale. Qendra duhet të rifreskohet herë pas here për të rritur interesin e fëmijëve në ndërmarrjen e projekteve të reja.
- Të përfshijë fëmijët në veprimtari të cilat tregojnë transformimin e materialeve (gatimi, ngjyrosja, prerja dhe ngjitja)
- Të lexojë libra (me formate të mëdhenj) me zë të lartë dhe duke i vënë theksin aspektit të botës fizike.
- Të ftojë në kopsht persona që kanë lidhje me shkencën (shkencëtarë, inxhinierë, ndërtues, zjarrfikës) për të diskutuar ose demonstruar se çfarë ata bëjnë në punën e tyre dhe mjetet e nevojshme që ata përdorin.
- Të tërheqë vëmendjen e fëmijëve në drejtim të botës fizike për t'i nxitur në zhvillimin e interesave dhe veprimtarive të tyre
- Të bëjë pyetje me fund të hapur për të nxitur ndërgjegjësimin rreth botës fizike (p.sh. "Si mendoni, çfarë ndodh me topin e borës kur e lëmë mbi tavolinë?").
- Të përdorë mjete të thjeshta për të vëzhguar objekte të ndryshme (p.sh. si



xham zmadhues, lente, llupa për të vëzhguar një guaskë).

- Të nxisë fëmijët të bëjnë koleksione me objektet që i interesojnë atyre me qëllim angazhimi në ruajtjen e objekteve.

### Hetojnë vetitë fizike të objekteve dhe materialeve

Shkenca është një proces që kalon nëpërmjet kërkimit për informacion dhe dhënies së përgjigjeve në mënyrë zbuluese, të mbështetura nga një metodikë e caktuar. Tre treguesit kryesorë të vlerësimit të aftësisë së fëmijës për të zbuluar natyrën dhe objektet e saj janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Bën pyetje rreth materialeve dhe objekteve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyet, "Si bëhen kubat e akullit?";</li> <li>• Pyet, "pse ky topi i rrumbullakët është më i lehtë se sa ky tjetri?";</li> <li>• Pyet, "Pse magnetet ngjiten së bashku?".</li> </ul>
Eksperimenton me objekte dhe materiale për të mbledhur informacion rreth vëzhgimit të kryer.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendos në ujë objekte të ndryshme që pluskojnë ose fundosen duke luajtur me to;</li> <li>• Përzien bojërat gjatë vizatimit duke formuar ngjyra të ndryshme.</li> </ul>
Tregon njohuritë që ka për vetitë dhe cilësitë fizike të objekteve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Klasifikon objektet dhe materialet në bazë të përbërjes së tyre (p.sh. gurë, metal, plastikë, dru, qelq, tekstil,);</li> <li>• Klasifikon objektet dhe materialet sipas karakteristikave të ndryshme (p.sh. e butë/e fortë, pluskon/zhytet, i zhurmshëm/i qetë);</li> <li>• Tregon (jo gjithmonë saktë) se si është bërë akullorja, pudingu etj.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët të vëzhgojnë e zbulojnë cilësitë e objekteve dhe materialeve:

- Të drejtojë pyetje rreth objekteve dhe materialeve dhe të inkurajojë fëmijët të gjejnë përgjigjen e duhur
- T'u japë fëmijëve një shumëllojshmëri materialesh të cilët mund të mblidhen nga vetë ata dhe t'i angazhojë në bashkëbisedime rreth klasifikimit dhe ndarjes së objekteve.

- Të modelojë gjuhën e krahasimit (p.sh. i njomë/i thatë, i ndritshëm/i errët, i ashpër/i lëmuar).
- Të sigurojë materiale të ndryshme për shkencën nga revista e libra, interneti etj.



### Zgjidhin problema duke përfshirë vetitë fizike të objekteve dhe materialeve

Kjo gjë i referohet identifikimit të aftësive të fëmijëve për të zgjidhur në mënyrë personale problemet duke përfshirë objektet dhe materialet me të cilat veprojnë, manipulojnë ose transformojnë. Tre treguesit kryesorë janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Identifikon problemet duke përfshirë cilësitë fizike të objekteve dhe materialeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë, "Unë dua një makinë me shpejtësi të madhe";</li> <li>• Thotë, "Unë dua të ndërtojë një pallat shumë të lartë";</li> <li>• Thotë, Unë kam ngjyrat e kuqe, blu dhe të verdhë, por unë dëshiroj të gjelbrën".</li> </ul>
Eksperimenton me objekte që i japin rezultatin e dëshiruar.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëviz marshet e një makine lodër e cila lëviz me shpejtësi të ndryshme;</li> <li>• Përpiqet të krijojë një ngjyrë të re duke përzier ngjyra të ndryshme;</li> <li>• Përpiqet të gjuajë me top në shenjë.</li> </ul>
Hamendëson duke u bazuar në cilësitë e objekteve dhe materialeve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sugjeron se si të vepohet me objektet dhe materialet të cilat pluskojnë ose fundosen.</li> <li>• Supozon dhe gjen vetë se cili çelës e bën makinën të ecë më shpejt ose më ngadalë.</li> <li>• Hamendëson cilin objekt e tërheq magneti ose e shtyn (p.sh. bimë, pambuk, kapëse letrash, lodrat).</li> <li>• Bën sugjerime çfarë e bën akullin të ngrijë më shpejt.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët të zgjidhin probleme me vetitë e objekteve dhe materialeve

- Të bëjë pyetje me fund të hapur (p.sh. "Çfarë duhet të bëjmë që makina të ecë edhe më shpejt?" ose "Çfarë ndodh nëse magneti prek kapësen e letrave?");
- T'i japë përparësi spontanitetit për zgjidhjen e problemeve me substanca dhe objekte (p.sh. gjatë ngrënies së mëngjesit kur diçka derdhet; në këndin e blloqeve kur fëmijët tentojnë të ndërtojnë kulla të larta);
- T'u sigurojë fëmijëve kohë dhe hapësirë të mjaftueshme për të punuar me objekte dhe materiale që të vazhdojnë vetë kërkimin e tyre (p.sh. të ndërtuarit me blloqe);
- Të furnizojë fëmijët me sa më shumë materiale për të eksperimentuar (p.sh. për të parë se si qarkullon uji në enët komunikuese, se si pluskojnë dhe zhyten materiale të ndryshme; për të parë se si pupla ose copat e letrës notojnë në ujë dhe çfarë ndodh kur ato lagen dhe zhyten ose kur i përziejmë me kallam);
- Të angazhojë fëmijët në hamendësime se çfarë ndodh kur ata eksperimentojnë;
- T'u japë mundësi fëmijëve të testojnë hamendësimet e tyre;
- Të inkurajojnë fëmijët të ndërtojnë njohuritë në bazë të përvojës së tyre duke bërë lidhje me atë çfarë dinë për objektet dhe kafshët.

### Paraqesin vëzhgimin e botës fizike në forma të ndryshme

Arritja i referohet aftësive të fëmijëve për të demonstruar në mënyra të ndryshme, se çfarë perceptojnë ata nëpërmjet shqisave të tyre për botën fizike. Katër treguesit kryesorë të vlerësimit të vëzhgimit të botës fizike janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Paraqesin vëzhgimin nëpërmjet lojërave pretenduese	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën sikur rregullon diçka/gatuan</li> <li>• Përdor mjete të thjeshta (magnete, xhama zmadhues, prizma, epruveta) në lojëra pretenduese;</li> <li>• Angazhohet në lojëra me role (p.sh. bën sikur është shkencëtar, doktor, ndërtues, artist, shofer etj.)</li> </ul>
Përfaqëson vëzhgimin nëpërmjet muzikës dhe lëvizjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën sikur rrëshqet në akull, luan me burrin prej bore;</li> <li>• Bën sikur po ngrihen valët e detit;</li> <li>• Këndon këngë me lëvizje;</li> <li>• Krijon këngë rreth përvojave që ka për botën fizike.</li> </ul>
Përfaqëson vëzhgimin nëpërmjet artit dhe ndërtimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërton dhe/ose vizaton ndërtesa të larta, rrugë, ura, tunele, makina etj.;</li> <li>• Me qëllim përziën ngjyrën blu me të verdhë për të përftuar të gjelbrën;</li> <li>• Vizaton "harta" ose "skica" si një ndërtues i vërtetë.</li> </ul>
Flet rreth botës fizike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyet, "si e bëtë këtë?"</li> <li>• i thotë një shoku, "Në qoftë se ti do të shtosh edhe një bllok në ndërtimin tënd, ai do rrëzohet".</li> </ul>

Flet rreth botës fizike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan objektet duke pasur parasysh madhësinë, formën, ngjyrën ose shpejtësinë;</li> <li>• Emërton mjetet (xham zmadhues, magnet, shkallë, vinç);</li> <li>• Përdor fjalët e duhura për të cilësuar objektet (p.sh. e ashpër, e butë, e lëmuar, e fortë);</li> <li>• Përdor fjalët e duhura për matjen (p.sh. e rëndë/e lehtë, e nxehtë/ e ftohtë, e vogël/e madhe, e gjatë/e shkurtër, shpejt/ngadalë).</li> </ul>
-------------------------	--

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët në vëzhgimin e botës fizike

- Të angazhojë fëmijët në bashkëbisedime rreth botës fizike;
- Të nxisë tek ata që të prezantojnë vëzhgimin e tyre;
- Të angazhojë fëmijët në përvoja muzikore dhe këngë ku mund të shpalosin vëzhgimin e tyre;
- Të sigurojë burime dhe materiale që ata të eksperimentojnë vëzhgimin e tyre nëpërmjet të shkruarit dhe vizatimit
- T'u japë fëmijëve personazhin e duhur në lojën me role;
- Të pasurojë klasën me sa më shumë materiale
- Të modelojë fjalorin për të përshkruar botën fizike
- Të parashikojë sa më shumë mundësi (në rreth ose në këndin e shkencës) për fëmijët që të prezantojnë idetë e tyre se si funksionon bota fizike dhe t'i shkëmbejnë ato edhe me fëmijët e tjerë.



## SHKENCA E JETËS

### Eksplorojnë karakteristikat e gjallesave

Arritja i referohet zhvillimit të fëmijëve në të kuptuarit e ndryshimit midis gjallesave dhe sendeve, si edhe se si rriten dhe ndryshojnë gjallesat. Dy treguesit kryesorë të vlerësimit për aftësinë e zbulimit të karakteristikave të gjallesave janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Tregon interes për ndryshimet që pësojnë bimët dhe kafshët.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Komenton ndryshimet e gjallesave (p.sh. bebja rritet dhe bëhet i madh, farat bëhen bimë, zogjtë lindin nga vezët).</li> <li>Thekson mirë që gjetet ndryshojnë ngjyrën, pemët kanë degë dhe gjethe, lulet lulëzojnë.</li> <li>Sheh librat, revistat dhe posterat të cilat kanë pamje me gjallesa të ndryshme.</li> </ul>
Përdor një ose më shumë shqisa për të vëzhguar natyrën përreth	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shpreh habi/entuziazëm rreth gjallesave (p.sh. për lepujt, peshqit, merimangat, lulet).</li> <li>Thotë, "Unë dëgjoj zogjtë që cicërojnë", ose "Qeni po leh".</li> <li>Thotë, "Po i marr erë kësaj luleje"</li> <li>Komenton shijet e ndryshme të ushqimeve</li> <li>Mban në dorë ose vështron lëvizjet e një krimbi ose të insekti të vogël.</li> <li>Kap kandra dhe i vendos ato në një mbajtëse, kavanoz.</li> <li>Përdor llupën për të vëzhguar gjallesat.</li> <li>Ekzaminon gjethe, boça pishe, guaska etj.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët të eksplorojnë karakteristikat e gjallesave

- Të vendosë në kopsht një akuarium, një maket ferme dhe të nxisë fëmijët të vëzhgojnë dhe të kujdesen për to.
- Të angazhojë fëmijët në veprimtari me objekte natyrale ose gjallesa (gjithmonë duke pasur kujdes ndaj fëmijëve)
- Të tërheqë vëmendjen e fëmijëve për gjallesat sa herë që i jepet rasti.
- Të organizojë shëtitje në natyrë për të eksploruar gjallesat.
- T'u japë mundësi fëmijëve për të bërë koleksione me fara, gjethe, boça pishe, guaska etj. dhe të diskutojnë për karakteristikat e koleksioneve që kanë mbledhur.
- Të angazhojë fëmijët në mbjelljen e farave (brenda dhe jashtë klasës) dhe të vëzhgojë herë pas here se si ato rriten dhe ndryshojnë.
- Të përdorë burime të ndryshme nga interneti, CD. që tregojnë për ciklin jetësor të përshtatura për fëmijët si një burim të mirë për të rritur sa më shumë vëzhgimin e fëmijëve.

### Hetojnë karakteristikat e gjallesave

Fëmijët tërhiqen shumë nga transformimi i gjallesave, cilësive dhe karakteristikave të tyre, duke bërë krahasime me veten dhe duke zhvilluar njëkohësisht konceptin e ciklit jetësor. Kurioziteti natyral fëmijëror, kërshtëria janë një inspirim i mirë, shtytje, për fillesat e kërkimit dhe hetimit shkencor për botën natyrore. Tre treguesit kryesorë të vlerësimit të aftësisë vëzhguese të fëmijëve janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Bën pyetje rreth botës natyrore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyet, "Pse gurët nuk rriten?"</li> <li>• Pyet, "Nga vijnë bebet?"</li> <li>• Pyet, "Nga se formohet mjegulla në dimër?"</li> <li>• Pyet, "Si merr frymë peshku?"</li> <li>• Pyet, "Po kafshët si ushqehen?"</li> </ul>
Mbledh informacion për të mësuar rreth gjallesave	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Koleksionon gjethë, boça pishe, fara, kandra etj.</li> <li>• Përdor llupën për të vëzhguar një merimangë.</li> <li>• Përdor dylbi (edhe lodër) për vëzhguar natyrën (p.sh. zogjtë, pemët).</li> <li>• Sheh libra, revista për të mësuar rreth gjallesave.</li> </ul>
Tregon njohuri rreth karakteristikave të gjallesave	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjen ngjashmëritë ndërmjet kafshëve;</li> <li>• Bashkon kafshët mami-bebja në piktura dhe vizatime;</li> <li>• Klasifikon koleksionet e bëra;</li> <li>• Flet për ndryshimet ndërmjet kafshëve (p.sh. zogjtë kanë flatra, peshku jeton në ujë, qentë dhe macet kanë qime, gëzof.</li> <li>• Identifikon gjallesat përkundrejt jo gjallesave (p.sh. "Ky është një gjarpër plastik").</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët të hetojnë karakteristikat e gjallesave

- T'u drejtojnë fëmijëve pyetje që nxisin interesin e tyre për të vëzhguar gjallesa në mjediset e kopshtit dhe tij (p.sh. Si mendoni, ku jetojnë gjallesat?"ose "Pse kanë rënë këto gjethë?").





- Të përdorë pyetjet e fëmijëve dhe interesin e tyre për gjallesa specifike (p.sh. milingonën, lulet) për t'i angazhuar ata në projekte të cilat zgjerohen dhe plotësohen nëpërmjet zhvillimit të kurrikulës.
- Të lexojë libra me zë të lartë për gjallesat dhe ciklin jetësor, si dhe të angazhojë fëmijët në bashkëbisedime rreth këtyre informacioneve.
- Të organizojë diskutime rreth funksionimit të trupit të njeriut dhe shqisave duke bërë pyetje (p.sh. "Nga e kuptoni që jeni të uritur?").
- T'u japë mundësi fëmijëve të mbajnë në duar kafshë, insekte, zhapikë etj., për të eksploruar karakteristikat e tyre (gjithmonë në radhë të parë të mbizotërojë kujdesi dhe siguria e fëmijëve).
- T'u japë mundësi fëmijëve të realizojnë koleksionin e tyre, ose punimet artistike me materiale natyrore (p.sh. guaska, fara të ndryshme, gjethe, pendë).
- Të nxisë fëmijët të prezantojnë idetë dhe vëzhgimet e tyre për gjallesat në forma të ndryshme mediatike.

### Zgjidhin problema lidhur me gjallesat

Arritja i referohet aftësisë së fëmijëve **për të identifikuar** dhe për të zgjidhur problemet që kanë të bëjnë me gjallesat dhe botën natyrore. Tre treguesit kryesorë të vlerësimit të aftësive të fëmijëve për të zgjidhur problema me gjallesat janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Identifikon problemet duke përfshirë gjallesat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komenton përse bien gjethe, kur ato shndërrohen</li> <li>• Ankohet, proteston përse kafazi i kafshëve ka erë të keqe.</li> <li>• Thotë, "unë nuk mund të luaj jashtë sepse mund të më pickojnë insektet".</li> </ul>
Njih faktin që gjallesat kanë nevoja	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë, "Lulet kanë nevojë për ujë".</li> <li>• Thotë, "Mua më hahet".</li> </ul>
Bën hamendësime duke u bazuar në përvojën e gjallesave.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë, "Bebja e pulës del jashtë nga veza".</li> <li>• Thotë, "Në qoftë se ne nuk i ujisim lulet, ato vdesin".</li> <li>• Thotë, "Kur qeni sjell topin, ai kërkon të luajë".</li> <li>• Thotë, "Kur bebja qan, ajo ka nevojë për mamin".</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët për të zgjidhur problemat lidhur me gjallesat

- Të bëjë të njohur, të demonstrojë vëzhgimin e fëmijëve për ndryshimet e gjallesave (përfshirë edhe qeniet njerëzore) dhe të ndihmojë ata të realizojnë lidhjen shkaktuese.
- Të modelojë kujdesin për gjallesat (p.sh. bimët, kafshët, reptilët dhe ata vetë).
- Të lexojë me zë të lartë libra të cilat lidhen me shqetësimet për gjallesat.
- Të bëjë pyetje për të nxitur problem-zgjidhjen (p.sh. pyesni "Si mendoni përse kafazi i kafshëve ka erë të keqe?").
- Të japë sa më shumë mundësi për të vëzhguar dhe për të ndërvepruar me gjallesat (brenda dhe jashtë).
- Të modelojë kërshërinë dhe interesin ndaj botës natyrore.

### Prezantojnë vëzhgimin rreth gjallesave në mënyra të ndryshme

Arritja i referohet aftësisë së fëmijëve për të shprehur atë çfarë ata perceptojnë nga ndërveprimi me gjallesat në kontakt të drejtpërdrejt me botën natyrore. Katër treguesit kryesorë të vlerësimit të aftësisë vëzhguese të fëmijëve janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Përfaqëson vëzhgimin nëpërmjet lojës pretenduese	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Angazhohet në lojë me role (p.sh. bën si veteriner, kopshtar, doktor, fermer, lulishtar, prindër etj.);</li> <li>• Pretendon të jetë një kafshë (p.sh. qen, elefant, zog).</li> </ul>
Përfaqëson vëzhgimin nëpërmjet muzikës dhe lëvizjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëviz si një elefant, merimangë, gjarpër etj.;</li> <li>• Këndon këngë për gjallesat;</li> </ul>
Përfaqëson vëzhgimin nëpërmjet artit dhe ndërtimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vizaton ose pikturon kafshë;</li> <li>• Përdor blloqet për të ndërtuar një fermë;</li> <li>• Vizaton ose pikturon familjen e tij.</li> </ul>
Flet rreth bimëve dhe kafshëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Flet rreth familjeve të kafshëve dhe këlyshëve të tyre, gjithashtu për mbresat nga vizita në kopshtin zoologjik etj.;</li> <li>• Komenton se si të kujdesesh për një këlysh (shtëpiak) të vogël;</li> <li>• Përdor fjalë si gjethe, pemë, lule, në bashkëbisedimet e tij;</li> <li>• Përdor emrat e gjallesave (p.sh. elefant, lopë, zog, peshk, qen, merimangë, insekt, lule, pemë, bar).</li> <li>• Përdor fjalë si sqep, flatra, lëkurë, guaskë, kokë, bisht, kthetra, pendë, gëzof në bashkëbisedim.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë aftësitë e fëmijëve për të paraqitur vëzhgimin e tyre rreth gjallesave

- Të sigurojë mjetet e nevojshme si blloqe, pamje kafshësh, njerëzish, të përshtatura për fëmijë në mënyrë që ata të luajnë me to dhe të diskutojnë për veprimet dhe krijimet e tyre.
- Të hartojë një libër klase, në të cilin ngjiten dhe pasqyrohen përshtypjet e fëmijëve nga vëzhgimet e kryera në kopshtin zoologjik, gjatë ekskursioneve etj.
- Të ftojë në klasë vizitorë me profesione si veteriner, fermer, infermier
- Të mbështesë lojën pretenduese të fëmijëve me gjallesat
- Të modelojë fjalorin që përdoret për përshkrimin e karakteristikave të botës së gjallë.
- Të pajisë klasën me libra tërheqës për të përfshirë fëmijët në botën natyrore të gjallesave.
- Të angazhojë fëmijët në veprimtari muzikore dhe artistike për të imituar gjallesat dhe tingujt që ata bëjnë
- Të mbështesë tentativën e fëmijëve për të bërë piktura ose skulptura (plastelinë, brumë, pastele etj.) me gjallesa.



## TOKA DHE HAPËSIRA

### Eksplorojnë karakteristikat e tokës dhe të hapësirës

Arritja i referohet interesit dhe kuriozitetit të fëmijëve për tokën dhe hapësirën. Tre treguesit kryesorë të vlerësimit për këtë aftësi të fëmijëve janë :

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Tregon interes për tokën dhe hapësirën	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komenton ndryshimet e motit, retë, stinët;</li> <li>• Sheh libra dhe revista rreth tokës dhe hapësirës.</li> </ul>
Përdor një ose më shumë shqisa për të vëzhguar tokën dhe hapësirën	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Luan, koleksionon, ekzaminon gurë, vende, baltë, rërë, guaska etj.;</li> <li>• Vëzhgon hijen</li> <li>• Thotë, "Unë dëgjoj shiun (stuhinë, erën, shkretimat)";</li> <li>• Vrojton retë, yjet dhe hënën;</li> </ul>
Përdor mjete të thjeshta për të eksploruar tokën dhe hapësirën	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor mjete të ndryshme (sitë, kovë, lopatë) për të eksploruar pluhurin, baltën, rërën dhe gurët;</li> <li>• Përdor një elektrik dore për të formuar hijen;</li> <li>• Luan me pajisjet matëse (p.sh. termometër, matës shiu, vizore, gota, broke)</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët të eksplorojnë karakteristikat e tokës dhe hapësirës:

- Të tërheqë vëmendjen e fëmijëve drejt motit, ndryshimeve klimaterike, stinëve dhe t'i angazhojë ata në bashkëbisedime për atë çfarë shohin, dëgjojnë dhe ndiejnë;
- Të sjellë në klasë sa më shumë libra dhe revista për tokën dhe hapësirën;
- Të organizojë lojëra të tilla që fëmijët të mund të luajnë me rërë dhe baltë;
- Të angazhojë fëmijët në lojëra që të mësojnë për hijen
- Të lexojë me zë të lartë sa më shumë histori për tokën dhe hapësirën, hënën dhe yjet, etj.;
- Të nxisë fëmijët që të krijojnë koleksione me gurë të ndryshëm.

### Hetojnë karakteristikat e tokës dhe të hapësirës

Njohuritë e fëmijëve të vegjël për tokën dhe hapësirën janë të ndërtuara në mënyrë konkrete, të drejtpërdrejtë nëpërmjet hetimit të atyre materialeve dhe proceseve që ngjallin interes për ta. Tre treguesit kryesorë të vlerësimit të kësaj aftësie të fëmijës janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Bën pyetje rreth tokës dhe hapësirës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyet, " Si bëhet balta?";</li> <li>• Pyet, " Pse ky guri shkëlqen?";</li> <li>• Pyet, " Si formohet shkrepitima dhe vetëtima?";</li> <li>• Pyet, " Pse bie bora?";</li> <li>• Pyet, " Pse hëna zhduket gjatë ditës?";</li> <li>• Pyet, " Ku shkon dielli të flejë?";</li> <li>• Pyet, " Pse hëna më ndjek mua ?".</li> </ul>
Kryen eksperimente për të fituar njohuri për tokën dhe hapësirën	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shton ujë në enën me rërë për të bërë baltën;</li> <li>• Kërkon për gurë në forma të rregullta;</li> <li>• Përpiqet të ndryshojë gurët (p.sh. i thyen ato në copëra të vogla ose i bën ata të ndriçojnë duke i larë me ujë ose duke i fërkuar me vaj).</li> <li>• Ngjyros me bojëra uji gurët</li> </ul>
Demonstron njohuri për ndryshimet e tokës dhe hapësirës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komenton ndryshimet e motit, retë, temperaturat, dita - nata;</li> <li>• Thotë, "Hëna ka formë tjetër sonte";</li> <li>• Komenton ndryshimet e barit, prerjes e dëmtimit të drurëve, rërës, pellgjeve me ujë të vendeve të ndryshme etj.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët për të hetuar cilësitë e tokës dhe hapësirës

- Të angazhojë sa më shumë fëmijët në lojëra me rërë dhe ujë dhe të nxisë biseda rreth veprimeve dhe eksperimenteve të tyre;
- Të bëjë pyetje me fund të hapur për të motivuar vëzhgimin e fëmijëve (p.sh. pyesin, "Si mendoni, pse pellgu me ujë është zhdukur?");
- Të sigurojë një mjedis jashtë kopshti ku fëmijët mund të gërmojnë, të luajnë me ujë etj.;
- Të nxisë fëmijët të bëjnë vëzhgime dhe krahasime për qiellin, motin dhe stinët;
- T'u japë fëmijëve mundësi të eksplorojnë cilësitë e gurëve dhe mineraleve të ndryshme, lloje të ndryshme dherash etj.

### Zgjidhin problema që përfshijnë tokën dhe hapësirën

Arritja i referohet aftësisë së fëmijëve për të **identifikuar** dhe **zgjidhur** në mënyrë personale problemat që lidhen me tokën dhe me hapësirën. Dy treguesit kryesorë të aftësisë së fëmijëve në problem zgjidhje janë:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Identifikon problemet që përfshijnë tokën dhe hapësirën	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë, "Është ftohtë jashtë";</li> <li>• Thotë, "Unë nuk mund të eci në rërë kur është e nxehtë";</li> <li>• Thotë, "Këpucët e mia qullen, kur unë futem në pellg";</li> <li>• Thotë, "Unë nuk mund të gërmoj në këtë vend të fortë";</li> </ul>
Hamendëson për tokën dhe hapësirën duke u bazuar në përvojat e tij	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë, "Ne do të luajmë jashtë se është kohë me diell";</li> <li>• Thotë, "Unë mendoj se bora do të shkrijë sepse dielli po shkëlqen";</li> <li>• Thotë, "Unë rrëshqas në akull";</li> <li>• Thotë, "Po bie shumë shi, ne nuk mund të shkojmë gjëkund";</li> <li>• Thotë, "Uji dhe pluhuri bëjnë baltën".</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët për të zgjidhur problemat lidhur me tokën dhe hapësirën

- Të mbështesë spontanitetin e ndodhive të ditës për të motivuar zgjidhjen e problemave (p.sh. dilet jashtë pasi ka pushuar shiu për të parë pellgjet e formuara);
- T'u sigurojë fëmijëve kohën dhe hapësirën e duhur për të ndjekur kërkimet e tyre nëpërmjet lojërave të ndryshme si ato me rërë dhe ujë, gurë etj.;
- Të angazhojë fëmijët në lojën me hije;
- Të angazhojë fëmijët në hamendësime se çfarë ndodh kur ata eksperimentojnë;
- Të motivojë fëmijët për të bërë lidhje me përvojën që ata kanë për të ndërtuar atë çfarë dinë për tokën, qiellin, motin, stinët etj.



### Prezantojnë vëzhgimin rreth tokës dhe hapësirës në mënyra të ndryshme

Arritja i referohet aftësisë së fëmijëve për të komunikuar vëzhgimet e tyre për tokën dhe hapësirën në mënyra të ndryshme. Katër janë treguesit kryesorë të vlerësimit të kësaj aftësie te fëmijët:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Prezanton vëzhgimet nëpërmjet lojës pretenduese	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Angazhohet në lojën me role (p.sh. bëhet si spikeri i motit, astronaut, fermer).</li> <li>• Vesh, zhvesh kukullat sipas stinëve;</li> <li>• Përdor mjete të thjeshta (p.sh. llupa, dylbi, harta, furça, kova) për të luajtur.</li> </ul>
Prezanton vëzhgimin nëpërmjet muzikës dhe lëvizjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëviz si era, raketa, astronauti në hapësirë, dinozauri etj.;</li> <li>• Këndon këngë të njohura (bie shiu pika-pika..etj.);</li> <li>• Krijon këngë për tokën dhe hapësirën.</li> </ul>
Prezanton vëzhgimin nëpërmjet artit dhe ndërtimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Formon male me baltë, rërë dhe ujë;</li> <li>• Vizaton ose pikturon qiellin, hënë, yjet, diellin tokën etj.;</li> <li>• Përdor blloqet për të bërë burrin prej bore, raketën kozmike, shpellat, dinozaurin etj.</li> </ul>
Flet rreth tokës dhe hapësirës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan gurët sipas madhësisë, formës dhe ngjyrës;</li> <li>• Thotë, "Yjet dhe hëna dalin natën";</li> <li>• Flet për ditë-natën;</li> <li>• Flet për stinët me radhë: dimri, pranvera, vera, vjeshta.</li> <li>• Përdor fjalët për tokën (p.sh. dheu, oqeani, mali, rëra, gurët, lumi, liqeni, përroi);</li> <li>• Përdor fjalë për motin (p.sh. shi, erë, borë, mjegull, diell, re, temperatura);</li> <li>• Përdor fjalë për hapësirën (p.sh. hëna, yjet, dielli, qielli, ajri)</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët për të prezantuar vëzhgimin

- Të bëjë pyetje me fund të hapur (p.sh. pyetje *pse* dhe *si*) për të angazhuar fëmijët në bashkëbisedim për elementët e tokës dhe hapësirës;
- Të nxisë fëmijët të prezantojnë vëzhgimin e tyre rreth stinëve, reve, lumenjve, maleve, edhe komponentëve të tjerë të tokës dhe hapësirës në mënyra të ndryshme;
- Të mundësojë burime të ndryshme që fëmijët të prezantojnë vëzhgimin e tyre duke eksperimentuar me të shkruarin ose të vizatuarin (p.sh. një stuhi, qielli me yje);
- Të pasurojë kopshtin me postera, libra të ndryshëm, revista që pasqyrojnë tokën dhe hapësirën;
- Të ftojë në klasë persona me profesione të ndryshme (gjeolog, meteorolog, minator) për të diskutuar dhe demonstruar se çfarë bëjnë në punën e tyre si edhe mjetet që përdorin;

- Të modelojë fjalorin për tokën dhe hapësirën (p.sh. moti dhe stinët, emërtimi i mjeteve);
- Të sigurojë sa më shumë mundësi (p.sh. gjatë kohës së qëndrimit në rreth, në qendrën e veprimtarive) që fëmijët të prezantojnë idetë e tyre rreth tokës dhe hapësirës dhe t'i shkëmbejnë idetë e tyre edhe me shokët e grupit.

## KRIJIMI I NJË MJEDISI STIMULUES PËR TË NXITUR TË MENDUARIN SHKENCOR

Një **mjedis** që u nxit fëmijëve interesin për shkencën, është ai që **stimulon kërkimin dhe eksperimentin**. Për fëmijët e vegjël, procesi i të menduarit shkencor fillon me kuriozitetin dhe pyetjet (pse-të).

Në këndin e shkencës, në klasë, vendosen **punime interesante** nga bota e natyrës fizike bashkë me instrumente e mjete shkencore si llupa, matës, vazo të formave të ndryshme, tuba, rërë, ujë, magnete, bulona, rrota, litarë. Në këtë mënyrë fëmijët duke u tërhequr nga kurioziteti i japin përgjigje pyetjeve që parashtrajnë duke eksperimentuar e manipuluar vetë.

Kërkohet sigurimi i materialeve bazë (p.sh. gurë, guaska, boça pishe) për të ndihmuar fëmijët të vetë eksplorojnë.

Në mënyrë periodike prezantohen mjetet e reja duke zhvendosur ato të mëparshmet dhe duke rritur në këtë mënyrë interesin e fëmijëve.

Një gjë që duhet të mbahet parasysh është që interesi shkencor i fëmijëve rritet në mënyrë të vazhdueshme veçanërisht kur njohuritë dhe aftësitë shkencore janë të **përfshira edhe në fushat e tjera kurrikulare**. Për shembull, fusha e artit i jep mundësi fëmijëve të eksperimentojnë me ngjyrat në mënyrë të natyrshme duke pikturuar, duke luajtur me plastelinë, rërë, brumë (miell+ujë).

Një shumëllojshmëri librash me figura dhe tekste për natyrën, tokën e hapësirën, botën fizike, të vendosura në qendrën e leximit do të mbështeste fuqishëm të menduarin shkencor të fëmijëve.

Pajisjet për kërkimin shkencor duhet të jenë sa më të thjeshta që të kuptohen nga fëmijët: një enë e vogël plastike mund të shërbejë për të bërë eksperimentet me ujë; materialet bazë dhe të riciklueshme mund të shërbejnë për të nxituri të fëmijët të eksperimentuarin, kërkimin.

## PËRFSHIRJA E PRINDËRVE DHE E FAMILJES

Puna me prindërit dhe familjarët për të mbështetur fëmijët në të menduarin shkencor është njëkohësisht një punë e lodhshme dhe e këndshme

Nxiten familjarët:

- të gatujnë bashkë me fëmijët,
- të ndër marrin shëtitje rreth zonës së tyre të banimit,
- të vëzhgojnë natyrën,
- të krijojnë koleksione me gurë, gjethë, boça pishe etj.
- të vëzhgojnë hënën dhe yjet bashkë me fëmijën

Këto janë forma e mënyra shumë të mira për të përfshirë prindërit në kurrikulën e shkencës me fëmijët.

Dhënia e librave, prindërve, me fakte e tematika shkencore ndikon në rritjen e interesit për shkencën

Në vazhdim, mbledhja e të dhënave, gjetja e informacionit për projektin e kopshtit është një mënyrë tjetër për përfshirjen e prindërve në fushën e shkencës.





## 4. FUSHA SOCIALE DHE EMOCIONALE

### Qëllimet sociale dhe emocionale dhe strategjitë e të mësuarit

Në fushën e zhvillimit social ekzistojnë tre komponentë: njohja e vetes, njohja e të tjerëve dhe strategjitë e të mësuarit. Në faqet e mëposhtme ju si mësues dhe prindër do të gjeni procesin e përmbushjes së standardeve, përmes treguesve dhe shembujve, të shoqëruar me secilin nga këto komponentë të përmbajtjes. Së bashku përmbajtja dhe proceset e treguesve reflektojnë dimensione të ndryshme të zhvillimit social dhe emocional.

#### Njohja e vetes

- Demonstron vet ndërgjegjësimit.
- Zhvillon vet kontrollin
- Zhvillon përgjegjësinë personale

#### Njohja e të tjerëve

- Ndërton marrëdhënie të besimit dhe respektit reciprok dhe të vazhdueshëm me të tjerët
- Bashkëpunon me fëmijët dhe të rriturit.

#### Strategjitë e të mësuarit

- Tregon kuriozitet
- Ndërmerr iniciativa
- Shfaq shpirt krijimtarie
- Tregon besim dhe vet besim
- Përdor aftësitë problemzgjdhëse

## NJOHJA E VETES

### Zhvillojnë vet- ndërgjegjësim

Treguesit socialë i referohen rritjes së fëmijës 4-5 vjeçar në lidhje me ndërgjegjësimin e tij, aftësitë dhe preferencat si dhe informacionin personal. Këtu janë tre tregues që vlerësojnë se sa fëmija demonstroi vetëndërgjegjësim:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Tregon respekt për veten	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngrihet në mbrojtje të të drejtave të veta dhe të nevojave që ka</li> <li>• Njeh mundësitë vetë realizuese (thotë, p.sh. Unë mund të ngjitem në atë pemë)</li> <li>• Përdor aftësitë vet ndihmuese (p.sh. lan duart me sapun dhe ujë, përdor furçën e dhëmbëve me asistencën e një të rrituri, provon ushqimet e reja etj.)</li> </ul>
Zhvillon pëlqimet personale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën zgjedhje</li> <li>• Shpreh pëlqimet dhe mos pëlqimet e tij</li> <li>• Zgjedh ngjyrën, ushqimin, këngën, mikun e preferuar etj.</li> </ul>
Njeh informacionin personal	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan veten duke përdorur disa prej karakteristikave të tij bazë (p.sh. gjinia, mosha, ngjyra e flokëve dhe e syve etj.)</li> <li>• I referohet vetes nga emri dhe mbiemri</li> <li>• Njeh emrat e prindërve dhe të mësueseve</li> <li>• Mund të njohë adresën e shtëpisë dhe numrin e telefonit</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të mbështetur zhvillimin e vet ndërgjegjësimit

- T'u japë mundësi fëmijëve për të shprehur pëlqimet dhe për të bërë zgjedhje gjatë ditës (në kohën e lojës apo në kohën e pushimit)
- Të respektojë pëlqimet dhe vendimet e fëmijëve (gjithnjë në përputhje me arsyen dhe rregullat e sigurisë)
- Të pranojë idetë dhe opinionet e fëmijëve
- Të zhvillojë lojëra të ndryshme si p.sh. loja e emrave që i ndihmon fëmijët të mësojnë dhe të kujtojnë informacionin personal

**Zhvillojnë vetëkontroll**

Arritja i referohet rritjes së aftësisë së fëmijës për të kontrolluar impulset dhe për të marrë pjesë në veprimtari me të tjerët, po aq mirë sa dhe për të pranuar ndryshimet e rrethanave në mënyra të përshtatshme dhe të kulturuara. Këtu janë katër treguesit e zhvillimit të vetëkontrollit:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Ndjek rregulla të thjeshta	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjek pak rregulla të qarta dhe të qëndrueshme në shtëpi dhe në klasë</li> <li>• Ndjek rregullat e bëra me të rriturit ose bashkëmoshatarët gjatë një loje</li> <li>• Ndjek rregullat e sigurisë</li> </ul>
Pranon kalimet nga një veprimtari në tjetrën dhe ndjek rutinat ditore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton dhe ndjek skedat apo rutinat ditore në shtëpi dhe në shkollë</li> <li>• Menaxhon kalimet e buta nga një veprimtari në tjetrin (p.sh. shkon në banjë të lajë duart, të ushqehet, të dëgjojë një histori etj.)</li> <li>• Ndahet lehtësisht nga prindërit në mëngjes</li> </ul>
Shpreh ndjenjat përmes gjeve të përshtatshme, veprimeve dhe gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon emocionet e veta (p.sh. thotë "Unë jam i gëzuar sepse...." ose "unë po qaj sepse....")</li> <li>• Ndan gëzimin ose suksesin me një fëmijë tjetër</li> <li>• I ofron ndihmë dikujt që ka nevojë</li> <li>• Përdor lojën e pretenduar për të kuptuar dhe për t'ju përgjigjur ndjenjave</li> <li>• Kontrollon impulsin marrjes së një objekti nga një fëmijë tjetër (p.sh. përdor fjalë të përshtatshme në vend që të rrihet me të)</li> </ul>
Përshtatet në mjedise të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshtat sjelljen sipas udhëzimeve që i jepen në mjedise të ndryshme (p.sh. në librari, shtëpi, sheshin e lojës apo në shkollë)</li> <li>• Ndjek rregullat për të cilat është ndërgjegjësuar në mjedise të ndryshme</li> </ul>

**Strategjitë e mësuesit për të nxitur aftësinë e vet kontrollit**

- Të modelojë fjalorin e fëmijëve për të shprehur ndjenjat nëpërmjet gjuhës
- Të njohë dhe të nxisë shprehjen e ndjenjave të fëmijëve
- Të angazhojë fëmijët në biseda se si duhet të sillen në situata të ndryshme
- Të përdorë literaturën për të ndihmuar fëmijët të marrin në konsideratë ndjenjat e të tjerëve
- Të shfrytëzojë ngjarjet në grup për të shpjeguar nevojën për rregulla dhe për të përfshirë fëmijët në bërjen e rregullave dhe zgjidhjen e konflikteve
- Të japë sinjale të qarta të kalimit nga një veprimtari në tjetrën nëpërmjet muzikës, këngës, ziles etj.
- Të krijojë një vend ndenjeje ku jepen skedat e ditës dhe tregohen ngjarjet (ditore, javore etj.) në mënyrë që fëmijët të kuptojnë sa më shumë (p.sh. me piktura, foto ose simbole)
- Të vendosë rutina që marrin në konsideratë nevojat e fëmijëve për pushim, veprimtari, lojë, bashkëbisedim etj.

### Zhvillojnë përgjegjësinë personale

Arritja i referohet sensit në rritje të fëmijës të përkatësisë dhe pjesëmarrjes si anëtar i një familjeje, komunitetit, kur ndodhet në mjedise familjare apo kopsht. Këtu janë dy tregues që vlerësojnë sensin e zhvillimit personal të fëmijës:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Kujdeset për gjërat e veta dhe të grupit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kujdeset për librat dhe objektet tjera</li> <li>• I përdor lodrat me më shumë kujdes se më parë</li> <li>• Mbledh gjërat që i përkasin, të tilla si veshjet, lodrat apo materialet e kopshtit</li> </ul>
Fillon të pranojë pasojat e veprimit të tij	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I sjell një objekt të dëmtuar prindit ose mësuesit për ta riparuar pasi e ka thyer atë</li> <li>• Justifikon gabimet e veta (p.sh. thotë: "Unë e godita atë sepse më mori lodrën"</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të nxitur zhvillimin e përgjegjësisë personale

- Të modelojë metoda të përshtatshme për ruajtjen e objekteve, pastrimin e tyre etj.
- T'u japë mundësi fëmijëve për të bërë gjëra vetë për veten dhe kopshtin
- Të diskutojë çështje si kujdesi, shkatërrimi i pronës etj. aq shpejt sapo ndodh një gjë e tillë, duke kërkuar sugjerime për zgjidhjen e problemit
- Të dëgjojë shpjegimin e fëmijëve dhe të mbështesë përpjekjet e tyre për t'u ndarë nga eksperiencat negative familjare apo në kopsht
- Të përdorë histori dhe literaturë të ndryshme për të angazhuar fëmijët në marrjen në konsideratë të perspektivave të tjerëve
- Të bëjë pyetje të hapura dhe të mbyllura për të evokuar përgjigjet e fëmijëve

## NJOHJA E TË TJERËVE

### Ndërtimi i marrëdhënieve të besimit dhe respektit të vazhdueshëm me të tjerët

Arritja i referohet aftësisë në rritje të fëmijës për të nisur dhe mbështetur marrëdhëniet mes të rriturve dhe bashkëmoshatarëve që duhet të jenë të karakterizuara nga ndershmëria, hapja dhe konsiderata për ndjenjat dhe këndvështrimet e të tjerëve. Këtu janë gjashtë tregues për vlerësimin e fëmijës në zhvillimin e aftësisë së besimit dhe respektit:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Respekton të drejtat e të tjerëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dëgjon kur të tjerët janë duke folur</li> <li>Zbaton jo gjithnjë radhën dhe ndjek rregullat</li> <li>Respekton hapësirat personale të të tjerëve (mban krahet të mbledhur për të mos prekur të tjerët)</li> </ul>
Respekton udhëheqjen e të rriturve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdor të rriturin si burim (p.sh. i kërkon informacion, asistencë ose këshillë)</li> <li>Ndjek udhëzimet e të rriturve për sigurinë në kopsht ose në shtëpi</li> <li>Ndjek rregullat e të rriturve për sjellje të përshtatshme në mjedise të ndryshme</li> <li>Tregon interes për punonjësit e komunitetit (p.sh. zjarrfikësit, oficerët e policisë, dentistët, mjekët etj.) dhe kupton rolet e tyre në komunitet.</li> </ul>
Merr siguri dhe komfort nga të rritur domethënës për të	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregon atashim ose bindje ndaj një të rrituri të veçantë</li> <li>Shkon te një i rritur kur ballafaqohet me një problem</li> <li>Ndihet i sigurt me të rriturit e veçantë</li> </ul>
Zhvillon miqësinë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ofron ndihmë dhe burime për të tjerët</li> <li>Ka një miqësi speciale me një ose dy bashkëmoshatarë të tij (i mungojnë ata kur do të bëjë diçka, zakonisht janë pjesë e lojës së fëmijës)</li> <li>Thirret si mik ose partner loje nga të tjerët</li> </ul>
Përdor fjalë dhe veprime mirësjelljeje	<ul style="list-style-type: none"> <li>Thotë "të lutem" dhe "faleminderit" ose "ditën e mirë" në kohë të përshtatshme</li> <li>Ndan lodrat e tij me të tjerët; flet për tema të ndryshme gjatë ushqimit</li> <li>Pret radhën gjatë bisedës</li> </ul>
Respekton ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet te të tjerët</li> <li>Përfshin fëmijë me ndryshime në lojë (p.sh. ndryshime të tilla si gjinia, raca, nevojat speciale, kultura dhe gjuha)</li> <li>Zbulon situatat e jetës reale përmes lojës së pretenduar</li> <li>Njeh që individë të ndryshëm kanë lloje të ndryshme të aftësive dhe të informacionit.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të mbështetur zhvillimin e marrëdhënieve të besimit dhe respektit të vazhdueshëm me të tjerët

- Të modelojë besimin, ndershmërinë dhe respektin në lidhje me fëmijët dhe të rriturit
- Të zhvillojë mbledhje të grupit për të diskutuar rreth ngjarjeve dhe çështjeve, zgjidhjen e problemeve dhe bërjen e festave me ta
- Të angazhojë fëmijët në votim për çështje të caktuara (p.sh. të vendosim llojin e lojës që do të luajmë)
- Të krijojë një mjedis ku fëmijët ndihen të sigurt dhe ku ndjenjat e tyre të jenë të pranuar jashtë paragjykitimit
- Të modelojë fjalorin dhe sjelljet e mirësjelljes dhe politesës
- T'u japë mundësi fëmijëve gjatë ditës për të zgjedhur të punojnë ose të luajnë me persona të veçantë (të rritur ose shokë)
- Të ftojë miqtë që janë “ndihmësit e komunitetit” të bisedojnë me fëmijët rreth roleve të tyre dhe pse ata bëjnë, çfarë bëjnë
- Të japë mundësi dhe materiale për fëmijët që të shprehin idetë e tyre, ndjenjat dhe lojën me role përmes lojës së pretenduar
- Të inkurajojë pjesëmarrjen në grup (të vogël ose të madh) në lojëra, duke i lejuar fëmijët të bëjnë ose të modifikojnë rregulla si dhe të zgjidhin konfliktet e tyre ose të tjerëve (gjithnjë në përputhje me sigurinë e tyre)

### Punojnë në bashkëpunim me moshatarët dhe të rriturit

Arritja lidhet me zhvillimin e aftësisë së fëmijës për të marrë pjesë si anëtar kontribuues në familjen dhe komunitetin e tij. Këtu janë katër tregues që vlerësojnë kapacitetin e fëmijës të punojnë në bashkëpunim me fëmijët e tjerë dhe të rriturit

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Merr pjesë suksesshëm si anëtar i një grupi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I lejon të tjerët t'i bashkohen lojës dhe veprimtarive të tij</li> <li>• Bashkëpunon në grupe të vogla dhe të mëdha gjatë veprimtarive (ndonjëherë si udhëheqës dhe ndonjëherë si ndjekës)</li> <li>• Luan duke bashkëpunuar me të tjerët (respekton radhën kur është duke luajtur një lojë)</li> <li>• Identifikon veten si anëtar grupi (p.sh. i referohet familjes së tij, kopshtit, skuadrës)</li> </ul>
Ndan përvojat dhe idetë me të tjerët	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Angazhohet në bashkëbisedim për të shprehur idetë e tij.</li> <li>• Shpreh veten përmes lojës së pretenduar, artit, muzikës, kërcimit, punës së shkruar dhe gjuhës së folur</li> <li>• Shkëmben informacionin personal</li> </ul>
Fillon të analizojë situatën nga perspektiva e një personi tjetër	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Adopton role të ndryshme gjatë lojës së pretenduar</li> <li>• Shpreh mbështetje (p.sh. ngushëllon shokun që ka humbur lojën)</li> <li>• Përshtat planet duke marrë në konsideratë dëshirat e të tjerëve (p.sh. pyet një shok apo një shoqe se çfarë do të donte të bënte)</li> </ul>

Zgjidh konfliktet me të tjerët	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon interes për të zbatuar dhe për të vendosur rregulla</li> <li>• Bën përpjekje për të bërë paqe (p.sh. duke thënë "Më fal" ose duke dhënë një lodër si shkëmbim)</li> <li>• Bën përpjekje për të zgjidhur probleme pa ndihmën e të rriturve</li> </ul>
--------------------------------	--

### Strategjitë e mësuesit për të nxitur aftësinë e bashkëpunimit si anëtar grupi

- Të planifikojë çdo ditë "kohë në rreth" për të inkurajuar fëmijët të ndajnë lajmet dhe këndvështrimet e tyre, planet e veprimtarive etj
- Të përdorë mbledhjet e kopshtit dhe diskutimet për të zgjidhur çështje të ndryshme që lidhen me fëmijët
- Të angazhojë fëmijët në punën me grup të vogël
- T'u japë mundësi ditore fëmijëve për të shprehur veten përmes artit, ndërtimit, muzikës, lëvizjes dhe gjuhës
- Të përfitojë nga ngjarje spontane në klasë për të përfshirë fëmijët në bërjen e rregullave dhe zgjidhjen e problemeve në projekte të ndryshme
- Të mbështesë fëmijët në ndërtimin e marrëdhënieve dhe të miqësisë me bashkëmoshatarët, si dhe zgjidhjen e problemeve duke i dhënë kohë dhe hapësirë për veprimtari praktike dhe lojëra
- Të japë kohë të caktuara për të njohur dhe festuar ngjarje speciale me individë dhe të gjithë grupin apo kopshtin.

## STRATEGJITË E TË MËSUARIT

### Tregojnë kuriozitet

Arritja i referohet kërkesës së brendshme të fëmijëve- dëshirës aktive të tyre për të mësuar. Lidhur me këtë tendencë natyrale të fëmijës zbulohen të gjitha aspektet e mjedisit duke filluar nga objektet dhe njerëzit e deri te idetë dhe zakonet e tyre. Këtu janë tre tregues për të vlerësuar mënyrat se si fëmijët demonstrojnë kuriozitetin:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Shpreh interes rreth njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyet rreth njerëzve në mjedisin e tij të afërt</li> <li>• Tregon interes për veprimtaritë e të tjerëve</li> <li>• Pyet të tjerët për informacione personale (p.sh. pyet: "Si e ke emrin" ose " Pse ke hipur në makinën lodër?"</li> </ul>
Tregon interes në mësimin e gjërave të reja dhe përpiqet të fitojë përvoja të reja	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbulon veten e tij</li> <li>• Zhvillon një interes personal (p.sh. pëlqen makinat, dinozaurët, kukullat etj.)</li> <li>• Kërkon dhe eksperimenton me materiale të ndryshme</li> <li>• Tregon interes se si i bëjnë të tjerët gjërat</li> </ul>
Bën pyetje	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor pyetjet për të gjetur përgjigjet</li> <li>• Habitët pse një gjë është ashtu siç është</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të nxitur kuriozitetin

- Të krijojë një mjedis të mësuarit me shumëllojshmëri materiale që fëmijët të zbulojnë dhe manipulojnë (duke qenë i kujdesshëm për të shmangur krijimin e një situatë të mbi stimuluar ose të nën stimuluar)
- Të sjellë në klasë “objekte reale” që u vlejnë fëmijëve në procesin e zbulimit, si p.sh. makina shkrimi, telefona etj
- Të ndërhyjë në mënyrë periodike me materiale të reja në klasë (ose heqjen e tyre kur shihet se fëmijët kanë humbur interesin për to)
- T’u bëjë fëmijëve pyetje me fund të hapur rreth se çfarë janë dukë bërë, duke vëzhguar ose duke menduar
- Të japë disiplinën e “shkencës” me shembuj të objekteve (p.sh. shkëmbinj, fole zogjsh etj.) dhe përmes qenieve të gjalla (kafshë ferme, gjethë etj.) në mënyrë që fëmijët të vëzhgojnë dhe të ndërveprojnë me to.
- Të inkurajojë fëmijët për të bërë pyetje
- Të pranojë teoritë e fëmijëve dhe t’i inkurajojë për t’i provuar ato (gjithnjë duke pasur në konsideratë rregullat e sigurisë)
- Të lexojë literaturën që stimulon interesin e fëmijëve dhe kuriozitetin e tyre për njerëzit, vendet, botën natyrore, makinat etj
- Të përdorë pyetjet e fëmijëve rreth ngjarjeve spontane për angazhimin e tyre në një projekt (p.sh. rreth ndërtimit të një rruge, rreth një objekti kulture nga vizita e familjes në një vend tjetër)
- Të bëjë vizita dhe ekskursione me fëmijët për të zbuluar botën natyrore

### Marrin iniciativa

Arritja i referohet rritjes së aftësisë së fëmijës për të demonstruar shpirtin e pavarësisë dhe sensin e kontrollit mbi zgjedhjet e tij. Këtu janë tre tregues për të vlerësuar kapacitetin e fëmijës për të ndërmarrë iniciativa:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Nis ndërveprimin me të tjerët	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyet një shok nëse dëshiron t’i bashkohet lojës</li> <li>• Bashkohet në një lojë apo veprimtari që ka filluar</li> <li>• Merr pjesë në veprimtaritë e grupit</li> <li>• Sugjeron veprimtari lojë</li> </ul>
Merr vendime në mënyrë të pavarur	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjedh materiale për një projekt</li> <li>• I ofron ndihmë të tjerëve</li> <li>• Bën gjëra korrekte edhe kur të tjerët nuk i bëjnë</li> </ul>
Zhvillon pavarësinë gjatë veprimtarive, lojës dhe rutinave ditore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Var pallton e vet kur vjen nga jashtë në kopsht</li> <li>• Vesh përparësen e punës për manipulimin e plastelinës</li> <li>• Luan i vetëm për një periudhë kohe</li> <li>• Përfundon detyrën</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të nxitur aftësinë e marrjes së iniciativës

- Të zhvillojë mbledhje të grupit ku fëmijët mund të propozojnë zgjidhje për problemet ditore ose të konflikteve të ndryshme.



- Të vendosë rutina dhe të angazhojë kujdestarët ditorë të grupit për të menaxhuar detyrat
- Të inkurajojë fëmijët për të marrë pjesë në lojë, në grupe (të mëdha ose të vegjël) ku ata mund të modifikojnë ose të bëjnë rregullat e tyre ose të zgjidhin konflikte
- T'u japë mundësi fëmijëve që të bëjnë zgjedhje gjatë ditës (p.sh. në qendrat e kopshtit ose në oborr)
- Të lejojë fëmijët të luajnë
- Të japë materiale që lehtësojnë fëmijët të përfshihen në veprimtari ditore sipas interesit që kanë ose angazhimit të tyre në projekte personale
- Të marrë sugjerime të fëmijëve për zgjidhjen e problemeve dhe të përpiqet së bashku me ta për t'i vënë në jetë
- T'u japë përgjegjësi fëmijëve për mbajtjen e rutinave, kujdesit për mjediset e kopshtit etj.



### Demonstrojnë shpirt krijues

Arritja i referohet kapacitetit të fëmijës për të shprehur veten si person unik nëpërmjet mënyrave të të parit të botës dhe tregimit të talentit të tij, po ashtu. Këtu janë tre tregues që vlerësojnë shprehjen e krijimtarisë të fëmija:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Gjen mënyra të reja të të bërit të gjërave	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfundon projektin në mënyrë të ndryshme nga të tjerët (p.sh. vendos një strukturë blloku në mënyrë të veçantë, bën një pikturë, përdor një ngjyrë të krijuar nga vetë ai etj.)</li> <li>• Përdor materialet në mënyra të reja</li> <li>• Shpik veprimtari dhe lojëra të reja; sugjeron rregulla të reja për lojëra familjare me fëmijët</li> </ul>
Përdor imagjinatën për të gjeneruar një varietete idesh	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjen fjalë që rimojnë, këngë ose histori</li> <li>• Angazhohet në lojën e pretenduar</li> <li>• Bën ndryshime në historitë familjare për të duke shtuar veprime dhe karaktere</li> <li>• Shpreh idetë e tij përmes artit, ndërtimit, lëvizjes ose muzikës</li> </ul>
Shfaq ndjenjë humori	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qesh kur dikush tregon një histori argëtuese</li> <li>• Ekzagjeron një lëvizje ose një thënie për të qenë argëtues</li> <li>• Bën vargje të thjeshta; luan me tinguj</li> <li>• Bën mjaft lojëra (tregon lojëra të thjeshta duke i përsëritur shpesh dhe duke i kthyer në shprehi)</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të nxitur krijimtarinë

- Të përdorë materiale të larmishme që i ndihmojnë fëmijët të zbulojnë (p.sh. lloje të ndryshme letrash, pipash, farash, veglash druri etj.)
- Të lejojë fëmijët të shprehin veten në të gjitha llojet e artit të medias përtej asaj që i ofron mësuesi në prodhimin e versioneve të ndryshme të projektit
- Të inkurajojë fëmijët për të bërë këngë dhe histori apo për të ndryshuar fjalë që janë familjare me historinë e treguar në klasë
- Të krijojë një qendër me shumë materiale dhe objekte në të cilat fëmija mund të shkojë për të luajtur lojën e pretenduar dhe të zgjedhë veshje apo objekte që e ndihmojnë për të luajtur
- Të lexojë poema dhe histori humoristike
- Të angazhojë fëmijët me këngë të shoqëruara me gjeste
- Të lejojë fëmijët të luajnë shpesh lojën e pretenduar
- Të përdorë humorin në përgjigjet që u jep fëmijëve

### Tregojnë vet besim

Arritja i referohet ndjenjave të fëmijës që lidhen me besimin në veten e tyre dhe në aftësitë që kanë; është mbase pika më e rëndësishme që siguron sukses në të mësuar. Këtu janë dy tregues që vlerësojnë si një fëmijë shpreh besimin e tij:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Shpreh idetë ose opinionet e tij	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komunikon pëlqimet ose mos pëlqimet e tij</li> <li>• Sugjeron një zgjidhje për konfliktin apo problemin</li> <li>• Ndan idetë e tij në situata grupi (p.sh. me familjen, bashkëmoshatarët ose shokët e grupit)</li> </ul>
E sheh veten si kompetent dhe ka një vetëvlerësim pozitiv	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh mjeshtërinë e aftësive të tij (p.sh. thotë "Tani unë do ta ndërtoj si duhet")</li> <li>• Pyet të tjerët se çfarë mendojnë rreth krijimit të tij (p.sh. thotë "Shihe vizatimin tim")</li> <li>• Kontribuon në diskutimet e familjes ose të grupit</li> <li>• Kërkon vlerësim për një detyrë të realizuar</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të nxitur ndjenjën e vetëbesimit

- Të zhvillojë mbledhjet e mëngjesit në rreth dhe të inkurajojë fëmijët për të shprehur idetë dhe opinionet e tyre
- T'u japë përgjegjësi fëmijëve në detyrat ditore (p.sh. shpërndarjen e materialeve didaktike, pastrimin e tavolinave etj.)
- Të vlerësojë dhe të përshëndesë fëmijët në përfundim të një detyre, projekti apo pune- pa bërë vërejtje apo pyetje hetuese
- T'u kërkojë fëmijëve të përshkruajnë detyrat ose krijimet e tyre (p.sh. "Ju jeni duke punuar shumë në këtë pikturë. Më tregoni rreth saj". ose "Unë kurrë nuk kam parë një skulpturë balte të ngjashme me këtë më parë. Çfarë ishit duke menduar ju kur e bëtë këtë gjë?")
- Të mbështesë iniciativën e fëmijës dhe drejtimin e mbledhjes së klasës në diskutimin e çështjeve që u përkasin

- Të tregojë besim ndaj aftësisë së një fëmije për të bërë gjëra të reja (p.sh. duke i thënë “Unë e di që ti je një vrapues i mirë. E di që do të vraposh më shpejt këtë herë”).



### Tregojnë këmbëngulje

Arritja i referohet kapaciteteve të fëmijëve për t'u angazhuar plotësisht në çfarë janë duke bërë dhe se si përmbushin sfidat në përshtatje me fazat e zhvillimit. Këtu janë tre tregues që vlerësojnë se si një fëmijë është i aftë të jetë këmbëngulës

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Tregon vëmendje ndaj një veprimtarie ose detyre të përshtatshme për moshën e tij	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qëndron i angazhuar në një veprimtari (p.sh. ndërton një bllok me durim ose përfundon luajtjen e një loje)</li> <li>• Ndjek përfundimin e detyrës me kujdes për të mos prishur ndonjë gjë</li> <li>• Punon mbi një detyrë për një periudhë kohe, duke e lënë dhe duke u kthyer (p.sh. duke punuar me një strukturë druri ose një vizatim etj.)</li> </ul>
Sfidon në vazhdim	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën plane për një veprimtari</li> <li>• Përfundon një projekt</li> <li>• Vazhdon të bëjë një detyrë të vështirë (p.sh. ndërton strukturën e një blloku kompleks)</li> </ul>
Kapërcen dështimin	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon të kuptuar kur një bashkëmohatar aksidentalisht e rrëzon ose i prish strukturën e bllokut që po ndërton</li> <li>• Mund të humbë një lojë pa u ndierë keq</li> <li>• Vazhdon të përpiqet për të bërë një detyrë pas shumë përpjekjesh në të cilat ka dështuar (p.sh. duke kërkuar të ecë me biçikletë, duke lidhur një lidhëse etj.)</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të nxitur aftësinë e këmbënguljes

- Të lejojë fëmijët të vazhdojnë punën në interesat që ata kanë (p.sh. gjatë kohës së punës në një disiplinë)
- Të pajisë klasën në mënyrë të tillë që shumë fëmijë të kenë mjaft hapësirë për të punuar në një projekt mbi kohën e planifikuar
- Të organizojë skedën ditore në mënyrë që fëmijët të kenë blloqe të mëdha kohe për t'u angazhuar dhe për të realizuar detyrat dhe projektet e tyre
- Të hartojë kurrikulën të mbështetur në interesat e fëmijëve
- Të sjellë në klasë materiale të nevojshme në mënyrë që fëmijët të kenë burimet që u duhen për të përfunduar projektin.

### Përdorin aftësitë problemzgjdhëse

Arritja i referohet aftësisë së fëmijës për të identifikuar çështje që do të vëzhgohen dhe që kërkojnë zgjidhje në problemet e jetës së përditshme. Këtu janë tre tregues që vlerësojnë se si një fëmijë shfaq aftësitë problemzgjdhëse:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Njeh problemet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Deklaron një problem personal (p.sh. thotë "Unë nuk po e gjej lapsin tim blu" ose "Unë nuk e vesh dot këtë xhakëtë sepse është shumë e ngushtë)</li> <li>• Tregon një problem potencial (p.sh. thotë "Unë mund të ngjitem shumë lart, por nuk do të di si të zbres")</li> <li>• Kujton problemet e mëparshme (p.sh. thotë "Unë kujtoj që herën e fundit, kur ne ndërtoam shtëpinë, ishte një bllok që e vendosëm për të mbajtur strukturën mirë)</li> </ul>
Përpiqet t'i zgjidhë problemet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Modifikon veprimet bazuar mbështetur në informacionin dhe përvojat e reja (p.sh. ndryshon strukturën e bllokut kur kështjella vazhdon të bjerë, lëviz gjatë kohës që është duke parë një libër etj.)</li> <li>• Ndryshon sjelljen në përgjigje të një fëmije ose të rrituri (p.sh. ngushëllon një fëmijë që është duke qarë)</li> <li>• Kërkon ndihmë nga një fëmijë tjetër ose i rritur</li> </ul>
Punon me të tjerët të zgjidhë problemet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunon në marrjen e vendimeve me një fëmijë tjetër (p.sh. planifikon me një bashkëmoshatar për të bërë një kështjellë me blloqe, zgjedh çfarë loje do të luajë ose si të ndajë materialet të tilla si bojërat apo lodrat)</li> <li>• Shpesh zgjidh konfliktet që ka me një fëmijë tjetër</li> <li>• Respekton radhën (p.sh. thotë "Le të vendosim kush do të shkojë i pari, i dyti, i treti etj.)</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të nxitur aftësinë e problem zgjidhjes

- Të hartojë kurrikulën të bazuar në interesat e fëmijëve
- Të japë një variete materialesh që përdoren nga fëmijët për t'u angazhuar personalisht në projekte të ndryshme

- Të përdorë pyetjet e hapura për të mbështetur vëzhgimin dhe eksperimentimin e fëmijëve (p.sh. duke pyetur “Çfarë do të përdorje për ta bërë më të lartë kullën e vrojtimit?” ose “A ka ndonjë mënyrë tjetër për ta bërë urën më të qëndrueshme?”)
- T’u japë mundësi fëmijëve që të punojnë së bashku (p.sh. në çifte ose në grup të vogël)
- Të organizojë skedën ditore në mënyrë që fëmijët të kenë kohë të mjaftueshme për vazhdimin e vëzhgimit dhe përfundimin e projektit
- Të lexojë me zë të ulët histori të ndryshme duke i pyetur fëmijët për përgjigjet e tyre në situata të ndryshme
- Të zhvillojë mbledhjet e klasës dhe të nxisë diskutimet për të arritur në zgjidhjen e çështjeve që u përkasin fëmijëve.

## **KRIJIMI I NJË MJEDISI QË MBËSHTET ZHVILLIMIN SOCIAL DHE EMOCIONAL TË FËMIJËVE**

Mjedisi i kopshtit është një komponent i rëndësishëm në përshtetimin e zhvillimit social dhe emocional të fëmijëve. Si është mobiluar kopshti, si janë hartuar skeda ditore dhe rutinat, si veprojnë rregullat që janë vendosur – të gjithë këto elementë kontribuojnë në ndërtimin e një komuniteti të mësuarit të fortë ku fëmijët ndihen të mirëseardhur, të sigurt dhe të etur për të mësuar.

Mobilimi i mjedisit në kopsht duhet të ketë një hapësirë të gjerë për mbledhjet e grupit, por gjithashtu duhet të përfshijë hapësira ku grupet e vogla të fëmijëve të mund të punojnë së bashku në një vend më të qetë (si këndet e ndryshme që duhet të shkojnë deri në tre). Duke pasur një varietete materiale që fëmijët mund t’i përdorin në qendrat ku janë të interesuar të punojnë (p.sh. lojë e pretenduar ose kuzhina e gatimit; qendra për lojërat e matematikës, për blloqet e ndërtimit) një qendër arti etj. krijohen mundësi të shumta për ndërveprimin e fëmijëve.

Lejimi i fëmijëve për të zgjedhur këto veprimtari jo vetëm mbështet të mësuarit e tyre, por gjithashtu ndihmon të reduktohen konfliktet. Hartimi i një skede që u jep fëmijëve kohë të mjaftueshme për të vazhduar interesat e tyre dhe pajisja e kopshtit me mjedise të ndryshme ndihmon një menaxhimin të lehtë të nevojave individuale. Rutinat që përfshijnë fëmijët në mbajtjen e hapësirave për një farë kohe u japin fëmijëve ndjenjë e pronësisë dhe të investimit në klasën e tyre. Sikurse të rriturit, edhe fëmijët kërkojnë një mjedis të përshtatshëm për plotësimin e nevojave të tyre- nevoja për të qenë vetëm ose në shoqëri, angazhim dhe pushim- dhe ku ata ndihen të sigurt dhe të vlerësuar si anëtar kontribuues i një komuniteti

## **BASHKËPUNIMI ME PRINDËRIT DHE FAMILJEN**

Prindërit janë, natyrisht, partnerët tanë më të rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit social dhe emocional të fëmijëve që kemi në kujdes. Të hapur, me besim dhe komunikim të përshtatshëm nga respekti për familjet është linja që rregullon transicionin e butë midis shtëpisë dhe kopshtit. Shkëmbimi i informacionit rreth rregullave dhe

rutinave, si zgjidhen konfliktet dhe si lidhemi me çështjet që shqetësojnë fëmijët tanë është shumë e rëndësishme, veçanërisht sepse çdo familje do të ketë informacionin e vet në lidhje me disiplinën apo çështjet përkatëse. Ekzistojnë shumë burime për edukatorët dhe mësuesit të interesuar në komunikimin me familjet. Partneriteti prindër-mësues është një burim i mrekullueshëm dhe bën që çdo program të ketë në konsideratë vlerat e një bashkëpunimi të tillë



## 5. FUSHA E ZHVILLIMIT FIZIK DHE SHËNDETI

### Qëllimet fizike dhe shëndetësore dhe strategjitë e të mësuarit

Në fushën e zhvillimit fizik dhe shëndetësor mësuesit dhe prindërit duhet të vlerësojnë se ekzistojnë tre komponentë: zhvillimi fizik dhe koordinimi, shëndeti, ruajtja dhe kujdesi, si dhe strategjitë e të mësuarit. Në faqet e mëposhtme ju do të gjeni procesin e përbushjes së standardeve, përmes treguesve dhe shembujve, të shoqëruar me secilin nga këto komponentë të përmbajtjes. Së bashku përmbajtja dhe proceset e treguesve reflektojnë dimensione të ndryshme të zhvillimit fizik dhe shëndetësor.

#### Zhvillimi fizik dhe koordinimi:

- Përdor aftësitë motore të mëdha me qëllim dhe koordinim;
- Përdor aftësitë motore fine me qëllim dhe kontroll;
- Reagimi ndaj ngacmuesve të jashtëm

#### Shëndeti:

- Praktikon sjellje të shëndetshme.

#### Ruajtja dhe kujdesi:

- Praktikon sjellje të kujdesshme.

#### Strategjitë e të mësuarit

- Tregon kuriozitet
- Ndërmerr iniciativa lëvizore
- Shfaq shpirt bashkëpunimi dhe solidariteti
- Tregon vet besim
- Përdor aftësitë motore të mëdha dhe të vogla

## ZHVILLIMI FIZIK DHE KOORDINIMI

### Përdorin aftësitë motore të mëdha me qëllim dhe koordinim

Fëmijët adhurojnë të lëvizin dhe të eksplorojnë mjedisin përreth tyre. Arritja i referohet aftësive të fëmijëve për të manipuluar në mënyrë të qëllimshme me trupin e tyre nëpërmjet ushtrimit të muskujve të mëdhenj. Tre treguesit kryesorë të vlerësimit janë:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Lëviz nga një pikë në një tjetër.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vrapon, shëtit, kërcen dhe hidhet me një këmbë.</li> </ul>
Kontrollon lëvizjet trupore.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Paloset, shtriqet, kthehet para mbrapa</li> <li>Rrotullon trupin në një drejtim</li> <li>"Ndalon" ose "ngrin" kur jepen komandat e lojërave</li> <li>Qëndron në një këmbë.</li> </ul>
Përdor lëvizjet e muskujve të mëdhenj	<ul style="list-style-type: none"> <li>Godet topin me duar ose me një mjet,</li> <li>Pret topin me duar;</li> <li>Pedalon një mjet me 2 ose 3 rrota.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të nxitur te fëmijët aftësitë motore të mëdha

- Të parashikojë kohë dhe hapësirë të gjerë për lojëra lëvizore brenda dhe jashtë mjedisit të shkollës;
- Të sigurojë një sërë mjetesh statike si rrëshqitëse, shkallë ngjitëse blloqe të mëdha, biçikletë për fëmijët që të zbulojnë dhe të krijojnë vetë lojëra të ndryshme;
- Të mundësojë që për arsye sigurie, sipërfaqet e lojërave të jenë të lëmuara;
- Të sigurojë një sërë mjetesh për veprimtari brenda kasës (p.sh. blloqe të gjera, topa etj. për lojëra që zhvillojnë aftësitë motore të mëdha;
- Të angazhojë fëmijët në veprimtari të tilla që zhvillojnë muskujt e mëdhenj si imitimi i lëvizjeve të insekteve ose kafshëve (flutura, elefanti, luani etj.)
- Të krijojë në vazhdimësi mundësi në planifikimin ditor për lëvizje dhe veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë, si dhe për lojëra sipas dëshirës. Këto veprimtari të shpërndara në mjediset e kopshtit në qendra të ndryshme bëjnë që fëmijët të marrin pjesë në veprimtari që iu përshtaten interesave dhe nivelit të aftësive. Zakonisht ato marrin një kohë të paktën 5-10 minuta
- Të planifikojë në bazë të përvojës lëvizje që i lejojnë fëmijët të marrin pjesë në bazë të aftësive
- Të inkurajojë fëmijët të kërcejnë aq kohë sa munden ose të vallëzojnë sipas dëshirës;
- Të përshtatin pajisjet për veprimtari të ndryshme, ku fëmijët të marrin pjesë në bazë të aftësive
- Të angazhojë fëmijët në veprimtari lëvizore të shoqëruara nga muzika ose ritmi.



### Përdorin aftësitë motore fine me qëllim dhe kontroll

Gjatë viteve të qëndrimit në kopsht, fëmijët fillojnë të ndërtojnë lëvizjet motore fine dhe duart e tyre forcohen. Në mënyrë individuale në këtë moshë shfaqen një sërë aftësish që i përkasin lëvizjeve motore fine. Këtu janë katër tregues që vlerësojnë se si një fëmijë shfaq aftësitë motore fine dhe kontrollin e tyre:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Zhvillon dhe përmirëson kërkesat e lëvizjeve motore fine	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtrydh sfungjer të lagët, hap e mbyll një tapë shisheje;</li> <li>• Punon me plastelinë ose baltë;</li> <li>• Përdor duart dhe gishtat për të hapur e mbyllur kopsat e rrobave, përdor mbajtësen e letrës etj.</li> </ul>
Përdor gishtat dhe duart për të plotësuar kërkesat e lëvizjeve motore fine	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Me shpejtësi hap e mbyll kopsat, zinxhirin tek veshjet e tij</li> <li>• Përshkon rruazat në fill, formon me makarona formën "O"</li> <li>• Klasifikon format e vogla në kuti ndarëse formash</li> <li>• Ndërton me blloqe të vogla forma të ndryshme (blloqe që lidhen me njëra - tjetrën)</li> <li>• Lustron këpucët</li> <li>• Mban letrën me një dorë dhe pret me tjetrën.</li> </ul>
Përdor mjetet në mënyrë funksionale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor furçat, gërsërët, setin e ushqimit</li> <li>• Mban mjetet e shkrimit me gishta për të shkruar ose për të vizatuar</li> <li>• Përdor mjete të thjeshta teknike (çekiçi) nën mbikëqyrjen e mësuesit.</li> </ul>
Shfaq koordinimet e muskujve të fytyrës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tenton të mbyllë një sy</li> <li>• Bën fluska me gojë, ose shuan qiririn</li> <li>• Imiton ose bën fytyra qesharake</li> <li>• Flet qartë kur është i motivuar të kërkojë diçka</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të zhvilluar lëvizjet motore fine

- Të hartojë planin ditor në mënyrë të tillë që fëmijët të kenë kohë të plotë për t'u marrë me veprimtari.
- Të modelojë veprimtari të tilla që i ftojnë fëmijët në pjesëmarrje aktive, si dhe të angazhohet bashkë me fëmijët në lojë.
- Të sigurojë një sërë mjetesh që mundësojnë punën e fëmijëve në klasifikim dhe numërim, në qendrën e matematikës.
- Të pajisë dhe të menaxhojë mirë qendrën e shkrimit (p.sh. me lapsa, shkronja alfabeti, kapëse letrash, magnetofon, marker të madhësive të ndryshme, lloje të ndryshme letrash, blloqe shënimesh, fletore, receta ose rregulla të shkruara) ku fëmijët të eksplorojnë dhe të eksperimentojnë me të shkruarin.
- Të ketë një larmi mjetesh për fëmijët të cilët mund të punojnë nën mbikëqyrjen e mësuesit në Qendrën e veprimtarive me konstruksione.
- Të pajisë Këndin e ujit (enë me ujë) me sfungjerë, gota plastike të tejdukshme

me forma të ndryshme dhe të shkallëzuara që fëmijët të shohin sasinë e ujit që përdorin.

- Të sigurojë te Këndi i artit një shumëllojshmëri mundësish për fëmijët për të eksperimentuar me materialet e artit (p.sh. ngjyrosje, punë me plastelinë, gërvshërë, ngjitëse, materiale me të cilat bëhet kolazh). Fokusi duhet të jetë te krijimtaria që shpalosin vetë fëmijët.
- Të zhvillojë veprimtari me lojëra argëtuese si rebuse, formim figurash etj.
- Të krijojë Qendrën e blloqeve në një mjedis të qetë të klasës, ku nuk para lëvizin shumë fëmijët, me shumë hapësirë e cila mund të shërbejë për ndërtimin dhe realizimin e projekteve të tyre.
- T'u shërbejë fëmijëve ushqime sipas traditës familjare që ata të kenë mundësi të mbushin gotën vetë, t'i shërbejnë vetvetes dhe të përdorin setin e ngrënies lugë, pirun
- Të angazhojë fëmijët në lojëra me gishta, këngë, veprimtari ritmike dhe histori që përfshijnë lëvizje, imitime fytyrash, kafshësh etj.
- Të mbështesë fëmijët që të vishen vetë, të lajnë dhëmbët, të pastrohen etj.

### Reagimi ndaj ngacmuesve të jashtëm

*(Fëmija përdor shqisat në funksion të mjedisit)*

Arritja i referohet aftësive të fëmijëve për të marrë informacion nga mjedisi i jashtëm nëpërmjet shqisave të tyre. Katër janë treguesit kryesorë për këtë aftësi:



<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Shfaq ndërgjegjësim të shqisave	<p><b>Të prekurit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon objekte të fshehura nëpërmjet prekjes</li> <li>• Merr pjesë në lojëra të ndryshme si ngjyrosje me gishta, punë me plastelinë, me rërë etj.</li> </ul> <p><b>Të dëgjuarit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjek udhëzimet e dhëna gojarisht ndërsa po luan në lojë</li> <li>• I përgjigjet zhurmave të mjedisit (reagon kur i thërritet emri, vëzhgon dhe heton zhurma të pazakonta si sirena, gota që thyhet.</li> </ul> <p><b>Të shikuarit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjen detaje në librat e ilustruar për fëmijë.</li> <li>• Rregullon objektet sipas ngjyrës, madhësisë, përmbajtjes dhe formës.</li> <li>• Godet topin në shenjë</li> <li>• Ndjek një linjë me gisht ose me laps.</li> </ul> <p><b>Të nuhaturit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Thotë, "Ky marker mban erë alkool"</li> <li>• Thotë, "Po nuhas kokoshka të pjekura"</li> </ul> <p><b>Të shijuarit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëpin me kënaqësi një akullore në kaush</li> <li>• Mbetet i kënaqur mbas shijimit të ushqimit</li> </ul>
Shfaq ndërgjegjësim për pjesët e trupit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon pjesët e trupit nëpërmjet lojës me gishta dhe këngëve</li> <li>• Krijon forma të ndryshme me trupin e tij (p.sh. bën një rreth me gishta, bën një urë me një fëmijë tjetër).</li> <li>• Imiton lëvizjet e kafshëve me pjesët e trupit (p.sh. rrëshqet në tokë si gjarpri, hap krahët si shqiponjë)</li> </ul>
Shfaq ndërgjegjësim hapësinor	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëviz trupin para, mbrapa, anash, ngrihet lart, ulet poshtë.</li> <li>• Luan lojëra në të cilat janë përfshirë lëvizjet e trupit dhe drejtimet.</li> <li>• Lëviz në dhomë pa penguar të tjerët dhe pa u përplasur me mobilimet e saj.</li> <li>• Gjen zgjidhje për të dalë nga labirinti, dhe për të kapërcyer pengesat.</li> <li>• Vendos blloqet në një hapësirë të caktuar</li> </ul>
Shfaq ndërgjegjësim kohor	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëviz trupin sipas një ritmi</li> <li>• Rregullon lëvizjet e trupit sipas ritmit dhe kohës</li> <li>• Kap një top në kohën e caktuar</li> <li>• Ndjek sekuencat ose pjesët e një kënge ose bën lojëra me gishta</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit për të zhvilluar shqisat

- Të sigurojë një tabelë për shqisat, si dhe materiale të ndryshme që shërbejnë për t'u eksploruar në mënyrë të rregullt dhe periodike. Këto materiale ndryshojnë herë pas here duke u zëvendësuar me të reja.
- Të angazhojë fëmijët të dëgjojnë, të hetojnë dhe të imitojnë tingujt, zhurmat e natyrës dhe të mjedisit përreth.

- T'u sigurojë fëmijëve mundësinë të luajnë me instrumente muzikorë ose të bëjnë vetë instrumente me objekte që ndodhen në mjedis.
- T'u kërkojë fëmijëve të gjejnë detaje në librat e ilustruar, gjatë tregimit të një përralle ose historie.
- T'u japë detyra fëmijëve të kryejnë koleksione, klasifikime, ndarje të objekteve sipas ngjyrës, madhësisë, formës etj.
- Të angazhojë fëmijët në lojëra me objektiv (të godasin me top shishet etj.)
- Të inkurajojë fëmijët të identifikojnë nuhatjen (p.sh. të ekzaminojnë fruta të ndryshme dhe të diskutojnë aromat e tyre, të organizojë një lojë ku të gjejnë artikujt sipas aromës).
- T'u prezantojë fëmijëve përvoja gatimi në klasë në mënyrë që ata të mund të prekin, shijojnë, nuhasin lloje të ndryshme ushqimesh.
- Të organizojë bashkëbisedime rreth pëlqimeve të të ngrënit (shijon si ...ose nuk më pëlqen).
- Të angazhojë fëmijët në muzikë dhe në lëvizje ekspresive që mund të zhvillojnë gjymtyrët e ndryshme të trupit.
- Të angazhojë fëmijët me sa më shumë lojëra ritmike ose lojëra të tjera ku ai ose ajo ka nevojë të zbatojë drejtimet ose të përmirësojë një sekuencë lëvizjeje.
- Të zhvillojë sa më shumë lojëra jashtë kopshtit.

## SHËNDETI

### Praktikojnë sjellje të shëndetshme

Fëmijët nuk mund të zhvillojnë vetë sjellje të shëndetshme, nevojitet që këto sjellje të mësohen dhe të mbështeten nga të rriturit. Arritja reflekton në sjelljet që do dëshironim të kenë fëmijët me qëllimet vëna në programin e parashkollorit. Tre janë treguesit kryesorë të vlerësimit për këtë aftësi:

Treguesit Fëmija	Shembujt Fëmija
Shfaq pavarësi në higjienën personale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Menaxhon tualetin;</li> <li>• Lan dhe fshin duart;</li> <li>• Mbulon hundën dhe gojën kur teshtin;</li> <li>• Përdor shaminë.</li> </ul>
Zgjedh të marrë pjesë veprimtari fizike ditore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Luan me lodrat e oborrit;</li> <li>• Angazhohet në lojëra aktive;</li> <li>• Del për shëtitje me anëtarët e familjes;</li> <li>• Merr pjesë në lojëra brenda dhe jashtë klasës</li> </ul>
Tregon forcën dhe rezistencën e trupit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngjitet dhe zbret vetë nga rrëshqitësja;</li> <li>• Zbraz ujin nga një broke;</li> <li>• Mban vetë pajisjet e lojërave nga një kënd në një tjetër;</li> <li>• Angazhohet në veprimtari lëvizore të ndryshme.</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët për të zhvilluar sjellje të shëndetshme

- Të modelojë sjellje të shëndetshme dhe të japë shembuj shpjegues përse ne i bëjmë këto (p.sh. themi, “unë gjithmonë i laj duart përpara se të ha bukë, sepse nuk dua që të sëmurem”)
- Të sigurojë që klasa është e pajisur me peshqirë, kartë-peceta, letra higjienike etj., si edhe këta artikuj të jenë në përdorim për fëmijët.
- Të demonstrojë ngrohtësi ndaj nevojave të fëmijëve për të ndjekur rregullat e tualetit dhe të lejojë fëmijët të kenë pavarësi për të bërë rregulla vetë.
- Të tregojë entuziazëm për veprimtaritë fizike dhe të marrë pjesë bashkë me fëmijët në lojëra.
- Të organizojë lojëra dinamike brenda dhe jashtë klasës, në mënyrë të rregullt.
- Të angazhojë gjatë ditës fëmijët në bashkëbisedime rreth rëndësisë së shëndetit.



## SIGURIA DHE KUJDESI

### Praktikojnë sjellje të kujdesshme

Si sjelljet e shëndetit ashtu edhe kujdesi-siguria nevojiten të mësohen dhe të mbështeten nga të rriturit. Arritjet në vazhdim përshkruajnë sjelljet që do dëshirojmë të shikojmë te fëmijët 4-5 vjeç nën drejtimin dhe kujdesin e të rriturit. Katër janë treguesit kryesorë të vlerësimit për këtë aftësi:

<b>Treguesit Fëmija</b>	<b>Shembujt Fëmija</b>
Dëgjon dhe ndjek drejtimin e të rriturit gjatë ndodhjes së emergjencave	<ul style="list-style-type: none"> <li>Merr pjesë gjatë ushtrimit për të përballuar emergjencat (p.sh. gjatë zjarrit, takimit me persona të panjohur, shkatërrimeve natyrore etj.) në kopsht dhe në shtëpi.</li> </ul>
Ndjek krahun e rrugës së sigurt për publikun	<ul style="list-style-type: none"> <li>Qëndron me të rriturin kur kalon rrugën, gjatë parkimit të makinave në shtëpi ose mjedise publike;</li> <li>Nget biçikletën me mjete mbrojtëse (p.sh. mban një kokore mbrojtëse, e nget në vende të sigurta);</li> <li>Qëndron larg makinerive të ndryshme (p.sh. makineri elektrike, pajisje të fermave, korrëse bari etj.)</li> </ul>
Njeh rrezikun personal	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njeh objektet siç janë armët, shiringat, shkrepëset etj., që mund të jenë burim rreziku dhe që s'duhet të preken në asnjë mënyrë</li> <li>Manifeston mënyra kujdesi ndaj ujit, zjarrit, lartësive, ndaj njerëzve të panjohur dhe kafshëve;</li> <li>Di që nuk duhet të hajë ushqime apo substanca të panjohura si ilaçet mjekësore, helme të ndryshme, pastruesit higjienikë shtëpiakë etj.</li> </ul>
Di si dhe kur të kërkojë ndihmë	<ul style="list-style-type: none"> <li>I kërkon një të rrituri ndihmë kur i nevojitet në raste të ndryshme;</li> <li>Thërret për ndihmë gjatë emergjencave (p.sh. tërheq vëmendjen e një të rrituri, kërkon ndihmë në raste emergjence, lajmëron policinë me telefon 129.</li> <li>Njeh personat që japin ndihmë (p.sh. policin, zjarrfikësin).</li> </ul>

### Strategjitë e mësuesit që ndihmojnë fëmijët për të zhvilluar sjellje të kujdesshme

- Të modelojë dhe të diskutojë rreth rëndësisë së sjelljeve të kujdesshme (p.sh. “Unë gjithmonë lidh rripin e sigurimit kur jam në makinë”. Si mendoni, pse kjo gjë është e rëndësishme?”).
- Të ushtrojë emergjencat e zjarrit dhe të tjera, herë pas here, në mënyrë që fëmijët të familjarizohen me procedurat e emergjencave.
- Të lexojë përralla, pjesë të ndryshme për fëmijët, që trajtojnë çështjet e kujdesit dhe sigurisë, që kanë për personazhe policë, zjarrfikës etj., dhe të diskutojë bashkë me fëmijët.

- Të ftojë herë pas here në klasë policë, zjarrfikës, veteriner për të shpjeguar punën dhe rolin e tyre në shoqëri.
- T'u mësojë fëmijëve procedurat bazë të kujdesit dhe të sigurisë (p.sh. si të thërrasin për ndihmë; mos të prekin objektet, armët apo shiringat; çfarë do të bënin në rast se një i rritur i ngacmonte etj.) dhe të bëjë lojë me role për këto procedura, bashkë me fëmijët.
- Të përfshijë mjete të ndryshme në këndin e dramës (kokore, kukull të ulur në karrige me rrip sigurimi) duke i bërë fëmijët të luajnë lojë pretenduese dhe duke u fokusuar në sjelljen e kujdesshme.
- T'u mësojë fëmijëve simbolet bazë (p.sh. simbolet e helmeve, shenja DALJE,) për rrezikun, ruajtjen prej tij dhe sigurinë.



## KRIJIMI I NJË MJEDISI QË MBËSHTET ZHVILLIMIN FIZIK, SHËNDETIN DHE KUJDESIN

### Zhvillimi fizik

Është mirë të dihet rëndësia që duhet t'i japim zhvillimit fizik të fëmijëve në kurrikulën e parashkollorit, e cila është e njëjtë sikurse ajo e zhvillimit njohës dhe gjuhësor të tyre. Planifikimi i ushtrimeve lëvizore në mënyrë periodike brenda dhe jashtë klasës duhet të bëhet pjesë e planifikimit ditor. Për mësuesit e klasave përgatitore ndonjëherë kjo fushë prezanton vështirësi, për arsye hapësire dhe mjetesh. Këtu secili gjen mënyra krijuese për të kapërcyer këto lloj vështirësish. Në qoftë se hapësira prezanton problem

nuk duhen angazhuar të gjithë fëmijët në veprimtari fizike, puna me grupin e madh duhet të bëhet sa më rrallë; mirë është që veprimtaritë të zhvillohen rreth e përçark klasës me grupe të vogla fëmijësh ose individualisht. Mjetet realizohen edhe me materiale të riciklueshme që mund të jenë : disa shishe 2 litrash bosh, të cilat mund të përdoren për birra, kutitë e këpucëve me të cilat krijohen blloqe të ndryshme etj. Mos harroni se edhe familjarët janë një burim i mirë, ata mund të ndihmojnë në organizimin e lojërave sportive të ndryshme, në ngritjen e këndit të lojërave, mund të dhurojnë materiale ose pajisje sportive të përdorura që mund t'i shërbejnë klasës.

### **Shëndeti dhe kujdesi**

Nën kujdesin tonë dëshirojmë që fëmijët të kenë shëndet të mirë dhe të jetojnë në një mjedis të sigurt. Është detyra që të përmbushim standardet e parashkollorit për shëndetin dhe sigurinë për të gjithë fëmijët e klasës. Ata duhet të jenë të vëzhguar në çdo moment prej nesh. Do të ishte e mrekullueshme që të mos ndodhte asnjë aksident në klasë. Në mënyrë të vazhdueshme mësuesit duhet të modelojnë sjellje të sigurt dhe të shëndetshme, pasi janë të vëzhguar nga fëmijët dhe imitohen prej tyre. Ata duhet të dinë se si të sillen në situata emergjente ose në raste aksidentesh. Janë sërish mësuesit që duhet të nxisin fëmijët të praktikojnë këto sjellje pozitive, në mënyrë të pavarur, si në klasë, edhe në shtëpi.

## **PËRFSHIRJA E PRINDËRVE DHE E FAMILJES**

Mësuesit, prindërit, familjarët janë një forcë e madhe për të nxitur te fëmijët praktika të shëndetshme dhe kujdesshme. Kjo ndodh kur kemi të bëjmë me një komunitet të hapur dhe marrëdhënie të besueshme prind-mësues. Mësuesit i sigurojnë prindërve burime informacioni rreth problemeve shëndetësore dhe ruajtjes e kujdesit (dërgojnë në shtëpi fletëpalosje rreth mirë-ushqyerjes, programeve të vaksinimit etj.). Mësuesit ofrojnë sugjerime rreth veprimtarive fizike që prindërit dhe fëmijët mund t'i bëjnë bashkë, si piknikë të ndryshme, ekskursione. Shëndeti dhe siguria janë shqetësime për të gjithë, një komunikim i hapur dhe i respektueshëm me prindërit dhe familjarët bën të mundur përmbushjen dhe plotësimin e qëllimeve të vëna.





## PLANIFIKIMI JAVOR, MUJOR DHE VJETOR

### Shtator I. EMRI IM ËSHTË I VEÇANTË

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Sociale</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Të njohim veten dhe të tjerët;</li> <li>Emri im</li> <li>Njerëz të shquar</li> </ol>	
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Njoh dhe dalloj emrin tim</li> <li>Shkronja e parë e emrit tim</li> <li>Modeloj emrin tim</li> </ol>	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Sa shumë jam rritur</li> </ol>	
<b>Matematikë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Të njohim numrat nga 1-5</li> </ol>	
<b>Arte</b>	<p>Ngjyrat kryesore: <b>e kuqe,</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>edukim figurativ: ngjyrosje fletësh pune</li> <li>edukim muzikor-dëgjim muzikor</li> </ul>	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Trupi im</li> <li>Shqisat e mia</li> </ol>	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Përpiqem të kuptoj veten dhe të tjerët brenda mundësive që lejon zhvillimi im <ul style="list-style-type: none"> <li>Përmes fotove krahasoj veten ndër vite dhe gjej ndryshimet, duke u ndalur tek rritja dhe zhvillimi im.</li> <li>Mësoj të numëroj duke larë dhëmbët dhe duke numëruar çdo etapë të këtij procesi</li> <li>Mësoj të dalloj ngjyrën e kuqe, tek objektet që kam përreth, në kopsht, familje, rrugë etj.</li> <li>Mësoj rreth trupit tim dhe shqisave të mia, me ndihmën e kukullës., duke treguar shqisat dhe pjesët e trupit të saj.</li> </ul> </li> <li>Mësoj emrin tim dhe të shokëve me ndihmën e mësueses, nëse është e nevojshme <ul style="list-style-type: none"> <li>Ngjyros me dorën e mësueses fletët e punës.</li> </ul> </li> <li>Përafroj emrin tim ose të shokëve me një figurë të shquar, ose person të afërm, duke u asistuar nga shokët dhe mësuesja.</li> </ol>	

## Tetor    2. FAMILJA IME

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Sociale</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Unë dhe familja ime</li> <li>2. Respekti për veten dhe të tjerët</li> <li>3. Respekti për familjen dhe prindërit</li> <li>4. Të ngjashëm dhe të ndryshëm</li> </ol>	
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Çfarë më pëlqen në familjen time?</li> <li>2. Dita e familjes - (ekskursion/piknik)</li> <li>3. Të komunikojmë saktë</li> <li>4. Përshkruajmë anëtarët e familjes.</li> </ol>	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	Lojëra lëvizore: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Këndi i shtëpisë</li> <li>2. Familja në birrila</li> </ol>	
<b>Matematikë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. I ngjashëm dhe i ndryshëm</li> <li>2. E madhe, e vogël</li> <li>3. Aq sa,</li> <li>4. Të tregojmë numrat 1-5</li> </ol>	
<b>Arte</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngjyrosje: Portreti familjar</li> <li>2. Kolazh: Pema e familjes</li> <li>3. Kolazh me fotot e familjarëve</li> <li>4. Foto murale e klasës.</li> </ol>	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njohja e shqisave: Shqisat e bebes</li> <li>2. Identifikim objektsh të ndryshme familjare: Kush do ta përdorë këtë send?</li> </ol>	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Flas për familjen time; nëse nuk mundem përmes komunikimit verbal, tregoj rreth familjes sime edhe përmes vizatimit ose fotove. Mund të mos flas dot si shokët e mi ose të mos vizatoj si ata, por meritoj respektin e tyre, sikurse dhe ata timin.</li> <li>2. I dua shumë prindërit e mi, që nuk lodhen duke më ndihmuar dhe shërbyer në çdo moment. Faleminderit që jeni prindërit e mi/vëllai im/motra ime/gyshërit e mi, familja ime etj.</li> <li>3. Pavarësisht se kemi të njëjtën moshë dhe mësojmë në të njëjtin kopsht, jemi të ndryshëm në shumë aspekte, (zhvillimi fizik, mendor, emocional, social).</li> <li>4. Prindërit nuk lodhen duke më shpjeguar se si duhet ta bëj diçka. Familja ime konsideron nevojat dhe dëshirat e mia gjithmonë.</li> </ol>	

<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>5. Shkoj gjithmonë në festa familjare me familjen time, shtëpia ime është e hapur për miqtë e mi</li><li>6. Mund edhe t'i përshkruaj duke i vizatuar anëtarët e familjes sime.</li><li>7. Mësuesja dhe shokët më ndihmojnë të luaj tek këndi i shtëpisë, duke shmangur rreziqet.</li><li>8. Mësuesja më ndihmon të ndërtoj albumin e familjes time.</li></ol>	
---	---	--

## Nëntor 3.TRUPI YNË

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Sociale</b>	1. Të ngjashëm dhe të ndryshëm <b>Loja me dallime</b>	
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	1. Të përshkruajmë trupin tonë; 2. Të mbajmë trupin pastër Vjershë-"A e dini ç'ngjau?" 3. Bashkëbisedim " Sa jemi rritur?"	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	1. Si mbahet pastër trupi- demonstrim larje kukullash; 2. Si lahen dhëmbët.	
<b>Matematikë</b>	1. Të njohim numrat nga 1-10 Numërim me 10 gishta nga 1-10; 2. Vjershë-Dhjetë Gishta Forma - katrori; 3. Zbavitje me pjesët e trupit	
<b>Arte</b>	1. Hija- Ngjyrat e bardhë dhe e zezë 2. Kolazh: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Silueta</li> <li>• Portreti në pjatë</li> <li>• Krahët e pemës së mollës</li> <li>• Dhëmbët gjigantë</li> <li>• Forma ime, kolazh</li> </ul>	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	1. Vëzhgojmë <b>pjesët e trupit</b> 2. Shqisa dhe organi i saj 3. Të kujdesemi për trupin tonë	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	1. Mësuesja më ndihmon të kuptoj dallimet dhe ngjashmëritë duke e ilustruar me objekte konkretë, dhe duke ma përsëritur disa herë 2. Duhet të tregoj kujdes për higjienën e trupit që shokët, mësuesja dhe të tjerët të luajnë dhe të qëndrojnë me kënaqësi me mua. 3. Jam rritur, vitin e kaluar nuk e mbaja dot lugën tek dora për t'u ushqyer, tani mund të ha vet pa ndihmë. 4. Me ndihmën e mësueses dhe të prindërve në shtëpi, mësoj se si duhet të laj duart dhe fytyrën. 5. Mësoj me numëratore, me enët e kuzhinës, duke numëruar shokët, të numëroj brenda sasive nga	

<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<p>I në 2, në 3, në 4 etj. derisa të aftësohem për të numëruar deri në 5, nëse do të mundem</p> <p>6. Me ndihmën e mësueses mësoj format e thjeshta gjeometrike, p.sh. formën e topit, të portokallit, duke m'i konkretizuar.</p> <p>7. Ngjyros me ngjyrat bazë, përdor shumë ngjyra në një fletë, sipas dëshirës dhe bëj, pika, vija, shkarravina etj.</p>	
---	---	--

## Dhjetor 4. PESË SHQISAT

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Arte</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqisa e të prekurit- pikturë me gishta</li> <li>2. Shqisa e të nuhaturit dhe të shijuarit-Përvoja ndijore me lojëra argëtuese.</li> <li>3. Imitojmë tingujt dhe zhurmat</li> </ol>	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Koleksion me sende të ndryshme për shqisën e të prekurit;</li> <li>2. Veprimtari shkencore për shqisën e të shijuarit-</li> <li>3. Veprimtari shkencore për shqisën e të nuhaturit- "Kjo vjen erë si...";</li> <li>4. Shqisa e të parit - veprimtari argëtuese -"Pasqyrë, pasqyrim"</li> </ol>	
<b>Sociale</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të ngjashëm dhe të ndryshëm</li> <li>2. Vjershë: Nga kemi ardhur?</li> </ol>	
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bashkëbisedojmë për shqisat.</li> <li>2. Koleksion në formë libri për shqisën e të prekurit</li> <li>3. Përshkruajmë shijet</li> <li>4. Sytë e mi - vjershë</li> <li>5. Të dëgjuarit - Përshkrimi dhe imitimi i zhurmave dhe tingujve</li> </ol>	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Veprimtari arti në lëvizje: "Pikturë me këmbë"</li> <li>2. Luajmë së bashku - Loja e bilbilit</li> <li>3. Lojëra dëgjimore</li> </ol>	
<b>Matematikë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Numërimi nga 1-5 i gishtave të duarve dhe të këmbëve;</li> <li>2. Gjej sa janë?</li> </ol>	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Prek me duar, objekte dhe tregoj për to, nuhas erëra të ushqimeve apo lëngjeve me të cilat jam më i familjarizuar. Dëgjoj muzikën që më pëlqen, imitoj tingujt e thjeshtëa p.sh. si bën qeni, lopa etj.</li> <li>2. Duke parë lëvizjen e gojës, gjuhës përballë një pasqyre mësoj të shqiptoj më mirë, përpara pasqyrës bëj dhe ushtrime motorike.</li> <li>3. Ju tregoj se si arrij të dëgjoj duke përdorur aparatën tim të dëgjimit</li> <li>4. Unë ndihmohem nga syzet për të parë më mirë...</li> <li>5. Numëroj karamelat që më dha mësuesja kur mbarova vizatimin.</li> </ol>	

## Janar 5. STINËT

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Sociale</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të njohim stinët</li> <li>2. Kalendar i stinëve</li> <li>3. Punët e ndryshme në stinët e verës, pranverës, vjeshtës dhe dimrit</li> <li>4. Respekti për punën</li> </ol>	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të vëzhgojmë stinën -ekskursion;</li> <li>2. Koleksion gjethesh;</li> <li>3. Katër elementët për rritjen e një bime;</li> <li>4. Moti në stinë të ndryshme.</li> </ol>	
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Stinët -vjersha të ndryshme për stinët</li> <li>2. Familjarizim me alfabetin</li> <li>3. Gjurmëzim i një shkronje</li> <li>4. Përralla apo histori me tematikë stinët</li> </ol>	
<b>Arte</b>	<p>Ngjyrat : e gjelbër dhe e verdhë</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vizatime të stinëve dhe peizazheve të ndryshme;</li> <li>2. Punë me baltë</li> <li>3. Përgatitje posterash dhe mozaikësh me ngjyra të llojeve të ndryshme me materiale natyrore.</li> <li>4. Mësim i një kënge për stinët apo motin</li> <li>5. Dëgjim muzike klasike apo këngësh për natyrën (Vivaldi)</li> <li>6. Mësim i një valleje me temë pranverën apo dëborën e parë.</li> </ol>	
<b>Matematika</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikimi i numrave 1-4</li> <li>2. Format: rreth, katror, trekëndësh</li> <li>3. klasifikimi i formave me madhësi dhe ngjyra të ndryshme</li> <li>4. Numërim objektësh</li> </ol>	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Lojërat që zhvillojmë në stinë të ndryshme;</li> <li>2. Sportet që pëlqej më shumë;</li> <li>3. Kur rrezikojmë të sëmurëmi më shumë dhe pse?</li> </ol>	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mësuesja më ndihmon duke më treguar vizatimin me borën dhe plakun e vitit të ri dhe të gjithë shokët në grup më thonë se kjo stinë quhet dimër.</li> <li>2. Mësuesja u kërkon prindërve të më bëjnë një shëtitje, të më çojnë të luaj në lëndinë dhe të</li> </ol>	



<p><b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b></p>	<p>mbledh lule. Kjo stinë me lule, e ka emrin pranverë.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>3. Unë e pëlqej shumë rrushin, mësuesja më tregoi se rrushi piqet në vjeshtë.</li> <li>4. Unë dua të mësoj të notoj në det, por shokët më thanë se duhet të pres sa të vijë vera.</li> <li>5. Unë nuk di të kërcëj, por i përplas duart shumë bukur sipas ritmit.</li> <li>6. Unë kam shumë makina për të luajtur, makinën e kuqe, trenin, autobusin dhe makinën me telekomandë. E gjeni dot sa kam gjithsej? I numërojmë bashkë..</li> <li>7. Unë dua të luaj jashtë, por mami nuk më lejon se sëmurem shpejt dhe pastaj pi shumë ilaçe dhe shkoj tek xhaxhi doktori. Mësuesja më shpjegon....</li> </ol>	
--	---	--

## Shkurt 6. MOLLA

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Sociale</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Ndihmojmë njëri-tjetrin <ul style="list-style-type: none"> <li>Farërat e mia</li> <li>Molla e kuqe</li> </ul> </li> <li>Ekskursion në natyrë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Të gëzojmë natyrën e bukur;</li> <li>Ndihmojmë në punët e stinës ;</li> <li>Vizitë në një kopsht me mollë;</li> </ul> </li> <li>Shoqërizim Kek me mollë</li> </ol>	
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Fjalë të kundërta <ul style="list-style-type: none"> <li>Shtëpia e kuqe rrumbullake-përrallë</li> <li>Shijoni mollë të ndryshme;</li> <li>Lëng apo pelte molle?;</li> <li>Vjershë për mollën.</li> </ul> </li> </ol>	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Koordinim lëvizjesh sy-vesh-dorë <ul style="list-style-type: none"> <li>Kapja e mollës</li> <li>Paso mollën</li> </ul> </li> <li>Forcim i lëvizjeve motore fine <ul style="list-style-type: none"> <li>Mollë prej plasteline</li> <li>Molla e stampuar</li> <li>Pema e mollës</li> <li>Ngjyrosje e mollës</li> <li>Kolazh me fara mollësh</li> </ul> </li> </ol>	
<b>Matematikë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Numrat nga 1 deri në 5 Pesë mollë të kuqe- vjershë matematikore</li> <li>Numërim në zbritje nga 5 deri në 1 Numërimi i mollëve</li> <li>Krahasimet: <ul style="list-style-type: none"> <li>- i njëjtë me..</li> <li>- i ngjashëm me.. <ul style="list-style-type: none"> <li>- i madh</li> <li>- i vogël</li> </ul> </li> <li>Mollë të njëjta</li> <li>Në kërkim të mollës</li> <li>Mollë me ngjyra</li> <li>Renditja e mollëve</li> </ul> </li> </ol>	
<b>Arte</b>	E kuqe E verdhë, E gjelbër	

<b>Arte</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pema e mollës në dorën time</li> <li>• Molla prej qelqi</li> <li>• Korniza në formë molle</li> <li>• Gjysma e mollës</li> </ul>	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Molla si frut</li> <li>2. Pema e mollës</li> <li>3. Farat</li> <li>4. Kujdesi për pemët frutore</li> <li>5. Klasifikimi</li> </ol> <p>Sa kokrra molle i gjatë jam unë?</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Anketa e mollës</li> <li>• Numërimi i mollëve</li> <li>• Një krimb në mollë</li> <li>• Çfarë gatuhet me mollë?</li> <li>• Sallatë frutash</li> <li>• Molla e pjekur</li> <li>• Ylberi dhe ngjyrat e natyrës</li> </ul>	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Unë mundem vetëm ta ngjyros mollën; por, pavarësisht kësaj, mësuesja ma vendosi vizatimin tek këndi i klasës.</li> <li>2. Unë ha çdo ditë mollë</li> <li>3. Shokët dhe mësuesja më treguan mollën jeshile dhe të kuqe; ata më dhanë edhe një mollë të madhe fare edhe një të vogël fare.</li> <li>4. Me mollën prej lodre unë ushqeva kukullën.</li> <li>5. Unë nuk e kafshoj dot mollën, prandaj mami ma shtrydh lëngun e saj tek shtrydhësja</li> </ol>	

## Mars 7. I MADH DHE I VOGËL

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Sociale</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shtëpitë e qytetit</li> <li>2. Shtëpitë e fshatit</li> <li>3. Kujdesi për banesën</li> <li>4. Dorë e madhe, dorë e vogël</li> </ol>	
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Interpretim</li> <li>2. Lojë me role</li> </ol>	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kujdesi për shëndetin</li> </ol>	
<b>Matematikë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. I madh - I vogël</li> <li>2. Renditje</li> <li>3. Grupim</li> <li>4. Krahasim</li> </ol> <p style="text-align: center;"><b>Forma me madhësi të ndryshme</b> Gjatësia jonë Loja e komçave-krahasimi i komçave</p>	
<b>Arte</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dallimi i ngjyrave,</li> <li>2. Dallimi i përmasave dhe i formave Përmasat e arushit Punë me baltë ose plastelinë.</li> </ol>	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përmasat <ul style="list-style-type: none"> <li>• Matja e këmbës</li> <li>• Fara e vogël e bimëve</li> <li>• Gjërat që janë të mëdha/Gjërat që janë të vogla</li> </ul> </li> </ol>	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Unë i nxjerr të gjitha lodrat nga kutia dhe luaj me to. Kur shkoj tek shtëpia e gjyshes, atje ka shumë vend, ajo ka shtëpi të madhe.</li> <li>2. Kur mbaroj se vizatuari, mami më ndihmon t'i vendos të gjitha lapsat në vendin e tyre. Bashkë me mamin i numërojmë lapsat që fusim në kuti.</li> <li>3. Motra ime më lexon përralla shumë të bukura, ajo arrin ta marrë kukullën time lart tek dollapi, sepse ajo është e madhe, e gjatë. Unë nuk e marr dot librin, tek rafti, pasi...</li> </ol>	

## Prill 8.TË NJOHIM NUMRAT DUKE NUMËRUAR

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	1. Zhvillimi i aftësive perceptuese për të eksploruar botën nëpërmjet koncepteve të sasisë dhe numrit	
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	1. Pasurim fjalori i me emërtimet e ndryshme të numrave <b>Historia e lapsave me ngjyrë</b> 2. Karakteristikat e personazheve dhe veprimet e tyre.	
<b>Matematika</b>	1. Numër; 2. Sasia 1-6 3. Mbledhje +1 4. Zbritje -1 <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numërimi i qirinje në tortën e ditëlindjes.</li> <li>• Sa kupa akullore dëshironi?</li> <li>• Bashko sasinë me numrin.</li> <li>• Gjuetia e numrave.</li> <li>• Gjëzat me numra.</li> </ul>	
<b>Arte</b>	1. Përpunimi i plastelinës 2. Vizatime me më shumë se tri ngjyra	
<b>Sociale</b>	1. Përforcimi i vlerave të respektit dhe dashurisë në mes fëmijëve 2. Respektimi i radhës <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lokomotiva e trenit;</li> <li>• Sheshi i numrave;</li> <li>• Unë jam numri.</li> </ul>	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	1. Lojë me numra ;	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	1. Treni prej lodre qenka shumë i madh, ai paska 6 vagonë të vegjël. 2. Unë kam dy topa, një të verdhë dhe një kuq, të verdhin ma mori Jona, tani kam vetëm një (duke e treguar me gishta). 3. Unë doja të luaja me kukullën e Anës, por ajo nuk ma dha, mësuesja më tha se më parë duhet t'i them nëse mund ta marr apo jo. 4. Nuk mund ta hedh gjithmonë unë topin i pari, sepse të gjithë shokët duan të jenë të parët. 5. Sot luajta me plastelinë : e bashkova, e ndava, e rrotullova ja kështu....	

## Maj 9. TRANSPORTI

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Sociale</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndhmësi i komunitetit</li> <li>2. Nga një qytet në tjetrin</li> <li>3. Harta ime</li> </ol>	
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njohje me shkronjën "A", "a" "Aeroplani"</li> <li>2. Identifikim emrash i me shkronjën "A" Këngë ose vjersha të ndryshme <ul style="list-style-type: none"> <li>• Poshtë nga stacioni</li> <li>• Semafori</li> <li>• Drejtuesit</li> </ul> </li> </ol>	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	<p><b>Lojëra të ndryshme lëvizore</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hapësira ime e ndërtimit</li> <li>2. Transporti gjatë kohës së pushimeve;</li> <li>3. Çfarë do të vendosni në valixhen tuaj?</li> </ol>	
<b>Matematikë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shkrim numrash 1-5; Targa makinash me shkumës.</li> <li>2. Renditje numrash 1-10 Udhëtim me tren.</li> </ol>	
<b>Arte</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Semafori <ul style="list-style-type: none"> <li>• Trafiku im me drita</li> <li>• Makina ime e preferuar e transportit</li> <li>• Piktorë të vërtetë</li> <li>• Aeroplani im</li> <li>• Të ndërtojmë vet mjetin e transportit</li> <li>• Shenja Stop</li> </ul> </li> </ol>	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Veprimtari ndërvepruese vëzhguese; <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjurmët e një rrote</li> <li>• Kavanozat rrotullues</li> <li>• Kategoritë e transportit</li> </ul> </li> </ol>	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Unë duhet të shkoja në spital që të mund të shërohesha, kështu më duhej të përgatisja valixhen time, mora edhe arushin tim të bardhë, edhe furçën e dhëmbëve, edhe librin me përralla.</li> <li>2. Kur po vija për në kopsht e pyeta babin: Përse xhaxhi polici e ndali atë tetën me makinë? dhe ai më tha se ajo nuk e kishte ndaluar makinën kur</li> </ol>	

<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	kishte parë një tabelë që lexon "STOP"..3. Unë çdo ditë vij në kopsht me biçikletën e mamit. 4. Ne shkuam në cirk me autobus të madh. 5. Unë e kaloj rrugën duke ecur me karrocën time me rrota, të gjithë makinat më lejojnë të eci. (ilustro me figurë).	
---	---	--

## 10. TRENI

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Sociale</b>	<b>Aftësitë</b> 1. Njohja dhe zbatimi i rregullave të udhëtimit; 2. Kujdesi dhe siguria në rrugë; 3. Rregullat e komunikimit me të tjerët. 4. Dobia e përdorimit të mjeteve të transportit.	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	1. Vëzhgimi dhe klasifikimi i mjeteve të transportit; 2. Ekskursion me fëmijët në stacionin e trenit/ autobusëve apo të portit të qytetit tuaj. 3. Drejtuesit e mjeteve të transportit;	
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	1. Të bashkëbisedojmë për mbresat e udhëtimeve të ndryshme; 2. Familjarizim me alfabetin; 3. Të njohim gjurmët shkronjës "T" ; 4. Pasurim fjalori me fjalë që përmbajnë shkronjën "T"; 5. Zhvillimi i aftësive treguese për të përshkruar trenin me karakteristikat e tij.	
<b>Matematika</b>	1. Mbledhje dhe zbritje me 1; 2. Format : rreth, katror dhe trekëndësh 3. Klasifikimi i formave me madhësi dhe ngjyra të ndryshme.	
<b>Arte</b>	1. Punë me baltë; 2. Ngjyrosje; 3. Punë me letër; 4. Këngë për trenin; 5. Të vallëzojmë si mjete transporti.	
<b>Edukimi fizik dhe shëndeti</b>	1. Të mësuarit për të ngarë biçikletën, monopatinën dhe të tjera mjete sportive për fëmijë; 2. Ekskursion në mjedise të ndryshme ku fëmijët luajnë dhe argëtohen, zhvillojnë sporte etj	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	1. Kur ndizet drita e kuqe, babi e ndalon makinën, unë nuk e di përse..... 2. Unë nuk e dëgjoj dot burinë e makinave në rrugë, prandaj duhet të eci gjithmonë në trotuar që të mos rrezikoj të shtypem prej tyre, (ilustro me shembuj, një fëmijë me probleme dëgjimi, si mund ta njoftojmë për ardhjen e një makine përmes shenjave).	



<p><b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. Mësuesja dhe mami më tregojnë se me cilën shkronjë fillojnë emrat e shokëve, të pjesëtarëve të familjes.</li> <li>3. Në autobus unë kam vendin tim të përcaktuar që më lejon të qëndroj bashkë me karrocën time me rrota.</li> <li>3. Grisa shumë letra me gërshërë dhe i hodha lart si bora</li> <li>4. Mësuesja vizatoi një trekëndësh në dyshe me dhe unë qëndrova brenda tij, pastaj dola jashtë.</li> <li>5. Mësuesja vizatoi një rreth të madh tek oborri dhe ne të gjithë hymë brenda tij. Ana dhe Era qëndruan jashtë.</li> </ol>	
--	---	--

## II. NGJYRAT

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	1. Përdorimi në mënyrë krijuese i ngjyrave dhe materialeve;	
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	1. Pasurim fjalori me emërtimet e ndryshme të ngjyrave; 2. Zhvillimi i të folurit verbal dhe jo verbal.	
<b>Matematika</b>	1. Krahasim sipas formës, ngjyrës dhe madhësisë së objekteve.	
<b>Arte</b>	<b>Konceptet</b> 1. Dallimi i tonalitetëve të ngjyrë; 2. Teknikat e ndryshme të ngjyrit.	
<b>Sociale</b>	1. Të bashkëpunojmë në grup;	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	1. Veprimtari lojërash në mjedise të ndryshme të kopshtit, brenda dhe jashtë.	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	1. Unë ia tregova me gisht mësueses se ku ishte topi i verdhë. 2. Unë i përsërita disa herë me mësuesen se cilat janë ngjyrat e ylberit. 3. Mësuesja më tha ta hidhja topin tek bari i gjelbër. 4. Mësuesja më tregoi tek libri detin e kaltër.	

## 12. BIBLIOTEKA

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i dëshirës së fëmijëve për të lexuar librin në mënyrat e tyre</li> <li>Pasurim fjalori i 4-vjeçarëve si dhe nxitje e dashurisë dhe respektit për librin dhe e mirëmbajtjes së tij. <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbledhja e librave të ndryshëm;</li> <li>Vizitë në bibliotekën e qytetit apo të lagjes;</li> <li>Takim me një shkrimtar ose person tjetër;</li> <li>Organizimin e një pasditeje speciale për inaugurimin e bibliotekës;</li> <li>Zhvillimi i një teatri mbi përmbajtjen e një libri.</li> </ul> </li> </ol>	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Njohje me librat e shkencës;</li> <li>Klasifikimi i fushave të ndryshme të shkencës si natyra, universi, mjetet mekanike etj.</li> <li>Koleksion nga natyra, transporti, pushimet verore etj.</li> </ol>	
<b>Artet</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Bërja e një libri në format artistik;</li> <li>Hartimi dhe përdorimi i etiketave të ndryshme etj. ;</li> <li>Këngë për librin.</li> </ol>	
<b>Matematika</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Numërimi i librave të bibliotekës</li> <li>Madhësitë e librave;</li> <li>Klasifikimi i librave.</li> </ol>	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Kujdesi për qëndrimin e trupit gjatë leximit;</li> <li>Koordinimi i veprimtarisë mendore me aktivitetin fizik;</li> <li>Kujdesi për sytë;</li> <li>Të ndihmojmë në ndërtimin e bibliotekës së kopshtit.</li> </ol>	
<b>Shkencat sociale Aftësitë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Edukimi me dashurinë për librin;</li> <li>Kujdesi për librin dhe mirëmbajtjen e tij;</li> <li>Respektimin e radhës</li> <li>Rregullat e bibliotekës.</li> </ol>	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Unë e lexova librin vetëm duke i shfletuar faqet e tij, kështu di të lexoj unë, mësuesja më tha "të lumtë dora e vogël".</li> <li>Mësuesja më lexoi librin dhe unë e ndihmova duke i treguar me gisht figurat e tij.</li> <li>Unë e grisa librin, në një moment që u bëra nervoz/ e se nuk po shprehja dot dëshirën që kisha, por pastaj bashkë me mësuesen e ngjita prapë.</li> </ol>	

### 13. NË DYQAN

Fushat	Temat	Javët, shënime të ndryshme
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi, komunikimi dhe ndërveprimi</li> <li>Pasurimi i fjalorit me fjalë dhe terma të tregtisë dhe ekonomisë.</li> </ol>	
<b>Matematika</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Pesha</li> <li>Matja,</li> <li>Numërimi 1-10</li> <li>Mbledhje dhe zbritje të thjeshta brenda dhjetës</li> </ol>	
<b>Shkencat sociale</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Shkëmbimi dhe bashkëveprimi</li> <li>Rregullat e mirësjelljes dhe të edukatës së mirë</li> </ol>	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Përbërja e materialeve</li> <li>Dallimet materialeve të ndryshme</li> <li>Klasifikimi i produkteve</li> </ol>	
<b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Kujdesi nga ushqimet e pasigurta dhe produktet e rrezikshme</li> </ol>	
<b>Arte</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Hartimi i një reklame për një produkt</li> <li>Bërja e etiketave</li> </ol>	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Në lojën me dyqane tek kopshti, unë bleva mollë, duke i treguar me gisht sasinë që doja.</li> <li>Mësuesja i ngjiti disa ushqimeve jo të shëndetshme etiketa me ngjyra të ndryshme dhe unë tani di t'i dalloj ato.</li> </ol>	

## I. EMRI IM ËSHTË I VEÇANTË

Fushat	Udhëzime	Materialet
<b>Hyrje</b>	Fëmijët qëndrojnë një kohë të gjatë në kopsht. Ata shoqërizohen me njëri-tjetrin dhe momenti i parë i ndërveprimit të tyre është njohja e emrave të njëri-tjetrit. Ata gjithashtu janë në fazën e të kuptuarit se emri i bën të ndihen të veçantë dhe se secili njeri ka emrin e tij, të ngjashëm dhe të ndryshëm nga tjetri. Tema “Emri im është i veçantë” përcjell një mesazh të mirë për të motivuar fëmijët të praktikojnë njohjen dhe gjetjen e gjurmës së emrit të tyre.. Kërkimi i emrit është gjithashtu një hap i parë i mirë për shkrimin.	Libra, etiketa, shkronja të mëdha, figura fëmijësh
<p><b>Sociale</b></p> <p><b>Konceptet</b> Të mësuarit për të njohurvetentë tjerët, si dhe për të rritur vetëvlerësimin e shëndetshëm</p> <p><b>Vlera:</b> Humanizmi</p>	<p>Kjo veprimtari do të ndihmojë fëmijët të njohin dhe të kërkojnë për të gjetur emrin e tyre. Është shumë i rëndësishëm për fëmijët hapi i parë që do të hedhim në këtë drejtim. Është një mundësi që i jepet çdo fëmije për të ditur se emri i tij është special, gjë që promovon një vetëvlerësim të shëndetshëm dhe të pavarur.</p> <p>Këtu janë disa ide dhe sugjerime që shërbejnë për ndërtimin e veprimtarive të ndryshme të projektit mësimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kuptimi i emrit.</b> Fëmijët pëlqejnë të dinë kuptimin e emrave të tyre ose pse ua kanë vënë atyre këtë emër. Në qoftë se ju dini ose mund të gjeni informacionin e nevojshëm rreth kuptimit të emrave të fëmijëve mund të themi se keni gjetur një mënyrë interesante për të filluar këtë veprimtari.</li> </ul> <p><b>Shembull :</b> Në qoftë se një fëmijë e ka emrin Agron (emër ilir) ju mund të tregoni historinë e mbretërve Agron, Genti, Teuta dhe popullsisë ilire që ka jetuar në lashtësi në trojet amtare, gjë për të cilën fëmijët tregojnë interes kur historia ilustron edhe me figura.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mësuesja mund të gjejë gjithashtu edhe një <b>figurë historike</b> që ka të njëjtin emër me një prej fëmijëve të grupit. Ndjenja e një roli të mirë si Gjergj për Gjergj Kastriotin, Gonxhe Bojaxhiu për nënë Terezën, modelon te fëmijët cilësitë e këtyre personave historikë</li> </ul>	<p>Foto të bëra së fundmi nga fëmijët, piktura, libra,</p> <p>Album për nënë Terezën</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ju mund të përfshini në orën e mësimit një <b>libër të thjeshtë biografik</b> me koleksion fotosh dhe pikturash, libër që mund të ndodhet edhe në libraritë lokale</li> <li>Një <b>libër me foto</b> mund të jetë një mënyrë e mirë për të ndihmuar fëmijët të vlerësojnë dhe të respektojnë çdo emër. Titulli i një libri artistik apo personazheve të tij shpesh mund të bëhet një motiv më shumë për të gjetur emra dhe për të shpjeguar kuptimin e tyre</li> </ul> <p>Emri i humanistes së madhe shqiptare nënë TEREZA mund ta çojë natyrshëm mësuesen në përshkrimin e figurës së saj, vlerave që ajo ka mbartur në vetvete gjatë angazhimit të saj madhor për të kontribuar në eliminimin e varfërisë në botë, dhënien e ndihmës për të sëmurët, të pastrehët dhe ata që ndodheshin në vështirësi.</p> <p>Tregojini atyre se disa fëmijë mund të kenë të njëjtin emër me të gjyshit, gjyshes, apo të afërmeve të tjerë në familje.</p> <p>Pyetini fëmijët nëse dikush prej tyre ka trashëguar emrin e gjyshit, gjyshes apo ndonjë të afërmi tjetër. Kërkojini atyre që të diskutojnë në familje nëse prindërit apo motrat e vëllezërit e tjerë të tyre mbajnë/trashëgojnë emrin e ndonjë të afërmi.</p> <p>Nxitini fëmijët në grup të tregojnë për të afërmit e tyre, emrat e të cilëve i mbajnë ata apo pjesëtarë të tjerë të familjes, duke u ndalur tek individualiteti dhe vlerat e çdo njërit prej tyre.</p> <p><i>P.sh. a ka një histori emri juaj? Cila është ajo, do të na e tregosh?</i></p> <p>Tregojini gjithashtu fëmijëve se emri ndonjëherë mund të jetë i lidhur me vendin e origjinës së fëmijës, p.sh. fëmijët që kanë lindur në Kinë, në Itali, në Kosovë, e të tjera shtete. Në disa raste të tjera emrat e fëmijëve i vendosin prindërit, nisur nga dëshira dhe preferenca e tyre për emra të caktuar. Ndodh që dita e lindjes së fëmijës përkon me një ngjarje historike, me një festë fetare apo me ndonjë ngjarje apo ndodhi tjetër që familja mund të ketë përjetuar.</p>	
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p>	<p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b></p> <p>Krijoni një faqe me emrin e çdo fëmije.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Sillni në klasë një faqe shkrimi të vizuar, të vlefshme për një fëmijë parashkollor</li> </ul>	<p>Fletë të bardha, lapsa me ngjyrë, fletë plastike transparente</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Aftësitë</b> Të mësuarit për t'u fokusuar në shkronjën e parë të emrit të tyre, për të njohur gjurmët si dhe për të shkruar emrin e tyre</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Praktikoni fillimisht vetëm shkrimin e emrit. Shkruani emrin e fëmijës në rreshtin e parë. Bëni një demonstrim të ngadaltë për secilën shkronjë. Modeloni emrin sipas gjurmës. Tregojini fëmijës gjurmën që duhet të përshkruajë për të shkruar emrin e vet.</li> <li>• Inkurajoni fëmijën të praktikohet duke shkruar emrin e tij në rreshtat poshtë modelit të emrit të shkruar</li> <li>• Përdorni tryezën e ndriçuar ose një fletë transparente ku fëmija jo vetëm të ndjekë gjurmët, por edhe të mund të bëjë korigjimet e duhura</li> <li>• Në vazhdim të njohjes së figurës së nënë Terezës, flisni për jetën e saj si personazh duke përdorur fjalë që shërbejnë për të treguar karakteristikat e një personi të veçantë</li> </ul>	
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Të mësuarit për tu fokusuar në trupin e tyre, historinë e rritjes dhe zhvillimit fizik personal të tyre</p>	<p>Tema “Emri im është i veçantë” lidhet me çka fëmija mëson për veten dhe botën që e rrethon. Në moshën 4-5 vjeç fëmija është duke krijuar përmes un-it të vet identitetin e tij. Ai tashmë ka një histori të lindjes dhe zhvillimit personal si qenie njerëzore që mund ta shohë mjaft mirë përmes kujtesës së prindërve, të vetes, të shokëve dhe një albumi të thjeshtë fotosh.</p> <p>Fokusohuni si mësuese në pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Si lind një fëmijë?</li> <li>• Si rritet ai?</li> <li>• Kur ecën, flet dhe ha vetë?</li> <li>• Si kujdeset familja për shëndetin e fëmijëve?</li> <li>• Tregoni albume, foto dhe histori të veçanta me familjen tuaj</li> </ul> <p>Mësuesja ndalet edhe te kujdesi që secili fëmijë duhet të tregojë për shëndetin e vet duke i njohur ata me vaksinat, rregullin e duarve të pastra etj.</p> <p>Tregojini atyre se disa fëmijë rriten dhe zhvillohen më ngadalë sesa disa fëmijë të tjerë, se si disa shfaqin probleme gjatë lindjes ose më pas. Të tjerë fëmijë mund të kenë vështirësi kur flasin, ecin shohin, dëgjojnë, por pavarësisht të gjitha këtyre, të gjithë fëmijët janë të barabartë dhe kanë të njëjtat të drejta dhe kanë nevojë të ndihmohen prej të gjithëve, shokë shoqe mësues e prindër e të tjerë.</p> <p>Ilustroni me shembuj.</p>	<p>Albume dhe fletëpalosje me fokus trupin dhe shëndetin.</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Tregojini fëmijëve përmes shembujve : p.sh. për Erin, i cili megjithëse është 4 vjeç dhe shkon në kopsht, nuk arrin të flasë si shokët e tij, pasi ka disa vështirësi që i janë shfaqur që kur ai ka qenë bebe. Por pavarësisht vështirësive për të komunikuar me shokët dhe edukatoren, ai shkon në kopsht, si të gjithë shokët e tij.</p> <p>Diskutoni me ta mbi mënyrën me të cilën duhet të sillen me fëmijët të cilët, për arsye të ndryshme, nuk vrapojnë dot si ata, nuk flasin dot si ata, nuk numërojnë dot si ata etj. si këto</p>	
<p><b>Matematikë</b></p> <p><b>Konceptet</b> Numër Masë Peshë</p>	<p>Njohja e fëmijëve me lindjen dhe zhvillimin e tyre fizik krijon mundësi të shumta për përdorimin e koncepteve matematike si numri-kur lidhemi me sa vjeç është fëmija, matja- kur i kërkojmë fëmijës gjatësinë dhe pesha- kur flasim për ndryshimet e një fëmije nga 0 deri në 4 vjeç.</p>	<p>Peshore Metër dhe numra deri në 5</p>
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Konceptet</b> Bardhë e zi Ngjyra: e kuqe</p>	<p>Fusha e arteve jep mundësi të pafundme për fëmijët parashkollorë të veprojnë dhe të bëjnë punime të shumta rreth vetes. Ata mund të bëjnë vizatime dhe punë me plastelinë të ndryshme, si dhe të shpjegojnë përmes tyre konceptin që kanë për veten dhe të tjerët.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Secili prej fëmijëve mund të gjejë një kafshë që i duket e ngjashme me veten duke e vendosur përbri figurës së skicës së tij. Duke prerë figurën e kafshës së ngjashme me veten shpjegon edhe ngjyrat që dominojnë lëkurën e kafshës.</li> <li>• Mund të përdoren fletët e punës me portrete për të ngjyrosur tiparet e fytyrës me ngjashmërinë e secilit fëmijë: flokët, sytë, rrobat etj.</li> <li>• Po kështu mund të përdoren CD me muzikë dhe këngë që kanë në fokusin e tyre fëmijët me dëshirat dhe veprimtarinë e tyre ditore</li> </ul>	<p>Letra, lapsa me ngjyrë, plastelinë, figura kafshësh, fletë pune</p> <p>CD me muzikë dhe këngë</p>
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p> <p><b>Konceptet:</b> Trupi im Shqisat e mia</p>	<p>Tema “Emri im është i veçantë” mund të lidhet shumë mirë edhe me përcaktimin e secilit fëmijë si individ i veçantë.</p> <p>Trupi i secilit mund të bëhet objekt vëzhgimi dhe përshkrimi nga parashkollori. Po ashtu një vend të konsiderueshëm mund të zërë edhe trajtimi i shqisave i cili është konceptuar si një projekt njohjeje më vete. Rekomandohen të zhvillohen ushtrime të tilla si:</p>	<p>Një album ose libër "Trupi ynë", "Shqisat e mia"</p>



Fushat	Udhëzime	Materialet
	Me sytë ne shohim Me veshë ne..... Me gojë ne..... Me hundë ne.....	
<b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b>	<p>Tregojini fëmijëve se : Disa fëmijë, që nga lindja e tyre,ose disa të tjerë dhe pas lindjes, gjatë procesit të rritjes, shfaqin probleme të zhvillimit të tyre, p.sh. ka fëmijë, të cilët nuk arrijnë të shohin nga distancat e largëta, apo të afërta, sikurse të gjithë fëmijët e tjerë. Në këto raste mjekët, ku ata vizitohen, u rekomandojnë të përdorin syza në mënyrë që të mund të shohin si të tjerët dhe të ndihmohen për të mos pasur pengesa. Në raste të tjera, disa fëmijë për arsye të ndryshme kanë vështirësi për të dëgjuar si të tjerët dhe u duhet të vendosin tek veshët e tyre aparate të vegjël, ose proteza, në mënyrë që të dëgjojnë mirë dhe të komunikojnë me të tjerët. Të tjerë fëmijë mund të ecin vetëm me ndihmën e karriges me rrota, si i vetmi mjet për të siguruar lëvizjen e tyre ose me paterica për periudha të ndryshme kohore.</p> <p>Në kopsht mund të ketë fëmijë që kanë këto vështirësi, prandaj i gjithë grupi duhet nxitur për të folur e diskutuar rreth këtyre rasteve si raste të zakonshme.</p>	Foto fëmijësh të ndryshëm, me syza, me karrocë apo patericë, aparate dëgjimi etj

## DJALI ME TOP




Vendos emrin e shokut që po luan me top. Më pas ngjyrose.


## SHIU



Vendos emrin e vajzës me çadër në shi. Ngjyros vajzën dhe çadrën.

## SHOKËT





Në katrorët anash vendos shkronjën e parë të emrave të dy shokëve të grupit. A e di kuptimin e emrave të tyre? Ngjyros figurat e dy shokëve sipas ngjashmërisë që kanë.



Ngjyros fëmijën me syze.



## 2. FAMILJA IME

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Hyrje</b></p>	<p><b>"Unë dhe familja ime"</b></p> <p>Një ditë më parë udhëzoni fëmijët të fokusohen në bisedat me prindërit rreth familjes së tyre. Më pas porositini ata që çdo fëmijë të sjellë në kopsht një foto të familjes së tij. Ngjitini fotografitë në një tabak kartoni të madh. Nxitini fëmijët që të flasin për familjen e tyre dhe të shkruajnë ose vizatojnë rreth saj sipas fantazisë së tyre.</p> <p>Tregojuni atyre se disa fëmijë për arsye të ndryshme, mund të mos jetojnë në familjet e tyre biologjike, mund të rriten nga familjet birësuese, ose të jenë në shtëpitë e fëmijëve. Mësuesja tregon konceptin familje, si një bashkësi individësh që jetojnë së bashku dhe kanë interesa të përbashkëta.</p> <p>Organizoni një vizitë në shtëpinë e fëmijës apo të foshnjave. Nëse në rrethin/qytetin ka një tillë, shpjegojuni fëmijëve konceptin e familjes në dimensione të tjera (familja për fëmijët e shtëpisë së fëmijëve)</p>	<p>Foto familjare, albume, revista dhe libra që flasin për familjet etj</p>
<p><b>Sociale</b></p> <p><b>Konceptet</b></p> <p>Respekti për veten dhe të tjerët</p> <p>Respekti për familjen dhe prindërit</p> <p>Te ngjashëm dhe të ndryshëm</p>	<p><b>Po të isha...</b></p> <p>Po të isha një flutur, Unë do t' ju falënderoja për krahët e bukur ngjyra- ngjyra.</p> <p>Po të isha një zog, Unë do t' ju falënderoja për zërin e bukur me të cilin mund të cicëroja.</p> <p>Po të isha një peshk, Unë do t' ju falënderoja që mund të notoja me gëzim në det,</p>	<p>Albume, foto, libra dhe revista me temë familjen</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Por unë falënderoj <b>prindërit</b> e mi që më bënë mua. Ata më dhanë mua shumë buzëqeshje dhe një zemër, Ata më dhanë liri dhe bashkë me të një emër dhe unë, vetëm falënderoj prindërit e mi, që më bënë mua!</p> <p><b>Familja ime është si mua</b> Stamponi një formë fëmije mbi një copë letër. Prisni formën me gërshërë dhe stampojeni te çdo letër që fëmijët kanë në tryezë, më pas secili prej tyre do të vizatojë anëtarët e tjerë të familjes.</p> <p><b>Krahasimi me familjarët</b> Kërkojuni prindërve të sjellin foto të tyre të fëmijërisë së hershme, si dhe të fëmijëve të tyre. Pastaj lërin fëmijët të përpiqen që të gjejnë të ngjashmen me foton e tyre (shkruani emrat nga pas në mënyrë që fotot e fëmijëve të mos ngatërrohen).</p> <p><b>Pema familjare e grupit</b> Fëmijët sjellin fotografitë e familjes së tyre në klasë. Lërin fëmijët të vizatojnë një pemë në posterin e klasës. Më pas fëmijët ngjisin nga një fotografi në pemën e tyre. Tani ata kanë krijuar një pemë të madhe familjare të grupit të tyre.</p> <p><b>Llojet e ndryshme të familjes</b> Bisedoni me fëmijët mbi llojet e ndryshme të familjeve (me një prind, të dy prindërit, të dy prindërit dhe gjyshërit, vetëm me gjyshërit) Po ashtu bashkëngjituani të rriturve motrat dhe vëllezërit, fëmijë të tjerë që jetojnë me ta etj. Lejojini fëmijët të flasin një kohë të mjaftueshme rreth shumëllojshmërisë së familjeve sot dhe në të shkuarën ku jetonin së bashku më shumë se një familje. Bëni pyetje që nxisin tek ata respektin për të gjitha llojet e familjeve, duke mos paragjykuar asnjërin prej tyre</p> <p><b>Bisedë e udhëhequr</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregojini fëmijëve se llojet e familjeve janë të ndryshme, p.sh. ka fëmijë që jetojnë vetëm me njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër nuk jeton më, të tjerë fëmijë mund të jenë birësuar nga familje birësuese, disa fëmijë mund të jetojnë</li> </ul>	<p>Letër, Gërshërë, Ngjyra, Shënues, Bojë etj.</p> <p>Stampa, Ngjitës, Shkronja, Foto etj</p> <p>Foto familjesh të ndryshme nga sasia e anëtarëve, raca etj</p>



Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>vetëm me gjyshërit pasi prindërit e tyre mund të jenë emigrantë në një shtet tjetër, mund të mos jetojnë më ose të jenë të ndarë/divorcuar. Ka të tjerë fëmijë që jetojnë vetëm me njërin nga prindërit sepse prindërit janë të ndarë/divorcuar; por, pavarësisht kësaj mënyre jetese, mësuesja tregon se cilido qoftë numri i anëtarëve, lloji i familjes, përmbajta e saj, të gjithë fëmijët duhet të respektojnë familjen e tyre dhe t'i përmbahen rregullave që ajo ka.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkojuni atyre që të diskutojnë me prindërit për familjet e tyre të origjinës për të kuptuar dhe shpjeguar ndryshimet që ka pësuar familja ndër vite, nga familje të mëdha me shumë anëtarë në familje me më pak anëtarë, duke ua konkretizuar këto ndryshime edhe përmes fotove dhe tregimeve gojore.</li> </ul>	
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p>Shprehite e të folurit</p> <p><b>Aftësitë</b> Komunikimi në fjali të thjeshta,</p> <p>Përshkrimi i anëtarëve të familjes</p>	<p><b>Çfarë më pëlqen në familjen time?</b> Çdo fëmijë sjell një foto të familjes së tyre në kopsht. Ngjiteni në një letër vizatimi më pas kërkojuni fëmijëve të tregojnë atë çka u pëlqen më shumë në familjen e tyre.</p> <p><b>Familja ime</b> (vjershë) Familja ime jeni të gjithë ju, ju shokët e mi që fort ju dua, ju mësueset që më mësoni, ju kujdestare që më edukoni dhe shumë më doni.</p> <p><b>Dita e familjes</b> Një familje është burimi i dashurisë dhe i sigurisë për një fëmijë. Fëmijët kanë dëshirë të flasin për familjet e tyre, të tregojnë histori familjare dhe të jenë pjesë e një familjeje.</p> <p><b>Bisedoni me fëmijët që të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dinë se njerëzit të cilët jetojnë me ta përbëjnë atë që është ose quhet familja;</li> <li>• mësojnë të gjitha llojet e familjeve që ekzistojnë në shoqërinë tonë;</li> <li>• identifikojnë njerëzit me të cilët jetojnë në familjet e tyre</li> </ul> <p>Planifikoni me klasën tuaj një ditë tematike, "<b>Dita e familjes</b>".</p>	<p>Lapsa, shënues, letër, ngjyra.</p> <p>Postera, Fletëpalosje për ditën e familjes, Foto të vjetra të gjyshërve etj.</p>


Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Filloni duke biseduar për anëtarët e familjes me secilin fëmijë. Fëmijët do dëshirojnë të tregojnë vizatimet e bëra rreth familjes së tyre për t'i shfaqur në "Ditën e familjes".</p> <p>Kërkojuni fëmijëve që të përgatisin një ftesë për anëtarët e familjes së tyre, ku u kërkohet të gjithë prindërve/kujdestarëve të vijnë në kopsht në një ditë të veçantë familjare, siç është "Dita e familjes". Mësuesja bashkë me drejtuesen kanë përcaktuar ditën, dhe prindërit janë njoftuar në kohë për të marrë masat për prezencën e tyre.</p> <p>Disa sugjerime për piknikun përfshijnë mëngjesin, drekën, lojërat që do realizohen etj.</p> <p>Në ditën e festës, fëmijët mund të ndihmojnë për të bërë zbukurime të ndryshme si dhe për vendosjen e ushqimeve nëpër tryeza bashkë me mësuesin.</p> <p>Kur mbërrin anëtarët e familjes inkurajoni fëmijët që t'ua prezantojnë të tjerëve anëtarët e familjes që janë të pranishëm në festë.</p> <p><b>Te gjyshërit për çaj</b> Ndihmojini fëmijët për të bërë një ftesë çaji për gjyshërit e tyre.</p> <p>Siguroni artikuj të ndryshëm që shërbejnë për komplet çaji. Zbukuroni mjedisin me dantella, tabaka, biskota, çajnik etj., çdo gjë që ju mund të mendoni për ta bërë pasditen të veçantë. Një veprimtari e tillë mund të zhvillohet në kopsht ose në një nga shtëpitë e fëmijëve</p>	<p>Zbukurime prej letre, Materiale për përgatitjen e një dreke: pjata, gota prej letre, pirunë, thika dhe lugë lodër etj.</p> <p>Përgatitja e një tryeze për çaj: gota çaji, pjata, kek, çajnik etj</p>
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Lojëra lëvizore, aktivitete të ndryshme</p>	<p>Gjatë piknikut "Dita e familjes" jepini çdo fëmijë mundësi, që ata luajnë me familjen e tyre duke u treguar të tjerëve të veçantën e familjes së tyre. Ndërkohë fëmijët e tjerë do të gjejnë se çfarë loje janë duke zhvilluar.</p> <p><b>Këndi i shtëpisë</b> Në një qoshe të klasës krijoni një kënd për fëmijët për të luajtur shtëpish. Ju mund të shtoni objekte në këndin e shtëpisë herë pas here.</p> <p>Sigurohuni që të gjitha shishet dhe kutitë janë bosh dhe të pastra duke u krijuar fëmijëve një mjedis familjar të ngjashëm me atë që janë mësuar të shohin për ditë në shtëpinë e tyre si: shishe plastike, shishe e larësit të enëve, shishe sapuni, kuti drithërash, kuti të ushqimeve të ndryshme, jastëk me përmasa të</p>	<p>Postera, albume me aktivitete familjesh në kohën e lirë,</p> <p>Mjedise shtëpie të organizuara në një kënd të kopshtit të pajisura me materiale të ndryshme</p> <p>shishe plastike, shishe e larësit të enëve, shishe sapuni, kuti drithërash hapëse plastike, dorashka furre,</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>ndryshme, hapëse plastike, dorashka furre, peshqirë dore, lloje pëlhurash për të larë, shishe shampoje, sapun për bebe, shishe llaku, shalle, këpucë, lugë këpucësh etj.</p> <p><b>Familja në birra</b> Gjeni dhjetë shishe 2 litërshe. Mbushni më pak se gjysmën e shisheve me ujë dhe mbyllini me kapak mirë e mirë. Më pas zbukuroni shishet si njerëz, duke i shtuar fije të ndryshme për flokët, vizatoni sytë, hundën dhe buzët. Vendosini shishet lart në këmbë sikur të ishin birra dhe fëmijët do të hedhin topin mbi to.</p>	<p>peshqirë dore, lloje pëlhurash për të larë, shishe shampoje, sapun për bebe, shishe llaku, shalle, këpucë, lugë këpucësh etj.</p> <p>Birra, Lapsa me ngjyrë Fije akriliku Top etj</p>
<p><b>Matematikë</b></p> <p><b>Konceptet</b> I ngjashëm, I ndryshëm E madhe, e vogël Aq sa, Numra 1-5</p>	<p><b>Familje e "vogël"</b> Prisni forma njerëzish të madhësive të ndryshme. Fëmijët do të përzgjedhin forma njerëzish për familjarët e tyre dhe më pas do i ngjyrosin dhe do t'i ngjisin në një fletë. Bashkë me fëmijët e tjerë do të krahasojnë familjarët, motrat, vëllezërit, gjyshërit dhe do të shikojnë se cili ka ngjitur më shumë forma në fletën e tij e kush më pak dhe sa kanë ngjitur gjithsej secili.</p>	<p>Letër Markera Shënues Bojëra Ngjites etj.</p>
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Konceptet</b> Kolazh ngjyrosje</p>	<p><b>Portreti familjar</b> Fillimisht ngjisni letrën sipër një pjate plastike dhe priteni letrën sipas formës së pjatës në mënyrë që fëmijët ta kenë më të lehtë për të vizatuar dhe ngjyrosur. Fëmijët krijojnë një vizatim me ngjyra të familjes së tyre brenda pjatës. Pasi kanë përfunduar së vizatuar, bëhet një vrimë në anë të pjatës dhe shkohet një fije nëpër të. Tani ju mund të varni portretet e familjes në mur dhe të gjithë fëmijët do të jenë të gëzuar për familjen e tyre dhe njohjen që u kanë bërë shokëve me të..</p> <p><b>Pema e familjes</b> Fëmijët kanë sjellë fotografite e familjes së tyre në klasë. I lini fëmijët të pavarur për të vizatuar një pemë në një fletë vizatimi. Më pas fëmijët ngjisin fotot e familjarëve në pemën e tyre. Tani ata kanë një pemë familjare të këndshme dhe gëzojnë së bashku për punën e kryer.</p>	<p>Letër, pjata plastike, fije, lapsa me ngjyra, bojëra uji etj.</p> <p>Fletë vizatimi, lapsa me ngjyra, markera, pastel Bojëra uji, foto familjare</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p><b>Kolazh me fotot e familjarëve</b> Njoftoni prindërit më përpara për këtë veprimtari duke iu shpjeguar se fotot e tyre nuk do kthehen mbrapsht, por do shërbejnë si mjete pune për të realizuar një punim artistik. Pasi fëmijët kanë sjellë pamje, foto të secilit prej anëtarëve të familjes së tyre i presin fotot në pjesë-pjesë. Pastaj ata, sipas fantazisë së tyre, bëjnë një kolazh duke ngjitur fotot në copa letre, ngjyrosin dhe shtojnë vizatime të ndryshme në to.</p> <p><b>Foto murale e klasës</b> Fëmijët kanë sjellë në klasë fotografitë e familjeve të tyre. Pasi të diskutoni me fëmijët për familjarët e tyre vendosni të gjitha fotot në një afresk dhe kjo sjell në kopsht një veprimtari të këndshme, pasi fëmijët marrin pjesë me shumë gëzim në një ngjarje të tillë dhe kënaqen njëkohësisht.</p>	Letër, markera, shënues, ngjitës, karton
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Konceptet</b> Kolazh ngjyrosje</p>	<p><b>Ndarja e roleve dhe punëve në familje</b> Shpërndajini fëmijëve fleta pune, mbi të cilat janë vizatuar disa mjete apo orendi shtëpiake, si p.sh. hekur hekurosje, fshesë, makinë larëse. enët e kuzhinës, gjilpëra, top, kukull, TV, libra, gazeta etj. si këto. Më pas u kërkojmë atyre të tregojnë se cilat nga këto përdoren prej tyre, nga mami, babi, gjyshi, gjyshja, motra, vëllai. Kërkojini atyre të vizatojnë pranë secilës figurë portretin e pjesëtarit të familjes që i përdor. Në përfundim fëmijët krahasojnë fletët me njëri - tjetrin dhe identifikojnë ato figura të përbashkëta që përdoren nga pjesëtarë të ndryshëm të familjes për çdo njërin prej fëmijëve.</p> <p><b>Koleksion me foto</b> Fëmijëve mund t'u kërkohej të sjellin edhe foto të tyre dhe të familjarëve që janë duke përdorur mjete apo objekte shtëpiake të llojeve të ndryshme, apo duke luajtur me lodra të ndryshme. Këto foto ata i ngjisin në tabakë kartoni dhe diskutojnë rreth përdorimit të tyre nga burrat dhe nga gratë apo nga djemtë dhe nga vajzat</p> <p><b>Bisedë e udhëhequr</b> <b>Rolet gjinore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një nga detyrat kryesore të parashkollorëve</li> </ul>	<p>Letër, lapsa me ngjyra, bojëra uji etj.</p> <p>Fletë vizatimi, lapsa me ngjyra, markera, pastel Bojëra uji,</p> <p>Foto, ngjtëse, karton</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>është të mësojnë kush dhe çfarë janë. Zakonisht djemtë mësojnë se ata janë meshkuj dhe se meshkujt kanë pasur tradicionalisht karakteristika të tilla si të qenit të ashpër, të mos qajnë, të marrin vesh nga objektet mekanike dhe të pëlqejnë futbollin. Vajzat mësojnë se ato janë femra dhe se pritet që të jenë të sjellshme, të luajnë me kukulla, të pëlqejnë të qepin rroba.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregojini fëmijëve se këto janë rolet gjinore, apo standardet kulturore për sjelljen që përcaktohen nga familja dhe të tjerët, si të përshtatshme për secilën gjini. Përveç familjes, edhe moshatarët luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përfundimin e këtyre roleve gjinore.</li> <li>• Mos harroni se: Parashkollorët kritikojnë, qortojnë, madje nuk luajnë me moshatarët që shfaqin sjellje të ndryshme për sa i përket gjinisë së tyre. Ata janë kritikues, sidomos për djemtë që sillen si vajza.</li> <li>• Ditët e sotme, mendohet se njerëzit gjithnjë e më shumë po shfaqin karakteristika të dy gjinive.</li> </ul> <p><b>Koleksion lodrash dhe veshjesh</b> Kërkojuni fëmijëve të vizatojnë disa prej lodrave dhe veshjeve që ata kanë marrë dhuratë që kur kanë lindur. Më pas ju kërkon vajzave dhe djemve të shkëmbejnë fletë me vizatimet përkatëse dhe diskuton me ta se përse disa lodra dhe veshje sipas tyre quhen lodra apo veshje vetëm për vajza dhe disa të tjera vetëm për djem.</p> <p>Diskutoni me ta se rolet gjinore për djemtë dhe vajzat kanë ndryshuar dhe kërkojini që këtë çështje ta diskutojnë dhe me prindërit në familje, duke ju kërkuar atyre t'ju tregojnë për fëmijërinë dhe rininë e tyre, si dhe për karakteristikat e roleve gjinore të tyre.</p> <p>P.sh. fëmijët mund të tregojnë për vëllezërit dhe baballarët e tyre, të cilët kanë në gardërobat e tyre këmisha apo bluza edhe ngjyrë rozë, vjollcë etj. ngjyra të cilat vite më parë ishin të papërshtatshme për t'u përdorur nga djemtë.</p> <p><b>Harta e profesioneve</b> Mësuesja u shpërndan fëmijëve disa fletë pune, në të cilat janë vizatuar njerëz që ushtrojnë profesione të ndryshme, tipike ose jo tipike për burrat dhe gratë.</p>	<p>Foto që tregojnë përfshirjen gjinore në veprimtari të ndryshme jo tradicionale</p> <p>Lodra të ndryshme</p> <p>Lodra dhe veshje të dy gjinive,</p> <p>Fletë pune për profesionet e ndryshme</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Tregojini atyre se disa profesione që dikur kanë qenë të dominuara vetëm nga burrat dhe tani janë të kërkuara edhe nga gratë, duke i lidhur dhe shpjeguar këto me rolet gjinore.</p> <p>P.sh. dikur kishte vetëm shoferë burra, tani makinën e ngasin edhe gratë. Fëmijëve u kërkohet që kur të dalin nga kopshti, gjatë rrugës për në shtëpi, së bashku me prindërit të numërojnë makinat që drejtohen nga shofere gra</p> <p>Diskutoni me fëmijët se që sapo ata lindin, janë prindërit që vendosin t'i veshin me ngjyra të ndryshme vajzat dhe djemtë (vajzat me rozë dhe djemtë me bojë qielli). Më pas po familja i orienton drejt lodrave të ndryshme tipike për vajzat dhe djemtë (djemve u dhurohen makina, pistoleta dhe vajzave kukulla), duke u "diktuar" rolet sociale të gruas/burrit. Më pas fëmijëve u kërkohet po nga familja të sillen ndryshe (djemtë mund të rrinë të shkujdesur, ndërsa vajzat duhet të jenë të vetëkontrolluara deri në stres) dhe në fund djemtë dhe vajzat kuptojnë se janë të ndryshëm, duhet të sillen ndryshe dhe gjithashtu, duhet të zgjedhin profesione që i përshtaten gjinisë së tyre. Këto janë sjellje dhe qëndrime të mësuara që në moshë të vogël dhe që përforcohen vazhdimisht nga shoqëria</p> <p>Lërin fëmijët që sot në kopsht të tregojnë konkretisht përmes lojës dhe veprimtarive ditore se rolet gjinore kanë ndryshuar, p.sh. vajzat të luajnë me top dhe djemtë me kukulla, ose djemtë të ndihmojnë në shtrimin e tavolinave të bukës.</p> <p><b>Mësojini të mos jenë ambiciozë për njëri - tjetrin</b></p> <p>Fëmijët mësojnë të jetojnë në shoqëri duke u përshtatur me rregullat dhe vlerat e kësaj të fundit. Në shoqërinë e kohëve tona, fëmijët duhet të mësojnë të kenë besim tek vetja, të kërkojnë më të mirën nga vetja pa u krahasuar me të tjerët, të mos jenë agresivë, të pandershëm apo dëmtues ndaj të tjerëve</p>	



Çfarë po bën fëmija në figurë?



Kush nga prindërit ju ndihmon për të krehur flokët kur vini në kopsht?  
Përshtuaj një mëngjes në shtëpi.



Bisedoni me shokët tuaj si ju ndihmon babai në shtëpi.



### 3. TRUPI YNË



Fushat	Udhëzime	Materialet
<b>Hyrje</b>	Bashkëbisedoni mbi temën e trupit. Tregoni figurën e skeletit të njeriut dhe pse jo edhe të kafshëve si p.sh. të dinozaurëve etj. Çojini fëmijët në zonën e shkencës për të parë llojet e ndryshme të skeleteve.. Kjo i lejon fëmijët, për të parë dhe për të prekur eshtra të ndryshme të trupit. Ju gjithashtu mund të vendosni përreth postera ose fotografi të organeve të trupit që fëmijët të shohin dhe diskutojnë rreth organeve të trupit.	Skelet prej plastike Postera Libra me figurat e trupit
<b>Sociale</b>  <b>Konceptet</b> Të ngjashëm dhe të ndryshëm	<b>Loja me dallime</b> E gjithë klasa është ngritur në këmbë në formë rrethi. Zgjidhni një fëmijë dhe emërtoni cilësinë karakteristike të tij (flokët ngjyrë kafe). Më pas të gjithë fëmijët me flokë kafe të qëndrojnë në këmbë, ndërsa të tjerët ulen poshtë. Më pas loja vazhdon me një cilësi tjetër si p.sh. ngjyra e syve apo e veshjes, duke pasur kujdes që të gjithë fëmijët të jenë të angazhuar në lojë.	Foto Libra me figurën e trupit Libra me aventura etj
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>  <b>Aftësitë</b> Të mësuarit për të përshkruar trupin me karakteristikat e tij	Tema e trupit jep mjaft mundësi për mësueset të diskutojnë dhe t'u kërkojnë fëmijëve të shprehën përmes fjalive të thjeshta dhe të ndërtuara drejt. Fëmijët p.sh. mund të pohojnë: Unë kam një trup të fortë ; Sytë e mi shohin larg; Këmbët e mia ecin shpejt etj  Mësuesja mund të drejtojë pyetje që kërkojnë përgjigje përshkruese, p.sh: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për çfarë na shërbejnë mushkëritë?</li> <li>• Po zemra?</li> <li>• Çfarë bëjmë me duart tona?</li> <li>• Po me këmbët?</li> </ul> Një strategji tjetër mund të jetë shpërndarja e kartave me figura të trupit dhe të organeve të tij të gjithë fëmijëve dhe kërkesa për të përshkruar figurën dhe funksionet e saj  Mësuesja mund të përdorë edhe vjersha humoristike në lidhje me kujdesin që duhet treguar ndaj pastërtisë dhe higjienës.	Kartolina me figura fëmijësh Karta Libra Revista Album me foto         Vjersha dhe tregime rreth temës

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p><b>A e dini ç'ngjau?</b></p> <p>Mira lau duart, Bukur, me kujdes Mami bëhet gati Thonjtë që t'i presë Po e dini ç'ngjau? Mira qau, qau.....</p> <p>- Ç'ke moj xhan i mamit, Përse qan e ç'thua? - Preja thonjtë maces, pastaj premi mua Se ajo i ka Shumë të mëdha!</p> <p>Ne të gjithë qeshëm Edhe macja vetë Mira nga inati Gati sa s"pëlçet.</p> <p>Pastaj unë i thashë - Macja është kafshë dhe thonjtë i ruan Se me thonjtë gjuan.</p> <p>Miun faqeziun Në shtëpi kur vjen Macja nuk ka pushkë Me thonj e mbërthen</p> <p>Mira e kuptoi Prandaj më nuk qau, Macja se ç'i thoshte Mjau, mjau, mjau!....</p> <p>Së fundmi, mësuesja mund të pyesë fëmijët duke shfrytëzuar fotot e tyre nga fëmijëria e hershme për rritjen e tyre, ndryshimet që kanë pësuar, aftësitë e reja që kanë fituar etj. duke bërë kështu një bashkëbisedim të lirë dhe interesant për fëmijët që kanë shumë kënaqësi të venë në dukje se janë rritur.</p>	<p>Foto të fëmijëve në moshë të ndryshme,</p>
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p>	<p><b>Si mbahet pastër trupi</b> Propozojmë të sillni dy kukulla në tryezën e</p>	<p>Kukulla plastike Enë me ujë</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Aftësitë</b> Të mësuarit për t'u fokusuar në pastërtinë dhe higjienën vetjake dhe llojshmërinë e sëmundjeve që vijnë nga duart e papastra</p>	<p>e punës suaj. Po ashtu edhe një enë me ujë, sapun, sfungjer dhe peshqir. Më pas kërkojuni fëmijëve të demonstrojnë se si mund të lahen kukullat. Ata do të përcjellin gjatë demonstrimit modelin e pastrimit dhe të larjes së tyre. Më pas mund të bashkëbisedoni rreth kujdesit që duhet treguar për pastërtinë dhe higjienën vetjake.</p> <p><b>Si lahen dhëmbët</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tregojuni fëmijëve të grupit tuaj se si duhet të lahen dhëmbët e tyre. Merrni një pako me furçë dhe pastë dhëmbësh dhe mundësisht thërrisni atë ditë edhe dentistin e shkollës. Kërkojuni fëmijëve të fërkojnë dhëmbët me furçë dhe njëkohësisht të shohin në pasqyrë veprimin që kryejnë. Përsëriteni këtë veprimtari gjatë gjithë javës.</li> <li>Po ashtu, gjëzat shërbejnë për të nxitur problem zgjidhjen te fëmijët. P.sh</li> </ul> <p>Kush më blen E më përdor la zbardh dhëmbët Si dëborë Pisanjosët s'i kam xhan A e dini cila jam? (furça e dhëmbëve)</p>	<p>Sapun Peshqir Sfungjer</p> <p>Pastë dhe furçë dhëmbësh</p> <p>Figura ose karta me furçë dhëmbësh</p>
<p><b>Matematikë</b></p> <p><b>Konceptet</b> Numri 1-10 Forma e katrorit</p>	<p><b>Dhjetë Gishta</b> Dhjetë gishta unë kam Të gjithë, të mitë janë Me to numëroj dhe punoj Kukullën time të hajë e ndihmoj (Numërim me gishta 1-10)</p> <p><b>Zbavitje me pjesët e trupit</b> Vendosni katrorë në dysheme për çdo fëmijë. Ata shtrihen gjatë gjithë dhomës në shesh. Loja fillon me çdo fëmijë që qëndron në një katror. Fillon muzika dhe fëmijët lëvizin nëpër dhomë duke bërë lëvizje të tilla si: zvarritje, një këmbë prapa, kërcim etj. Kur muzika ndalon, fëmijët duhet të kthehen në katrorin e tyre dhe të prekin me dorë një pjesë të trupit; pikërisht atë që thoni ju, si: gjurin, bërrylin, këmbën etj.</p>	<p>Katrorë plastikë të mëdhenj Magnetofon Tabelë me gjurmë gishtash Karta me numra deri në 10</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Konceptet</b> Hija Ngjyrat e bardhë dhe e zezë Kolazhi</p>	<p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b></p> <p><b>Silueta</b> Përdorni një dritë të dukshme, një projektues ose diellin dhe merrni një copë letër, karton dhe vizatoni hijen e fëmijëve në letër. Prisni hijen mbi një bazën e një letre të zezë dhe ngjiteni mbi një letër të madhe me ngjyra. Dhe më pas lëroni fëmijët të zbkurojnë kornizën me ngjyrë të bardhë duke bërë dekorime të ndryshme.</p> <p><b>Portreti në pjatë</b> Pasi fëmijët shohin fytyrën e tyre në pasqyrë krijojnë portretin e tyre në pjatat prej letre duke përdorur mjete të ndryshme arti.</p> <p><b>Krahët e pemës së mollës</b> Së pari ngjyrosni duart e fëmijëve me ngjyrë kafe dhe sugjerojini atyre të stampojnë në letër duart e tyre për të bërë një trung peme. Më pas jepini fëmijëve ngjyrën e kuqe, të verdhë, dhe të gjelbër, si dhe pajisje të tjera sipas dëshirës së tyre. Lëroni fëmijët të krijojnë secili pemën e vet të mollës duke bërë plotësime në bazë të fantazisë së tyre.</p> <p><b>Dhëmbët gjigantë</b> Vizatoni dhëmbë të mëdha bashkë me fëmijët për t'i ndihmuar ata të njohin dhe mësojnë se si lahen dhëmbët. Është shumë e thjeshtë. Prisni fundin e shishes 2 litroshe të koka kolës dhe lyejini me bojë të bardhë dhe vizatoni mbi to dhëmbë duke treguar konkretisht se si lahen dhëmbët dhe kujdesin që duhet të tregojnë ndaj tyre çdo ditë.</p> <p><b>Forma ime, kolazh</b> Prisni format e gjurmëve të fëmijëve nga gazetatat. Lëroni ata të zgjedhin nëpër revista dhe i prisni me gërshtë gjërat që u pëlqejnë atyre. Më pas ata i ngjisin i bashkojnë duke krijuar kolazhin e tyre individual. Bashkoni kolazhet e fëmijëve në një flipchart për të krijuar kolazhin e përbashkët.</p>	<p>Letër Abazhur Zamkë Mjete të ndryshme sipas zgjedhjes suaj</p> <p>Markera, pastel Bojë për ngjyrosje Fije Pjata plastike</p> <p>Mjete të ndryshme arti për kolazh Bojë Mjete të ndryshme sipas zgjedhjes suaj.</p> <p>Shishe plastike Bojë e bardhë Ngjitës Lapsa Letër flip chart Revista</p>
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p>	<p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b></p> <p><b>Pjesët e trupit</b> Gjeni një kub të madh (kuti) dhe ngjisni fotografi me pjesët të ndryshme të trupit mbi të. Më pas lëroni</p>	<p>Skelet trupi, libra dhe revista për trupin, karta me figura etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Aftësitë</b> vëzhgimi klasifikimi vlerësimi</p>	<p>fëmijët të rrotullojnë kubin dhe të diskutojnë për pjesët e trupit, duke eksploruar njëkohësisht edhe trupat e tyre.</p> <p><b>Ku është shqisa juaj</b> Në një copë letër të madhe vendosni një fytyrë fëmijë, më pas ata vizatojnë mbi të, shkruajnë, ngjisin figura në vende të ndryshme ku janë shqisat e tyre, duke i simbolizuar sipas dëshirës, p.sh. pranë veshit vendosin një violinë, tek hunda miell etj.</p> <p><b>Zemra</b> Tregojuni fëmijëve se si punon zemra, pompimin, duke vënë ujë me ngjyrë të kuqe në një tullumbace transparente. Vendosni një kallam në tullumbace. Kur ju e shtrydhni atë, uji i kuq del nga tullumbacja në mënyrë të ngjashme me atë se si punon zemra në trupin tonë.</p> <p><b>Pjesët e trupit</b> Çdo ditë vëzhgoni bashkë me fëmijët pjesë të ndryshme të trupit të tyre konkretisht. Një mënyrë interesante për ta realizuar eksplorimin është koka dhe duke vazhduar më poshtë me pjesë të tjera të trupit. Për të theksuar më mirë pjesët e trupit përdorni thënie të bukura, interesante për shembull sytë ndriçojnë, hunda jonë bën pip, veshët tanë dëgjojnë, gjuha lëviz ose rrotullohet etj. Flisni me ta për shqisat e ndryshme që ka trupi i njeriut.</p>	<p>Miell, violinë lodër etj</p> <p>tullumbace transparente, ujë me ngjyrë të kuqe, kallam etj</p>
<p><b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b></p>	<p>Tregojini atyre se tek disa fëmijë, një apo disa organe mund të mos funksionojnë siç duhet, p.sh. mund të ketë fëmijë që kanë probleme me zemrën, veshkat, duart, këmbët, sytë, veshët etj., dhe për këtë arsye ata mund të mos përfshihen në mënyrë aktive në jetën e përditshme dhe kanë nevojë për përkujdesje të vazhdueshme dhe mbështetje nga të tjerët.</p> <p>Ftoni një mjek në kopshtin tuaj dhe kërkoji t'ju tregojë se përse disa shqisa, organe apo pjesë të trupit të njeriut mund të mos funksionojnë në mënyrë të përshtatshme dhe se si duhet të kujdesemi që të mbrojmë organet, trupin tonë nga dëmtimet dhe rreziqet e ndryshme</p>	<p>Postera për shëndetin, video që flet për sigurinë dhe mbrojtjen nga rreziqet etj</p>



Emërtoni pjesët e ndryshme të trupit.



Bisedoni me mësuesen dhe shokët tuaj çfarë bëjnë fëmijët në figurë për t'u kujdesur për trupin e tyre.





Aktiviteti fizik na ndihmon të rritemi të shëndetshëm.  
Bisedoni së bashku për llojet e sporteve që njihni.





## 4. PESË SHQISAT

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Hyrje</b></p>	<p><b>Mësimi përmes lojës</b>            Bëni që fëmijët të mësojnë nëpërmjet lojës, kështu që jepini atyre shumë kohë të lirë për të luajtur dhe për t'u argëtuar.            Mos jepni vazhdimisht direktiva apo instruksione lidhur me mënyrën e “duhur” për ta bërë diçka, sepse kreativiteti i fëmijës mund të frenohet            Mos harroni se: Një fëmijë, të cilit i jepen vazhdimisht instruksione dhe që mbahet vazhdimisht i okupuar mund të shfaqë më pak iniciativë dhe risi dhe në vend që të shijojë lirinë për të eksploruar dhe zbuluar, ai do të shohë ata që kanë autoritet mbi të (si prindërit apo edukatorët) lidhur me atë se çfarë duhet të bëjë dhe si. Ai mund të fillojë të ketë frikë mos bën gjë “gabim” në vend që të investigojë opsione të tjera të mundshme dhe të eksplorojë në mënyrë kreative.            Fëmijët kanë nevojë për liri për të eksploruar natyrën rreth tyre, për të eksperimentuar sipas mënyrës së tyre dhe për të qenë krijues dhe imagjinues në lojën e tyre gjatë fëmijërisë së hershme dhe përtej saj.            Sugjerohet që projekti të fillojë me këngën e pesë shqisave për të ndërhyrë te të mësuarit e fëmijëve në lidhje me shqisat dhe pjesët përkatëse të trupit.</p> <p><b>Pesë shqisat</b>            Ne kemi pesë shqisa            Njëra shikon, tjetra dëgjon,            Njëra nuhat, tjetra provon            Pesë shqisa, pesë shqisa            Ne shohim, prekim dhe dëgjojmë            Nuhasim dhe provojmë,            Pesë shqisat botën na tregojnë</p>	<p><b>Kënga e pesë shqisave</b>            albume me foto,</p>  <p>pamje të shkëputura të shqisave etj</p>


Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Këndohet kënga duke treguar pjesët e trupit. Fëmijët e pëlqejnë këngën dhe tregojnë me kënaqësi 5 shqisat e tyre bashkë me pjesët e trupit që korrespondojnë me shqisat përkatëse.</p>	
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Aftësitë :</b> Ndjeshmëri për materialet e ndryshme të punës, përbërjen, ngjyrat etj</p>	<p><b>I. SHQISA E TË PREKURIT</b> <b>Pikturë me gishta</b></p> <p>Sugjerohet piktura me gishta pasi inkurajon te fëmijët e vegjël përvojën shqisore për të shqyrtuar përzierje të ndryshme dhe nxit vëzhgimin si dhe përdorimin e fjalorit</p> <p>Vendosini fëmijët të ngjyrosin sipas dëshirës me materialet e sugjeruara.</p> <p>Pasi fëmijët kanë filluar të punojnë, nxitini t ë përshkruajnë me fjalë se çfarë përbërësish kanë shtuar në përzierjen e tyre dhe të thonë se çfarë shohin, çfarë ndiejnë kur i prekin dhe çfarë nuhasin.</p>	<p>Bojëra, temperë në një larmi ngjyrash, rërë, llum kafeje, erëza, artikuj natyrore, kripë e zezë, sodë buke, koll e lëngshme, kripë, miell misri, miell gruri etj.</p>
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p> <p><b>Aftësitë</b> përshkruese dhe ekspresive analizë dhe krahasim</p>	<p><b>Koleksion me sende të ndryshme</b></p> <p>Fëmijët parashkollorë në këtë plan mësimor do të përdorin kuptimin e prekurit. Ata gjithashtu do të vëzhgojnë, krahasojnë nëpërmjet eksperimenteve dhe zbatimit në praktikë duke rritur aftësitë përshkruese dhe ekspresive të tyre.</p> <p>Mësuesja me një grup të vogël e fëmijësh u prezanton atyre një koleksion me artikuj të ndryshëm në një tavolinë të ulët. Në koleksion përfshihen disa mostra të çdo lloji e cilësie në mënyrë që fëmijët të kenë objekte të mjaftueshme për të krahasuar. Së bashku, diskutojnë për këndvështrimet e ndryshme rreth gjërave që ndiejnë. Mësuesja thotë, “Sot ne do të prekim shumë gjëra të ndryshme. Çfarë ndiejnë duart dhe gishtat kur ju i prekni ato?”</p> <p>Nxitini fëmijët të prekin sa më shumë objekte dhe të tregojnë për atë çka dinë. Ndhimojini ata për të përdorur fjalorin e duhur, për shembull, “Shiko, kjo është me kokrriza (gunga) kur e prek. Mund të gjeni një tjetër që është me kokrriza (gunga)?”</p> <p>Gjithmonë duhet t’i lini kohë fëmijëve për eksplorimin e nevojshëm Pasi fëmijët fillojnë të prekin sendet, ata gjejnë sendet që kanë ngjashmëri në strukturë. Më pas ndihmojini ata për t’i grupuar, ndërsa i pyesni, “Pse ky send shkon në këtë grumbull? Sepse është i njëjtë me të tjerët?”, duke integruar kështu shkencën me matematikën.</p>	<p>Një sërë materialesh të ndryshme, të tilla si: topa pambuku, pëlthurë kadifeje, fletë metalike prej alumini, letër smeril, copë e ashpër, gjethe të thara, letër me përmasa të ndryshme, shkumësa, lapsa dylli, gërshtë, kapëse letrash dhe revista të vjetra.</p> 

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Pasi fëmijët kanë renditur sendet, ata mund të duan t'i përziejnë përsëri të gjitha ato bashkë dhe t'i rendisin përsëri nga e para. Ky proces është i këndshëm për fëmijët dhe sjell kënaqësi.</p> <p>Disa fëmijë kanë dëshirë të bëhen <b>“shkencëtarët e prekjes”</b> duke zgjedhur një objekt. Pasi e kanë prekur e mbajnë në dorë dhe lëvizin rreth klasës për të gjetur diçka që mendojnë se është e njëjtë me atë që kanë.</p> <p>Kur ata e gjejnë atë që kërkojnë, thërresin dhe fëmijët e tjerë për të provuar dhe ata të njëjtën gjë.</p> <p>Procesi i krahasimit me një send të vogël dhe gjetja e një diçkaje të ngjashme në mjedisin e tyre, i ndihmon fëmijët të praktikojnë më mirë <b>të menduarit krahasues</b>.</p>	
<p><b>Sociale</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Të ngjashëm dhe të ndryshëm</p>	<p><b>Nga kemi ardhur?</b> Ne të gjithë njëlloj jemi, flokë, sy dhe veshë kemi kemi këmbë dhe duar për të ecur dhe punuar veç sytë e mi janë të zinj, flokët e saj janë të verdhë lëkura e tij është e bardhë A e gjeni dot Prej cilit vend kemi ardhë?</p> <p><b>Bisedë e udhëhequr</b> Pyetini fëmijët se përse disa fëmijë kanë ngjyrë lëkure të ndryshme, flasin ndryshe, kanë ndryshime të dukshme fizike. A njohin ata fëmijë si këta ?, Ku dhe si i kanë njohur?.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutoni me ta nëse do t'u pëlqente të qëndronin pranë një lulishteje me lule njëngjyreshe dhe të një arome, apo pranë një lëndine me lule shumëngjyreshe e plot aroma të këndshme.</li> <li>• Tregojini fëmijëve duke ua konkretizuar se shumëllojshmëria dhe ndryshueshmëria përbëjnë bukurinë e jetës dhe filloni të tregoni se dhe njerëzit/fëmijët janë të ndryshëm.</li> <li>• Diskutoni me ta se fëmijët mund të kenë origjinë të ndryshme, disa kanë lindur në Shqipëri, të tjerë në vende të ndryshme të botës, jo të gjithë fëmijët mund ta kenë të njëjtë ngjyrën e lëkurës, të syve, gjuhën që flasin, peshën,</li> </ul>	<p>Foto dhe karta me figura trupi të njerëzve me raca dhe etni të ndryshme: të bardhë, aziatikë, afro amerikanë, afrikanë, eskimezë etj</p> <p>foto nga revista apo gazeta për njerëz/ fëmijë që duken të ndryshëm.</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>gjatësinë, pamjen fizike, flokët, tiparet.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkojuni atyre të mbledhin foto nga revista apo gazeta për njerëz/fëmijë që duken të ndryshëm. Fëmija prezanton foton dhe tregon çfarë ndryshimi ka personi në foto. Ngjitini këto foto dhe imazhe në tabakë të mëdhenj letre dhe tregojuni fëmijëve se pavarësisht ndryshimeve të gjithë quhen njerëz. Përcillni mesazhin se pavarësisht se ” të gjithë mund të jemi të ndryshëm, jemi të barabartë”, duke e ilustruar me të gjitha aspektet e jetës në kopsht, familje e shoqëri.</li> <li>• Diskutoni me ta rreth mënyrave të sjelljeve, qëndrimeve, komunikimit, vlerësimit, tolerancës, pranueshmërisë ndaj bashkëmoshatarëve që nuk flasin gjuhën e tyre, që nuk kanë të njëjtën origjinë, status familjar, pamje fizike, ngjyrë lëkure etj. si këto.</li> </ul>	
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p><b>Aftësitë:</b> Zhvillimin e aftësive për të projektuar dhe realizuar një koleksion shkencor të thjeshtë në formën e librit Të pasurojë fjalorin me termat e shqisave dhe funksionet e tyre</p>	<p><b>Bërja e koleksionit në formë libri:</b> Pasi elementët përbërës të një libri janë gati, ftojini fëmijët për të zgjedhur një grumbull (bashkësi) dhe të bëjnë një kolazh me to. Përdorni çdo kolazh të bërë nga fëmijët si një faqe libri. Kur libri është përfunduar vëzhgoni së bashku faqet me kujdes dhe kërkojuni atyre për t’ ju thënë me fjalë dhe shprehje atë që vërejnë në çdo faqe. Për shembull, ju mund të thoni: “Kjo faqe është plot me ashkla të ashpra. Ato janë të ashpra si...” Shkruaj përshkrimet në çdo faqe dhe plotësoni librin së bashku. Vendosni librin e ndjesive në një vend të dukshëm për fëmijët për të “lexuar” shqisën e të prekurit..</p> <p><b>Tabela “Shqisa e të prekurit”</b> Nëse ju keni disa pjesë të mbetura bëni një tabelë “shqisa e të prekurit” duke përdorur ngjitës dhe një shënues. Përdorni të njëjtat fjalë për skemën si faqet e librit që fëmijët përdorën për të përshkruar faqet e tyre. Në libër kanë nga një bashkësi për çdo cilësi ndërsa në skemë kanë një element për një cilësi. Për shembull, pranë pambukut vendoset fjala “i butë” etj. Në orën e tregimit mund të përdoren për të parë dhe lexuar libra rreth shqisës së të prekurit të tilla si, “Gjej duke prekur”, “Lepuri im është i butë”, “Këmbët” “Libri i këmbës” etj.</p>	<p>Libra, revista, figura shqisash, letër e bardhë, shirita me ngjyrë etj</p>


Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p> <p><b>Aftësitë:</b> Lëvizjet motorë, përdorimi i gishtave të këmbës dhe të dorës</p>	<p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b> <b>Aktivitetet arti me lëvizje “Pikturë me këmbë”</b> Fëmijët parashkollorë shpesh herë përfshihen në pikturim me gishta. Por, për këtë aktivitet ata do të përdorin aftësitë ndijore-lëvizore dhe problem-zgjidhjen për të mundësuar veten e tyre se si të pikturojnë me këmbë. Në këtë aktivitet mësuesja këshillohet të gjejë edhe një <b>ndihmës të rritur</b>. Mësuesja para se të zhvillojë këtë aktivitet në grup duhet t’i dërgojë shënim në shtëpi prindërve të fëmijëve. Shpjegoni se fëmijët e tyre do të marrin pjesë në një eksperiencë pikturë të veçantë dhe të <b>çrregullt</b> dhe u kërkoni atyre të dërgojnë fëmijët e tyre në kopsht në rroba të vjetra. Këshillohet gjithashtu si një ide e mirë që të ketë rroba pune në dispozicion të çdo fëmije. Përgatitja e zonës së pikturimit bëhet që më parë me kujdes, duke vendosur një fletë të gjatë murale në dysheme në mënyrë që asnjë të mos dalë nga zona e pikturimit dhe të gjithë të lëvizin lirshëm. Merrni kohë për t’u siguruar që letra është ngjitur poshtë. Kjo do të bëjë një dallim të madh kur veprimtaria është në zhvillim e sipër.</p>	<p>Gazeta, letra muri rule, bojë temperë bojë (2 ngjyra të kundërta), pastrues, të paktën 4 enë të mëdha, peshqir për pastrim, muzikë instrumentale për çlodhje</p>
<p>Zhvillimi i aftësive të lojës dhe kujdesit për veten</p>	<p>Vendosni një legen me ujë të ngrohtë dhe me sapun në fund të letrës murale. Në anën tjetër, vendosni sfungjerë të hollë të lagur dhe disa lloj pëlhurash. Përdorni bojë temperë, bojë mix si vend ku fëmijët do të fusin këmbët. Sfungjerët pastrues brenda përzierjes së bojës do të mbrojnë fëmijët nga rrëshqitjet në bojë dhe nga marrja e më shumë boje në këmbët e tyre! Mësuesit dhe fëmijët mblidhen së bashku dhe flasin për llojet e ndryshme të mjeteve që përdorin njerëzit që pikturojnë. Filloni diskutimin duke thënë, “Ndonjëherë ne kemi përdorur një furçë për të pikturuar. Ndonjëherë ne kemi përdorur gishtat tanë dhe duart. A mendoni se ne mund të pikturojmë me këmbët tona?” Inkurajoni fëmijët të mendojnë për mënyrat se si ata mund të pikturojnë me këmbët e tyre. Fëmijët duhet të zhysin gishtërinjtë e zhveshur në bojë dhe më pas të bëjnë stampa me shputën e këmbës. Ose pse jo, vallëzimi me këmbët e zbathura në bojë na sjell kënaqësi dhe ju mund tua sugjeroni fëmijëve një kërcim të tillë!</p>	<p>Legen me ujë të ngrohtë, sfungjer, lloje të ndryshme pëlhurash etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Vendosni në sfond një muzikë instrumentale të qetë e cila i ndihmon fëmijët të hedhin hapa të kujdesshëm me sfungjerin ngjyrosë në shputat e tyre dhe të kërcejnë sipas mënyrës së tyre në letrën e shtruar në dyshe. Ndhmoni dy ose tre fëmijë për të hequr këpucët e tyre dhe çorapet dhe i palosni pantallonat e tyre (mos harroni, ju mund të bashkoheni me ta). Tregojuni fëmijëve se muzika i bën të lëvizë trupat e tyre ashtu si vallëzojnë edhe ngjyrat me këmbët e tyre. Mos u habitni nëse disa fëmijë do të duan më shumë bojë dhe të vallëzojnë pa pushim.</p> <p>Pasi fëmijët parashkollorë të vallëzojnë dhe pikturojnë, sugjeroni mënyra të tjera, të ndryshme që ata mund të përdorin me këmbët e tyre. Për shembull, ju mund të pyesni duke nxitur kërkimin e tyre, “Çfarë do të ndodhte, nëse ju do të pikturonit mbi majat e gishtërinjve tuaj? Si do të dukej piktura nëse keni përdorur vetëm pjesën anësore të këmbës suaj? Si mund të pikturoni me gishtërinjtë tuaj?” Kushtojuni kohë fëmijëve për të bashkëbiseduar gojarisht më shumë dhe për të njohur edhe sugjerimet që ata bëjnë.</p> <p>Kur fëmijët të kenë mbaruar së vizatuari, ndihmohuni për të larë këmbët e tyre në vaskën me ujë të ngrohtë dhe me shkumë sapuni. Disa fëmijë do të thonë se kjo është pjesa më e bukur! Sigurohuni që një i rritur është afër për t’i ndihmuar fëmijët dhe për të fshirë këmbët e tyre.</p>	Magnetofon ose kompjuter, CD me muzikë të gjinive të ndryshme etj
<p><b>Matematikë</b></p> <p><b>Aftësitë:</b> Numërimi nga 1-5 i gishtave të duarve dhe të këmbëve</p>	<p>Gjurmët e duarve dhe të këmbëve vetvetiu të çojnë te koncepti i numërimit. Nëpërmjet pikturave të bëra në letër ose në kolazhet e ndryshme mësuesja zhvillon konceptin dhe aftësitë e numrit dhe të numërimit. Po ashtu mësuesja mund të ndalet edhe te format e shqisave të njeriut duke diskutuar dallimet në mes tyre.</p> <p><b>Gjej sa janë?</b> Shembujt janë të shumtë. Mësuesja mund të pyesë duke treguar shqisat e veta ose figura të shqisave të prera nga revistat: Sa gishta janë? Sa veshë kemi? Sa sy? Sa gojë, sa hundë etj?</p>	Piktura, figura të prera shqisash, numra, karta etj

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p> <p><b>Konceptet</b> Shijet: e hidhur, e ëmbël, e kripur dhe e thartë</p> <p><b>Aftësitë:</b> Analizë, Vëzhgim, Krahasim dhe dhënia e konkluzioneve</p>	<p><b>2. SHQISA ETË SHIJUARIT</b> <b>Veprimtari shkencore:</b> Gjatë kësaj faze të zhvillimit të fëmijërisë së hershme fëmijët parashkollorë eksplorojnë 4 shije me gjuhën e tyre dhe arrijnë të shijojnë <b>të hidhurën, të ëmblën, të thartën dhe të kripurën.</b> Mësuesit duhet të dinë se <b>ensorët e të shijuarit</b> janë të grupuar në pjesën e përparme të gjuhës, në pjesët anësore si dhe poshtë saj, ato gjenden gjithashtu dhe në pjesë të tjera të gojës. Përgatitni përpara mostrat me ushqime për çdo fëmijë. Ndërsa jeni duke bashkëbiseduar me fëmijët në lidhje me ushqimet e ndryshme që ata pëlqejnë, nxitini ata të përdorin fjalë të tilla si “e ëmbël”, “i kripur”, “i hidhur” dhe “i thartë” ndërkohë që i shijojnë ato. U thoni atyre se ata mund të shijojnë nga pak me gjuhën e tyre, nga të gjitha llojet e ushqimeve që kanë në pjatë. Shpjegojuni se ata kanë <b>“qendrat e shijes”</b> në gjuhët e tyre të cilat i ndihmojnë ata të shijojnë, dhe ndërkohë me një pasqyrë në dorë shikojnë me vërejtje gjuhën e tyre në pasqyrë. Disa fëmijëve (jo të gjithëve) u kërkohet që të parashikojnë shijen e ushqimeve. Për fëmijët e tjerë rekomandohet të provojnë vetëm dy shije dhe më pas t’i krahasojnë ato. Kur fëmijët thartohen në fytyrë nga shija që kanë provuar pyetini, “Pse e shtrembërove fytyrën? Si të shijoi? A është e ëmbël, e thartë, e hidhur apo i kripur? “Kuptohet që fëmijët në vend të provojnë mostrat, provojnë më me kënaqësi ushqime që u pëlqejnë atyre. Së fundmi diskutoni për shijen më të pëlqyeshme dhe atë jo të mirë. Gjatë kohës që janë duke shijuar pije freskuese jepuni limonadë dhe pyetini shijen e ç’frute u kujton atyre.</p>	<p>Limon, limonadë, karamele, patatina, kakao, një kanë dhe gota (për limonadë), letër, pjata, lugë të vogla, pasqyrë e vogël dore (e pathyeshme).</p> 
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p><b>Koncepte;</b> Cilësimi</p> <p><b>Aftësitë:</b> Pasurimi i fjalorit</p>	<p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b> Merrni parasysh fjalët dhe frazat që fëmijët përdorin për të përshkruar shijet e ndryshme dhe përdorini ato për të krijuar një tabelë mësimore që pasqyron katër shijet kryesore që mësuani. Zhvilloni lojën: <b>Gjej çfarë është</b> e thartë, e ëmbël, e hidhur dhe e kripur ose <b>Çfarë shije ka...</b> molla, limoni, akullorja, farat etj</p>	<p>Figura, ilustrime, libra, karta, revista, tabelë me xhepa të ndarë në katër radhë sipas shijeve etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet			
<p><b>Arte</b></p>	<p><b>3. SHQISA E TË NUHATURIT</b>  <b>Përvoja ndijore me lojëra argëtuese:</b>            Nxitini fëmijët të përdorin disa nga shqisat. Në këtë aktivitet për fëmijërinë e hershme nuk këshillohet, që për shkak të erës me të vërtetë të mirë, ata të përpiqen për ta ngrënë ushqimin që përgatisni, pasi ekstrakti mund t'i bëjë keq për shëndetin.“            Për 4-5 vjeçarët ky është një aktivitet i këndshëm. Shtrohet ushqim për t'u ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër dhe pastaj për t'i surprizuar ata, shtohet ekstrakt me karamelle mente. Ata e pëlqejnë shumë atë. Duke përdorur një formë biskotash, ata fillojnë të presin në forma brumin e gatshëm dhe përfshihen mjaft mirë në bërjen e biskotave me “karamelle mente”.            Ishte e shkëlqyer!-thonë shpesh ata, nëse ne ua lejojmë ta provojnë</p>	<p>2 gota miell, 1 filxhan kripë,            ujë për të arritur masën e dëshiruar            1-2 gota            Ekstrakt i zgjedhjes suaj            Ushqim për t'u ngjyrosur</p>			
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p> <p><b>Aftësitë</b>            Kërkimi,            Analiza,            Klasifikimi</p>	<p><b>“Kjo vjen erë si...”</b>            Kjo veprimtari shkencore nxit fëmijët parashkollorë për të vëzhguar, për të krahasuar dhe të përdorur aftësitë gjuhësore se si të përshkruajnë sendet aromatike. Fillimisht hapni vrmat në lastër dhe vendosni një artikull ose aromë të lëngshme.            Më pas bashkëbisedoni me një grup të vogël fëmijësh për shqisën e të nuhaturit dhe u kërkoni të mbyllin sytë dhe një fëmijë tjetër të spërkasë në ajër pak parfum. Kur fëmijët hapin sytë e tyre, pyetini ata se çfarë nuhasin. Bisedoni rreth asaj se si hundët tona na ndihmojnë të nuhasim gjëra dhe tregojuni një libër që flet për nuhatjen. Ndërsa çdo fëmijë është duke nuhatur parfumin, ata mund të tregojnë se prej çfarë arome është përbërë.            Së fundi, vendosni artikujt (në një kuti të mbyllur) në tavolinën e shkencës për hetime dhe vëzhgime të mëvonshme. Shumë nga fëmijët do të shkojnë përsëri në tavolinën me aroma të ndryshme për të provuar sërish aromat e ndryshme dhe do të gëzohen duke treguar atë që nuhasin.</p> <table border="1" data-bbox="452 1716 1037 1925"> <tbody> <tr> <td data-bbox="452 1716 602 1925">qepë ekstrakt vanilje uthull kanellë</td> <td data-bbox="602 1716 802 1925">alkool llum kafeje parfum gjalpë</td> <td data-bbox="802 1716 1037 1925">Copë bananeje lëng limoni karamelle mente naftalinë</td> </tr> </tbody> </table>	qepë ekstrakt vanilje uthull kanellë	alkool llum kafeje parfum gjalpë	Copë bananeje lëng limoni karamelle mente naftalinë	<p>Një film 35 mm (aparati fotografik) ose një lastër me vrma për të vendosur aromat e ndryshme: (përdoret shkop me pambuk për aromat e lëngshme)</p>
qepë ekstrakt vanilje uthull kanellë	alkool llum kafeje parfum gjalpë	Copë bananeje lëng limoni karamelle mente naftalinë			





Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p><b>Aftësitë:</b> Përshkrimi, Pasurimi i fjalorit</p>	<p>Nxitini fëmijët për të përdorur fjalë përshkruese. Më pas, prezantoni grupin me aroma të tjera, duke i caktuar çdo fëmijë një të tillë. Jepuni kohë fëmijëve që të flasin për aromat dhe për të shkëmbyer artikujt me njëri-tjetrin. Pyetini, “A mund të dimë se çfarë arome është?” dhe më pas të lejojmë fëmijët për të treguar për çdo artikull.</p>	<p>Karta me figura, objekte natyrale, tabelë me fruta dhe sende që mbajnë aroma të ndryshme</p>
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p> <p><b>Konceptet</b> Pasqyra dhe pasqyrimi</p> <p><b>Aftësitë:</b> Vëzhgimi, kërkimi shkencor, përbërja e materialeve</p>	<p><b>4. SHQISA E TË PARIT</b> <b>“Pasqyrë, pasqyrim”</b> <b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b></p> <p>Fëmijët parashkollorë mund të bëjnë eksperimente shkencore të thjeshtë, kur ata e përdorin shqisën e të parit për të mësuar rreth reflekseve. Ftoni disa fëmijë (3 ose 4) të ecin nëpër klasë me ju për të gjetur vendet ku ata mund të shohin reflektimet (pasqyrimet) e tyre. Bisedoni se çka është një reflektim dhe në cilin prej objekteve të shndritshëm fëmijët e kanë parë veten e tyre, p.sh. objekte të tilla si pajisjet metalike, dritare, lugë metalike apo në ujë. Së bashku gjeni shembuj të tjerë reflektimesh. Theksoni fjalën <b>pasqyrim</b> duke mbajtur një pasqyrë dhe duke thënë, “Unë mund të shoh reflektimin tim në këtë pasqyrë. Është fytyra ime, pikërisht si fotografia e fytyrës time! “Pastaj afrojuni pasqyrën çdo fëmijë për të parë reflektimin e saj/të tij, më shumë. Uluni me disa fëmijë dhe tregojuni lloje të ndryshme të pasqyrash. Lërnini kohë të mjaftueshme për t'i shqyrtuar dhe hetuar ato tërësisht. Çfarë ndodh në pak sekonda pasi ata lëshojnë frymën e tyre në pasqyrë? Kërkojuni atyre të mbajnë një pasqyrë në vende të ndryshme të tilla si para gojës së tyre të hapur, në gjatësinë e krahut - pak më lart se sa shpatullat e tyre, dhe në një kënd të kundërt të klasës. Sugjerojuni fëmijëve të mbajnë një pasqyrë nga dera, ndërsa qëndrojnë brenda. Çfarë mund të shohin tani? Përdorni letrën për të regjistruar zbulimet e tyre. Më vonë, vareni tabelën në zonën e shkencës bashkë me pasqyrat për hetim të mëtejshëm të pavarur. Disa fëmijë parashkollorë mund të argëtohen edhe më shumë në kërkimin me pasqyra.</p>	<p>Të gjitha llojet e <b>pasqyrave të pathyeshme</b>, dore, muri, xhepi etj., sende të tjera në të cilat fëmijët mund të shohin reflektimet e tyre të tilla pajisje si, dritare, lugë metalike, sipërfaqe uji të cilat nxjerrin në pah fytyrën, si dhe një copë letër, shënues.</p> 
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p>	<p>Mësohen vjersha dhe përsëriten bashkë me fëmijët duke vendosur në sfond një muzikë të qetë që u jep mundësinë të vallëzojnë duke interpretuar sipas dëshirës së tyre.</p>	<p>Libra, karta me figura sysh, skenë teatri, veshje</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Aftësitë:</b> Recitimi, memorizimi i vargjeve dhe i ritmit Shoqërizimi me muzikë Interpretimi teator</p>	<p><b>Sytë e mi</b> Kam dy sy që shohin mirë Lule, zogi, dritë dhe errësirë Majtas, djathtas, para, prapa Sytë e mi udhëheqin hapat Bardh e zi dhe ngjyra plot Sytë e mi shohin në botë.</p> <p>Mësuesja mund të përdorë libra shtesë, figura, përralla dhe tregime të ndryshme që flasin për shqisat. Ajo u jep mundësinë e zhvillimit të një teatri fëmijëve duke krijuar si personazhe shqisat e ndryshme dhe lojën: Cila prej nesh është më e rëndësishme?</p>	
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p> <p><b>Aftësitë e</b> Lojës dhe të bashkëpunimit</p>	<p><b>5. SHQISA ETË DËGJARIT</b> <b>Loja e bilbilit</b> Edhe më të vegjlit mund ta luajnë këtë lojë. Gjatë kohës së mbledhjes në rreth, mësuesja i jep një fëmijë një bilbil dhe e udhëzon të fshihet, ndërkohë që ai fillon t'i bjerë bilbilit. Fëmijët e tjerë ndjekin zërin e bilbilit për të gjetur fëmijën e fshehur. Fëmija i cili gjen fëmijën e fshehur fiton lojën dhe shkon të fshihet dhe kështu vazhdon me radhë.</p>	<p>Një bilbil</p> 
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p><b>Aftësitë:</b> Ndijimi, Të dëgjuarit, Përshkrimi dhe imitimi i zhurmave dhe tingujve</p>	<p><b>Lojëra dëgjimi</b> Gjatë këtij planifikimi mësimor fëmijët mësojnë të përdorin aftësitë e të dëgjuarit dhe të folurit për të rikrijuar tinguj në mjedisin e tyre. Disa ditë para se të zhvillohet loja, vini në dukje dhe përshkruani tingujt ashtu si dëgjoen. Ju mund të thoni, “Ua, Enea, makina jote bën një zhurmë të madhe kur ti e shtyn atë”. Ose “Fëmijë, a mund të dëgjojmë kur fryn era? Eja vendoseni veshin në dritaren tuaj. Ky është një tingull shumë i butë. “Ky tingull është aq i lartë, sa që unë nuk mund të dëgjojë muzikë. Oh, dëgjoni është makinë zjarrfikëse etj.” Fëmijët bashkë me mësuesit ndërmarrin së bashku “një shëtitje dëgjimore “. Nëse koha është e butë, ndërmerrni një shëtitje jashtë rreth kopshtit. Nëse jo, një shëtitje brenda. Për të ndihmuar përqendrimin e fëmijëve tek tingujt përpara se të filloni shëtitjen, bëni disa pyetje me fund të hapur, të tilla si, “Çfarë lloje tingujsh mendoni ju se ne do të dëgjojmë në ecjen tonë?”, “Si mund ta bëjmë që ne t'i dëgjojmë mirë tingujt e natyrës në ecjen tonë?” Si mund</p>	<p>Zërat e të rriturve dhe të fëmijëve, si dhe zërat e tingujt që rrethojnë mjedisin tuaj përreth.</p> 

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>ta bëjmë të sigurt që ne të dëgjojmë çdo gjë? Ku duhet të shkojmë të dëgjojmë sa më shumë tinguj?”.</p> <p>Ndërkohë që ju ecni, nxitini fëmijët t’ ju tregojnë për tingujt që dëgjojnë. Ndihmojini ata të përdorin fjalë përshkruese, si zë i lartë, tingull i butë, goditës, i zhurmshëm, tingëllues etj.</p> <p>Pas shëtitjes, uluni së bashku dhe bashkëbisedoni për zërat e tingujt që keni dëgjuar së bashku me fëmijët. Ftojini fëmijët të përpiqen për të rikrijuar tingujt duke përdorur vetëm zërat e tyre.</p> <p>“(Emri i fëmijës), e dëgjoni si tingëllon uji në lavaman”.</p> <p>Vazhdoni të ri krijoni tinguj.</p> <p>Ju mund të regjistroni ato në një magnetofon për t’i dëgjuar përsëri dhe të përpiqeni t’i identifikoni në një kohë tjetër më vonë.</p> <p>Libra për të lexuar gjatë kohës së leximit:</p> <p>Mos harroni se ndijimi dhe të dëgjuarit, si dhe rikrijimi i tingujve janë aftësi të veçanta. Fëmijët kanë nevojë shumë të praktikojnë të dëgjuarin e tyre duke l akorduar me tingujt përpara se ata të përpiqen t’i rikrijojnë ato.</p>	
<p><b>Arte</b></p>	<p>Provoni të këndoni këtë këngë duke zëvendësuar objektet me tingujt që keni dëgjuar në “shëtitjen lëvizore.</p> <p><b>Këngë:</b></p> <p>A keni dëgjuar një zile që tingëllon dhe për në kopsht çdo ditë na fton? Tring, tring, tingëllon dhe për në kopsht na fton A keni dëgjuar kur fryn era dhe viu, viu, viu bën te dera?, Viu, viu, viu bën era kur fryn te dera.</p> <p>Për të përfshirë fëmijët në imitimin e tingujve mund të përdoren edhe këngë si p.sh:</p> <p>Një zog të vogël unë kam parë Me pas dit sa bukur këndonte, Ciu-ciu bënte pa pra, ciu, ciu, dhe kurrë s’pushonte Një qen të vogël unë kam parë Me pas dit sa bukur këndonte, Ham-ham bënte pa pra, Ham, ham, dhe kurrë s’pushonte Një mace të vogël unë kam pa Me pas dit sa bukur këndonte,</p>	<p>Objekte që lëshojnë tinguj, zile, daulle, magnetofon, incizime tingujsh dhe zhurmash etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Mjau-mjau bënte pa pra, Mjau-mjau, dhe kurrë s'pushonte Një lopë të vogël unë kam pa Me pas dit sa bukur këndonte, Mu-mu bënte pa pra, Mu-mu, dhe kurrë s'pushonte zogu ci, ci, ci qeni ham,ham, ham macja mjau, mjau, mjau, lopa mu,mu, mu oh, sa kënaqësi.....</p> <p>Fëmijët udhëzohen të përplasnin duart dhe të imitojnë kafshët e ndryshme, duke përforcuar kështu mësimin e imitimit dhe të tingujve që lëshojnë disa prej kafshëve.</p>	
<p><b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b></p>	<p>Tregojini atyre se: Disa fëmijë për arsye të ndryshme e kanë të vështirë të komunikojnë dhe të marrin pjesë në aktivitetet apo lojërat e organizuara në kopsht, p.sh. nëse një fëmijë e ka të vështirë të tregojë përmes tingujve dhe të folurit se si bën lopa, kali, qeni, ai mund të imitojë si bën lepuri duke ngritur gishtat lart mbi kokë dhe duke kërcyer si lepuri sa andej këtej.</p> <p>Të tjerë fëmijë mund ta vizatojnë në fletë ose në tabelë, qengjin e vogël që bën be- be. Dhe edukatorja ose një shok tjetër i fëmijës mund ta paraqesë verbalisht vizatimin.</p> <p><b>Luajtje rolesh</b></p> <p>Improvizoni lojëra me fëmijët ku secili prej tyre të vihet në rolin e një fëmije p.sh. që nuk shikon, që ka vështirësi në të ecur, që nuk flet, që nuk e kupton gjuhën dhe të arrijë të marrë pjesë në lojë.</p> <p>Mbyllini sytë një fëmije me një shami dhe vëreni të gjejë shokun që i la topin, udhëzoni fëmijët e tjerë ta ndihmojnë shokun për të realizuar këtë lojë.</p> <p>Kërkojuni fëmijëve të përpiqen të kuptojnë mesazhin që ju po i përcillni përmes gjesteve dhe gjuhës së shenjave.</p> <p>Dhe po ashtu, lejojini fëmijët të vizatojnë atë çfarë duan, pa e shprehur me fjalë.</p>	





## 5. STINËT

Fushat	Udhëzime	Materialet
<b>Hyrje</b>	<p>Ndjeshmëria e fëmijëve ndaj stinëve është e madhe pasi shoqërohet me nevojën e tyre për lojë në mjedise të hapura jashtë kopshtit. Atyre u bëhen pyetje që lidhen me pushimet e verës, vendet ku kanë qenë për pushime në mal, det apo liqen dhe çfarë kanë përjetuar.</p> <p>Mjedisi i kopshtit duhet të përmbajë materiale të shumta që lidhen me natyrën në stinë të ndryshme, dhe po ashtu dhe me frutat, veshjet apo punët që bëhen në natyrë</p>	Libra, albume, shkronja të mëdha, figura peizazhesh të ndryshme.
<p><b>Sociale</b></p> <p><b>Konceptet</b> Të mësuarit për të njohur stinët motin punët që bëhen në stinët e verës, pranverës, vjeshtës dhe dimrit</p> <p><b>Vlera:</b> Përgjegjësia</p>	<p>Për fëmijët është e rëndësishme të mësojnë që në moshën parashkollore se shoqëria i siguron të mirat materiale nëpërmjet punëve të ndryshme që bëjnë prindërit e tyre.</p> <p>Tema e stinëve nxit fëmijët të njihen me disa nga proceset e punëve në bujqësi, si p.sh. kur mbillen drithërat, kur korren gruri dhe misri, kur vilen frutat e ndryshme etj</p> <p>Mësuesja përshkruan punën që bëjnë njerëzit në fshat duke u ndalur në disa aspekte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilat janë punët që bëhen në çdo stinë</li> <li>• Si është moti në stinët e ndryshme dhe si ndikon në natyrë</li> <li>• Kush punon në fshat dhe çfarë bën</li> </ul> <p>Vlera e trajtuar së bashku me fëmijët mund të jetë Përgjegjësia.</p> <p>Prindërit kanë përgjegjësi për.....</p> <p>Mësuesja ka përgjegjësi për.....</p> <p>Fëmijët kanë përgjegjësi për.....</p> <p>Gjyshërit kanë përgjegjësi për.....</p> <p>Ju mund të diskutoni shumë nga raste nga jeta e përditëshme kur fëmijët apo dhe të rriturit nuk i përmbushin përgjegjësitë e tyre në familje, në punë, shkollë dhe kopsht, e më gjerë.</p>	Foto të bëra së fundmi nga fëmijët, piktura, libra,  Albume për stinët
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	<p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b></p> <p>Aktivitetet që lidhen me stinët janë të larmishme dhe kanë në fokus të tyre zhvillimin e aftësive shkencore si vëzhgimin, klasifikimin dhe vlerësimin.</p> <p>Nëse keni folur për detin apo malin si mësuese mund të ndihmoni fëmijët të përqendrohen në elementët</p>	Pamje të peizazheve natyrore, të kafshëve, stinëve, llojeve të ndryshme të veshjeve, etj

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Aftësitë</b> vëzhgimi klasifikimi vlerësimi</p>	<p>që janë karakteristikë e stinëve si pemët dhe kafshët, ngjyrat, veshjet e njerëzve etj</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Varni nëpër muret e klasës <b>piktura apo foto që tregojnë barin dhe lulet në stinë të ndryshme</b>. Me një marker mund të plotësoni figurat me insekte si milingonat, krimbat apo kërmijtë. Prisni një formë luleje dhe lërin fëmijët ta ngjyrosin atë siç duan. Më pas orientojini fëmijët që nëpërmjet një kapëseje ta varin në murin ku keni ngritur qendrën e stinës përkatëse. Në një letër të gjelbër prisni format e gjetes të gjata ose ovale dhe kërkojuni më pas fëmijëve t'i vendosin pranë luleve duke i plotësuar figurat e tyre</li> <li>• Organizoni <b>një shëtitje</b> me fëmijët në një mjedis me sa më shumë bimësi dhe kafshë, p.sh. mund të jetë një pyll, një park, buzë një lumi apo liqeni, sipas kushteve që ju dikton qyteti apo fshati ku jetoni dhe punoni. Më pas zhvilloni bashkëbisedimin tuaj, duke i vendosur fëmijët në formë rrethi, mbështetur mbi këto tema: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë ju pëlqen më shumë nga stina e verës? Po nga stinët e tjera?</li> <li>• Si ndryshon natyra në verë, pranverë, vjeshtë dhe dimër?</li> <li>• Po veshja e secilit prej nesh? Çfarë na mban ngrohtë dhe çfarë na mban fresk? Duke diskutuar rreth ngjyrave, shijeve të frutave dhe gjithçkaje që lidhet me stinët e ndryshme, fëmijët kanë shansin të shkëmbejnë idetë e tyre dhe të japin fakte që lidhen me temën qendrore.</li> <li>• Bashkëbisedoni me fëmijët <b>rreth luleve të verës</b>. Inkurajojini ata të përshkruajnë ngjyrat, format, si dhe të shtojnë elementë që lidhen me stinën e verës, si p.sh. tharja e luleve apo bërja e një mozaiku me materiale që të kujtojnë stinën, si p.sh. guaska, boce pishe, lule të thara etj</li> <li>• Së bashku me fëmijët përgatisni një <b>koleksion gjethesh</b> të pemëve të ndryshme. Më pas përgatisni etiketa boshe në të cilat fëmijët me ndihmën tuaj mund të kopjojnë emrin e pemës apo të bimës</li> <li>• Nëse tema zhvillohet në pranverë ju mund të realizoni si aktivitet mbjelljen e fasuleve nëpërmjet së cilës fëmijët njihen me</li> </ul> </li> </ul>	<p>Piktura dhe foto për stinët, marker, ngjyra për fëmijët, letër e bardhë dhe me ngjyrë të gjelbër, gërshtë, ngjitëse, kapëse.</p> <p>Aparat fotografik, Çantë ku futen materialet e mbledhura nga shëtitja,</p> <p>Lule të thara, lule vere, guaska, boça pishe etj.</p> <p>Gjethet natyrore dhe gjethet artificiale, prej letre, etiketa boshe etj</p> <p>Marker me ngjyrë, kavanoz bosh prej qelqi ose materiali tjetër, qese me fara ose fasule, ujë, qese plastike dhe dritare</p>



Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p><b>fotosintezën</b> dhe <b>katër elementët</b> e saj: <b>dheun, diellin, ujin dhe farat</b>, të domosdoshme për rritjen e bimëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutoni për katër elementët e domosdoshëm për rritjen e një bime: toka (dheu), dielli dhe uji.</li> <li>• Ndhmoni fëmijët të vizatojnë një diell në posterin që keni vënë në qendrën e shkencës. Sigurohuni që ata kanë bërë shumë rreze në <b>posterin e diellit</b>. Vizatoni së bashku me ta edhe tokën, e cila duhet të zërë 1/5 e posterit. Filloni me krahun e majtë, vizatoni një <b>farë të zezë</b> nën tokë. Vizatoni fara të tjera duke përfshirë edhe rritjen e <b>barit të gjelbër</b> mbi secilën farë që keni vizatuar. Shtrini <b>rrezet e verdha</b> të diellit në mënyrë të tillë që ato të ngrohin edhe nëntokën. Shtoni <b>ujë në ngjyrë blu</b> dhe spërkasni me furçë dhe bojë rreth e rrotull fushën e mbjellë. Në përfundim kushtojini posterit një vend të rëndësishëm në mjedisin e klasës</li> <li>• Pastaj përdorini kavanozat dhe dheun duke i ndihmuar fëmijët të mbjellin farat ose fasulet. Shtoni ujë dhe mbulojini kavanozat me qese plastike transparente. Vendosini kavanozat nën diellin e dritares së kopshtit për disa ditë (mbajini ngrohtë edhe natën). Kur bima të mbijë, zbulojeni. Rishihni hapat e bërë çdo ditë për t'u kujtuar fëmijëve bimët e tyre.</li> <li>• Gjatë vitit, por veçanërisht në pranverë fëmijët kanë mundësi të shumta të merren me <b>ujtjen e luleve dhe të barit</b> rreth e rrotull kopshtit të tyre, si dhe të mbajnë përgjegjësi ditore për një shërbim të tillë. Së bashku me fëmijët vëzhgoni se <b>si rritet bari</b> dhe cilat janë insektet që bashkëjetojnë me bimët</li> <li>• Nëse jeni në <b>stinën e vjeshtës</b>, atëherë përpiquni së bashku me fëmijët të vëzhgoni se si ka ndryshuar natyra, lulet dhe gjethet, moti, veshjet etj</li> <li>• Dilni një shëtitje në parkun kryesor të qytetit apo në pyllin e fshatit. Bëni foto të mjediseve bimore ose zogjve dhe kafshëve që mund të shihen përreth. Bisedoni për shtegtimin e zogjve në vende të ngrohta. Pas bisedës për vjeshtën, ndaluni në elementin e ngjyrave që kanë gjethet apo frutat</li> </ul>	<p>Pamje të peizazheve natyrore, të kafshëve, stinëve, llojeve të ndryshme të veshjeve, etj</p> <p>Piktura dhe foto për stinët, marker, ngjyra për fëmijët, letër e bardhë dhe me ngjyrë të gjelbër, gërshtë, ngjitëse, kapëse.</p> <p>Aparat fotografik, Çantë ku futen materialet e mbledhura nga shëtitja,</p> <p>Lule të thara, lule vere, guaska, boça pishë etj.</p> <p>Video, libra të ilustruar, albume me gjethe dhe lule të thara etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kthehuni në klasë dhe analizoni <b>ndryshimin e ngjyrave të gjetheve</b> nga pranvera, në verë, në vjeshtë dhe deri në stinën e dimrit. Cilat janë pemët që nuk zhvishen, por i ruajnë gjethet gjatë gjithë vitit?</li> <li>• Edhe <b>moti</b> është një nga temat në të cilat fëmijët mund të fokusohen gjatë njohjes së stinëve. Koha me diell apo me shi, era, dëborë, stuhitë, retë, bubullimat janë të gjitha mjaft interesante dhe argëtuese për fëmijët si dukuri natyrore që karakterizojnë stinët e ndryshme. Rekomandohet që mësuesja së bashku me fëmijët të bëjnë një kalendar të madh mujor të cilin ta vendosin në mes të klasës dhe, ku për çdo ditë të hedhin në të shenjat e motit</li> </ul> <p>Mësuesja ka mundësi të panumërta për të zhvilluar aftësitë shkencore të vëzhgimit, të analizës dhe të vlerësimit të stinëve dhe elementëve të tyre. Ajo mund të shfaqë një video, të shfletojë me fëmijët libra të ilustruar dhe albume, të vizitojë me ta mjedise si kopshtet botanike apo zoologjike duke u mësuar atyre më shumë rreth ndryshimeve stinore të bimëve dhe kafshëve etj</p>	
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Të mësuarit për t'u fokusuar në shkronjën S, për të njohur gjurmët si dhe për të përshkruar stinët me karakteristikat e tyre</p>	<p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b> Mësuesja mund të përdorë një larmi pjesësh letrare duke filluar nga poezitë e duke vazhduar me përrallat, historitë, fjalët e urta, gjë e gjëzat etj. Më poshtë keni dy poezi të cilat mund të lexohen së bashku me fëmijët dhe të ilustrohen prej tyre në orën e artit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Stinët</b></p> <p><b>Erdhi pranvera</b> Kam si nuse një kurorë Dhe fustan të bardhë borë, Kur vij unë, vjen pranvera Edhe quhem....luledelja</p> <p><b>Erdhi vera</b> Ejani ju pulëbardha dhe më merrni fluturim Në këtë ditë të nxehtë vere më çoni pranë detit tim.....</p>	<p>Libra me përralla, histori, fjalë të urta, gjë e gjëzat, ilustrime me figura apo piktura etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p><b>Erdhi vjeshta</b> U zhdruk vapa, shkoi vera dhe bilbili më s'këndon Era fryn dhe fletët bien, pemët zhvishen si nga mot.....</p> <p><b>Erdhi dimri</b> Viu-viu, fryn veriu, nëpër xhama troket shiu. Viu-viu, era s'ndalet, bora zbardhi gjithë malet....</p> <p><b>Shiu</b> Shi, shi, baba shi, Bjer, bjer- o me furi, shi, shi, baba-shi jepi tokës pak freski! Shi, shi, baba-shi Ku ke qenë gjer tani? Presin arat Plot me grurë, Presin pyjet Plot me drurë. Presin lulet, trëndafilat Jaseminët, karafilat, presin rosat edhe patat Sqepkuqet, qafëgjatat.</p> <p>Për temën e stinëve janë të shumta edhe përrallat apo historitë e ndryshme. Rekomandohet që ju të përdorni gjë e gjëzat që nxisin fëmijët për problem zgjidhjen, ndërsa si shkronjë me të cilën do siguroni familjarizimin e fëmijëve me alfabetin mund të përzgjidhni S. Fjalët që kanë shkronjën S në brendinë e tyre mund të ilustrohen përbri me figurat: s- Shqipëria- Kosova- sapun – stinët –sporti –shiu- vesa- rosa- Vjosa- pusi etj</p>	
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Konceptet</b> Ngjyrat e stinës: e gjelbër dhe e verdhë</p>	<p>Si mësuese e parashkollorit, tema e stinëve ju ofron mundësi për të zhvilluar së bashku me fëmijët dhjetëra aktivitete arti. Disa prej tyre mund të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vizatime të stinëve dhe peizazheve të ndryshme</li> <li>• Ngjyrosje,</li> <li>• Punë me baltë</li> <li>• Punë dore me prerje dhe ngjitje</li> </ul>	<p>Ngjyra të ndryshme, fletë pune, fletë vizatimi, plastelinë, CD me muzikë të gjinive të ndryshme etj</p>




Fushat	Udhëzime	Materialet
<p>Prerje dhe ngjitje formash për mozaikun e pranverës</p> <p>Muzikë dhe kërcim me patina</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitje posterash dhe mozaikësh me ngjyra të llojeve të ndryshme dhe materiale natyrore.</li> <li>• Mësim i një kënge për stinët apo motin</li> <li>• Dëgjim muzike klasike apo këngësh për natyrën</li> <li>• Mësim i një valleje me temë pranverën apo dëborën e parë</li> </ul> <p>Më poshtë po japim disa shembuj të aktiviteteve të artit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vizatoni së bashku me fëmijët <b>diellin</b>. Inkurajojini ata të përdorin ngjyra të ndryshme në pjesë të veçanta të vizatimit të tyre.</li> <li>• Paraprakisht bisedoni me fëmijët rreth faktit se gjatë stinës së verës shumë ditë janë të nxehta dhe është dielli që i jep këto ditë. Më pas pyesni fëmijët se çfarë ngjyre ka dielli dhe lërin fëmijët të zgjedhin ngjyrat që dëshirojnë për bërjen e pikturës së tyre. Në përgjithësi fëmijët e kësaj moshe pëlqejnë shumë përdorimin e ngjyrave mikse ose ngjyrosjen me gishta</li> <li>• Projekt <b>arti i pranverës</b>. Ky aktivitet ndihmon fëmijët të kuptojnë konceptin e të parit të gjërave në mënyrë të ngjashme ose të ndryshme, duke nënvizuar se produkti final i secilit është individual dhe dallon nga të tjerët.</li> <li>• Jepini secilit fëmijë një pjatë letre mesatare dhe po ashtu shpërndajuni atyre forma rrethi, katrori dhe trekëndëshi me letra të ngjyrave të ndryshme dhe me përmasa të ndryshme. Inkurajojini ata të formojnë lule, pemë dhe t'i ngjitin në pjatën e bardhë ose në ngjyra të tjera. Më pas ata mund të vizatojnë insekte apo zogj mbi to.</li> <li>• Hapi i dytë i projektit të artit mund të jetë krahasimi i punëve që fëmijët kanë bërë dhe gjetja e ngjashmërive dhe dallimeve në mes tyre. Përse kanë përdorur këto ngjyra? Përse kanë gjetur fluturat apo krimbin për ta vendosur mbi pjatë etj</li> <li>• Mësuesja ka shansin që në këtë projekt arti të pranverës të përdorë vetëvlerësimin dhe vlerësimin e moshatarëve për punët individuale të secilit fëmijë, duke i dhënë atyre edukimin e duhur për diversitetin e shikimit të gjërave nga secili</li> <li>• <b>Valsi i dimrit</b>. Inkurajoni fëmijët parashkollorë të lëvizin dhe të përkulin trupin e tyre në mënyra të ndryshme, ngjashëm me lëvizjet e aktiviteteve të dimrit. Përpiquini të siguroni një</li> </ul>	<p>Letër të madhe të bardhë, ngjyrat : e verdhë, e bardhë dhe portokalli, Mjetet e ngjyrosjes mund të jenë furça, lapsa me ngjyra, pastelet, bojëra uji dhe përdoren po ashtu dhe gishtat.</p> <p>Letër e bardhë ose e verdhë për bërjen e pjatës, forma rrethi, trekëndëshi dhe katrori të madhësive dhe ngjyrave të ndryshme: e gjelbër, e verdhë, e kuqe, portokalli, ngjitesë, lapsa me ngjyrë etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>CD me muzikë vals. Po ashtu kërkohet që për çdo fëmijë të sigurohen krahe letre (copat e letrës duhet të jenë mjaftueshëm të mëdha që të mund ta bëjnë fëmijën të qëndrojë poshtë tyre). Fëmijëve u kërkohet të sjellin me vete patina nëse kanë në shtëpi ose sigurohen nga ju tre deri në katër të tilla.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Transformoni klasën tuaj në një fushë akulli ku mund të vallëzohet. Jepuni fëmijëve të dy krahet e letrës që ata të mund ta kenë si zbukurim. Kujtojuni fëmijëve që ata janë në kërkim të një kutie magjike dhe ata mund ta gjejnë atë duke kërcyer me patina</li> <li>• Vendosni paraprakisht në kutinë magjike thesarin që ju duket më i përshtatshëm, p.sh. boça pishe, lule të thara, fruta të thata, ëmbëlsira të vogla, figurina etj. Së bashku me dy fëmijë të grupit keni gjetur vendin ku do ta fshihni kutinë magjike</li> <li>• Më pas zgjidhen tre-katër fëmijë që nën ritmin e melodisë së valsit do të vallëzojnë dhe do të kërkojnë kutinë. Gjatë kësaj kohe fëmijët do të ndiejnë muzikën dhe do të patojnë rreth e rrotull.</li> </ul>	<p>CD player, CD me muzikë, letra të dekoruara për të bërë krahe fluturë, kuti këpucësh, boce pishe, lule të thara, fruta të thata, ëmbëlsira, figurina kafshësh etj</p>
<p><b>Matematika</b></p> <p><b>Konceptet</b> Numër: 1-3 Format: rreth, katror, trekëndësh</p>	<p>Në temën e stinëve mësuesja mund të shfrytëzojë sasinë dhe format e ndryshme të objekteve natyrore për të përsëritur numrat 1, 2 dhe 3, si dhe format rreth, katror dhe trekëndësh që shumica e fëmijëve njohin që nga grupi i parë.</p> <p>Përdorimi i fletëve të punës i ushtron fëmijët në njohjen e sasisë dhe formave, si dhe zgjidhjen e ushtrimeve të thjeshta. Mësuesja integron matematikën me artet duke përforcuar nëpërmjet kënaqësisë që jep zhvillimi artistik konceptet e numrit dhe formës.</p> <p>Llojet e ushtrimeve që mund të zhvillohen janë ndjekja e vijave, klasifikimi i formave me madhësi dhe ngjyra të ndryshme, ndërtimet konstruktive, gjetja sa objekte janë etj</p> <p>Të gjitha këto episode, duhen parë e trajtuar si hallka kyçe të procesit të të nxënit. Edhe përmes këtij procesi, fëmijët mund të zhvillojnë të kuptuarit e koncepteve matematikore si p.sh: vendos 4 kukullat tek rafti që ndodhet në të djathtë të dritares dhe 3 kubat e kuq vendosi tek tavolina e madhe e vizatimit. Gjithashtu, gjatë procesit që edukatorja thotë: Vendosini gjërat në vendet e tyre, aty ku i morët, fëmijët fillojnë të bashkëveprojnë me njëri – tjetrin,</p>	<p>Karta me numrat 1, 2 dhe 3 Petëza me format: rreth, katror dhe trekëndësh</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>të ndërveprojnë. Ky ndërveprim mund të fillojë si një zgjedhje e tyre, ose të ndikohet nga edukatorja, p.sh. Ana dhe Kevi të vendosin karriget në formë rrethore, ndërsa Deni, Era, Besa, Anisa dhe Toni do të mbledhin fletoret e vizatimit dhe lapsat me ngjyra e do t'i vendosin mbi raftin e kuq tek këndi poshtë. Në përfundim të aktivitetit është e rëndësishme që fëmijët t'ua tregojnë apo demonstrojnë atë çfarë kanë bërë fëmijëve të tjerë, edukatoreve apo prindërve të tyre.</p>	
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Të mësuarit për t'u fokusuar në lojërat e tyre, llojet e sporteve dhe llojshmërinë e sëmundjeve stinore</p>	<p>Tema e stinëve është shumë e lidhur me problemet e shëndetit dhe aktivitetet e ndryshme fizike. Mësuesja orienton fëmijët të përqendrohen tek lojërat apo sportet që ata zhvillojnë në natyrë gjatë pranverës, verës, vjeshtës dhe dimrit. Më poshtë keni disa çështje në të cilat mund të ndaleni gjatë bashkëbisedimit me fëmijët:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Cilat janë lojërat që zhvillonin në stinë të ndryshme?</li> <li>2. Cilat janë sportet që pëlqeni më shumë?</li> <li>3. Kur rrezikojmë të sëmuremi më shumë dhe pse?</li> </ol> <p>Ju mund të jepni mjaft informacion për sëmundjet e stinës si p.sh. gripi dhe të ftohurit gjatë dimrit apo dhimbjet e barkut gjatë verës. Po ashtu mund të flisni për efektet e qëndrimit në diell për një kohë të gjatë në pushimet e verës. Fletët e punës mund të plotësojnë bashkëbisedimin mbi temën e stinëve dhe zhvillimin fizik të fëmijëve.</p>	<p>Karta me lojëra dhe sporte të ndryshme, postera për shëndetin, fletë pune</p>
<p>Aftësimi i fëmijëve për t'u përballur me eksperiencat shëndetësore</p>	<p>Tregojuni fëmijëve se ndonjëherë për të pasur një shëndet të mirë, është e nevojshme që fëmijët të qëndrojnë të shtruar në spital ose të marrin ilaçe apo të bëjnë gjilpëra për një kohë të gjatë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxitini të tregojnë raste nga eksperiencia e tyre personale ose e të afërmeve, shokëve, motrave dhe vëllezërve të tyre, të cilët për arsye të ndryshme janë shtruar në spital.</li> <li>• Diskutoni me ta se ilaçet dhe gjilpërat, si dhe vizitat që xhaxhi doktorët dhe teta doktoreshat u bëjnë, kanë si qëllim përkujdesjen që ata të gëzojnë shëndet të mirë.</li> <li>• Për këtë arsye, fëmijëve mund t'u duhet të marrin pak gjak tek gishti ose tek krahu, të bëjnë gjilpëra, të pinë ilaçe, të vendosin termometrin për të matur temperaturën, të bëjnë operacione në pjesë të ndryshme të trupit, ose në disa</li> </ul>	<p>Disa lloje ilaçesh, termometër, gjilpëra me age, ankerplast, fasho, jodio etj.</p> <p>Postera të shërbimit dentar, farmaceutik, fletë palosje etj</p>


Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>situata të mbajnë të mbështjellë me fashë dhe të futur në allçi dorën ose këmbën për një periudhë të caktuar kohore etj. si këto.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregojuni atyre se është shumë e rëndësishme që të mos refuzojnë kryerjen e proceseve të lartpërmendura, por të jenë bashkëpunues me prindërit dhe personelin shëndetësor.</li> <li>• Diskutoni me ta se është normale që disa fëmijë mund të kenë frikë ndaj situatave të caktuara shëndetësore (vizita mjekësore, gjilpëra, analiza, analiza radiografike, vizita tek dentisti). Sepse këto procese përmbajnë shumë elementë të rinj, të pazakontë, të panjohur dhe ndonjëherë mund të shihen si të rrezikshme nga fëmijët.</li> <li>• Tregojini me shembuj se si mund të shmangët ankthi dhe tensioni i fëmijëve në këto situata</li> <li>• Flisni me ta për kujdesin që ata duhet të tregojnë edhe për dhëmbët e tyre, duke shkuar herë pas here tek dentisti.</li> <li>• Tregojini se fillimisht është normale që disa fëmijë mund ta kenë frikë dentistin, mjekun.</li> <li>• Nxitini fëmijët të flasin dhe tregojnë sa më shumë detaje rreth këtyre proceseve, dhe më pas përgatisni ndërhyrje komplekse për të shmangur frikën nga doktori, nga dentisti dhe përgatitjen e vizitave mjekësore</li> <li>• P.sh. Në kopsht mund të improvizohet një vizitë tek dentisti p.sh. ulja në poltronë, hapja e gojës, mbajtja e gojës hapur për disa minuta, imitimi i zhurmës së makinerisë etj. si këto</li> <li>• Shmangni përdorimin e shprehjeve të tilla si : “Po nuk u solle mirë do t’i them xhaxhi doktorit”. “Po nuk e hëngre ushqimin, do të bëj gjilpërën” etj. Përdorimi i këtyre shprehjeve bën që tek fëmijët të krijohen frika të kota, imagjinare dhe i pengon ata që ta shohin figurën e mjekut apo procesin e mjekimit si diçka që ndihmon për të pasur shëndet të mirë dhe jo si një lloj ndëshkimi. Kërkojuni dhe prindërve që t’i shmangin këto lloj presionesh apo ndëshkimesh në familje.</li> <li>• Bëjuni thirrje fëmijëve se nëse ndonjë prej prindërve apo të afërmëve të tyre është me profesion mjek, mund ta ftojnë në klasë për të parë dhe kuptuar se mjekët janë njerëz që i duan shumë fëmijët dhe që punojnë që ata të rriten të shëndetshëm.</li> </ul>	<p>Çanta mjekësore lodër me stetoskop, lugë, gjilpërë etj Libra që kanë të trajtuar këtë temë,</p>

# Shkruani nga 1 tek 3





## MBJELLJA E NJË PEME




A e dini si mbillet një pemë? Plotësoje vizatimin me dheun, ujin, diellin dhe farat.

## FLUTURA DHE LULJA




Ngjyrosni fluturën dhe lulen.  
Çfarë ngjyre kanë gjetet kur flutura vallëzon mbi to?

## BALONA E PRANVERËS



Vizatojeni dhe më pas bëni një balonë me ngjyra sipas këtij modeli dhe ngrijeni lart në qiell.

## LULJA



Ndiqni vizat dhe më pas ngjyroseni lulen.

## PLAZHI



A large empty rectangular box for drawing or writing.


A mund të bësh edhe ti plazhin tënd? Provoje!



Bisedoni me shokët dhe mësuesen tuaj për stinët e vitit.  
Tregoni çfarë bëni ju dhe familja juaj në secilën stinë.



## 6. MOLLA

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Hyrje</b></p>	<p><b>Farërat e mia</b>                      Bashkëbisedoni me fëmijët për rritjen zhvillimin e një peme molle, nga farërat deri te një frutë molle, tregojuni një mollë dhe le të mendojnë për numrin e farërave në të. Pastaj me kujdes prisni mollën dhe gjeni se sa janë në të vërtetë. Më pas prisni mollët në feta dhe fëmijët e provojnë dhe tregojnë për shijen e mirë të mollës. Në këtë mënyrë ju nuk i çoni dëm mollët që përdorët.</p>	<p>Kokrra molle, pjata</p>
<p><b>Sociale</b></p> <p><b>Konceptet</b>                      Shoqërizim,</p> <p>Ndihma ndaj njëri-tjetrit</p>	<p><b>Molla e kuqe</b>                      Një mollë e kuqe qëndronte lart në pemë.                      Unë e vështroja nga poshtë e ajo më vështronte nga lart gjithë bukuri.                      Unë e thirra zbrit poshtë të lutem, eja luajmë bashkë..                      dhe ajo zbriti gjithë hijeshi...                      drejt në kokën time ra dhe bëri a, a, a...</p> <p><b>Ekskursion në natyrë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gëzojmë natyrën e bukur</li> <li>• Ndihmojmë në punët e stinës</li> </ul> 	<p>Mollë,                      Karta me mollë të ngjyrave të ndryshme,                      Albume, revista dhe libra me foto të pemëve në natyrë etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p><b>Vizitë në një kopsht me mollë</b> Vizitoni një kopsht me dru frutor ose në pa mundësi një punishte të përpunimit të mollëve. Lërimi fëmijët të ndihmojnë në vjeljen e mollëve dhe në sistemimin e tyre nëpër kosha.</p> <p><b>Kek me mollë</b> Gjatë javës së mollës për të provuar shije të ndryshme bëni një kek me mollë. Ajo është e thjeshtë dhe e shijshme. Lërimi fëmijët të përdorin, bashkë me ju përbërësit dhe të shijojnë kënaqësinë e gatimit.</p>	
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Shprehëse dhe komunikuese</p> <p>Fjalë të kundërta</p>	<p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b> Librat për fëmijët parashkollorë lidhur me këtë tematikë që do t'ju ndihmojnë për t'i mësuar më mirë fëmijët.</p> <p><b>Shtëpia e kuqe rrumbullake -përrallë</b> Një djalë i vogël shkoi për të vizituar gjyshërit e tij në një vend jashtë Shqipërisë (<i>vendosni një shtet të cilin fëmijët e njohin nga tregimet e më të rriturve dhe në qoftë se keni një hartë në mjedisin tuaj tregojeni atë se ku ndodhet</i>). Por fëmija i vogël u mërzit shumë pasi në vendin ku shkoi (në atë vend) nuk kishte me kë të luante. Djaloshi i kërkoi gjyshes së tij se me kë të luante dhe çfarë të bënte.. Ajo i tha që të dilte jashtë dhe të gjente një shtëpi të rrumbullakët, me ngjyrë të kuqe e cila nuk ka as dyer as dritare, por ka një yll brenda saj. Djalit të vogël i pëlqeu ideja, por nuk kuptoi se çfarë duhet të gjente. Ai vendosi për të kërkuar ndihmë tek fermeri, fqinji i tij, i cili dukej mjaft i zgjuar. Më pas pyeti edhe një fermerin tjetër, por edhe ai nuk mund ta kuptonte atë që po i thoshte, por ai e drejtoi duke treguar: “Shiko atë peme molle para oborrit tim, shko ulu nën atë dhe mendo, se më pas shumë ide kanë për të ardhur nën një pemë molle. Kështu djali shkon e ulet poshtë pemës dhe më pas e zë gjumi. Fillon të fryjë erë e fortë, viu-viu dhe djali zgjohet papritur. Pema filloi të lëkundej dhe një kokërr molle ra nga pema pranë djaloshit. Djali mori mollën në dorë e vështronte atë dhe papritmas u kujtua se ajo ishte një mollë e rrumbullakët, e kuqe, nuk kishte as dritare as dyer, por a do kishte një yll brenda?</p>	<p>Foto, pamje të ndryshme për të ilustruar përrallën, karta me figurat e mollës, albume dhe libra mbi këtë temë</p>



Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Ai vrapoi për tek gjyshja dhe i kërkoi asaj që t'ia priste më dysh për të parë a kishte brenda një yll dhe pa dyshim, brenda në mollë kishte një yll (në këtë moment prisni një mollë përgjysmë tërthorazi dhe tregoni “yllin” brenda saj).</p> <p><b>Shijoni mollë të ndryshme</b> Lërimi fëmijët të lirë për të provuar shijet e mollëve të ndryshme. Më pas bëni një grafik duke shkruar përgjigjet e fëmijëve. Përdorni fjalë të thjeshta me shkronja kapitale, si e ëmbël, e thartë, e butë, e fortë etj. Gjatë shkrimit përdorni dy ngjyra të ndryshme për fjalët e kundërta.</p> <p><b>Lëng apo pelte molle?</b> Jepuni fëmijëve për të provuar lëng molle dhe pelte (të grirë në rende). Lërimi ata të dallojnë ndryshimin e lëngut nga peltja. Më pas pyesni çdo fëmijë se cila shije ishte më e mirë dhe bëni një grafik me dy kolona në njërin “lëng molle” dhe në tjetrin “pelte molle” duke renditur emrat e secilit fëmijë me shijet përkatëse. Fëmijët familjarizohen edhe më shumë me emrat e tyre dhe të shokëve e shoqeve.</p> <p><b>Vjershë për mollën</b> Trungu i mollës Kuqëlon Kokrra mbushur, seç na fton:  “Jam rënduar, S’po më shihni Faqekuqet Shpejt i vilni!”  Rrjedh në vjersha Lëngu i mollës Stina e vjeshtës Zilja e shkollës</p>	
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p>	<p>Përfshin veprimtari ekstra që përshtaten me kategoritë e tjera, duke i integruar në kohën gjatë ngrënies, udhëtimeve në terren dhe të tjera.</p> <p><b>Kapja e mollës</b> Kjo lojë është mjaft e pëlqyeshme për fëmijët.</p>	<p>Postera për vlerat e mollës, Karta me figura mollësh etj</p>


Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Aftësitë</b> koordinim lëvizjesh sy-vesh- dorë</p> <p>Forcim i lëvizjeve motore fine</p>	<p>Vendosni mollë të vogla në një shportë dhe lëri fëmijët të përpiqen për t'i marrë ato me gojët e tyre. Këshillë: Përdorni mollë të vogla ose mollë me feta për fëmijë më të vegjël, sepse gojët e tyre nuk mund të kafshojnë një mollë të plotë.</p> <p><b>Paso mollën</b> Fëmijët vendosen në formë rrethi ulur ose në këmbë. Loja fillon menjëherë sa dëgjojnë muzikën, ndërkohë fëmijët pasojnë mollën tek njëri-tjetri deri sa muzika pushon. Në momentin e ndalimit të muzikës, ai ose ajo fëmijë që ka mollën në dorë e dërgon atë në qendër të rrethit ku është vendosur një kosh.</p> <p><b>Mollë prej plasteline</b> Fëmijët përdorin plastelinë të kuqe ose të gjelbër për të bërë një ose disa mollë. Më pas i vendosin në këndin e artit për t'i tharë dhe me to përdorin në matematikë për të numëruar se sa mollë ka bërë secili fëmijë.</p> <p><b>Molla e stampuar</b> Pritini një mollë në gjysmë. Bëni një prerje tërthore duke ndarë pjesën e sipërme nga e poshtme për të nxjerrë në pah “yllin që është në mes”. Vendosni bojë të gjelbër ose bojë të kuqe në një enë të cekët, zhyteni mollën në bojë dhe më pas stampojeni mbi një copë letër duke krijuar një mollë të stampuar.</p> <p><b>Pema e mollës</b> Jepuni çdo fëmijë një formë peme dhe një stampë në formën e mollës, bojëra të kuqe, jeshile, ose të verdhë, kujdes mos të jenë toksike. Fëmijët vendosin “mollë” mbi pemë me ndihmën e stampuesit, ngjisin dhe giethe në pemë po të jenë reale aq më mirë. Pas përfundimit të punimit pyesni fëmijët se “<b>sa kokrra molle</b>” kanë vendosur në pemën e tyre.</p> <p><b>Ngjyrosje e mollës</b> Prisni forma molle nga një letër e bardhë dhe shtoni në të ca njolla të kuqe; më pas lëri fëmijët të vazhdojnë ngjyrosjen me bojë të kuqe të mollës.</p>	<p>Mollë, thikë, pjata</p> <p>Baltë, plastelinë, stampa molle etj</p> <p>Letra me ngjyrë, lapsa, bojëra të ndryshme, forma molle etj</p> <p>Fara mollësh, pemë plastike, kokrra molle plastike etj.</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p><b>Kolazh me fara mollësh</b> Ruani farat e mollës në një letër (zarf). Lërimi ato të thahen dhe pasi keni grumbulluar shumë, jepuni fëmijëve ngjitës për të bërë kolazhin në një copë letër sipas fantazisë së tyre.</p>	
<p><b>Matematikë</b></p> <p><b>Konceptet dhe aftësitë</b></p> <p>Numrat nga 1 deri në 5</p> <p>Numërim në zbritje nga 5 deri në 1</p>	<p>Mënyra më e mirë për të mësuar fëmijët, është kur ajo realizohet në një mënyrë interesante dhe argëtuese dhe më së miri kjo gjë realizohet në parashkollor nëpërmjet lojërave nxitëse dhe emocionuese.</p> <p><b>Pesë mollë të kuqe</b> Mundësisht shoqëroheni me muzikë në sfond ose përshtatni një melodi të njohur për fëmijët. Pasi e keni kënduar më parë vetë, ushtrohni bashkë me fëmijët disa herë. Do të shikoni që fëmijët do të argëtohen shumë duke kënduar dhe numëruar.</p> <p><b>Pesë</b> mollë të kuqe janë në një pemë (mbani pesë gishta lart) filloi të fryjë erë dhe mollët u lëkundën (valëvitje gishta në rënie) Dhe molla më e vogël u rrëzua në tokë (ulet një gisht)</p> <p><b>Katër</b> mollë të kuqe janë në një pemë (mbani katër gishta lart) filloi të fryjë një erë dhe mollët u lëkundën (valëvitje gishtash në rënie) Dhe një mollë e tjetër u rrëzua në tokë (ulet një gisht)</p> <p><b>Tre</b> mollë të kuqe, janë në një pemë (mbani tre gishta lart) filloi të fryjë erë dhe mollët u lëkundën (valëvitje gishtash në rënie) Dhe akoma një mollë tjetër u rrëzua në tokë (ulet një gisht)</p> <p><b>Dy</b> mollë të kuqe, janë në një pemë (mbani dy gishta lart) filloi të fryjë erë dhe mollët u lëkundën (valëvitje gishtash në rënie) Oh edhe një mollë tjetër u rrëzua në tokë (ulet një gisht)</p> <p><b>Një</b> mollë e kuqe, është në një pemë (mbani një gisht lart) filloi të fryjë erë dhe molla u lëkund (valëvitje gishti në rënie) Dhe molla e fundit u rrëzua në tokë (ulet gishti i fundit) Nuk ka më mollë të kuqe, në pemë, (dora me të gjitha gishtat poshtë).</p>	<p>Mollë me ngjyra të ndryshme, karta me figura mollësh, prerje gjysma, çerek etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p>Krahasimi i njëjtë me..</p> <p>i ngjashëm me..</p> <p>Numërim</p> <p>Grupim</p> <p>Renditje I madh I vogël</p>	<p><b>Mollë të njëjta</b> Vendosni në qendër të tavolinës mollë me ngjyrë të gjelbër, të verdhë dhe të kuqe, ndërsa në një kosh vendosni mollët korresponduese si të kuqe, të gjelbër dhe të verdhë. Fëmijët do të bashkojnë mollët njëjta sipas ngjyrës, dy të kuqe, dy të verdha, dy të gjelbra.</p> <p><b>Në kërkim të mollës</b> Të gjithë fëmijët mbyllin sytë e tyre gjatë kohës që ju “fshihni” një mollë në dhomë. (Mos kërkoni vende të vështira, mollën vendoseni në një vend të thjeshtë). I udhëzoni fëmijët të gjejnë mollën, por pa e prekur atë. Më pas, ai që gjen mollën, shkon dhe e fsheh përsëri në një vend tjetër. E kështu me radhë.</p> <p><b>Numërimi i mollëve</b> Prisni 10 mollë prej letre me gërshërë dhe i numëroni nga 1-10. Kërkojuni fëmijëve që t’i rreshtojnë ato përsëri si ju nga 1-10.</p> <p><b>Mollë me ngjyra</b> Kërkojuni fëmijëve të grupojnë mollët sipas ngjyrës.</p> <p><b>Renditja e mollëve</b> Kërkojuni fëmijëve të rendisin mollët sipas madhësisë.</p>	
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Konceptet</b> E kuqe E verdhë E gjelbër</p>	<p>Fusha e arteve përmban shumë veprimtari të preferuara, më shumë se çdo gjë tjetër në parashkollor, si edhe projekte të mrekullueshme për të argëtuar fëmijët tuaj.</p> <p><b>Pema e mollës në dorën time</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Së pari pikturoni dorën e fëmijës në ngjyrë kafe dhe stampojeni sipër një letre për të bërë trungun e pemës.</li> <li>• Pastaj jepuni fëmijëve bojë jeshile, të kuqe, të verdhë si dhe materiale të tjera sipas dëshirës së tyre.</li> <li>• Lërin fëmijët për të krijuar pemën e tyre me mollë duke e zbukuruar sipas fantazisë së tyre</li> </ul> <p><b>Molla prej qelqi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Jepuni fëmijëve letra transparente, gazeta të prera në formën e mollës si dhe ngjitës.</li> <li>• Pastaj lërin fëmijët të bëjnë vetë mollën e tyre prej qelqi.</li> </ul>	<p>Bojë, letër, materiale të tjera shtesë sipas mundësive dhe dëshirës së fëmijëve.</p> <p>Letër transparente ose letër kalku, gazeta; Ngjitës Vinovil Letra me ngjyra; Gjethë të thara; Kallama, pipa; Fije të ndryshme. Bojë</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lërimi ata të jenë krijues aq sa munden</li> <li>• Disa do të bëjnë mollë me ngjyrë të ndryshme si dhe shumë krimba në to (krimba në formë fijesh), ndërsa të tjerët do të bëjnë një mollë të kuqe të thjeshtë.</li> <li>• Pasi ato janë tharë varini mollët në dritare për të bërë një kolazh të bukur me mollët e të gjithëve.</li> </ul> <p><b>Korniza në formë molle</b> Jepuni fëmijëve korniza në forma mollësh dhe lërimi t'i zbukurojnë sipas dëshirës së tyre, ndihmojini për të vendosur fotografinë e tyre në mes të kornizës. Më pas bashkoni të gjitha kornizat me foto në një flipçart të madh duke bërë një kolazh të madh në formë molle.</p> <p><b>Gjysma e mollës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prisni një formë molle në letër, më pas vetëm gjysmën e saj dhe lërimi fëmijët të bëjnë pjesën tjetër.</li> </ul>	<p>Gjysma mollësh (mollët e prera në gjysmë)</p> <p>Letër flipçart në formë poster</p>
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p> <p><b>Konceptet</b> Molla si frutë Pema e mollës Farat etj.</p> <p><b>Aftësitë</b> Vëzhgimi, Kujdesi për pemët frutore Klasifikimi</p>	<p>Fusha jep mundësi për <b>veprimtari</b> të ndryshme mësimore për fëmijët: se si ata të mësojnë rreth shkencës në mënyrë sa më argëtuese</p> <p><b>Sa kokrra molle i gjatë jam unë?</b> Në dysheme vendosni disa kokrra mollë dhe fëmijët masin gjatësinë e tyre me kokrrat e mollës.</p> <p><b>Anketa e mollës</b> Sillni në kopsht mollë të llojeve të ndryshme dhe vetë fëmijët klasifikojnë mollët sipas udhëzimeve. Me ndihmën e fëmijëve më të rritur bëjnë klasifikimin në mollë të mira dhe mollë të dëmtuara.</p> <p><b>Numërimi i mollëve</b> Vizatoni tri pemë molle dhe disa mollë prej letre. Vendosni një numër në çdo pemë dhe vërimi fëmijët të vendosin mollë aq sa tregon numri pemës.</p> <p><b>Një krimb në mollë</b> Kjo veprimtari është shumë argëtuese për fëmijët dhe ka sukses. Prisni nga një forme molle për çdo fëmijë. Bëni rreth 4 vrima në mollë. Ata do kalojnë një fije kafe nëpër vrima.</p>	

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p><b>Çfarë gatuhet me mollë?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kek me mollë</li> <li>• Lëng molle</li> <li>• Komposto molle</li> <li>• Reçel molle</li> <li>• Gliko molle</li> <li>• Prevede molle</li> <li>• Mollë me kanellë</li> <li>• Mollë e tharë</li> <li>• Ëmbëlsirë</li> <li>• Byrek me mollë</li> <li>• Strudel me mollë</li> <li>• Mollë e pjekur</li> <li>• Mollë e sheqerosur</li> <li>• Mollë e zhytur në çokollatë etj.</li> </ul> <p>Ftoni një ditë familjarët në kopsht për të bërë disa gatime me mollë bashkë me fëmijët e tyre.</p> <p><b>Sallatë frutash</b> Ndhmoni fëmijët në procesin e larjes dhe pastrimit qërimt, prerjes së frutave (gjithmonë duke pasur edhe ndihmës të tjerë të rritur). Vendosni çdo frutë në tasa të veçantë, dhe kërkojuni fëmijëve të flasin për emrin dhe ngjyrën e secilës frutë që kanë në tavolinë. Çdo fëmijë ka një pjatë të vogël dhe një lugë. Pyetini se çfarë frutash ata do të donin në tasin e tyre për të bërë sallatë frutash. Pasi fëmijët janë ulur nëpër vendet e tyre në tavolinë, në formë rrethi, pyetini ata, “Kush ka mollë në tasin e tij?”, “Kush ka luleshtrydhe?” dhe kështu me radhë.</p> <p><b>Molla e pjekur</b> Lani dhe gërryeni mollën nga brenda. Mbusheni me sheqer, plotësojeni me rrush të thatë, arra. Vendoseni drejt e në furrë. Piqet për 60 minuta në 250 gradë. Sipas dëshirës shërbehët edhe me akullore.</p> <p><b>Ylberi dhe ngjyrat e natyrës</b> Frutat dhe perimet kanë ngjyrat e ylberit, ato fillojnë me të kuqe, të gjelbër, portokall dhe të verdhë. Këto ngjyra realizohen nga përbërësit natyral që gjenden brenda frutave dhe perimeve. Këta përbërës natyral iu japin frutave dhe perimeve vetitë e shëndetshme për organizmin tonë. Përpikuni të provoni sa “ngjyra të shëndetshme” mund të hani çdo ditë, të paktën pesë ngjyra të</p>	<p>Sallatë frutash 1 mollë, 1 portokall, 1 banane, 1 filxhan me luleshtrydhe 1 pjeshkë 1 dardha etj.</p> <p>Mollë për çdo fëmijë Sheqer Rrush të thatë Arra Kanellë etj.</p>


Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>ndryshme në ditë. Më pas jepuni fëmijëve të ngjyrosin fletën e punës dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin se sa “ngjyra” në ditë kanë provuar.</p>  <p>Ngjyros ylberin si frutat</p>	
<p><b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b></p>	<p><b>Teknika për të punuar me fëmijë që hasin pengesa në mësim nxënie</b>  Mësueset duhet të hartojnë plane edukative individuale për fëmijët, të cilët e kanë të vështirë të asimilojnë programin mësimor, për arsye të ndryshme. Ky plan duhet të jetë në gjendje të përmbushë të gjitha nevojat e fëmijës, duke ofruar një përmbajtje dhe metodë që janë në dukje të ndryshëm nga plani i kurrikulës së përgjithshme dhe që realizohet me ndihmën e bashkëpunimit të prindërve dhe të komunitetit shkollor.</p> <p>Ndihmojini këta fëmijë përmes mënyrës <b>Verbale</b>. Çdo gjë që thuhet dhe që ndihmon fëmijën të arrijë të bëjë atë që i është kërkuar, p.sh. dhënia e udhëzimeve verbale për të ngjyrosur ylberin, në aktivitetin më sipër si frutat, duke shqiptuar shkronjën apo tingullin e parë apo dhe të dytë të frutës që fëmija do zgjedhë etj. sjell përqendrim të këta fëmijë për të përparuar sado minimalisht.</p> <p><b>Modelimi dhe demonstrimi,</b>  Mësuesja i demonstroi fëmijës veprimin e duhur, që ai duke e imituar të arrijë atë që i është kërkuar. Kjo është veçanërisht e dobishme kur fëmija e ka të vështirë të marrë instruksione verbale.</p> <p><b>Vizuale,</b> Kjo përfshin çdo sinjal viziv që i jepet fëmijës dhe që e ndihmon të bëjë atë që i kërkohet, p.sh. duke drejtuar gishtin tek vizatimi i ylberit dhe tek ngjyrat. Duhet bërë shumë kujdes me sugjerimet që mësueset japin përmes lëvizjeve me sy.</p> <p><b>Fizike.</b> Kjo ka të bëjë me çdo gjë që bëhet fizikisht dhe që nxit reagimin e fëmijës, p.sh. të mbajturit e dorës së fëmijës për të ngjyrosur brenda kontureve të ylberit</p>	<p>Karta me figura, fletë vizatimi, fruta të stinës etj</p>

## FLETË PUNE


Përfshin ngjyrosje faqesh me formate të ndryshme për këtë tematikë duke i mundësuar çdo fëmije punën me to. Ju mund t'i fotokopjoni në mënyrë që të gjithë fëmijët të kënaqen me krijimtarinë e tyre.













Ngjyrosni figurat e mësipërme:

1. E verdhë
2. Blu
3. E gjelbër
4. E kuqe
5. Portokalli



Ngjyrosni qepën, fasulen dhe karotën. Cilat janë ngjyrat e tyre?



A i njihni frutat dhe perimet në figurë? Ngjyrosini!



Ngjyros ylberin si frutat.



## 7. I MADH DHE I VOGËL

Fushat	Udhëzime	Materialet
<b>Hyrje</b>	<b>Dorë e madhe, dorë e vogël</b> Ndhmoni fëmijët të dallojnë ndryshimin ndërmjet i vogël dhe i madh. Vërinë ata të stampojnë dorën e tyre në një copë letër. Më pas ju (ose një fëmijë me dorë më të madhe se të tjerët) të stampojë dorën e vet pranë duarve të fëmijëve dhe në fund ta ngjyrosin dhe të shohin ndryshimet.	Letër Zamkë Letër me shkëlqim Mjete të ndryshme sipas zgjedhjes suaj.
<b>Sociale</b>  <b>Konceptet dhe aftësitë:</b> Shtëpitë e qytetit Shtëpitë e fshatit Kujdesi për banesën	Disa njerëz jetojnë .... Disa njerëz jetojnë në shtëpi të mëdha dhe disa jetojnë shtëpi të vogla. Pallate, vila, shtëpi qyteti shtëpi fshati .... Mësuesja mund të drejtojë vëmendjen e fëmijëve në historikun e shtëpive të banimit duke i njohur ata me njeriun e lashtë që jetonte nëpër shpella dhe deri tek njeriu i sotëm që jeton në pallate shumëkatëshe. Ajo e orienton bisedën e saj në disa çështje kryesore: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilat janë dallimet midis shtëpive të ndërtuara në qytet dhe atyre në fshat?</li> <li>• Si kujdesen familjet për shtëpitë brenda?</li> <li>• Si kujdesen njerëzit për mjediset jashtë pallatit apo shtëpisë ?</li> <li>• Pse janë të ndryshme shtëpitë e disa njerëzve që banojnë në vende të ngrohta nga të atyre që banojnë në vende të ftohta?</li> <li>• Përse shtëpia është një vend shumë i rëndësishëm dhe duhet të jetë e madhe? Cilat janë mjediset brenda saj?</li> <li>• A ka njerëz që nuk kanë shtëpi dhe jetojnë në rrugë, poshtë urave dhe pemëve? Pse?</li> </ul> Mësuesja mund të përdorë edhe ndonjë vjershë në përshtatje me moshën për të orientuar fëmijët drejt kujdesit që duhet treguar për mjediset brenda dhe jashtë shtëpisë Një shembull	Fotografi Revista me modele shtëpish



Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p><b>Artani dhe fidani</b>  Dje në rrugë  Një fëmijë  Që e ka emrin Artan  E përkuli dhe e shkuli  Kot së koti një fidan</p> <p>Po kur shkuam  E qortuam:  “more Tani, ç'bën kështu?”  U përgjigj si pa të keq:  “Pse roje jeni ju?”</p> <p>Sa keq ti,  Nuk e di,  se te ne, kudo mbarë  Për të mbrojtur shtëpitë  Janë të gjithë rojtarë”</p> <p>Ne u mblodhëm  Dhe e mbollëm  Shpejt fidanin përsëri  Gjyshe Nomi nga ballkoni  Buzëqesh me dashuri</p> <p>Në mëngjes me kujdes  A e dini ç'pamë ne?  Erdh Artani te fidani  Për të sjellë një vazo pleh</p>	<p>Libra dhe revista  me vjersha dhe  tregime rreth temës,  ilustrime me figura  dhe vizatime, fletë  pune etj</p>
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p><b>Aftësitë</b>  Komunikimi,  interpretimi, loja  me role</p>	<p>Përfshihen të gjitha këngët më të preferuara nga fëmijët që lidhen me këtë tematikë.</p> <p><b>Fara e mollës</b>  Një farë molle u fut brenda në tokë dhe shiu e zhyti thellë e më thellë. Më pas dielli ndriçoi dhe ngrohu tokën përreth. Dhe fara e vogël pak nga pak na u rrit dhe u bë një pemë e madhe mbushur me mollë plot.</p> <p>Librat për fëmijët parashkollorë lidhur me këtë tematikë do t'ju ndihmojnë për të ngulitur më mirë te fëmijët aftësitë e të treguarit dhe të ilustruarit me figura të ngjarjeve dhe historive të ndryshme.</p>	<p>Libra me tregime dhe përralla  Albumë me foto të fëmijëve kur ishin më të vegjël  Vizatime dhe piktura</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p> <p><b>Aftësitë</b> e kujdesit për shëndetin</p>	<p>Mësuesja ka mundësi të shumta të japë shembuj nga jeta e përditshme mbi zhvillimin fizik të njerëzve dhe kafshëve duke përdorur termat e madh dhe të vogël.</p> <p>Ajo mund të përdorë krahasimet se çfarë është në gjendje të bëjë një fëmijë i vogël dhe një tjetër i madh, ku janë dallimet fizike, si është shëndeti i tyre etj</p> <p>Bashkëbisedimi mund të fokusohet në temat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Si e mbrojmë shëndetin kur jemi të vegjël?</li> <li>• Si kujdesen prindërit për shëndetin tonë?</li> <li>• Po mësueset në kopsht?</li> <li>• Përse u shërben të vegjëlve kujdesi i të rriturve?</li> </ul> <p>Tregojini grupit tuaj se disa fëmijë kanë nevojë gjithmonë për kujdesin e më të rriturve, se ata e kanë të vështirë të ecin pa ndihmën e tyre, të shkojnë në kopsht, të shkojnë në tualet, të ushqehen, të lahen, të kujdesen për veten etj. si këto.</p> <p>Kërkoju fëmijëve të sjellin shembuj nga jeta familjare apo shoqërore, ku ata ose të afërm të tyre kanë pasur nevojë për ndihmën e të tjerëve për të realizuar një proces apo detyrë.</p>	<p>Postera për rritjen dhe zhvillimin e njeriut nga vegjelia në moshë të rritur, mjedise lojërash fizike që nxisin zgjatjen e trupit dhe forcim të muskujve etj</p>
<p><b>Matematikë</b></p> <p><b>Konceptet :</b> i madh i vogël Renditje Grupim Krahasim</p>	<p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b> Mësuesja përpiqet të mësojë fëmijët në një mënyrë interesante dhe argëtuese dhe kjo gjë realizohet më së miri në parashkollor nëpërmjet lojërave nxitëse dhe emocionuese.</p> <p><b>Forma me madhësi të ndryshme</b> Prisni forma në madhësi të ndryshme dhe lërin fëmijët t'i ngjisin në një letër apo karton format, duke i renditur nga më i vogli tek më i madhi.</p> <p><b>Gjatësia jonë</b> Masni gjatësinë e fëmijëve mbi një shkop druri ose në murin e klasës. Bëni një grafik të fëmijëve me emrat përkatës nga më i vogli tek më i madhi dhe pastaj bisedoni me ata rreth gjatësisë së tyre kush është më i gjatë dhe kush është më i shkurtër. Grafikun mund ta bëni edhe me sende të tjera sipas mjeteve rrethore që dispononi.</p> <p><b>Loja e komçave-</b> krahasimi i komçave Vendosni komça me madhësi të ndryshme dhe renditini nga më e madhja te më e vogla; lërin</p>	<p>Metër Objekte me madhësi të ndryshme Letër Lapsa me ngjyra komça</p>




Fushat	Udhëzime	Materialet
	fëmijët t'i rendisin sipas modelit tuaj. Më pas vëri t'i rendisin sipas numrit të vrimave që ato kanë: me një vrimë, me dy, me tre dhe me katër. Në qendër të tavolinës vendosni një grumbull të madh me komça me numër të ndryshëm vrimash dhe i kërkoni fëmijëve t'i grupojnë në katër grupe sipas numrit të vrimave.	
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Konceptet</b>                      Dallimi i ngjyrave,                      I përmasave dhe i                      formave</p> <p>Vizatim dhe punë                      dore</p>	<p>Artet japin mundësi për shumë veprimtari të                      preferuara, si edhe projekte të mrekullueshme për                      të argëtuar fëmijët tuaj.</p> <p>Fletët e punës së programuara për t'u ngjyrosur                      kanë në përmbajtjen e tyre figura kafshësh nëna dhe                      bebe, njerëzish të rritur dhe të vegjël, objektsh të                      mëdha dhe të vogla</p> <p><b>Përmasat e arushit</b>                      Prisni një arushë në madhësi të ndryshme dhe lëri                      fëmijët të krahasojnë madhësitë nga më i madhi te                      më i vogli si dhe të përdorin ngjyra të ndryshme për                      t'i ngjyrosur ata.</p> <p><b>Punë me baltë ose plastelinë</b>                      Vendosni shabllonë të ndryshëm makinash të                      madhësive nga më e vogla deri tek më e madhja dhe                      krahasojini punimet e fëmijëve me baltë. Kë do të                      hipin në këto makina?</p>	Letër të bardhë, me ngjyra, lapsa me ngjyra, bojëra të ndryshme, shabllonë të mëdhenj dhe të vegjël shtëpish, makinash etj Baltë dhe plastelinë etj
<p><b>Shkencë dhe                      vëzhgim</b></p> <p><b>Aftësitë</b>                      Vëzhgime,                      Matje dhe                      krahasime, analizë,                      përfundime.</p>	<p>Shkenca ofron <b>veprimtari</b> të ndryshme mësimore                      për fëmijët se si ata të mësojnë rreth përmasave në                      mënyrë sa më argëtuese.</p> <p><b>Matja e këmbës</b>                      Masni këmbët e të gjithë fëmijëve të klasës. Stamponi                      gjurmët e tyre dhe vendosini në mënyrë të tillë nga                      më i madhi te i vogli dhe anasjelltas.</p> <p><b>Fara e vogël e bimëve</b>                      Bisedoni me fëmijët tuaj se si një farë e vogël bëhet                      një pemë e madhe. Pastaj tregojuni atyre disa bimë                      dhe pemë të cilat ndodhen në mjedisin përreth                      godinës për të parë se si një farë është shndërruar                      në një pemë të madhe. Gjithashtu në kopsht mbillni                      fara lulesh dhe kujdesuni bashkë me fëmijët për                      rritjen e tyre.</p>	Albume me kafshë dhe bimë të vogla dhe të mëdha Metër Koleksione farash Gjethe pemësh

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p><b>Enciklopedia</b> Përmban informacion të gjerë për të mësuar në lidhje me temën dhe se si tu a transmetoni këtë informacion fëmijëve.</p> <p><b>Gjërat që janë të mëdha</b> Elefantët Hipopotami Balena Ndërtesat Makinat Prindërit Mësuesit</p> <p><b>Gjërat që janë të vogla</b> Bebet Fluturat Milingonat Xixëllonjat Kokoshka</p>	
<p><b>Konceptet</b> Ndryshueshmëri Njëllojshmëri</p>	<p>Tregojini atyre se disa fëmijë mund të zhvillohen ndryshe nga fëmijët e tjerë, p.sh. disa fëmijë që kur lindin dhe derisa rriten janë më të shkurtër ose më të gjatë se të tjerët, disa mund të ecin me vështirësi etj</p> <p>Kërkojini të sjellin figura, foto njerëzish ose kafshësh që janë dukshëm më të mëdhenj ose më të vegjël, më të gjatë ose më të shkurtër, më të hollë ose më të trashë dhe diskutoni me ta mbi ndryshimet që i shoqërojnë.</p>	



Rretho të vegjlit! Ngjyros të mëdhenjtë!



Rretho të vegjlit! Ngjyros të mëdhenjtë!

## 8.TË NJOHIM NUMRAT DUKE NUMËRUAR

Fushat	Udhëzime	Materialet
<b>Hyrje</b>	Në çdo kopsht apo program të edukimit parashkollor përfshihen ide dhe aktivitete që nxisin numërimin dhe aftësitë dëgjuese. Njohja e numrave theksohet mjaft te lojërat e ndryshme të fëmijëve duke filluar nga dominotë, letra e deri te ato lojëra që nxisin zhvillimin motor të gjerë kur mësuesja apo instruktori i edukimit fizik numëron për të nisur vrapin, për të kërcyer së gjati apo për t'u bërë gati për zhvillimin e një aktiviteti në periudhat transitore.	Karta me numra, objekte me forma të ndryshme, si p.sh. një tren me vagonë, disa makina, petëza, libra me numra dhe figura të tjera
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p> <p>Zhvillimi i aftësive perceptuese</p> <p>Të vepruarit konkret për :</p> <p>Përdorimin në mënyrë krijuese të objekteve të ndryshme në ndërtime</p> <p>Zhvillimin e aftësive për të projektuar dhe realizuar një koleksion shkencor të thjeshtë</p>	<p>Veprimtaritë që po ju paraqesim, synojnë që t'i përgatisin fëmijët me aftësitë vëzhguese të nevojshme për të eksploruar botën nëpërmjet koncepteve të sasisë dhe numrit. Në jetën e përditshme fëmijët ndeshen shpesh me numrin: Kam një mace, dy makina të kuqe, tri qershi etj. Është shumë e rëndësishme të stimulohet dhe të nxitet interesi i fëmijëve nëpërmjet materialeve të shumta si dhe përdorimit të tyre për të formuar konceptin e numrit dhe të sasisë.</p> <p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b></p> <p>Nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme mësuesja i jep mundësi fëmijës të perceptojë dhe të veprojë me sasinë dhe numrin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Fëmijëve u vihen në dispozicion konstruksione të ndryshme për të ndërtuar një urë, për të bërë një tren me disa vagonë, për të bërë një lule me disa petale etj.</li> <li>Mësuesja u ofron fëmijëve përdorimin e numrit për të nxitur veprime të ndryshme të tyre. Sa blloqe konstruksioni duhen për të ndërtuar hekurudhën? Po treni sa vagonë duhet të ketë? Në këto veprimtari përdoren blloqe të madhësive dhe formave të ndryshme. Mësuesja u ofron fëmijëve objekte me cilësi të ndryshme duke filluar nga druri e deri te plastiket. Më pas ajo ndihmon për të bërë klasifikimin e llojeve të ndryshme të materialeve dhe u kërkon fëmijëve të numërojnë sesa i përket një lloji dhe sa një tjetri. Më poshtë jepet një shembull se si fëmijët mund të fokusohen te numri</li> <li>Në tavolinën e punës për çdo grup 3-4 fëmijësh vendosni jo më shumë se katër objekte të</li> </ul>	<p>Objekte të ndryshme dhe me cilësi të ndryshme: natyrale-gjethë-boça pishe, guaska-gurë, blloqe druri-copëza tekstili, shishe plastike apo qelqi etj</p> <p>Lodra konstruktive, gërshërë, makina të vogla, etiketa, lodra të vogla, monedha, gurë,</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>përbërjeve të ndryshme, p.sh. blloqe druri, pjesë plastike, copa tekstili, lodra xhami apo metali. Kërkojuni fëmijëve t'i klasifikojnë dhe të tregojnë disa cilësi të tyre: është i fortë dhe i pathyeshëm, pritët me gërshërë ose jo, digjet ose jo etj. Më pas ndihmoni fëmijët të tregojnë se ku përdoren këto lëndë që ndryshojnë nga njëri-tjetri: druri-shtëpi, tekstili-veshje, metalishinat e hekurudhës, plastika- makinat apo petëzat, qelqi- shishja e qumështit etj</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitetet tjetër që mbart elemente të eksperimentimit është prova që bëjnë fëmijët me këto objekte duke i zhytur në ujë ose duke i mbushur me rërë apo me ujë, gjithashtu.</li> <li>• Fëmijët orientohen të bëjnë koleksione të ndryshme: p.sh. duke grumbulluar boce pisha, guaska, gurë, makina të vogla, të ngjisin lloje të ndryshme tekstili në një copë kartoni etj. Prindërit përfshihen shpesh me dëshirë në këtë lloj aktiviteti pasi secili kujton nga fëmijëria e tij dëshirën dhe hobin që ka pasur për të mbledhur etiketa, lodra të vogla, monedha, gurë, guaska etj. Ata mund të përdorin shëtitjet që bëjnë me fëmijët e tyre pikërisht në funksion të idesë së koleksionit.</li> </ul>	
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p>Të fokusojë vëmendjen e fëmijëve te kartat apo librat që kanë në figurat e tyre numra apo personazhe në sasi lehtësisht të identifikueshme për moshën</p> <p>Të pasurohet fjalori i fëmijëve me emërtimet e ndryshme të numrave</p>	<p>Mësuesja përzgjedh një përrallë, tregim apo vjershë ku numrat janë të pranishëm. Më poshtë po japim një tregim të shkurtër, por mësuesja mund të tregojë dy ose tre versione të ndryshme përrallash ose tregimesh.</p> <p><b>Historia e lapsave me ngjyrë</b></p> <p>Diku në një pyll të mbushur me pisha dhe pemë të tjera jetonin pesë lapsa vëllezër : i kaltri, i gjelbri, kafi, i verdhi dhe i kuqi. Ata punonin gjithnjë së bashku dhe ndiheshin shumë të lumtur:</p> <p>I kaltri ngjyoste qiellin dhe detin, i verdhi diellin, hënën dhe yjet, kafi tokën dhe trungjet e pemëve, i gjelbri pyjet, kodrat dhe të gjithë natyrën kurse i kuqi ngjyoste veshjet e fëmijëve, tullumbacet, balonat, flamujt e festave dhe lulet.</p> <p>Ata luanin shpesh me njëri-tjetrin, sidomos në pranverë, kur rrezet e diellit janë më të ngrohta dhe toka mbulohet nga një qilim i gjelbër. Qielli është më i kthjellët se në stinët e tjera, dielli fillon të pëshpëritë</p>	<p>Letër të bardhë, lapsa me ngjyra, ilustrime të përrallave, ngjyrosje të fletëve të punës etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p>Të ndihmojë zhvillimin e të folurit verbal si dhe të nxisë të folurin jo verbal.</p>	<p>dhe t'u thotë fëmijëve: edhe pak dhe do të takohemi bashkë dhe lulet çelin në pemë, në bar, në kodër e kudo.</p> <p>Në një nga këto ditë të bukura tek shihte balonën lart në qiell, flamujt dhe tullumbacet e kuqe të fëmijëve, trëndafilat dhe tulipanët e kuq, lapsi i kuq mendoi dhe tha me zë të lartë: Unë jam ngjyra që duan më shumë njerëzit dhe sidomos fëmijët. Unë jam më i rëndësishmi.</p> <p>Kështu kur u kthye në shtëpi mori çantën dhe pa i përshëndetur vëllezërit, si një mendjemadh i vërtetë tha: Unë duhet të shëtis nëpër botë që të më njohin të gjithë dhe që të më thonë sesa i rëndësishëm jam</p> <p>Rrugës tek ecte takoi një lopë e cila iu lut që ta vizatonte atë. Më bëj një portret sepse dua t'ia çoj një shoqes sime që jeton në pjesën tjetër të botës dhe ta ketë sa herë ta marrë malli për mua.</p> <p>Posi-tha menjëherë lapsi i kuq dhe pas disa minutash ia dha letrën në të cilën kishte vizatuar lopën.</p> <p>Uaaaa... sa e tmerrshme! Po pse e kuqe jam unë? Unë jam në ngjyrë kafe. O sa gjë e frikshme është një lopë kaq e kuqe. Shoqja ime do të frikësohej nga një pikturë e tillë.</p> <p>Lopa u largua kurse lapsi i kuq mendoi se vëllai i tij kafi do ta kishte bërë lopën të kënaqur nëse do ta kishte vizatuar siç ishte në të vërtetë.</p> <p>Duke ecur dhe më tej lapsi i kuq takoi një rosë të lumtur që po kënaqej nën rrezet e diellit. Rosa pa çantën dhe penelat e të kuqit dhe thirri gjithë gëzim. Sa do të desha një portret për ta kujtuar gjithnjë këtë ditë shndritshme dhe të gëzuar. Mund të ma bësh?</p> <p>Lapsi i kuq e pa dhe pas pak i dha letrën në të cilën kishte bërë pikturën e rosës.</p> <p>Rosës i iku i gjithë gëzimi që kish treguar deri atëherë. Oooooooo... Po nuk jam e plagosur dhe e lyer me gjak, unë nuk jam e kuqe. Kjo është dëshpëruese dhe e trishtuar. Ngjyra ime është e verdhë njëlloj si dielli që ndrit atje lart, kurse kjo që shoh i ngjan një gjëje të përbindshme...Sa frikë, sa frikë.....</p> <p>Lapsi i kuq u trishtua dhe i vajti mendja te vëllai i vet, I verdhi dhe kujtoi buzëqeshjen e tij të ëmbël teksa vizatonte dhe i jepte dritë gjithçkaje.</p> <p>Rosa u largua dhe tashmë lumturia e saj ishte zhdukur. Vërtet ishte ajo aq e përbindshme sa ky shpend që</p>	<p>Balonë e kuqe, flamuj, lule të kuqe, lopë lodër ose e vizatuar, rosë lodër ose e vizatuar, bretkosë lodër ose e vizatuar</p> <p>Peizazhe natyrorë; qiell me diell dhe re, det, mal dhe fushë e gjelbër, pemë dhe lule etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>ishite vizatuar? Nuk ishte e mundur, jo, jo.....</p> <p>Lapsi i kuq vazhdoi udhëtimin e tij dhe përpara i doli një bretkosë. Ajo ishte në mes të ujërave, por sapo dalloi piktorin i bëri me shenjë dhe duke e thirrur kuak, kuak e ftoi t'i bënte një portret. Do të vendoste në pemën pranë që kur të flinte gjatë dimrit, pisha ta kujtonte.</p> <p>Lapsi i kuq nuk e kundërshtoi. Pas pak kohe i dha pikturën që bëri.</p> <p>Bretkosa e trembi. Filloi një kuak,kuak të paparë ndonjëherë. Çfarë më ka ndodhur? Unë sot u pashë në pasqyrën e përroit dhe gjithçka dukej në rregull. Pse jam bërë kështu e shëmtuar? Oh, sa keq që kërkoja një pikturë që më tregoi shëmtimin tim. Sot gjithë ditën do të jem e mërzitur që pashë shëmtimin tim fizik. E kuqe, e gjitha e kuqe... nuk e kisha ditur një gjë të tillë.....</p> <p>Lapsi i kuq u dëshpërua dhe gati po qante. Pisha e gjelbër që ishte aty pranë e ftoi të rrinte nën hijen e saj. Lapsi i dashur.. A mund të më bësh mua një portret?</p> <p>Lapsi i kuq u drodh. Pishë e gjelbër, pishë.. Për ty dhe bretkosën njoh një artist të vërtetë. Është vëllai im i gjelbri. Ai do mund t'ju bënte të lumtur të dye. Unë nuk mundem. Unë jam vetëm i kuq si balona, si tullumbacja, si fustani i Erës, si... trëndafili dhe tulipani.....</p> <p>Nën hijen e pemës ai hodhi vështrimin lart dhe pa qiellin e kaltër, diellin e verdhë, ndërsa kur pa poshtë ndeshi me qilimin e gjelbër të barit, pemët me trungun dhe degët kafe dhe tha me vete: Sa mendjemadh dhe i keq që jam treguar me vëllezërit e mi. Kujtoja se isha më i rëndësishmi, por e gjithë bota është me ngjyrat e tyre.....Duhet të shkoj në shtëpi dhe të kërkoj falje....</p> <p>Përsëritet pemën dhe në rrugën e kthimit mbledhi një tufë me lule të kuqe, mori dhe një tullumbace dhe sapo arriti në shtëpi duke përqafuar vëllezërit thirri me zë të lartë:</p> <p>Erdha sepse pa ju unë nuk jam askush. Duhet qielli që balona e kuqe të pëlqehet nga të gjithë, duhet bari i gjelbër që trëndafilat dhe tulipanët e kuq të pëlqehen nga fluturat, duhet pema me trung dhe degët kafe që fëmijët të ngjiten dhe t'u shkëlqejnë fustanet dhe këmishët e kuqe.....</p> <p>Unë jam i lumtur vetëm së bashku me ju. Më falni!</p>	



Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p><b>Bisedë e udhëhequr</b>                      Bazuar në tregimet apo vjershat që janë treguar në klasë, mësuesja nxit bisedën me fëmijët dhe i orienton ata në analizën e karakteristikave të personazheve dhe veprimet e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I nxit të krijojnë situata të reja në të cilat mund të veprojnë këto personazhe apo të imagjinojnë një fund tjetër të tregimit.</li> <li>• I fton fëmijët të vizatojnë situatën që kanë krijuar dhe në varësi të produktit përfundimtar i drejton pyetjet për të shpjeguar se përse kanë përdorur një ngjyrë apo një tjetër</li> <li>• U kërkon fëmijëve të bëjnë një teatër të improvizuar mbi temën e lapsave me ngjyrë duke krijuar personazhe dhe situata të përmendura në tregim.</li> <li>• I fton fëmijët që brenda një kohe të caktuar të gjejnë sa personazhe duhen për teatrin, t'i vendosin një numër secilës ngjyrë dhe të flasin për karakteristikat e ngjyrës dhe të numrit.</li> </ul>	Libra me personazhe lapsat me ngjyra, përgatitja e një teatri duke përdorur për personazhet veshjet me ngjyrat përkatëse etj
<p><b>Matematika</b></p> <p><b>Konceptet</b>                      Numër,                      Sasia 1-6                      Mbledhje +1                      Zbritje -1</p>	<p>Fëmijët kanë dëshirë të mbledhin, të krahasojnë, të rendisin sepse kjo veprimtari u jep mundësi të kontrollojnë dhe të venë rregull në sendet që i rrethojnë.</p> <p>Mësuesja shfrytëzon këtë dëshirë për t'i nxitur fëmijët të realizojnë veprimtari krahasuese me objekte të ndryshme.</p> <p>Ajo mund të përdorë petëza, forma gjeometrike të ndryshme, karta me figura deri në 5, domino, letra etj</p> <p>Pyetjet që mund të drejtojnë lidhen me sasinë, mbledhjen dhe zbritjen e thjeshtë (+1; -1)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sa janë:</li> <li>• Sa u bënë?</li> <li>• Sa mbetën?</li> </ul> <p>Në aktivitetet që mund të realizoni përfshini:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Numërimi i qirinje në tortën e ditëlindjes.</b> Improvizoni një tortë dhe vendosni mbi të qirinj të vegjël. Në të njëjtën kohë përgatitni 10 karta me numrat nga 1 deri në 10. Duke krijuar radhën dhe duke ndryshuar sasinë e qirinjeve, kërkojuni fëmijëve të zgjedhin numrin për të treguar se sa qirinj janë vendosur mbi tortë. Mos e kaloni numrin mbi 6, në raste të tjera shihni dhe kushtet lokale të kopshtit dhe grupit me të cilin punoni.</li> </ul>	<p>Figura numrash, karta me numra, objekte të mëdha dhe të vogla etj</p> <p>Lapsa me ngjyra</p> <p>Qirinj të vegjël, numra prej qiriri deri në 6</p>


Fushat	Udhëzime	Materialet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Sa kupa akullore dëshironi?</b> Kjo është një lojë që mund ta organizoni duke improvizuar një masë të ngjashme me akulloren dhe duke pasur disa kupa dhe lugë për shërbimin e saj. Dy-tre fëmijë luajnë rolin e shitësit të akullores dhe shërbejnë duke dëgjuar kërkesat e klientëve, pra fëmijëve të tjerë të grupit. Në këtë mënyrë argëtuese mund të vlerësoni se cila është shkalla e njohjes së numrit të fëmijët që keni në grup</li> <li>• <b>Bashko sasinë me numrin.</b> Fëmijët janë në gjendje që të bashkojnë sasinë e objekteve në një radhë me numrin përkatës. Bëni një kartë të madhe me xhepa ku vendosni sasi makinash të vogla, petëza me ngjyrë, lapsa dhe kërkoni fëmijëve të venë numrin përkatës në radhën e duhur.</li> <li>• <b>Gjuetia e numrave.</b> Përpiquni të siguronit ose të përgatisni një mjet rrethor duke krijuar dy lloj kartash një me numra - shifër dhe një me numra – fjalë. (1-6 ose 10) Vendosni nga një shportë në secilën tavolinë, duke futur në të ose kartat shifër ose kartat fjalë. Kërkoni që fëmijët e një tavoline të shkojnë të tjetra për të plotësuar bashkimin shifër- fjalë.</li> <li>• <b>Gjëzat me numra.</b> Gjenerat figurat përkatëse dhe ilustroni fjalët me to, në mënyrë që fëmijët të veprojnë konkretisht në të menduarin e tyre</li> </ul> <p>Një ari, një patok, një cironkë dhe një maçok sa këmbë kanë të gjitha tok? (dhjetë)</p> <p>Mua më dha nëna Tetë kokrra gështenja Dy ia dhashë Meritës Dy të tjera Lidës Dy i ruaj për Marjetën Po për vete sa më mbetën? (dy kokrra)</p>	<p>Kupa akulloreje, lugë për akullore, masë pelteje për të imituar kremin e akullores etj.</p> <p>Fletë pune, Xhepore për shkronjat dhe numrat</p> <p>Shporta, karta me numra ose fjalë etj</p> <p>Gjëza të shoqëruara me figura</p>


Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Konceptet</b> Përpunimi i plastelinës</p> <p>Vizatime me më shumë se tri ngjyra</p> <p>Lëvizje numerike të shoqëruara me muzikë</p>	<p>Fëmijët duhet të perceptojnë se sasia dhe numri përdoren mjaft në jetën e përditshme. Kur ata tregojnë se sa vjeç janë kjo lidhet me një masë të caktuar fizike, i gjatë-i shkurtër, i hollë- i gjerë, i madh- i vogël etj</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mësuesja përdor plastelinën në klasë për të ngulitur te fëmijët konceptin e numrit. Ajo i orienton ata të bëjnë me baltë shporta, petëza në forma të ndryshme, kukulla etj. Më pas i rendit në sasi të ndryshme dhe u kërkon fëmijëve të numërojnë. Cili rresht ka më shumë? Cili rresht ka më pak?</li> <li>• Fëmijëve u vihen në dispozicion fletë pune në mënyrë që të kryejnë veprime të ndryshme numerike. Mësuesja u sugjeron atyre të ngjyrosin sasi të caktuara objektesh etj.</li> <li>• Në fushën e muzikës dhe vallëzimit mund të përdoren gjithashtu këngë për numrat, vallet për to duke improvizuar kërcime të thjeshta me shporta që kanë brenda tyre sasinë e objekteve që i përkon numrit</li> </ul>	<p>Plastelinë me ngjyra të ndryshme, forma, fletë pune etj</p> <p>CD me muzikë dhe këngë, shporta me objekte dhe numra për kërcim etj</p>
<p><b>Sociale</b></p> <p><b>Aftësitë sociale dhe personale</b> Përforcimi i vlerave të respektit dhe dashurisë në mes fëmijëve</p> <p>Respektimi i radhës</p> <p><b>Vlera:</b> Respekti</p>	<p>Fëmijët ndahen në 4-5 grupe të vogla. Para se të fillojnë lojën mësuesja u shpjegon se duhet të realizojnë udhëtime në grup si të ishin një tren me lokomotivë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fëmijët vendosin paraprakisht në grup se sa do të jetë numri i atyre, cili do të jetë <b>lokomotiva e trenit</b> të tyre, çfarë numrash do të kenë vagonët dhe më pas provojnë të kapen njëri pas tjetrit duke zhurmuar si tren. Kjo i bën ata të ndihen miqësorë me njëri-tjetrin, të zhvillojnë aftësitë numerike, të sigurojnë koordinimin sy dhe duar dhe të njohin vlerat e njëri-tjetrit duke bërë përzgjedhjen e lokomotivës si fëmijën që e pëlqejnë më shumë të gjithë, pra nëpërmjet votës.</li> <li>• <b>Sheshi i numrave</b> është një tjetër lojë që siguron marrëdhënie bashkëpunuese me fëmijët. Ndërtohet një shesh me katrorë që përmbajnë numrat nga 1 në 9, dhe më pas u kërkohet fëmijëve të ndarë në grupe dhe me nga një numër të ngjitur në përparësen e kopshtit t'i çojnë mesazhet që duan në kutinë që përputhet me numrin e shokut. Mesazhet mund të jenë objekte të vogla, kartolina, lule etj.</li> </ul>	<p>Tabak kartoni, karta të mëdha dhe të vogla me numra, objekte të ndryshme si lokomotiva e trenit me vagonat,</p> <p>Sheshi i numrave, mesazhe: kartolina, lule të freskëta ose të thara, objekte të vogla etj</p>



Fushat	Udhëzime	Materialet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Unë jam numri.</b> Një nga elementët e parë që duhet të mësojë fëmija në kopsht është dhe respektimi i radhës në marrjen e mjeteve mësimore, në vajtjen në tualet, në marrjen e fjalës etj. Loja “Unë jam numri” është e ndërtuar mbi situatën ku fëmijëve u kërkohet të respektojnë radhën mbi bazën e numrave që kanë tërhequr. Mësuesja do t’u japë nga një objekt të gjithë fëmijëve të grupit, por ndjek radhën mbi numrin që ka çdo fëmijë</li> </ul> <p><b>Respekti</b> Shpjegojini fëmijëve konceptin mbi grupin duke ia ilustruar atë, p.sh. grupi i fëmijëve, i valltarëve, i sportistëve. Tregojini atyre si jetohet, punohet në grup, cilat janë rregullat, pse duhet t’i respektojnë rregullat e grupit etj. si këto P.sh. nëse valltarët janë duke kërcyer të gjithë në grup në formë rrethi dhe njëri prej tyre nuk e ndjek ritmin e melodisë sipas shokëve, do të prishet rregullsia e valles. Vërinë fëmijët të kërcëjnë një valle në rreth, ku të marrin pjesë të gjithë fëmijët dhe improvizoni pjesë ku një apo disa prej fëmijëve nuk ndjekin ritmin e shokëve. Diskutoni me ta se çfarë ndodh.</p>	<p>Figura ose vizatime që tregojnë respektimin e radhës nga njerëzit ose fëmijët</p> <p>Libra dhe revista me ilustrime për respektimin e rregullave, të njerëzve të moshuar, shokëve etj.</p>
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Të mësuarit për t’u fokusuar në numra dhe sasi të ndryshme gjatë kohës që fëmijët luajnë dhe argëtohen, zhvillojnë sporte etj</p>	<p>Për t’i familjarizuar fëmijët me numrat, mësuesja mund të përdorë edhe aktivitetet sportive apo të lojës në mjedisë të ndryshme të kopshtit, brenda dhe jashtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjetet e sportit duhet të jenë një nga sasi të mësuara së bashku me fëmijët numërojnë (topat, birrilat, balonat, çantat etj.)</li> <li>• Në lojëra të ndryshme mund të vendoset një tabelë për të shënuar pikët e secilës skuadër, gjë e një natyrshëm fëmijët me përdorimin e numrit</li> <li>• Posterat që flasin për higjienën e dhëmbëve, temperaturën e mjedisit etj. janë mundësi që prodhojnë situata dhe kërkesa për t’u thelluar në konceptin e numrit</li> <li>• Ne mund të zhvillojmë bashkëbisedime me fëmijët sesa herë ata kanë qenë vizitë te doktori, dentisti duke lidhur numrin me kohën</li> <li>• Një tjetër element që mund të bëhet shkas i</li> </ul>	<p>Mjete sportive, postera shëndeti etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	thelimit në konceptin e numrit mund të jetë pirja e ilaçeve të ndryshme, sasia e tyre etj.	
<b>Aftësitë njohëse</b>	<p>Tek fëmijët që paraqesin vështirësi në asimilimin e programit, mësuesja temën e ditës mund ta lidhë me një aktivitet të përshtatshëm për aftësitë e fëmijës p.sh. me numrin e veprimeve që duhet të kryejë ai për të larë duart sipas një radhe të caktuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Marrim sapunin ose shtypim shishen e sapunit të lëngshëm</li> <li>2. Hapim rubinetin e çezmës</li> <li>3. Lagim duart me ujë dhe i fërkojmë me sapun me njëra-tjetrën</li> <li>4. Mbyllim rubinetin e çezmës</li> <li>5. Fshijmë duart me peshqir</li> </ol> <p>Përdorni për secilin veprim numërorin përkatës.</p>	Foto ose figura që kanë vazhdimësinë e veprimeve si tipar

### Loja me domino






 <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>	 <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<hr/> <hr/> <hr/> <hr/>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/>

Përdorni lojën me domino për të familjarizuar fëmijët me sasinë dhe numrin.







Sa delfinë janë në secilën figurë? Ngjyrosni!  
A mund të bëjmë një tregim me delfinët që luajnë?



## 9. TRANSPORTI

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Hyrje</b></p>	<p>Provoni ta filloni bashkëbisedimin për projektin e transportit pas kësaj loje: <b>“Dritë e kuqe, dritë e gjelbër”</b></p> <p>Prisni një rreth të kuq dhe një të gjelbër. Ngjisni rrathët në shkopinje të shkurtër. Filloni lojën klasike, kur ju mbani në dorë rrethin e gjelbër fëmijët ecin përreth jush, kur ju mbani rrethin e kuq ata duhet të ndalen, vazhdoni këtë lojë disa herë duke argëtuar fëmijët dhe pyetini përse ndaluan kur ju treguat rrethin e kuq dhe pse vazhduan kur panë rrethin e gjelbër.</p>	<p>Letra me ngjyrë Shkopinj të shkurtër Rrathë Mjete transporti lodër, figura Albumet</p>
<p><b>Sociale</b></p> <p><b>Konceptet</b></p>	<p><b>Ndihmësi i komunitetit</b></p> <p>Ftoni në klasë një punonjës të shërbimit të zjarrfikësve ose një shofer autobusi bashkë me mjetet e tyre të transportit (brenda mundësive) në mënyrë që fëmijët të vëzhgojnë dhe të shohin më nga afër këto mjete të rëndësishme që u shërbejnë qytetarëve.</p> <p><b>Nga një qytet në tjetrin</b></p> <p>Vendosni hartën e Shqipërisë mbi një tavolinë dhe rrethoni dy qytete të mëdha. Lëroni fëmijët të lirë të tregojnë me gishtin e tyre të gjitha mënyrat e mundshme të udhëtimit që ata mund të ndërmarrin nga njëri qytet në qytetin tjetër.</p>	<p>Harta e vendit ose e fshatit dhe e qytetit tuaj, libra dhe revista, figura mjeteve transporti dhe punonjësve që shërbejnë me to etj</p>
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p>	<p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b></p> <p><b>Bëni një aeroplan prej letre</b> (letër me ngjyra ose çfarëdo letre tjetër), bashkë me fëmijët luani lojën “Aeroplani që fluturon më lart e më larg”, Edhe ju vetë mund të luani bashkë me fëmijët duke i nxitur për të bashkëbiseduar.</p>	<p>Fletë pune për ngjyrosje Libra ose revista me tregime dhe përralla me mjete udhëtimi</p>


Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Aftësitë</b> Njohje me shkronjën “A”, “a” “Aeroplani”</p>  	<p>Fjalë të ndryshme që fillojnë me shkronjën “a”, aeroplan, akrobat, ari, ara, arra, të identifikojnë emrat e shokëve të grupit që iu fillon emri me shkronjën “A”</p> <p><b>Këngë ose vjersha</b> Përfshihen të gjitha këngët më të preferuara nga fëmijët që lidhen me tematikën e transportit.</p> <p><b>Poshtë nga stacioni</b> Poshtë nga stacioni Herët në mëngjes Shiko vagonët, të gjithë në një rresht Shiko makinistin dorën larte ngre Puf, puf, treni ecën bashkë me ne.</p> <p><b>Semafori</b> Ndririt dhe vezullon semafori rruga dhe makina e sheh <b>e gjelbra jep leje të kalojmë</b> dhe makina e njerëz shkojnë, <b>e verdha</b> kërkon të presim, edhe në qoftë se me vonesë jemi <b>e kuqja</b> na thotë : Ndalo Ndririt, vezullo semafor dhe gjithnjë në rrugë na ndihmo!</p> <p><b>Drejtuesit</b> <b>Shoferi Miri</b> ka makinë, bip: bip, bip, bip, bip Dhe në makinë ai ka një bori: bip, bip, bip, bip, bip Me një bip bip këtu dhe një bip atje, bip, bip, shkojmë kudo ku na pëlqen ne.</p> <p><b>Piloti Arian</b> ka një aeroplan: zum, zum, zum, zum, zum. Dhe avioni ka dy krahë: zum, zum, zum, zum, zum. Me një zum, zum, këtu dhe një zum, zum atje, avioni ynë fluturon mbi re</p> <p><b>Makinisti Fred</b> ka një tren, çuf, çuf, çuf, çuf, çuf. Dhe në tren ka një oxhak: çuf, çuf, çuf, çuf, çuf. Me një çuf këtu dhe një çuf çuf atje, treni na çon ku të duam ne. Librat për fëmijët parashkollorë lidhur me këtë tematikë do t’ju ndihmojnë për t’ua bërë më konkret të mësuarin e fëmijëve.</p>	<p>Foto ose piktura të mjedisve të ndryshme që lidhen me transportin: stacioni treni, autobusi, semafori etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p> <p><b>Aftësitë</b></p>	<p><b>Lojëra:</b> Mënyra më e mirë për të mësuar fëmijët, është kur ai realizohet në një mënyrë interesante dhe argëtuese dhe kjo gjë zhvillohet më së miri në parashkollor nëpërmjet lojërave nxitëse dhe emocionuese.</p> <p><b>Më shumë veprimtari për transportin</b> Përfshihen veprimtari ekstra që nuk përshtaten me kategoritë e tjera, duke i integruar në kohën gjatë ngrënies, udhëtime në terren, dhe më shumë!</p> <p><b>Hapësira ime e ndërtimit</b> Vendosni zhavorr, rërë, dhe materiale të tjera në një sipërfaqe të sheshtë, ndërkohë jepuni fëmijëve buldozerë dhe kamionë lodre për të zhvendosur gurë të madhësive të ndryshme.</p> <p><b>Transporti gjatë kohës së pushimeve</b> Sillni kuti të ndryshme në klasë nga ato që përdoren për ambalazhin e pajisjeve elektronike të cilat mund t'i përdorni si anije, autobusë, aeroplanë dhe makina. Pasi fëmijët t'i kenë zbukuruar sipas dëshirës së tyre do t'i përdorin për një udhëtim në vendin që kanë caktuar për pushime.</p> <p><b>Çfarë do të vendosni në valixhen tuaj?</b> Gjatë kësaj loje në grup është koha e përforcimit të "ABC".Vendosini fëmijët në rreth dhe përmendni emrin e një fëmije që fillon me shkronjën "A" A-Ana "çfarë do të vendosësh në valixhen tënde?"</p>	<p>Postera për kujdesin dhe sigurinë në rrugë</p> <p>Zhavorr, rërë, buldozer dhe kamion lodër etj</p> <p>Kuti ambalazhi, zbukurime të ndryshme</p> <p>Valixhe ose çantë udhëtimi dhe veshje, libra apo materiale të tjera që merren me vete kur udhëton</p>
<p><b>Matematikë</b></p> <p><b>Konceptet</b> Shkrim numrash 1-5</p>	<p>Gjatë javës së transportit lëroni fëmijët të lirë të bëjnë targa makinash me shkumës.</p> <p><b>Udhëtim me tren</b> Vendosini karriget në vijë të drejtë për të krijuar një tren.Vendosni në të gjitha karriget numrat përkatës. Pastaj shpërndani biletat (me numrat përkatës), për nxënësit tuaj.Pastaj ju jeni në platformë (kontrollori), për të kontrolluar biletat e tyre dhe të shënoni një vrimë në to për kthimin. Për të pasur më shumë larmi në këtë lojë, shtoni dhe gjëra shtesë të tilla si; valixhet, çantat dhe hartat si edhe sende të tjera udhëtimi. Kjo lojë mund të luhet edhe për një udhëtim me autobus ose aeroplan.</p>	<p>Karta me numra</p>


Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Konceptet</b></p>	<p>Artet propozojnë shumë veprimtari të preferuara në parashkollor, si edhe projekte të mrekullueshme për të argëtuar fëmijët tuaj.</p> <p><b>Trafiku im me drita</b> (semafor) Lërimi fëmijët të lirë për të vizatuar sipas dëshirës semaforin e kuq duke përdorur letra me ngjyra të ndryshme. Më pas le të krijojnë një “skenë” për të shkuar së bashku me semaforin e kuq.</p> <p><b>Makina ime e preferuar e transportit</b> Jepini çdo fëmijë një kuti. Më pas jepuni edhe nga një foto me një mjet transporti të preferuar për ta. Mundohuni të keni një larmi fotosh me mjete të ndryshme transporti për t’i lehtësuar në zgjedhjen e tyre. Më pas ata do t’i ngjisin në kutitë e tyre dhe do të tregojnë për mjetin e tyre të preferuar të transportit. Nëse nuk keni hapësirë të mjaftueshme, vendosini fëmijët të punojnë në çifte.</p> <p><b>Piktorë të vërtetë</b> Jepuni fëmijëve letër dhe bojë për ngjyrosje. Më pas, duke parë makinën lodër, ata do të vizatojnë dhe do ta ngjyrosin ashtu si e mendojnë. Kjo gjë i bën ata të ndihen të zotë në të vizatuar si “piktorë të vërtetë”.</p> <p><b>Harta ime</b> Tregojuni fëmijëve disa harta të ndryshme. Secili të ketë nga një hartë për të ngjyrosur dhe më pas të tregojë pse ka përdorur ato lloj ngjyrash.</p>	<p>Letër Bojë Mjete të ndryshme sipas zgjedhjes suaj. Kuti kartoni Foto të ndryshme mjete transporti Mjete të ndryshme arti sipas zgjedhjes suaj</p> <p>Letër Bojë Makina lodër Mjete të ndryshme arti sipas zgjedhjes suaj</p> <p>Letër Markera (shënues), pastel Bojë për ngjyrosje</p> <p>Harta të ndryshme</p>
	<p><b>Aeroplani im</b> Fillimisht bëni dy të çara anash tubit të kartonit, më pas ngjisni krahët të bërë prej kartoni në këto të çara. Së fundmi, lërimi fëmijët të projektojnë dhe të dekorojnë vetë aeroplanin e tyre. Vazhdoni të diskutoni se çfarë e bën aeroplanin të fluturojë.</p> <p><b>Të ndërtojmë vet mjetin e transportit</b> Prisni forma të ndryshme automjete transporti (aeroplanë, autobus, makinë, kamion etj.) dhe lërimi fëmijët të krijojnë vet mjetin e tyre të transportit.</p> <p><b>Shenja stop</b> Ju mund të shkruani në një pjatë të vogël prej letre fjalën “stop” me një shkumës prej dylli (pastel), më</p>	<p>Tub kartoni (letrave higjienike) Karton Bojë Markera/pastel</p> <p>Letër Temperë Pastel</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>pas duke përdorur ngjyrën e kuqe (bojë temperë) të holluar me ujë ngjyrosni pjatën dhe fëmijëve do t'ju shfaqet si me magji fjala "stop". Fëmijët do të eksperimentojnë me pastel dhe me temperë sipas dëshirës së tyre për të realizuar shenjën ndaluese stop. Më pas diskutohet me fëmijët se ku e kanë parë këtë shenjë dhe si duhet të veprojnë kur shfaqet ajo.</p>	
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p> <p><b>Aftësitë:</b> Investigim shkencor, Veprim interaktiv Analizë Sintezë</p> <p>(enciklopedia)</p>	<p>Tema jep mundësi për <b>veprimtari</b> të ndryshme mësimore për fëmijët se si ata të integrohen në shkencë në mënyrë sa më argëtuese.</p> <p><b>Gjurmët e një rrote</b> Lërimi fëmijët të ngasin makina lodre në një sipërfaqe ku janë vendosur disa substanca të ndryshme si: ujë, bojë, baltë, pastë dhëmbësh, ngjitës etj. Flisni me ta në lidhje me gjurmët e ndryshme që janë bërë prej makinave lodër të lyera nga substancat e ndryshme.</p> <p><b>Kavanozat rrotullues</b> Sillni në grup disa kavanoza të pastër me të njëjtën madhësi. Vendosni në çdo kavanoz materiale të ndryshme të vogla (gurë, shkumës, bllok, laps etj.) I lini fëmijët të rrotullojnë kavanozat dhe diskutoni me ta, se si sendet e ndryshme ndikojnë në rrokullisjen e kavanozave.</p> <p><b>Enciklopedia.</b> Përmban informacion të gjerë për të mësuar në lidhje me temën dhe se si t'ia transmetoni këtë informacion fëmijëve.</p> <p><b>Kategoritë e transportit</b> Transport kafshësh Aviacioni Transporti i njeriut Transporti rrugor i motorizuar Transporti hekurudhor Transport anijesh Transporti hapësinor Transporti i së ardhmes</p>	<p>Mjete transporti lodër prej plastike, druri, letër, karton etj bojë, baltë, pastë dhëmbësh</p> <p>Kavanoza gurë, shkumës, lapsa etj</p>
<p><b>Mjete të tjera transporti</b></p>	<p>Karroca me rrota e fëmijëve që nuk mund të ecin është një mjet transporti për ta. Nxitini fëmijët të tregojnë dhe të diskutojnë se si mund të ndihmojnë një individ që lëviz përmes</p>	

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>karriges me rrota të eci në rrugë, të hyjë në një ndërtesë.</p> <p>Tregojini për rëndësinë e pajisjes së të gjitha rrugëve, lulishteve, dyqaneve dhe çdo ndërtesë tjetër me pjesën e pjerrët ose rampin për individët që duhet të lëvizin me karrocë me rrota.</p> <p>Fëmijët mund të vëzhgojnë të gjitha ambientet dhe rrugët ku ata kalojnë për të parë nëse janë të pajisur me pjesën e pjerrët dhe mund të diskutojnë mbi ato çfarë kanë parë.</p>	





Aeroplani fluturon lart në qiell





aeroplani im















Si emërtohen mjetet e transportit që shihni në faqet 200-203?  
Ngjyrosini dhe tregoni ku lëvizin ato dhe për çfarë shërbejnë.

aeroplani



zogu



flutura



Vështro lart në  
qiell.

## 10.TRENI

Fushat	Udhëzime	Materialet
<b>Hyrje</b>	Mjetet e transportit janë mjaft të pëlqyeshme nga fëmijët. Ata përveç lodrave me përmasa të mëdha mbajnë shpesh nëpër xhepat e veshjeve të tyre makina, barka, aeroplanë të vegjël, mjete këto që u ngjallin fantazinë e udhëtimit dhe të kënaqësisë së drejtimit të tyre si shofer, pilot, marinar etj. Pasi kanë mësuar për mjetet e udhëtimit në përgjithësi, mësuësja i orienton 4-5 vjeçarët drejt një mjeti disi special si treni që përbëhet nga lokomotiva dhe vagonët.	Libra, albume, Figura, lodra treni të përmasave të ndryshme, blloqe konstruktive etj.
<p><b>Sociale</b></p> <p><b>Aftësitë</b> për të njohur dhe zbatuar rregullat e udhëtimit,</p> <p>të kujdesit dhe sigurisë,</p> <p>rregullat e komunikimit me të tjerët</p> <p><b>Vlera:</b> Ndhima</p>	<p>Udhëtimet janë një prej veprimtarive shoqërore që fëmijët e pëlqejnë shumë. Por ata duhet të përfitojnë që në moshë të vogël aftësitë dhe shprehitë e udhëtimit me mjete të ndryshme të transportit.</p> <p>Mësuësja mund të përdorë tregimin e mëposhtëm për të filluar bisedën se si duhet të sillen ata në një rast udhëtimi</p> <p><b>Një udhëtim me tren</b> Ty, ty, ty.....Nisemi! Familja e Erës merr trenin për të shkuar te kushërinjtë që banojnë larg. Babi merr biletat në stacion. Mami blen libra dhe gazeta te libraria e stacionit, ndërsa një punonjës i stacionit të trenit ndihmon të çojë valixhet në tren. Ja ku erdhi dhe treni me një lokomotivë të bukur duke bërë zhurmë, çuf, çuf, çuf.... Era së bashku me prindërit dhe vëllanë e vogël u ngjiten në tren. Ja e gjithë familja është ulur tashmë në kolltukët e trenit dhe shohin me kureshtje përjashta xhamave. Të gjithë në kabina, të ulur! Treni po nis. Ai është duke dalë nga stacioni. Sinjali i dritave po i tregon makinistit që binarët para tij janë të zbrazura. Mendoni se çfarë mund të ndodhë nëse një tren tjetër është duke ardhur përballë! Shihni, familja e Erës është ulur në restorant për të ngrënë diçka. Një banakier përgatit ushqimin dhe kamerieri po e shërben atë. Në një stacion tjetër lokomotiva shkoi te karburanti për t'u furnizuar. Treni tashmë vrapon me shpejtësi në rrugën e hekurt.</p>	<p>Foto të bëra së fundmi nga fëmijët, piktura, libra,</p> <p>Albume për mjetet e transportit</p> <p>Blloqe konstruktive, lodër treni me shinat, figura që tregojnë copëza të udhëtimit me tren. etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p>Aftësitë sociale</p>	<p>Sa shumë shina hekuri që paska!-tha Era. Në një prej këtyre shinave po vinte një tjetër tren. Kush është duke lëvizur, ne apo ata?</p> <p>Kontrollori sheh biletat dhe me një pincë i shpon. Bileta tregon se babi ka paguar udhëtimin.</p> <p>Çuf, çuf, çuf. Treni është duke bërë kilometra të tëra dhe fëmijët janë duke parë nga dritarja male, pyje, lumenj, qytete.....</p> <p>Më në fund duket se familja arriti në qytetin e kushërinjve. Ja, në stacion kanë dalë për t'i pritur kushërinjtë me një tufë lule në dorë.</p> <p>Ky udhëtim ishte vërtet shumë i kënaqshëm! Nuk e besoni? Provoni të shkoni edhe ju diku me tren</p> <p>Biseda mund të orientohet në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullat e udhëtimit në tren: si qëndrohet në kabinë, si pritet bileta, si mund të hahet atje, ku hidhen mbeturinat</li> <li>• Rregullat e kujdesit dhe të sigurisë: çfarë sjellje duhet të kenë fëmijët, si t'i shmangin rreziqet etj</li> <li>• Rregullat e komunikimit me të tjerët: si duhet t'i drejtohem të rriturve, si duhet të flasim me të tjerët, çfarë pyetjesh mund të bëjmë dhe çfarë jo.</li> </ul> <p><b>Ndihma</b></p> <p>Tregojini fëmijëve se duhet të jenë ndihmues ndaj të moshuarve, mamave që mbajnë bebe tek barku, njerëzve të tjerë që kanë probleme shëndetësore, duke i lejuar të ulen në stolat e tyre, nëse ata ndodhen në autobus, tren dhe janë duke qëndruar në këmbë dhe nëse vendet e tjera për t'u ulur janë të gjitha të zëna. Përdorni tregime dhe ngjarje të jetës së përditëshme për t'i bërë fëmijët të kuptojnë vlerën e ndihmës dhe rëndësinë e dhënies së saj gjatë gjithë ditës për ata që kanë nevojë.</p> <p>Edhe pse disa fëmijë nuk mund të kuptojnë gjithçka e nuk mund të shprehin ndjenjat e tyre ashtu siç duhet, asnjëherë nuk duhet harruar se ata janë NJERËZ e duhen trajtuar si të tillë.</p>	<p>Bileta udhëtimi me autobus, tren apo avion,</p> <p>Tregime që flasin për komunikimin në mjetet e ndryshme të transportit etj</p> <p>Libra dhe revista me ilustrime që tregojnë akte ndihme ndaj të tjerëve</p>
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p>	<p>Aktivitetet që lidhen me mjetet e transportit janë të larmishme dhe kanë në fokus të tyre zhvillimin e aftësive shkencore si vëzhgimin, klasifikimin dhe vlerësimin.</p> <p>Nëse keni folur për mjetet e transportit në përgjithësi, si mësuese mund të ndihmoni fëmijët të</p>	<p>Pamje të trenave të ndryshëm, blloqe konstruktive, tren me vagonë që shpëputen etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Aftësitë</b> Vëzhgimi krahasimi klasifikimi</p> <p><b>Konceptet</b> Rrota, Motori, Helika</p>	<p>përqendrohen në elementët që janë karakteristike e trenit si lokomotiva, vagonët etj</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Varni nëpër muret e klasës <b>piktura apo foto që tregojnë trenin me lokomotivën dhe vagonët</b>. Me një marker mund të plotësoni figurat me familje, fëmijë, kafshë, valixhe duke treguar se cilët janë pasagjerët që udhëtojnë me tren. Prisni një formë makinisti dhe lërinin fëmijët ta ngjyrosin atë siç duan. Më pas orientojini ata, që nëpërmjet një kapëseje ta varin në murin ku keni ngritur stacionin e trenit dhe keni vendosur gjithçka që lidhet me projektin.</li> <li>• Organizoni <b>një shëtitje</b> me fëmijët në stacionin e trenit të qytetit tuaj. Kur nuk keni një të tillë, mundohuni të bëni një vizitë të ngjashme në stacionin e autobusëve apo të portit nëse jeni qytet detar, pra gjithnjë, sipas kushteve që ju dikton qyteti apo fshati ku jetoni dhe punoni.</li> <li>• Më pas zhvilloni <b>bashkëbisedimin</b> tuaj, duke i vendosur fëmijët në formë rrethi, mbështetur mbi këto çështje: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë ju pëlqen më shumë nga udhëtimet me tren? Po nga ato me mjete të tjera transporti?</li> <li>• Si ndryshon forma, madhësia mënyrat se si punojnë te mjetet që udhëtojnë në ajër, në ujë dhe në tokë? Përdorni metodën e krahasimit duke ilustruar atë me të gjitha llojet e mjeteve të transportit.</li> <li>• Po drejtuesit e tyre pse kanë emra si <b>makinist, pilot apo marinar</b>? Cila është veshja e secilit prej tyre?</li> <li>• Duke diskutuar rreth mjeteve të ndryshme të transportit dhe gjithçkaje që lidhet me udhëtimet, fëmijët kanë shansin të shkëmbejnë idetë e tyre dhe të japin fakte që lidhen me temën qendrore.</li> </ul> </li> <li>• Bashkëbisedoni me fëmijët rreth <b>pjesëve përbërëse të trenit</b>. Inkurajojini ata të përshkruajnë ngjyrat, format, si dhe të shtojnë elementë që lidhen me mundësinë e shkëputjes së vagonëve, mënyra se si janë lidhur ato etj. që është mjaft interesante për fëmijët Do të ishte me vlerë bërja e një <b>mozaiku</b> me pjesëza të trenit si rrotat, kabinat, vendi i makinistit etj</li> <li>• Së bashku me fëmijët përgatisni <b>një album mjetesh transporti</b> duke i klasifikuar në</li> </ul>	<p>Piktura dhe foto për mjetet e transportit, ngjyra për fëmijët, letër e bardhë ose me ngjyrë blu, gërshtë, ngjitëse, kapëse.</p> <p>Aparat fotografik, Bileta të mbledhura nga udhëtime të ndryshme, foto të tyre dhe të shëtitjes së organizuar</p> <p>Billoqe konstruktive për ndërtimin e një rruge hekurudhore dhe trenit.</p> <p>Pamje të rrugëve në qytet dhe fshat, në mal dhe det.</p>



Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>mjete që udhëtojnë : në tokë, në det dhe në ajër. Këtë gjë mund ta zhvilloni duke përdorur edhe një tabak të madh letre e cila ngjyroset pjesërisht me blu dhe të gjelbër për të vendosur sipas përkatësisë mjetet e transportit tokësor- e gjelbër, ujqor dhe detar-blu.</p> <p>Mësuesja ka mundësi të panumërta për të zhvilluar aftësitë shkencore të vëzhgimit, të analizës dhe të krahasimit të mjeteve të transportit dhe elementëve të tyre. Ajo mund të shfaqë një video, të shfletojë me fëmijët libra të ilustruar dhe albume, të vizitojë me ta mjedise si stacione hekurudhore, porte dhe aeroporte etj</p>	<p>Video, libra të ilustruar, albume me mjete transporti etj</p>
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Të mësuarit për t'u fokusuar në shkronjën T, për të njohur gjurmët si dhe për të përshkruar trenin me karakteristikat e tij</p> <p>Zhvillimi i aftësive treguese</p> <p>Përdorimi i imagjinatës krijuese</p>	<p>Njihet tashmë nga të gjithë se tema e transportit është shumë e pëlqyer nga fëmijët. Ekzistojnë tregime, vjersha dhe gjëza të shumta që kanë në fokusin e tyre udhëtimet dhe aventurat e personazheve në tren, anije apo avion.</p> <p>Mësuesja mund të përdorë libra të njohur si Pinoku për të ilustruar temën.</p> <p>Po ashtu vjersha e mëposhtme mund të shërbejë si pikënisje e projektit në fushën e gjuhës dhe të komunikimit:</p> <p><b>Në udhëtim</b> Udhëtojmë, udhëtojmë Larg qytetit ne po shkojmë Ku po shkojmë, kush e di? Tutje, tutje, në veri</p> <p>Lart në male grupi jonë Do të ngrejë një balonë</p> <p>Udhëtojmë, udhëtojmë drejt detit ne po shkojmë Ku po shkojmë këtë herë Për pushimet në verë</p> <p>Sa gëzim, ç'bukuri Diell, ajër, kaltërsi</p> <p>Udhëtojmë, udhëtojmë Buzë pyjeve po shkojmë</p>	<p>Libra me përralla, tregime dhe vjersha të ilustruara, figura personazhesh dhe treni, Cd ose video filmi që kanë në fokus udhëtimet me tren apo mjete të tjera transporti, kartë me shkronjën T</p>




Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Ku na çon Ky tren i shpejtë? Erdhëm prapë në qytet Në shtëpi, në kopshtin tonë Se shtatori po afron</p> <p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Planifikimi i mësimit për një temë të tillë mund të fillojë me gjetjen e një libri të përshtatshëm, me format të madh dhe tërheqës për ilustrimet që ka. Nëse mund të siguroni për çdo tavolinë do të ishte një avantazh që fëmijët të mund t'u ndiqnin gjatë leximit dhe interpretimit që do t'i bënit pjesës. Mos harroni të përdorni dhe të kërkoni t'ju përsërisin se si bën treni, se si fishkëllen lokomotiva, se si i bie bilbilit apo si i përdor sinjalet konduktori etj. Kjo bën që fëmijët të përfshihen tërësisht në rolet e personazheve të tregimit dhe të përsërisin: ty ty...çaf,çuf,çaf,çuf.....</li> <li>• Kërkojuni fëmijëve të sjellin foto të bëra në qytetet e tjera dhe të përshkruajnë shkurt histori të ndryshme të udhëtimeve të tyre, mbresat dhe përshtypjet që u kanë lënë këto udhëtime</li> <li>• Duke shpërndarë karta me figura mjetesh transporti, mësuesja u kërkon grupeve të vogla të fëmijëve të krijojnë tregime dhe histori të thjeshta</li> <li>• Më pas u jep fëmijëve fletë pune në të cilat kërkohet të ndjekin vijat për të formuar shkronjën T dhe i familjarizon ata me fjalët që përmbajnë këtë shkronjë, duke bërë edhe ilustrimin me figura: topi, traktori, deti</li> </ul> <p><b>Bisedë e udhëhequr</b></p> <p>Bazuar në tregimet apo vjershat që janë treguar në klasë, mësuesja nxit bisedën me fëmijët dhe i orienton ata në analizën e karakteristikave të personazheve dhe veprimet e tyre gjatë udhëtimit me tren.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I nxit të krijojnë situata të reja në të cilat mund të veprojnë këto personazhe apo të imaginojnë një fund tjetër të tregimit.</li> <li>• I fton fëmijët të vizatojnë situatën që kanë krijuar dhe në varësi të produktit përfundimtar i drejton pyetjet për të shpjeguar se përse kanë futur në vizatimet e tyre këtë personazh dhe jo një tjetër</li> </ul>	

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• U kërkon fëmijëve të bëjnë një teatër të improvizuar mbi temën e trenit duke përdorur karriget si vagonë të lidhur njëri pas tjetrit si dhe duke krijuar personazhe dhe situata të përmendura në tregim. I fton fëmijët që brenda një kohe të caktuar të gjejnë sa personazhe duhen për teatrin, cilat do të jenë veshjet që do të përdorin, të vendosin sfondet për çdo ngjarje etj</li> <li>• Rekomandohet që të përdorni gjë e gjëzat që nxisin fëmijët për problem zgjidhjen, p.sh:                  Dhoma –dhoma si kuti                  Kam hipë unë, ke hipë dhe ti                  Dhomat përmbi rrota rrinë                  Ndër stacione venë e vinë                  Fy-fy-fy e ta-ta-ta                  Thoni emrin si e ka?                  (treni)</li> </ul> <p>Ndërsa si shkronjë me të cilën do siguroni familjarizimin e fëmijëve me alfabetin mund të përzgjidhni T.                  Fjalët që kanë shkronjën T në brendinë e tyre mund të ilustrohen përbri me figurat:  <b>T</b>-treni, traktori, deti, shëndeti, Tirana, karota, sport, pilot, helikopter.</p>	
<p><b>Matematika</b></p> <p><b>Aftësitë</b>                  Mbledhje dhe zbritje me l</p> <p>Format rreth, katror dhe trekëndësh</p>	<p>Në temën e trenit, mësuesja mund të shfrytëzojë sasinë dhe format e ndryshme të mjeteve të transportit për të përsëritur numrat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 si dhe format rreth, katror dhe trekëndësh që shumica e fëmijëve i përdor për të bërë trenin, makinat, anijen apo aeroplanin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Duke shfrytëzuar trenin me vagonët që shkëputen mund të realizohen ushtrime të thjeshta me mbledhje dhe zbritje l, që u jep fëmijëve mundësi të shprehen matematikisht.</li> <li>• Po kështu, përdorimi i fletëve të punës i ushtron fëmijët në njohjen e sasisë dhe formave, si dhe zgjidhjen e ushtrimeve të thjeshta. Mësuesja integron matematikën me artet duke përforcuar nëpërmjet kënaqësisë që jep zhvillimi artistik, konceptet e numrit dhe formës.</li> <li>• Llojet e ushtrimeve që mund të zhvillohen janë ndjekja e vijave, klasifikimi i formave me madhësi dhe ngjyra të ndryshme, ndërtimet konstruktive, gjetja sa vagonë apo mjete transporti janë etj</li> </ul>	<p>Bllloqe konstruktive, forma të shumëllojshme me ngjyra dhe madhësi të ndryshme, tren lodër me shumë vagonë, fletë pune etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Aftësitë</b></p> <p>Punë me baltë</p> <p>Ngjyrosje</p> <p>Punë me letër</p> <p>Këngë për trenin</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Parashkollorët 4-5 vjeç pëlqejnë të manipulojnë baltën dhe të bëjnë me të mjete transporti, po aq sa dhe të ngjyrosin fletë pune ku ato janë vizatuar.</li> <li>• Mësuesit kanë shansin të përdorin disa strategji që nxisin fëmijët të përdorin modele për të prerë, ngjitur dhe krijuar mjete transporti. Po ashtu mund të realizojnë nëpërmjet palosjes së letrës anije apo avionë dhe më pas të provojnë t'i bëjnë të qëndrojnë mbi ujë ose t'i hedhin në ajër.</li> <li>• Një aktivitet tjetër është vizatimi e një treni në letër të madhe tabak dhe ngjyrosja apo plotësimi me ngjitje me figura personazhesh të ndryshme. Po ashtu fëmijët mund të përpiqen të eksperimentojnë përmes ngjyrave duke diskutuar edhe se cilat janë ngjyrat më të përdorshme të mjeteve të transportit</li> <li>• Muzika dhe këngët për mjetet e transportit janë të shumta dhe mjaft popullore. Nën melodinë e tyre fëmijët mund të vallëzojnë si mjete transporti</li> <li>• Së fundmi mësuesja mund të përdorë trenat lodër për t'i argëtuar fëmijët dhe për të diskutuar me ta udhëtime imagjinare</li> </ul> <p><b>Tregimi i trenit lodër</b></p> <p>Jam një tren, ama, tren lodër Që s'kam parë mal e kodër</p> <p>S'kam kaluar lumë e urë As tunel, nuk kam parë kurrë</p> <p>Si çdo tren lëviz mbi shina Mbi traversa me perçina</p> <p>Nuk kam ndenjësë me sfungjerë, S'udhëtojnë pasagjerë</p> <p>Më kurdisin-fluturim Zë vrapoj përmbi qilim</p> <p>Shkoj e vij, s'lodhem si era Shëtis me lodrat e tjera</p>	<p>Plastelinë me ngjyra të ndryshme, Letër, Gërshërë, ngjitëse, Lapsa me ngjyra, bojëra uji</p> <p>CD me muzikë dhe këngë për trenin</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Edukimi fizik dhe shëndeti</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Të mësuarit për të ngarë biçikletën monopatinë dhe të tjera mjete sportive për fëmijë, Bërja e vizitave në mjedise të ndryshme ku fëmijët luajnë dhe argëtohen, zhvillojnë sporte etj</p>	<p>Udhëtimet janë pjesë e rëndësishme e aktivitetit fizik. Duke vizituar qytete dhe fshatra të vendit, por edhe jashtë tij, fëmijët provojnë të bëjnë lëvizje të shumta që u forcojnë muskujt dhe i bëjnë ata aktivë në jetën e përditshme. Ju mund të flisni rreth mjediseve që ata vizitojnë kur shkojnë në vende të tjera, shëtitje që bëjnë në një mal ose në bregdet, ajrin e pastër që thithin, kënaqësinë estetike që provojnë nga bukuritë natyrore. Mësuesja mund të kalojë nga mjetet e transportit të përgjithshëm në gjëra që janë më të lidhura me fëmijët si biçikleta, monopati etj.</p> <p>Tema e shëndetit me fëmijët mund të fokusohet te:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjenjat dhe emocionet që ata provojnë gjatë udhëtimeve, por edhe para dhe pas</li> <li>• Mbresat që u kanë lënë udhëtime të ndryshme</li> <li>• Përdorimi i mjeteve të transportit si aeroplani dhe anija kur i kanë për herë të parë</li> </ul> <p>Aktiviteti fizik mund të përqendrohet në mësimin e biçikletës apo monopatinës etj</p>	<p>Foto, postera, mjete sportive për fëmijë si biçikletë dhe monopatinë</p>
<p><b>Për fëmijët me nevoja të veçanta</b></p>	<p>Në grupin e fëmijëve flitet edhe për njerëzit apo fëmijët që udhëtojnë me karrocë invalidi për shkak të sëmundjeve të ndryshme. Jepen pamje të mjediseve të përshtatura për kalimin e karrocës dhe tregohen ngjarje që lidhen me ndihmën dhe komunikimin e mirësjelltë me ata që janë përdorues të këtij mjeti transporti</p>	<p>Foto dhe libra, postera dhe fletëpalosje për fëmijët me nevoja të veçanta</p>

## TRENI



Ndiq pikat dhe shkruaj numrat nga 1 te 10. Pastaj ngjyrose trenin dhe numëro vagonët. Cilët po udhëtojnë me tren?

## TRANSPORTI



**DETI**



**TOKA**



**AJRI**



Lidhni figurën me fjalën që tregon mjedisin ku ato lëvizin.

## II. NGJYRAT

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Hyrje</b></p>	<p>Planifikimi dhe organizimi i procesit edukativ në kopsht, sipas fushave të veprimtarisë, është i suksesshëm dhe i dobishëm kur temat që përzgjidhen janë motivuese për fëmijët. Një prej tyre është tema e ngjyrave. Ngjyrat janë të pranishme dhe e shoqërojnë fëmijën kudo. Gjuha e ngjyrave është në vetvete një gjuhë e vërtetë nëpërmjet të cilës fëmija shpreh dhe komunikon, por nga ana tjetër është edhe një element themelor i veprimtarisë grafike. Fëmija ka një informacion shumë të pasur ndijor rreth ngjyrave dhe kjo përbën një bazë të mirë motivuese për mësuesen që të organizojë një projekt rreth ngjyrave.</p>	<p>Objekte me ngjyra të ndryshme, letra, bojëra, plastelinë, katrorë, rrrathë dhe trekëndorë në formën e petëzave me ngjyra të shumëllojshme etj</p>
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Zhvillimi i aftësive perceptuese</p> <p>Të vepruarit konkret për :</p> <p>Përdorimin në mënyrë krijuese të ngjyrave dhe materialeve në dispozicion</p> <p>Zhvillimin e aftësive për të projektuar dhe realizuar një veprimtari</p>	<p>Veprimtaritë që po ju paraqesim, synojnë që t'i përqasin fëmijët në mënyrë globale me ngjyrat. Këto veprimtari duhet të jenë krejtësisht të lira në kuptimin që fëmija të shprehë lirshëm mendimin e tij në raport me ngjyrat. Është shumë e rëndësishme të stimulohet dhe të nxitet interesi i fëmijëve nëpërmjet materialeve të shumta si dhe përdorimi i teknikave të ndryshme, gjithmonë të reja që nxisin procesin e kërkimit në fushën e përzierjes së ngjyrave. Gjithashtu është e nevojshme të ngulet këmbë në përvetësimin e sjelljeve dhe zakoneve korrekte të fëmijëve në përdorimin e ngjyrave.</p> <p><b>Përdorimi i teknikave të ndryshme</b> Nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme mësuesja i jep mundësi fëmijës të perceptojë dhe të veprojë me ngjyrat.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fëmijëve u vihen në dispozicion ngjyra të ndryshme (mirë do të ishte përdorimi i bojërave të ujit ose temperë), një tabak i madh letre dhe copa sfungjeri. Mësuesja i fton fëmijët të përdorin ngjyrat me dorë dhe me sfungjer. E vetmja këshillë që u jepet atyre është që të mos përdorin të njëjtin sfungjer për ngjyra të ndryshme dhe të fshijnë duart para se të përdorin një tjetër bojë uji apo temperë.</li> <li>• Mësuesja u ofron fëmijëve përdorimin e tabakasë për të nxitur veprimin e përzierjes së bojërave. Gjithashtu ajo identifikon këto përzierje me</li> </ul>	<p>Lapsa, lapustina, temperë, bojëra uji të ngjyrave të ndryshme Letër A4, tabak letre. Copa sfungjeri Rrjet teli ose kullojës me rrjet teli.</p>






Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>fëmijën që i ka përgatitur. Në këtë veprimtari përdoren penela të trashësive të ndryshme. Mësuesja u ofron fëmijëve fleta me madhësi të ndryshme, gjithashtu mund të përdorë dhe forma të ndryshme gjeometrike, (shabllon katrori, drejtkëndori, trekëndëshi, rrethi, formë ovale) të cilat mund të përdoren nga fëmijët (p.sh. një trekëndësh mund të shërbejë si trupi i një kukulle, katrori si shtëpi dhe trekëndëshi si çati e saj etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitet tjetër që mbart elemente të eksperimentimit është përdorimi i fletëve të ngjyrosura për të konstatuar efektin që kanë bojërat në këto fletë. Vazhdimi i mëtejshëm i procesit të kërkimit rreth ngjyrave vijon me përdorimin e teknikave të ndryshme grafike dhe vizatimore si p.sh. sprucimi (merret një rrjetë teli e cila është lyer me bojë dhe shkundet mbi sipërfaqen e letrës), mozaiku i ngjyrave etj. dhe stimulohen fëmijët të realizojnë vizatime apo piktura tematike në grup të vogël.</li> </ul>	
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Të fokusojë vëmendjen e fëmijëve në elemente që kanë ngjyrë.</p> <p>Të pasurohet fjalori i fëmijëve me emërtimet e ndryshme të ngjyrave</p>	<p>Mësuesja përzgjedh një përrallë, tregim apo vjershë ku ngjyrat janë të pranishme. Më poshtë po japim një tregim të shkurtër, por mësuesja mund të tregojë dy ose tre versione të ndryshme përrallash ose tregimesh.</p> <p><b>Goni dhe tullumbacja e kuqe</b></p> <p>Goni si të gjithë fëmijët e botës i pëlqente tullumbacet. Sa herë që kalonte në park i thoshte shitësit të tullumbaceve: “më jep tullumbacen më të madhe”, burri tundte kokën dhe i thoshte, je shumë i vogël për këtë tullumbace kaq të madhe, është e rrezikshme. Por Goni nuk donte t’ia dinte për rrezikun.</p> <p>Një ditë Goni bleu tullumbacen më të madhe, por sapo e mori në dorë, këmbët ju shkëputën nga toka. “Hej, ku po më çon tullumbace e kuqe?” filloi të thërriste Goni duke u ngritur lart në qiell. Por tashmë ishte shumë vonë për t’u kthyer mbrapsht. Atëherë, Goni shtrëngoi fort fillin e perit dh e la veten që të ngrihej lart e më lart.</p> <p>Duke parë poshtë mendoi: “Oh sa bukur është të fluturosh. Sa ndryshe duket toka nga sipër”.</p>	<p>Letër të bardhë, Bojëra uji, penel, lapsa me ngjyra, lapustina me ngjyra</p> <p>Ilustrime të përrallave</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
Të ndihmojë zhvillimin e të folurit verbal si dhe të nxisë të folurin jo verbal.	<p>Goni me tullumbacen e kuqe fluturoi afër zogjve, reve, madje pa nga afër aeroplanët që udhëtonin me shpejtësi.</p> <p>Filloi të errësohej dhe yjet mbushën qiellin. Papritur tullumbacja u përplas me një yll dhe plasi. Goni filloi të binte me shpejtësi shumë të madhe tamam si gur. Oboboooo, do të bëhem copë e thërrime -mendoi Goni i tmerruar. Por në vend që të përplasej në tokë, Goni ra mbi një mullar bari të butë. “Je me fat” -i tha mullari i Gonit. “Me të vërtet jam me fat, jam fëmija i parë që ka fluturuar me një tullumbace të kuqe”</p> <p><b>Bisedë e udhëhequr</b></p> <p>Bazuar në tregimet apo vjershat që janë treguar në klasë, mësuesja nxit bisedën me fëmijët dhe i orienton ata në analizën e karakteristikave të personazheve dhe veprimet e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I nxit të krijojnë situata të reja në të cilat mund të veprojnë këto personazhe apo të imagjinojnë një fund tjetër të tregimit.</li> <li>• I fton fëmijët të vizatojnë situatën që kanë krijuar dhe në varësi të produktit përfundimtar i drejton pyetjet për të shpjeguar se përse kanë përdorur një ngjyrë apo një tjetër</li> <li>• U kërkon fëmijëve të përmendin sende të tjera që kanë të njëjtën ngjyrë si të personazheve apo sendeve të përmendura në tregimet.</li> <li>• I fton fëmijët që brenda një kohe të caktuar të gjejnë sa më shumë objekte, në mjedisin përreth me një ngjyrë të caktuar dhe të flasin për karakteristikat e ngjyrës.</li> </ul>	
<p><b>Matematika</b></p> <p><b>Konceptet</b> Numër, Masë I madh, i vogël</p>	<p>Fëmijët kanë dëshirë të zgjedhin, të krahasojnë, të klasifikojnë, të rendisin sepse kjo veprimtari u jep mundësi të kontrollojnë dhe të venë rregull në sendet që i rrethojnë.</p> <p>Mësuesja shfrytëzon këtë dëshirë për t'i nxitur fëmijët të realizojnë veprimtari krahasuese në bazë të formës, ngjyrës, madhësisë së objekteve.</p>	<p>Figura gjeometrike të madhësive të ndryshme dhe të ngjyrave të ndryshme. Lapsa me ngjyra</p>
<p><b>Arte</b></p> <p><b>Konceptet</b> Dallimi i tonaliteteve të ngjyrës</p>	<p>Fëmijët duhet të perceptojnë se e njëjta ngjyrë ka tonalitete të ndryshme. Për të realizuar këtë u kërkohet fëmijëve të sjellin nga shtëpia sende të ndryshme të së njëjtës ngjyrë p.sh. e kuqe, e verdhë dhe blu.</p> <p>Në një tabak të bardhë, të ndarë në tre rreshta ku në secilën prej tyre është ngjyrosur një njollë e kuqe,</p>	<p>Tabak i bardhë, lapsa me ngjyrë, letër transparente, bojëra uji, patate,</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p>Eksperimentimi i teknikave të ndryshme të ngjyrit</p>	<p>e verdhë dhe blu, ftohen fëmijët të vendosin sendet e sjella sipas ngjyrës. Në këtë mënyrë veprohet edhe për ngjyrat bazë apo dhe ngjyrat e tjera.</p> <p>Përmes këtij procesi mund të bëhet një album kolektiv ose individual ku fëmijët të rreshtojnë sendet sipas ngjyrës dhe tonalitetit të tyre.</p> <p>Me bojërat që prodhohen, mësuesja i fton fëmijët të lyejnë fetat e patates se qëruar për të vëzhguar se çfarë ndodh.</p> <p>Fëmijëve u vihen në dispozicion letra transparente në mënyrë që t'i lyejnë. Mësuesja u sugjeron të shohin nëpërmjet tyre, t'i mbivendosin etj.</p> <p>Në fushën e muzikës dhe vallëzimit mund të përdoren gjithashtu këngë për ngjyrat, vallet për stinët duke veshur çdo personazh me ngjyrat përkatëse etj</p>	<p>letra me ngjyrë për bërjen e punëve të ndryshme aplikative etj.</p> <p>CD me muzikë dhe këngë, veshje me ngjyra për kërcim etj</p>
<p><b>Sociale</b></p> <p><b>Aftësitë sociale dhe personale</b></p> <p>Përforcimi i aftësive bashkëpunuese për arritjen e një qëllimi të përbashkët</p> <p>Zhvillimi i aftësisë së përdorimit të lëvizjeve të kontrolluara të dorës.</p> <p><b>Vlera:</b></p> <p>Bashkëpunimi</p>	<p>Fëmijët ndahen në 4-5 grupe të vogla. Para se të fillojnë punën mësuesja u shpjegon se duhet të realizojnë një vizatim të përbashkët, secili grup.</p> <p>Në secilën tavolinë është vendosur një tabak letre dhe ftohen fëmijët të bëjnë një vizatim të përbashkët. Temën e vizatimit do ta zgjedhin vetë fëmijët. Për të lehtësuar punën mësuesja ndalet në secilën tavolinë dhe i udhëzon se si duhet të bashkëpunojnë dhe si të përcaktojnë vendin përkatës në fletën e tabakut ku dot të punojë gjithsecili.</p> <p>Mësuesja duhet të ndalet në disa çështje që lidhen me bashkëpunimin e fëmijëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I detë e secilit krijojnë idenë e përbashkët të grupit. Fëmijët duhet të respektojnë idetë e të tjerëve për të bërë një punë të mirë</li> <li>• Secili fëmijë mund të bëjë diçka të ndryshme nga tjetri më mirë. Së bashku ata mund të realizojnë një gjë më mirë se veçmas</li> <li>• Kur punojmë së bashku nuk duhet të kemi zili njëri-tjetrit dhe të grindemi sepse na pëlqen më shumë vetja. Kjo është një cilësi që dëmton bashkëpunimin. Mësuesja mund të përdorë një histori ose përrallë që ilustron dëmin që sjell zilia në punën në grup.</li> </ul>	<p>Tabak kartoni (lapsa, lapustina, bojëra uji etj.), letër ngjitëse me ngjyrë, letër me shkëlqim dhe me ngjyrë, ngjitëse dhe gërshtë.</p>
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p>	<p>Për t'i familjarizuar me ngjyrat e ndryshme mësuesja mund të përdorë me fëmijët aktivitetet e përditshme të lojës në mjedise të ndryshme të kopshtit, brenda dhe jashtë.</p> <p>Topat, veshjet e sportit, tapetet e palestrës apo të</p>	<p>Postera për shëndetin me ngjyra të ndryshme, Lodra dhe topa me ngjyra, birra etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Aftësitë</b> Të mësuarit për t'u fokusuar në ngjyrat e mjediseve të ndryshme ku fëmijët luajnë dhe argëtohen, zhvillojnë sporte etj</p>	<p>shesheve të lojës japin mundësi që ju të përforconi nocionet e disa ngjyrave bazë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendosni në mjedisin e lojës disa topa me ngjyra të ndryshme. Kërkojuni fëmijëve tua pasojnë topat duke i thënë më parë: Më hidh topin e kuq! Prite topin e verdhë!</li> <li>• Një alternativë tjetër loje është ajo me birrila duke i caktuar secilës skuadër ngjyra të ndryshme të veshjeve sportive apo të shenjave dalluese sikurse mund të jetë një rreth i gjelbër apo i kaltër që fëmijët duhet të mbajnë në krahë. Përdorimi i treguesve të tillë si: Çfarë ngjyra kanë birrilat e rrëzuar? Po ato që mbetën në këmbë?</li> <li>• Ngjyrat mund të mbeten në fokus indirekt kur ju shpjegoni koncepte që lidhen me shëndetin. Përse ndryshon ngjyrë lëkura jonë kur vjen vera? Po kur kemi temperaturë?</li> </ul>	

## Shkruani nga 4 tek 6



Ndiqni pikat me lapsat me ngjyrën e figurave. A i njihni numrat që po shkruani?


## Punë dore me letra me ngjyrë



Ngjyrosni figurat e prera nga shoku juaj. Tregoni ngjyrat që keni përdorur.

## Ngjyrat e Stinës

# Pranvera




# Vjeshta





# Vera





Cilat janë ngjyrat e dimrit dhe të pranverës? Plotësoni me ngjyrat e tyre pikturat e stinëve. Rrethoni shkronjën e përbashkët në emrin e stinëve.

## 12. BIBLIOTEKA

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Hyrje</b></p>	<p>Gjatë viteve të parashkollorit fëmijët kanë kontakte të shumta me librat, revistat dhe materiale të tjera të shkruara. Gradualisht ata mësohen të shkojnë në qendrën e librit në grup dhe të shfletojnë një libër për ta “lexuar” duke parë figurat, ilustrimet dhe duke bërë interpretimet e tyre.</p> <p>Mësuesja duhet të shfrytëzojë pikërisht këto kontakte për të zhvilluar së bashku me ta projektin e bibliotekës, nëpërmjet të cilit fëmijët njihen më mirë me librin dhe familjarizohen me të aq sa duhet për t’i dhënë jetë ndjenjës së dashurisë për librin dhe kënaqësisë së të lexuarit.</p> <p>Si hyrje mund të shërbejë leximi i një libri ose biseda rreth librit të fundit që prindërit u kanë lexuar fëmijëve të grupit.</p>	<p>Libra, revista me ilustrime, një qendër e librit e pajisur me tabelë të re dhe e ndryshuar si infrastrukturë etj.</p>
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p><b>Aftësitë</b></p> <p>Zhvillimi i dëshirës së fëmijëve për të lexuar librin me mënyrat e tyre</p> <p>Pasurimi i fjalorit të 4-vjeçarëve dhe nxitja e dashurisë dhe respektit për librin si dhe e mirëmbajtjes së tij</p>	<p>Librat janë një burim shumë i vlefshëm për të zhvilluar gjuhën dhe komunikimin te fëmijët e kopshtit. Leximi i librave duhet të bëhet një veprimtari e përditshme; ai i shërben jo vetëm zhvillimit të fantazisë së fëmijëve, por edhe pasurimit të fjalorit, ndërtimit strukturor të fjalive të 4-5 vjeçarit dhe tërë formimit gjuhësor të tij.</p> <p>Çdo grup, pavarësisht moshës së fëmijëve që e përbëjnë, duhet të ketë si bazë të punës së tij qendrën e librit, e cila mund të krijohet thjesht dhe në mënyrë tërheqëse duke ekspozuar libra, revista dhe materiale të tjera të shkruara, të gjitha të vendosura në lartësinë e fëmijëve me qëllim që ata të mos kenë vështirësi në marrjen e tyre.</p> <p>Mësuesja përzgjedh një përrallë, tregim apo vjershë ku flitet për librat dhe raportin që kanë fëmijët me ta dhe më pas diskuton me fëmijët lidhur me: sa libra kanë në shtëpi, kush ua dhuron dhe kush ua lexon, ku i vendosin, a kanë qenë ndonjëherë në librari dhe bibliotekë, si i zgjedhin librat që pëlqejnë etj.</p> <p>Mësuesja mund të përdorë disa strategji në projektin e bibliotekës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mbledhja e librave të ndryshëm</b> nëpërmjet thirrjes që mund t’u bëjë fëmijëve ose prindërve të tyre për krijimin e bibliotekës së kopshtit.</li> </ul>	<p>Libra, revista, letër e bardhë, ngjitëse, figura të prera, karta etj.</p> <p>Qendra e librit ose biblioteka e grupit</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Një vizitë në bibliotekën e qytetit apo të lagjes.</b> Nëse ky institucion mungon, mund të përdoret edhe biblioteka e një shkolle apo universiteti ku fëmijët të mund të bashkëbisedojnë me bibliotekaren dhe lexuesit etj.</li> <li>• <b>Takim me një shkrimtar ose person tjetër</b> të specializuar në lëmin e librit. Fëmijët mësojnë se si bëhet një libër: si shkruhet, si ilustrohet, ku shtypet, ku shitet etj.</li> <li>• Organizimi i një <b>pasditeje speciale për inaugurimin e bibliotekës</b> së grupit ku të ftohen të marrin pjesë prindërit së bashku me fëmijët e tyre dhe “leximi” i disa pjesëve të thjeshta dhe të shkurtra nga fëmijët me mënyrën e tyre (p.sh. lexim figurash, tregim i përrallës me ilustrime nga libri etj.).</li> <li>• Zhvillimi i një <b>teatri mbi përmbajtjen e një libri</b>, krijimi i personazheve dhe i mjedisit, veshja e tyre, dialogu etj. Përzgjedhja e pjesës duhet t’u lihet në dorë fëmijëve duke i vënë ata të shohin disa libra dhe duke vendosur mbi bazën e diskutimit të tyre lidhur me cili u pëlqen më shumë.</li> <li>• Krijohet <b>rutina e përditshme e leximit të librit</b> në rreth për 10 deri në 15 minuta, para pushimit të drekës. Duke bërë një kalendar paraprak dhe një listë me emrat e fëmijëve, mësuesja i kërkon çdo ditë njërit prej tyre që të zgjedhë librin që do të lexojë atë ditë.</li> <li>• Në kërkesat e saj, mësuesja mund të përfshijë mësimin përmendsh të një vjershe, tregimin e një përralle apo historie, thënien e gjëzave të ndryshme, shfletimin jo vetëm të librave letrarë por edhe të revistave shkencore për të vegjël dhe për të rritur duke nxitur kështu familjarizimin me të gjithë llojet e librave dhe revistave. Në bibliotekë mund të përfshihen po ashtu dhe postera, karta me figura si dhe materiale të tjera të shkruara.</li> </ul>	
<b>Shkencë dhe vëzhgim</b>	<p>Veprimtaritë që po ju paraqesim, synojnë që t’i qasin fëmijët me njohjen e librave të ndryshëm që kanë në përmbajtjen e tyre njohuri nga shkenca dhe teknika. Këto veprimtari duhet të jenë krejtësisht të lira, në kuptimin që fëmija të shprehë lirshëm mendimin e tij në lidhje me figurat dhe leximin e tyre. Është</p>	<p>Libra dhe revista shkencore me përmbajtje: universin, mjetet mekanike, natyrën me bimët dhe kafshët etj.</p>


Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Konceptet</b> Universi Mjete mekanike Natyra me bimët dhe kafshët</p> <p><b>Aftësitë</b> Zhvillimi i aftësive perceptuese Klasifikimi</p>	<p>shumë e rëndësishme të stimulohet dhe të nxitet interesi i fëmijëve nëpërmjet materialeve të shumta, gjithmonë për të zhvilluar procesin e kërkimit në fushën e shkencës.</p> <p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b> Nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme, mësuesja i jep mundësi fëmijës të perceptojë dhe të veprojë me konceptet shkencore të librave dhe revistave.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Fëmijëve u vihen në dispozicion libra dhe revista të ndryshme (mirë do të ishte që të përmbanin sa më shumë ilustrime), një tabak i madh letre dhe gërshtë. Mësuesja i fton fëmijët të ngjisin me ndihmën e saj, figurat në tabakun e letrës, të renditura në kolona.</li> <li>Mësuesja u ofron fëmijëve përdorimin e tabakasë të mbushur me figura për të nxitur <b>klasifikimin e fushave të ndryshme të shkencës</b>, si p.sh. natyra, universi, mjetet mekanike etj. Gjithashtu ajo identifikon edhe format e këtyre figurave së bashku me fëmijët gjatë prerjes me gërshtë dhe ngjitjes në tabakun e letrës. Në këtë veprimtari, mësuesja u ofron edhe fëmijëve fleta me madhësi të ndryshme. Ajo gjithashtu mund të përdorë forma të ndryshme gjeometrike, (shabllon katrori, drejtkëndori, trekëndëshi, rrethi, formë ovale) të cilat mund të shfrytëzohen nga fëmijët (p.sh. një trekëndësh mund të shërbejë si sfond ku ngjitet një pemë ose lule, katrori për makinën, shablloni oval për ngjitjen e yjeve etj.)</li> <li>Veprimtari tjetër që mbart elemente të eksperimentimit është <b>krijimi i një libri të shkencës</b> duke përdorur fletë të ngjyrosura dhe figura që ngjiten mbi to. Vazhdimi i mëtejshëm i procesit të kërkimit rreth elementeve të shkencës në libra dhe revista të ndryshme vijon me përdorimin e teknikave të ndryshme grafike dhe vizatimore si p.sh. vizatimi i diellit dhe i tokës, mozaiku i mjeteve të transportit etj. dhe stimulohen fëmijët të realizojnë vizatime apo piktura tematike në grup të vogël, mbështetur mbi klasifikimin e bërë paraprakisht nga mësuesja.</li> </ul>	<p>Objekte natyrore si gjethe dhe lule të thara, figura mjetesh transporti, karta me kafshë dhe bimë të llojeve të ndryshme etj.</p> <p>Guaska, gurë, boça pishash, copa tekstili etj.</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Një veprimtari që zë shumë vend në kopshtin e fëmijëve është dhe bërja e <b>librit të koleksionit</b> mbi një temë të caktuar që zakonisht merret nga fusha e shkencës dhe ka si përmbajtje mbledhjen dhe ngjitjen në libër të objekteve nga natyra, transporti, pushimet verore etj.</li> </ul>	
<p><b>Artet</b></p> <p><b>Aftësitë</b></p> <p>Të fokusojë vëmendjen e fëmijëve në ndërtimin e bibliotekës së kopshtit, bërjen e një libri në format artistik, përdorimin e etiketave të ndryshme etj.</p> <p>Këngë për librin</p>	<p>Fusha e arteve jep mundësi krijuese të pafundme. Fëmijët me fantazinë dhe dëshirën e madhe për të vizatuar marrin përsipër të bëjnë librat e tyre, të vizatojnë kopertinat me emrin e tyre si autor etj</p> <p>Mësuesja i orienton ata drejt ndërtimit apo pasurimit të bibliotekës së grupit, në varësi të gjendjes në të cilën ajo është.</p> <p>Më lart u përmendën një sërë strategjish që mund të ndikojnë në ndërtimin dhe pasurimin e bibliotekës në grup si p.sh. mbledhja e librave nga prindërit, organizimi i një takimi me një punonjës të librit, etj. Tanimë ju keni të renditura edhe strategji të tjera që ndihmojnë në realizimin e qëllimit të projektit të fëmijëve: të kenë një bibliotekë sa më të pasur në grupin e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Sillni në grup libra të ilustruar dhe vendosini ato në tryezat e punës së fëmijëve. Udhëzoni fëmijët t'i shohin me vëmendje dhe më pas pyetini në se grupet e vogla mund të përgatisin nga një libër të ngjashëm me atë që kanë përpara</li> <li>Kërkojuni fëmijëve të hartojnë një listë me gjërat e nevojshme <b>për të bërë një libër</b> dhe më pas ju i shkruani nevojat që ata paraqesin në tabelë, duke i plotësuar tryezat e punës me letrën e duhur, lapsat me ngjyra, kapëset apo hapëset e vrimave, spangon apo ngjitësen etj. Po ashtu ju i ofroni fëmijëve figura të mjaftueshme për të plotësuar librin e tyre me vizatime, shkronja, zburime si flamurë të vegjël, lule të thara etj. Pas përfundimit të librave nga grupet mësuesja u kërkon fëmijëve të gjejnë një titull për librin e tyre. Vetëm pas gjithë këtij procesi bëhet demonstrimi i librave nga një fëmijë i çdo grupi dhe më pas vendosja e tyre në bibliotekë. Mësuesja shton në listën e librave të bibliotekës edhe titujt e rinj që fëmijët kanë dorëzuar për pasurimin e bibliotekës së kopshtit</li> <li>Festa e librit mund të shërbejë si një veprimtari përmbyllëse e projektit. Për këtë festë fëmijët</li> </ul>	<p>Letër të bardhë, bojëra uji, penel, lapsa me ngjyra, lapustin me ngjyra, ngjitëse, fjongo,</p> <p>Ilustrime të përrallave dhe tregimeve, shkronja, zburime të ndryshme</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>përgatiten paraprakisht duke mësuar këngë dhe valle, dukë bërë prova teatri, duke zbukuruar mjediset ku do të zhvillohet festa etj. Gjatë festës së librit mësuesja së bashku me fëmijët flasin për hapat që kanë hedhur gjatë projektit, çfarë kanë mësuar për librin dhe bibliotekën. Kjo festë do të ishte një ngjarje e shënuar në qoftë se mësuesja së bashku me prindërit kanë rënë dakord që në këtë festë t'i bëjnë secilit fëmijë si dhuratë një libër, të mbështjellë në pako me fjongo. Fëmijët do të njihen me librat e dhuruar, mund t'i shkëmbejnë me njëri-tjetrin dhe kjo është mbase mënyra më e mirë për t'i mbajtur ata në kontakt të vazhdueshëm me një mjet sa edukativ, aq dhe social saç është libri.</p>	
<p><b>Matematika</b></p> <p><b>Aftësitë :</b> Numërimi, madhësitë,  Klasifikimi</p>	<p>Projekti i krijimit të bibliotekës i ofron matematikës shanse të shumta për të përforcuar aftësitë e numërimit, klasifikimin e librave sipas fushave, formateve të tyre të mëdha ose të vogla, të gjata ose të shkurtra, të hollë ose të trashë etj</p> <p>Nëpërmjet veprimtarive të përditshme me librin mësuesja mund të ndalet gjithnjë te numri i librave që kanë në grup, tek ndarja e tyre sipas formateve, te madhësia e rafteve dhe ndarjeve të bibliotekës, te forma e etiketave, te kartelat e fëmijëve dhe numri i librave “të lexuar” nga ta etj</p>	<p>Libra në formate të ndryshme, raft biblioteke me ndarje të madhësive të ndryshme etj</p>
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p> <p><b>Aftësitë:</b> Kujdesi për qëndrimin e trupit gjatë leximit</p> <p>Koordinimi i veprimtarisë mendore me aktivitetin fizik</p> <p>Kujdesi për sytë</p>	<p>Edukimi me dashurinë për librin është një qëllim i mirë i parashkollorit, por së bashku me këtë qëllim, mësuesja e parashkollorit duhet të synojë të mësojë të fëmijët dhe shprehitë e mira të përdorimit të librit, në mënyrë që ai t'i shërbejë si shëndetit mendor të fëmijës 4-5 vjeçar dhe atij fizik. Shpesh fëmijët e përqendruar vetëm te libri shfaqin shenja të mos dëshirës për t'u marrë me aktivitet fizik, lojëra ndërvepruese, mjaft të nevojshme për moshën e tyre. Po ashtu mësuesja gjatë projektit të librit ka kohë të ndalet në teknikat dhe qëndrimin e fëmijës në të lexuar, shfletuar apo parë figurat. Ajo duhet t'ua bëjë të qarta të gjithë fëmijëve rregullat e mbajtjes së trupit gjatë leximit, kujdesin për sytë dhe distancën që duhet vendosur libri nga sytë etj.</p> <p>Mësuesja sipas rrethanave mund të përfitojë për të sjellë në klasë edhe libra që flasin për shëndetin dhe kujdesin ndaj tij. Pjesë e edukimit me materialet</p>	<p>Libra me temë shëndetin, Postera, karta me figura për lojërat dhe pjesët e trupit të njeriut etj</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	e bibliotekës janë dhe shpjegimet që jepen për posterat, kartat me figura etj. që kanë në fokusin e tyre shëndetin dhe zhvillimin fizik	
<p><b>Shkencat sociale</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Kujdesi për librin dhe mirëmbajtjen e tij</p> <p>Respektimin e radhës</p> <p>Rregullat e bibliotekës</p>	<p>Të edukosh dhe ta bësh fëmijën ta dojë librin është me përfitim të madh edhe nga pikëpamja sociale. Fëmijët e edukuar me ndjenjën e afërsisë me librin shihen të bëhen të rritur më socialë, ndihmës dhe në përgjithësi më idealistë se të tjerët. Studimet tregojnë se janë modelet që ndërveprojnë me fëmijët dhe krijojnë personazhet pozitivë që ata duhet të ndjekin.</p> <p>Në fushën e shkencave sociale mësuesja bashkë-bisedon me fëmijët rreth tri çështjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kujdesit që duhet treguar për librat (mirëmbajtjen kur grisen qoftë edhe pa dashur, mos shkarravitjes, prerjes së figurave pa pyetur të rriturit etj.). Ajo mund të zhvillojë veprimtari për ngjitjen dhe riparimin e tyre, vendosjen në rregull në raftet e bibliotekës etj.)</li> <li>• respektimit të radhës kur dëshirojmë të marrim një libër. Fëmijëve u tregohet se kur është momenti i leximit nuk duhet të vrapojnë të gjithë për të marrë të njëjtin libër, por duhet të respektojnë radhën e vendosur së bashku. Po ashtu nuk duhet të grinden me njëri-tjetrin për të tërhequr të njëjtin libër por të krijojnë marrëveshje për kohën kur duan ta kenë në dispozicion librin</li> <li>• rregullat e bibliotekës janë një tjetër element i domosdoshëm për të qenë pjesë e veprimtarive të shkencave sociale dhe mund të përqendrohen në: tërheqjen e librit nga mësuesja me një kartelë të thjeshtë, kohën e dorëzimit dhe korrektësinë e respektimit të saj, ruajtjen e qetësisë që edhe të tjerët të mund të lexojnë etj.</li> </ul>	
<p><b>Aftësi njohëse</b></p>	<p>Për fëmijët që e kanë të vështirë të dëgjojnë leximin e një përralle apo të një libri për një periudhë të caktuar, ose që kanë vështirësi të tregimit e asaj çka u lexohet mund të improvizoni bërjen e një libri të thjeshtë duke kërkuar dhe ndihmën e fëmijëve të tjerë.</p> <p>Prisni figura që janë pjesë e një përralle, ndodhie dhe ngjitini në librin që po krijoni sipas radhës së ngjarjeve. Me gishtin e fëmijës tregoni përrallën sipas figurave përkatëse.</p>	







Tregoni gjërat e përbashkëta dhe të ndryshme të figurave të mësipërme.  
Ngjyrosni figurat që ndodhen më lart.

## 13. NË DYQAN

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Hyrje</b></p>	<p>Në moshën 4-5 vjeçare, tek fëmijët shfaqet së tepërmi dëshira për të hyrë në dyqane të ndryshme dhe për t'u njohur me mallrat që shiten aty. Edhe fëmijët që ndodhen jashtë sistemit të parashkollorit dhe e kalojnë pjesën më të madhe të kohës në rrugë përfshihen shpesh në lojërat e improvizuara të një dyqani ku ka një peshore, një arkë me lekë dhe mjaft mallra për t'u tregtuar. Duke pasur kontakte të shumta me këto mjedise, ata duken si profesionistë në organizimin e kësaj loje me role, gjatë së cilës materialet e përdorura janë rrethanore dhe të larmishme.</p> <p>Mësuesja duhet të shfrytëzojë pikërisht këto kontakte për të zhvilluar së bashku me ta projektin e dyqanit nëpërmjet të cilit fëmijët njihen më mirë me konceptet e numrit, të peshës, të shkëmbimit të mallrave, të mirësjelljes me të tjerët dhe të bashkëveprimit reciprok.</p> <p>Ju gjithashtu mund t'i edukoni ata edhe lidhur me përmbajtjen dhe korrektësinë në kërkesat përkundrejt prindërve duke u shpjeguar se jo çdo gjë që ndodhet në dyqan mund të blihet nga të rriturit për kënaqësi të tyre.</p> <p>Mësuesja duhet të marrë në konsideratë se jo të gjithë fëmijët mund të arrijnë të kuptojnë çdo instruksion lidhur me lojën me dyqane.</p> <p>Për disa fëmijë është e rëndësishme që këto instruksione apo detyra të ndahen në hapa më të thjeshtë apo të përsëriten disa herë në kohë; kjo i ndihmon ata të arrijnë të fitojnë autonominë dhe shërbimet e nevojshme ndaj vetes dhe të tjerëve.</p>	<p>Banak dyqani, peshore, arkë dhe lekë prej letre, mallra të ndryshëm ushqimorë, veshje, lodra, etiketa çmimesh etj.</p>
<p><b>Gjuha dhe komunikimi</b></p> <p><b>Aftësitë</b> Zhvillimi i komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët</p>	<p>Lojërat me role janë mjaft efikase për të zhvilluar dhe pasuruar fjalorin e fëmijëve të kësaj grupmoshe. Ata mësohen të komunikojnë me njëri-tjetrin duke përdorur në shumë raste shprehje që dëgjojnë nga mjedise të caktuara, si p.sh. "Të lutem, mund të më peshosh 1kg pjeshkë?", "A mund të më japësh një bukë?", "Sa kushton? Faleminderit!"</p> <p>Mësuesja përzgjedh një përrallë, tregim apo vjershë ku flitet për dëshirat dhe nevojat që kanë fëmijët për ushqim, veshje dhe argëtim dhe më pas diskuton me</p>	<p>Lekë letre, reklama me figura, etiketa me çmime, Etiketat HAPUR dhe MBYLLUR, orari</p> <p>Dyqani me pajisjet e tij</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p>Pasurimi i fjalorit të fëmijëve 4-5 vjeçarë me fjalë dhe terma të tregtisë dhe ekonomisë.</p>	<p>fëmijët nëse “mund t’i blejnë njerëzit të gjitha gjërat që janë në dyqan? Pse? Si i zgjedhin fëmijët gjërat që u pëlqejnë?” etj.</p> <p>Mësuesja mund të përdorë disa strategji në projektin e dyqanit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Bashkëbisedimi</b>, nëpërmjet të cilit mund të kuptojë se ç’loj dyqani dëshirojnë më shumë fëmijët të ngrenë në mjedisin e kopshtit, duke parë kështu mundësinë e gjetjes së materialeve të nevojshme për ngritjen e dyqanit në grupin e saj.</li> <li>• <b>Vizita në një nga dyqanet e fshatit apo të qytetit</b>. Vizita mund të bëhet edhe në ndonjë qendër tregtare të madhe për të parë llojshmërinë e dyqaneve që ekzistojnë sot kudo.</li> <li>• <b>Organizimi i një dyqani</b> me të gjitha pajisjet dhe mjetet e nevojshme në një prej këndeve të sallës pritëse brenda kopshtit</li> <li>• Zhvillimi i një <b>loje me role: shitës-klient</b>, krijimi i personazheve dhe i mjedisit, veshja e tyre, dialogu etj. Më pas, mësuesja diskuton me fëmijët mbi rolet që atyre u pëlqyen më shumë.</li> <li>• Krijohet <b>rutina e përditshme e shitjes së mallrave të ndryshme</b> për rreth 10 deri 15 minuta para ngrënies së drekës. Duke bërë një kalendar paraprak dhe një listë me emrat e fëmijëve, mësuesja kërkon prej secilit zgjedhjen e rolit të shitësit apo klientit që do të zhvillojë çdo ditë.</li> <li>• Mësuesja mund të kërkojë prej fëmijëve të monitorojnë veprimet me lekët, çmimet e vendosura nga shitësi, kthimin e kusurit, zgjedhjen e mallit, shërbimin e kulturuar, përdorimin e fjalëve të mirësjelljes etj.</li> <li>• Një strategji tjetër mund të jetë leximi i një vjershe për lodrat që shiten në dyqan dhe diskutimi me fëmijët mbi çfarë u pëlqen më shumë.</li> </ul> <p><b>Qengji i vogël</b></p> <p>Në vitrinë të banakut Afër bubit dhe rosakut Qengji i vogël blegërin Nuk e di ku ka shtëpinë</p> <p>“Këtu s’qenka si në fshat Pula s’ka, as gjel pendartë,</p>	

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>S'ka livadh e as zabele As balash, tufa me dele”.</p> <p>Hedh vështrimin rreth e qark Po ç'të shohë?! Pak më larg Si i fjetur ky traktori Më tej treni dhe zetori....</p> <p>Në vitrinë të banakut Pranë bubit dhe rosakut Blegërin e ka një hall: Të kullotë paska mall!</p> <p>Kërkon gjethe, kërkon bar Ujë të ftohtë qelibar; Në dyqan s'ka pyll e kodër, Na harron që është veç lodër.</p> <p>Ku ka ndodhur kjo çudi? Brenda qengji në kuti Lidhur qafës një kordele Na kërkon tufën me dele.</p>	
<p><b>Matematika</b></p> <p><b>Konceptet dhe aftësitë:</b> Pesha, Matja, Numërimi, Mbledhje dhe zbritje të thjeshta brenda dhjetës</p>	<p>Fusha e matematikës është pothuajse parësore në projektin e dyqanit. Ajo përfshin të mësuarin e koncepteve bazë të peshës, matjes, numërimit, mbledhjes dhe zbritjes. Për të realizuar përmbushjen e qëllimeve matematikore mësuesja mund të ofrojë një larmi veprimtarish.</p> <p><b>Përdorimi i strategjive të ndryshme</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendosni çmimet nga 1 te 10 për të gjitha produktet që do të tregtohen në dyqanin e projektit tuaj. Shpjegojuni fëmijëve që çdo mall duhet të ketë etiketën e vet dhe së bashku me ta plotësoni këtë kriter.</li> <li>• Klasifikoni mallrat në segmente të ndryshme të mjedisit të dyqanit sipas përdorimit, p.sh. ushqime, veshje, lodra, artikuj shkollorë etj.</li> <li>• Pajisni secilin klient me monedha deri në 10 lekë duke i kufizuar blerjet e tyre deri në këtë sasi parash. Monitoroni kthimin e kusurit dhe bërjen e llogarive nga ana e shitësit duke e ndihmuar atë.</li> <li>• Kërkojuni fëmijëve të klasifikojnë mallrat në mallra që peshohen, mallra që maten dhe mallra</li> </ul>	<p>Karta me numra, lekë letre, peshore dhe gurë peshoreje, metër, letër, copë tekstili, kavanoza, qese të mbushura me drithëra etj.</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>që shiten të paketuara. Bëni një bashkëbisedim mbi këtë temë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në përfundim, së bashku me shitësin dhe fëmijët vëzhgues bëni një përmbledhje të mallrave të shitura dhe të lekëve të grumbulluara. Pyetini fëmijët vëzhgues: cila ishte sjellja që ju pëlqeu më shumë dhe cila jo? A u bë ndonjë gabim në blerje, në kthimin e kusurit etj.</li> <li>Ndani rolet për ditën tjetër duke i përfshirë fëmijët në sistemimin e dyqanit, arkës së lekëve dhe gjithçkaje tjetër në mjedisin ku është ngritur dyqani.</li> </ul>	
<p><b>Shkencat sociale</b></p> <p><b>Aftësitë:</b> Shkëmbimi dhe bashkëveprimi, Rregullat e mirësjelljes dhe të edukatës së mirë</p>	<p>Fëmijët mund të fusin në fushën e dijes së tyre njohuri nga historia e shkëmbimit të mallrave që në kohë të lashta përmes tregimeve dhe historive që u përcjell mësuesja në mjediset e dyqanit duke konkretizuar me shembuj faktin se mund të blihet jo vetëm me lekë por edhe me shkëmbim. Më pas, mësuesja ndalet në historinë e lindjes së monedhës që është sot shumë e përhapur dhe që ndryshon nga vendi në vend formën, ngjyrën, madhësinë, emrin etj.</p> <p>Ja disa nga çështjet në të cilat mund të ndalet bashkëbisedimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Çfarë blihet me lekë?</li> <li>Kush bën më shumë blerje në shtëpinë e tyre dhe çfarë blen?</li> <li>Kur kërkojmë të na blejnë diçka, cilat janë fjalët që përdorim?</li> <li>Si na përgjigjet shitësja pas blerjeve?</li> <li>A mund të blejmë pa respektuar radhën?</li> <li>Cilat janë disa nga rregullat që duhen respektuar në një dyqan?</li> </ul> <p>Një strategji tjetër për të folur rreth punës që bëjnë njerëzit në prodhimin e një malli apo produkti mund të jetë leximi i vjershës së mëposhtme dhe më pas diskutimi i ngjarjes:</p> <p><b>Këmisha e Lecit</b> Një ditë Leci Grindaveci, Duke bredhur Pas një keci Nëpër ferra Hopa, hopa E bëri këmishën copa.</p>	<p>Mallra të ndryshme, kartëmonedha të vendit dhe të huaja prej letre, foto, libra dhe revista me historikun e shitjes dhe të blerjes etj.</p>

Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Dhe kur shokët E qortuan Për këmishën që kish grisur Ai tha: Kjo është e vjetër, Mami do më blejë një tjetër!</p> <p>Ah, ti, Lec O grindavec Pa dëgjo Duhet ta dish Sa punëtorë kanë punuar Për ta bërë këtë këmishë:</p> <p>Traktoristi punoi arën Makinistja mbolli farën Pastaj çik e çik Pambuku u rrit.</p> <p>Vjelëset e volën Në makinë e vunë Dhe për ta pastruar Në fabrikë e shpunë</p> <p>Punëtorët e punuan Bukur e pastruan Pastaj kombinatit Shpejt e shpejt ia çuan</p> <p>Dhe në kombinat Punë ditë e natë Pambukun ta shihje E bënë fije-fije</p> <p>Dhe me fijet endën Basma të mira Të bardha, të kuqe Me lule plot ngjyra.</p> <p>Teta rrobaqepëset Plot këmisha qepën Edhe për fëmijë Edhe për të rritur. Shitëset në dyqane Morën për t'i shitur.</p>	




Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Shkencë dhe vëzhgim</b></p> <p><b>Aftësitë :</b> Përbërja e materialeve të ndryshme, Dallimet në mes tyre, Klasifikimi i produkteve/ mallrave</p>	<p>Në fushën e shkencës, mësuesja mund të ndalet në përbërjen e materialeve që shiten në dyqan duke filluar që nga mallrat ushqimore e deri te lodrat.</p> <p>Janë disa strategjitë që sugjerohen të përdoren me fëmijët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fëmijëve u vihen përpara në tryezat e tyre të punës mallra të ndryshme dhe u kërkohet t'i klasifikojnë sipas përdorimit: ushqime, veshje, lodra etj.</li> <li>• Nga çfarë janë të përbëra dhe nga vijën produktet ushqimore në dyqan? (rruga e qumështit, gjalpiti, çokollatave, miellit, bukës, mollëve etj.)</li> <li>• Po lodrat? (plastika, druri, materialet tekstile etj.)</li> <li>• Po veshjet e ndryshme (leshi, lëkura, pambuku etj.)</li> <li>• Përse shërbejnë mallrat e ndryshme?</li> <li>• Më pas mësuesja pyet për dallimet që kanë mallrat midis tyre: p.sh. gjërat ushqimore janë të buta sepse njerëzit nuk mund të ushqehen me gjëra të forta, janë të shijshme sepse duhet të pëlqehen nga njerëzit etj. Bicikleta duhet të jetë e fortë sepse ndryshe prishet po u përplas me objekte të tjera etj.</li> <li>• Në kuadrin e përbërjes dhe funksioneve që kanë mallrat e ndryshme mund të përdoret edhe vjersha e mëposhtme që i jep një mundësi tjetër fëmijëve për të luajtur me kutizën e konstruksionit të blerë në dyqan.</li> </ul> <p><b>Kutiza e konstruksionit</b></p> <p>Sa e këndshme kjo dhuratë Një kutizë konstruktore Me ca pjesë lloje-lloje Ngre plot vepra madhështore...</p> <p>Kopsht ngrita kat më kat Dielli vrap hyri pari, Në oborrin plot me lule Shkëlqen ylli porsi zjarri.</p> <p>Tullë-tullë u rrit godina Fushat mbushur me gjelbërim, Shok me malet, gjer te retë ngre oxhakun që nxjerr tym</p>	<p>Materiale të ndryshme ushqimore, Artikuj veshjeje dhe kuzhine, lodra plastike dhe prej druri etj.</p> <p>Kuti me lodra konstruksioni</p>



Fushat	Udhëzime	Materialet
	<p>Për makinat ngre një urë Dhe për trenin hap tunel Kalanë gurë-gurë Majës saj shqiponja del.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Orientojini fëmijët që të vëzhgojnë gjatë ndërtimit se si duhen vendosur lodrat konstruktive, prej çfarë materiali janë të përbëra në të vërtetë objektet që ata ndërtojnë dhe përse shërbejnë ato, duke përforcuar në këtë mënyrë konceptet dhe aftësitë e vendosura si objektiv në fushën e shkencës.</li> </ul>	
<p><b>Zhvillimi fizik dhe shëndeti</b></p> <p><b>Aftësitë:</b></p> <p>Mbrojtja nga ushqimet e pasigurta dhe produktet e rrezikshme</p>	<p>Projekti i dyqanit përfshin në përmbajtjen e tij edhe edukimin e fëmijëve me çështjen e sigurisë ushqimore që është sot një nga temat më të diskutuara. Duhet të sillen në mjediset e kopshtit ushqime ndaj të cilave fëmijët kanë ndjeshmëri të lartë si karamete, çokollata, patatina, sheqer ose kripë për t'u treguar atyre të metat e kësaj lloji ushqyerjeje. Po ashtu, nga krahu tjetër vendosen karotat, frutat dhe zarzavatet e stinës për të treguar vlerat e tyre. Në veprimtaritë që zhvillon me fëmijët 4-5 vjeçarë, mësuesja fokusohet në objektivat e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Si mund të rritemi mirë fizikisht? (ushqimi, regjimi ditor, ushtrimet fizike etj.)</li> <li>• Si mund t'i mësojmë fëmijët të hanë ushqime të shëndetshme edhe pse mund të mos jenë të pëlqyeshme për ta?</li> <li>• Si duhet të ruhem nga përdorimi i ushqimeve të njëanshme që mund të rrezikojnë dhëmbët, stomakun dhe organe të tjera të trupit tonë?</li> <li>• A ka edhe lodra të rrezikshme? Shpesh përbërja e disa lodrave, sidomos e atyre plastike, sjell dëme për shëndetin e fëmijëve.</li> </ul> <p>Mësuesja mund të përdorë fletë pune të ndryshme për të ngulitur te fëmijët konceptin e sigurisë ushqimore duke kërkuar klasifikimin nga ana e tyre të ushqimeve të dobishme dhe problematike.</p>	<p>Karamete, çokollata, sheqer, kripë, patatina etj.</p> <p>Karota, fruta të stinës, qumësht dhe produkte të tjera bulmetore etj.</p>
<p><b>Arte</b></p>	<p>Fëmijët përdorin fushën e arteve në projektin e dyqanit që nga fillimi i tij. Atyre u duhet të konceptojnë dhe planifikojnë mjediset e ndryshme të dyqanit, pajisjet dhe sfondin, reklamën që duhet të bëjnë për hapjen e dyqanit e të tjera si këto.</p>	

Fushat	Udhëzime	Materialet
<p><b>Aftësitë</b> Hartimi i një reklame për një produkt, Prodhimi i etiketave, Prerje dhe ngjitje, Ngjyrosje</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Më pas, mësuesja i fokuson fëmijët në bërjen e etiketave, duke i lejuar të përdorin figura dhe lapsa me ngjyrë, si dhe në vënien e çmimeve që është një gjë mjaft tërheqëse për 4-5 vjeçarët.</li> <li>• Në çdo tryezë pune vendosni një tabak të madh letre të bardhë ose me ngjyra duke u ofruar fëmijëve figura, karta, lapsa me ngjyrë etj. për të bërë reklamën e dyqanit të tyre. Ju mund të përdorni konkurrimin për tabelën e reklamës më të goditur, por, për të shmangur ndjenjën e konkurrencës prej së cilës jo të gjithë fëmijët do të ndihen të kënaqur, mund të ndani tematikën e dyqanit dhe mjetet e materialet që ofroni në disa sektorë: ushqime, lodra, veshje, artikuj shkollorë etj. Gjatë punës së tyre për bërjen e reklamës, fëmijët mund të kërkojnë materiale shtesë, si p.sh. revista për prerje figurash, karta etj. Ata mund të aplikojnë vizatimet e thjeshta, figurat e prera, ngjitjen e tyre dhe kolazhe të tjera sipas dëshirës.</li> <li>• Një tjetër strategji mund të jenë fletët e punës: ngjyrosja dhe plotësimi i tyre me vizatime.</li> <li>• Edhe vizatimet e tyre të lira rreth projektit të dyqanit janë një veprimtari domethënëse. Duke mbledhur më të mirat, të cilat përzgjidhen nga vetë fëmijët, ju mund të krijoni librin e projektit të dyqanit të cilin e vendosni në hyrje të maketit të tij.</li> </ul>	

# Shkruani nga 7 tek 9



# Fletore vlerësimi

Parashkollorët 4-5 vjeçarë



**Një botë  
për t'u zbuluar**



**Save the Children**  
në Shqipëri





## Të dashur mësues dhe prindër,

Fletorja që po merrni në duar është pjesë përbërëse e materialit të udhëzuesit për mësuesit e klasave të arsimit parashkollor.

Ky është një material ndihmës për vlerësimin e procesit mësimor edukativ të fëmijëve 4-5 vjeçarë. Ajo është rezultat i punës së mjaft ekspertëve dhe mësuesve që dëshirojnë ndryshimin në mësimdhënie dhe nxënie, ecurinë më të mirë të fëmijëve dhe grupit me të cilin ndërveprojnë, nxitjen për zhvillime dhe përmirësime të punës me fëmijët parashkollorë të grupmoshës 4-5 vjeç.

Fletorja e vlerësimit duhet të shërbejë jo aq për evidentimin, nga ana e mësuesve dhe prindërve, të cilësisë së të nxënit në fusha të ndryshme të fëmijët parashkollorë, sesa për gjetjen e strategjive dhe teknikave të reja që çojnë në përmirësimin e gjendjes aktuale të grupeve të fëmijëve dhe fëmijëve si individë.

Grupi i autorëve dëshiron që, gjatë përvojës që do të keni gjatë vitit shkollor, të mbani shënime dhe të jepni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja konkrete për gjithçka që mendoni se mund të përmirësohet në këtë botim. Duke ju falënderuar paraprakisht, ju urojmë punë të mbarë dhe zhvillime të mëtejshme cilësore në arsimin parashkollor në vendin tonë.

**Autorët**



## FLETORE VLERËSIMI

1. Fusha sociale dhe emocionale .....	249
2. Fusha gjuhësore-komunikuese .....	254
3. Fusha e matematikës .....	270
4. Fusha e shkencës dhe e vëzhgimit .....	274
5. Fusha e edukimit fizik dhe shëndeti .....	278
6. Artet .....	284





## ZHVILLIMI SOCIAL DHE EMOCIONAL

Nr.	Kontrolloni nëse fëmija:	PO	Akoma JO
1	Përdor fjalët e nevojshme për zgjidhjen e situatave në të cilat fëmija provon emocione të ndryshme		
2	Përdor fjalët: të lutem, më fal dhe faleminderit		
3	I shërben vetvetes: vishet vetë, mbledh lodrat dhe gjërat që i përkasin, kujdeset në tualet për nevojat e veta		
4	Respekton radhën dhe ndan gjërat e veta me të tjerët		
5	Ndërvepron në mënyrë të përshtatshme me bashkëmohatarët e vet dhe me të rriturit		
6	Kërkon ndihmë kur është e nevojshme		
7	Ka vëmendjen e duhur ndaj një aktiviteti deri në përfundimin e tij: mbaron vizatimin, "lexon" librin etj.		
8	Ndjek të rriturit kur i japin udhëzime		
9	Është korrekt ndaj rregullave dhe kufizimeve që i vendosen gjatë lojës, rutinës ditore etj.		
10	Respekton të drejtat dhe ndjenjat e të tjerëve		


Fëmijët duhet të jenë shoqërisht të përgatitur për jetën në komunitet. Prindërit mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre duke u dhënë mundësi të jenë pjesë e një grupi shoqëror si në sheshin e lojërave, ashtu edhe në kopsht. Fëmijët duhet të mësojnë të respektojnë radhën, të bëjnë kompromise, t'u binden autoriteteve në familje e në kopsht dhe të jenë të sjellshëm me të tjerët.

### Për mësuesit dhe prindërit


- Kujtoni që disiplinimi i fëmijës suaj nënkupton që t'i mësoni atij se si të silltet më shumë sesa të dënoni sjelljen e papërshtatshme;
- Kujtojini fëmijës suaj në çdo moment që e doni atë dhe që është sjellja e keqe ajo që nuk ju pëlqen;
- Përpiquni të keni pritshmëri realiste nga fëmija. Kuptoni kufizimet e tij;

- Bëjini të ditur fëmijës suaj se çfarë prisni prej tij;
- Tregohuni pozitiv me fëmijën duke përdorur falënderimet dhe inkurajimin;
- Jepini fëmijës buzëqeshje dhe dashuri duke shpenzuar kohë së bashku;
- Ndihmojeni fëmijën të gjejë fjalë për të përshkruar ndjenjat e veta;
- Bëjini të ditur fëmijës se çfarë duhet të bëjë dhe çfarë nuk duhet të bëjë;
- Jepini mundësi fëmijëve të jenë me fëmijë të tjerë në sheshin e lojërave, në librari, në ekskursion dhe në teatër;
- Tregojini fëmijës se si të zgjidhë situatat kur nuk është dakord me të tjerët;
- Jepini shembullin e përdorimit të fjalëve të lutem, faleminderit, më fal;
- Jepini fëmijës suaj përgjegjësi të vogla në shtëpi dhe në kopsht: derdhjen e plehrave, mbledhjen e lodrave, kujdesin për kafshët shtëpiake. Tregojini fëmijës respektin tuaj për përgjegjshmërinë e tij.

## GJEJ RRUGËN PËR NË KOPSHT!



## DITA E NËNËS



Ngjyroseni dhe dhurojani nënës për ditën e saj këtë vizatim.

**MBITAPET**

Çfarë provoni kur bëni kollotumba?  
Ngjyrosni dhe tregoni emocionet tuaja gjatë lojës.

## GJUHA DHE KOMUNIKIMI

Nr.	Kontrolloni nëse fëmija:	PO	Akoma JO
1.	Flet me fjali të shkurtra		
2.	Kupton dhe ndjek udhëzimet tuaja lidhur me një drejtim të caktuar		
3.	Përdor fjali të thjeshta dhe të shkurtra gjatë bisedës		
4.	Reciton ose këndon vargje dhe këngë për parashkollorët		
5.	Përdor fjali që përfshijnë dy ide të ndara		
6.	Imiton, krijon dhe interpreton një histori të thjeshtë		
7.	Flet për përvojat e jetës së përditshme		
8.	Bën pyetje lidhur me si funksionojnë gjërat në shtëpi dhe kopsht		
9.	I shpreh idetë në mënyrë të tillë që të tjerët ta kuptojnë		
10.	Ritregon histori të ndryshme		
11.	Sheh librat dhe figurat e tyre dhe bën sikur lexon librat duke interpretuar figurat		
12.	Përpiqet të lexojë në çdo situatë ditore: sinjalet e rrugës, etiketat, revistat)		
13.	Përpiqet të tregojë historitë e dëgjuara në klasë		
14.	Përpiqet të lexojë me ju pjesë që i pëlqejnë duke i përsëritur me dhjetëra herë		
15.	Ju sheh teksa lexoni		
16.	Përpiqet të shkruajë vija, rrahë ose të vizatojë		
17.	Ka koleksion të letrave, ngjyrave dhe lapsave. Përdor shkumësin dhe shkronjat magnetike		
18.	Përpiqet të shkruajë shkronja dhe numra. Përpiqet të shkruajë emrin e vet		

Zhvillimi i aftësive gjuhësore – të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit – është çelësi i suksesit për fëmijët, jo vetëm në vitet e para të kopshtit por edhe gjatë gjithë jetës së tyre. Ky zhvillim është i lidhur me gjithçka që fëmijët mësojnë ose bëjnë në kopsht. Prindërit mund të mbështesin zhvillimin e aftësive gjuhësore duke biseduar dhe dëgjuar me kujdes fëmijët të cilëve u pëlqen të ndajnë me ta idetë dhe përvojat e tyre.

Leximi i librave me fëmijët është një përvojë e gëzueshme dhe interesante. Një gjë e tillë duhet të bëhet pjesë e rutinës ditore të kopshtit dhe të familjes. Të lexuarit së bashku është mënyra më domethënëse nëpërmjet të cilës prindërit mund t'i ndihmojnë fëmijët të mësojnë të lexojnë.


Në mënyrë që të bëhen shkruar të aftë e jetëgjatë, është e nevojshme që fëmijët të inkurajohen dhe të mbështeten menjëherë, sapo fillojnë procesin e të shkruarit. Ata luajnë duke lexuar dhe shkruar. Kërkojuni fëmijëve t'ju thonë se çfarë janë duke lexuar dhe shkruar. Fëmijët ndjekin faza të ndryshme të zhvillimit të shkrimit. Këto faza përfshijnë shkarravinat, vizatimin dhe të bërit sikur shkruajnë. Këtu po japim disa këshilla për prindërit dhe mësuesit.

#### **Për mësuesit dhe prindërit:**

- Bisedoni me fëmijët rreth interesave që ata kanë;
- Përdorni pyetje që kërkojnë më shumë se një përgjigje;
- Luani me vargje dhe lojëra të rimuara;
- Dëgjojini sa më shumë fëmijët kur flasin;
- Shihini në sy dhe tregoni interes kur ata flasin;
- Inkurajoni anëtarët e tjerë të familjes apo stafit që t'i dëgjojnë fëmijët;
- Inkurajoni fëmijët të zhvillojnë dhe të bashkëndajnë idetë e tyre duke bërë pyetje dhe duke ofruar sugjerime;
- Jepini fëmijës një larmi librash, përfshirë vargjet e rimuara dhe përrallat;
- Bëjeni leximin pjesë të rutinës ditore;
- Lejojeni fëmijën të përzgjedhë histori që i pëlqen t'i dëgjojë;
- Jepini fëmijës materiale si lapsa, bojëra dhe letër si dhe një hapësirë të përshtatshme për të shkruar;
- Inkurajojeni fëmijën tuaj të lexojë shkrimet e tij së bashku me ju;
- Jepini fëmijës shkronja magnetike për të praktikuar formimin e fjalëve që ai dëshiron të njohë.



**“Ndhimoheni breshkën të fitojë garën”  
Kujdes mos zgjohet lepuri nga gjumi!**



Krijoni një tregim për lepurin dhe breshkën.  
Kush e bëri më të bukur?

## Të njohim shkronjat rreth e qark nesh!

Mes shkronjave të gjithë jetojmë  
 Në kopsht, në rrugë dhe në shtëpi  
 I shohim ato ne çdo ditë  
 Me dashuri dhe kënaqësi







Me A fillon një akullore  
 Me B fillon një burrë prej bore  
 Me K fillon fjala kali  
 Me M fillon fjala mali





Me I mbaron fjala mami  
 L qëndron në mes të fjalës djali  
 T është në traktor  
 N është te punëtor






Të gjitha shkronjat luajnë tok  
 Si fëmijë çamarrokë  
 Kërcejnë edhe këndojnë  
 Dhe gjërat rrotull emërtojnë





Një e quajnë Lule  
 Tjetrën Era  
 Njërën stinë dimër  
 dhe tjetrën pranvera







Këtu shkronjat kemi  
 A mund të formojmë  
 Që të gjithë bashkë  
 Fjalët që dëshirojmë?





























































## MATEMATIKË


Nr.	Kontrolloni nëse fëmija:	PO	Akoma JO
1	Njeh format (katror, trekëndësh, rreth)		
2	Klasifikon sendet sipas ngjyrës, formës dhe masës		
3	Vendos në grup gjërat që janë njëloj		
4	Rendit objektet ose lodrat sipas rregullit të masës: nga i madhi te i vogli ose nga i vogli te i madhi		
5	Përdor fjalë si: "më i madh" dhe "më i vogël" që të bëjë krahasimin		
6	Krahason masën e grupeve të lodrave ose të sendeve		
7	Numëron në mënyrë korrekte objekte nga 4 deri në 10		
8	Shfaq një të kuptuar të drejtë të kohës së shkuar		

Zhvillimi i koncepteve të numrit si klasifikimi, renditja e numërimit lidhen drejtpërdrejt me aftësinë e fëmijës për të realizuar detyrat e matematikës në vitet e para të kopshtit dhe gjatë gjithë pjesës tjetër të jetës. Është e rëndësishme t'i ndihmojmë fëmijët 4-5 vjeç të ndihen të sigurt në zgjidhjen e detyrave me numrat.

### Për mësuesit dhe prindërit

- Kur uleni në tavolinë bëjini fëmijës këto pyetje: Sa pirunë na nevojiten? Sa karrige na duhen?
- Jepuni mundësi fëmijëve t'ju ndihmojnë kur bëni pazarin;
- Jepuni mundësi atyre të krahasojnë objektet;
- Jepuni ushqime, objekte ose lodra që ata të mund t'i numërojnë.

## NUMRAT















Ngjyrosni dhe provoni duke numëruar:

A i njihni numrat deri në 10?











## SA BËJNË?

 $+$  $=$ 
 $+$  $=$ 
 $+$  $=$ 
 $+$  $=$ 
<span style="font-size: 2em; color: red; margin-right: 40px;">1</span> <span style="font-size: 2em; color: red; margin-right: 40px;">2</span> <span style="font-size: 2em; color: red; margin-right: 40px;">3</span> <span style="font-size: 2em; color: red; margin-right: 40px;">4</span> <span style="font-size: 2em; color: red;">5</span>

Pritni dhe vendosni numrat përkatës në secilin rresht.

## Sa kafshë janë në kopshtin zoologjik?

        2      3	        2      3
        2      3	        2      3
        2      3	        2      3
        2      3	        2      3

Numëroni kafshët në secilën kuti dhe rrethoni numrin e duhur.

## SHKENCË

Nr.	Kontrolloni nëse fëmija:	PO	Akoma JO
1	Njeh dhe emërton pjesët e ndryshme të trupit dhe shqisat		
2	Njeh dhe emërton disa lloje materialesh si letër, qelq, plastikë, metal, dru		
3	Dallon mjetet e transportit dhe përcakton se në cilat hapësira udhëtojnë ato		
4	Dallon stinët e vitit dhe përshkruan veçoritë e tyre		
5	Demonstron njohje të natyrës dhe elementeve të saj. Tregon duke emërtuar peizazhet e ndryshme si mali, deti, lumi, fusha, liqeni, pylli		
6	Bën një listë të kafshëve, zogjve dhe peshqve; i gjen ata në foto ose i përshkruan thjesht		
7	Ndërvepron në mënyrë pozitive me mjedisin: kujdeset për pastërtinë e tij		
8	Shfaq një të kuptuar të drejtë të fenomeneve të thjeshta natyrore		



Edukimi shkencor dhe mjedisor është mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e fëmijës. Konceptet e natyrës, të botës së kafshëve dhe bimëve dhe të mjeteve të transportit do t'i shoqërojnë fëmijët jo vetëm në vitet e para të kopshtit, por edhe gjatë gjithë jetës. Vëzhgimi dhe kërkimi janë aftësi që fëmijët do të mund t'i përdorin gjatë gjithë procesit të njohjes.

### Për mësuesit dhe prindërit

- Ndihmoheni fëmijën të vëzhgojë dhe të zhvillojë shpirtin kërkues duke i dhënë mundësi të marrë pjesë në ekskursione, vizita në kopshtet zoologjikë dhe botanikë, shëtitje në natyrë;
- Jepini mundësi fëmijës të kujdeset për kafshë apo lule në shtëpi; përveç ndjenjës së përgjegjësise, ai do të zhvillojë edhe respektin për mjedisin;
- Jepini mundësi të fitojë përvojën e ndërtimit nëpërmjet lodrave me konstruktion, gjithnjë duke pasur kujdes për sigurinë e tij;
- Jepni shembullin e ruajtjes së mjedisit duke hedhur mbeturinat në vendin e duhur.


**BIMËT**

Pritni dhe ngjisni brenda në kuti vetëm bimët:



## KAFSHËT

Prisni dhe ngjisni brenda në kuti vetëm kafshët:



## TRANSPORTI

Në TOKË	Në DET	Në AJËR



Prite dhe vendose në kolonën e duhur mjetin e transportit.

## EDUKIMI FIZIK DHE SHËNDETI

Nr.	Kontrolloni nëse fëmija:	PO	Akoma JO
1	Vendos copëzat e të gjithës si duhet		
2	Përpiqet të presë me gërshërë		
3	Mbërthen kopsat dhe lidh këpucët e tij		
4	I gëzohet lojës duke vrapuar, duke u hedhur dhe duke u ngjitur		
5	Mban në dorë lapsin, penelin ose ngjyrat		
6	Hedh dhe pret topin		
7	Ka një regjim për kohën e gjumit, higjienën personale (larjen e dhëmbëve dhe dushin) dhe vaktet e ushqimit		
8	Përdor shprehitë e mira (përdor pirunin, mban gojën mbyllur kur ha, mbulon gojën dhe hundën kur kollitet, lan duart para dhe pas ngrënies)		
9	Ndjek rregullat e thjeshta të sigurisë		
10	Ha ushqime të shëndetshme		

Fëmijëve u nevojiten aftësi fizike për të qenë të suksesshëm në kopsht dhe më tej në shkollë. Atyre duhet t'u krijohen mundësi të përditshme për të përdorur muskujt e vegjël dhe të mëdhenj.

Fëmijët kanë nevojat e tyre bazë lidhur me kujdesin shëndetësor dhe ushqimin. Për t'i përmbushur ato, atyre u duhet të fitojnë aftësi të mira për sigurinë dhe kujdesin për veten.

### Për mësuesit dhe prindërit

- Merreni fëmijën në park që të luajë me mjete sportive;
- Lërnin fëmijës kohë që të vishet vetë;
- Jepini mundësi fëmijës që të presë me gërshërë figura nga revistat dhe fletët e punës;
- Jepini mundësi fëmijës të përdorë lapsin, ngjyrat dhe penelin;

- Jepini mundësi fëmijës të eksperimentojë me baltë, të ngasë biçikletën dhe të kapërcejë pengesa të vogla;
- Sigurohuni që fëmijët tuaj të bëjnë kontrole të rregullta mjekësore;
- Kujtojeni fëmijëve larjen e rregullt të dhëmbëve;
- Punoni me fëmijën tuaj që të krijojë dhe të zbatojë rutina të caktuara si kohën e pushimit dhe të gjumit;
- Mësojini fëmijës të notojë ose kujdesuni që ai të marrë ca mësimet e notimit;
- Inkurajoni dhe jepni shembullin tuaj lidhur me përdorimin e ushqimit të shëndetshëm dhe kufizoni ushqimet e konservuara;
- Mësojini fëmijës rregullat e sigurisë: kundër zjarrit, trafikut etj.;
- Paralajmërojeni fëmijën për rreziqet nga të panjohurit dhe ilaçet.






molla ime \_\_\_\_\_

## USHQIMET



Cilat nga frutat dhe perimet janë më të shëndetshme? Rrethoju dhe më pas ngjyrosi njëlloj si gjenden në natyrë.

## RREGULLAT E SIGURISË NË RRUGË



Plotësoni figurën me shqisat që keni mësuar.

Më pas ngjyroseni.



## ARTET



Nr.	Kontrolloni nëse fëmija:	PO	Akoma JO
1	Njeh dhe emërton ngjyrat kryesore (e bardhë, e zezë, e kuqe, blu, e gjelbër, e verdhë)		
2	Përcakton masat dhe ngjyrat që kanë sendet dhe objektet e ndryshme rreth e rrotull tij		
3	Merr pjesë me kënaqësi në aktivitetet e artit dhe të muzikës		
4	Vizaton veten duke bërë kokën, trupin, krahët dhe këmbët		
5	Vizaton peizazhe natyrorë duke përdorur ngjyrat reale të objekteve		
6	Manipulon baltën për të bërë modele të ndryshme		
7	Ka qejf të shoqërojë ritmin e muzikës me përplasje duarsh		
8	Demonstron kuriozitet e kënaqësi kur sheh libra dhe revista me piktura, kur ndjek koncerte muzikore etj.		

Këtu po ju japim disa sugjerime mbi llojet e ndihmës që mund t'i jepni fëmijës jo vetëm për të zhvilluar të kuptuarit për artet, por edhe për të mësuar se si ndërveprohet dhe punohet me materialet, njerëzit, ngjarjet dhe idetë.

### Për mësuesit dhe prindërit

- Jepuni fëmijëve lodra të përshtatshme që nxisin të menduarit e tyre. Këtu përfshihen tabelat e formimit, blloqet ose veglat muzikore;
- Përdorni kuti, shishe dhe sende të tjera shtëpiake për t'i nxitur fëmijët në përvojat krijuese;
- Luani me fëmijët duke përdorur këngë dhe valle për t'i zhvilluar atyre ritmin muzikor;
- Jepuni mundësi fëmijëve të manipulojnë baltën, ngjyrat, letrën dhe materiale të tjera.


## NDIQNI PIKAT




Ndiqni me laps secilën rrugë dhe më pas ngjyrosni figurat.

A e dini se cilat janë ngjyrat e duhura?

Ngjyrosni, pritni dhe ngjisni ashtu si duhet figurat e mëposhtme:







Bëjeni figurën e dytë në secilin rresht të duket njësoj si e para.



## RRETHI DHE TREKËNDËSHI




Ndiqni  dhe ngjyroseni me të verdhë.


Ndiqni  dhe ngjyroseni me të kuqe.





Numëroni sa rrrathë dhe sa trekëndësha janë në figurë.

## NGJYRAT











Emërtoni ngjyrat, prisni me gërshërë katrorët dhe më pas vendosini dy e nga dy katrorët me ngjyra të njëjta.



Ngjyrosni dhe prisni, më pas bashkoni pjesët sipas modelit të dhënë.





**Tolerancë** **Bashkëpunim** **Pranueshmëri**  
**Solidaritet** **Ndihmë** **Respekt për të tjerët**  
**Zgjidhje e konflikteve** **Drejtësi** **Miqësi** **Humanizëm**

Ky botim vjen në kuadër të projektit “Zhvillimi i Fëmijërisë së Hershme” të organizatës Save the Children në Shqipëri i cili zbatohet në marrëveshje dhe bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Botimi mbështet konsolidimin e kurrikulës së arsimit parashkollor. Ai është ndërtuar duke u bazuar në standardet e arritjes për fëmijët 4-5 vjeçarë të hartuara dhe miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë.

Këtë botim e gjeni në adresën: [www.scalbania.org](http://www.scalbania.org)